



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

NË

DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”

Tetor 2023

Nr	Përmbajtja	Faqe
-----------	-------------------	-------------

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
	a. Përshkrim i shkurtës i Projektit të Auditimit	3
	b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
	c. Opinioni i Auditimit	6
II.	HYRJA	9
	1. Objekti i auditimit	9
	2. Qëllimi i auditimit	9
	3. Identifikimi i çështjes	9
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
	5. Përgjegjësitë e audituesve	10
	6. Kriteret e vlerësimit	10
	7. Standardet e auditimit	10
	8. Metoda e auditimit	11
	9. Dokumentimi i auditimit	11
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	12
2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.	12
2.2	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.	30
2.3	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.	53
2.4	Mbi deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH.	73
2.5	Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.	81
2.6	Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operationale.	90
2.7	Auditim i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare.	124
2.8	Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion.	170
2.9	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime.	190
2.10	Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm	201
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	218
V	ANEKSE	236

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 284/1 prot., datë 03.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.04.2023 deri në datë 14.07.2023, në Institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), u krye në terren auditimi i “Përputhshmërisë”.

Auditimi përfshin periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm, përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT, të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, si Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë së Kontrollit Tatimor; Drejtorisë së Hetimit Tatimor; Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH; Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, hartimin e pasqyrave financiare, marrëdhëniet e punës dhe pagat, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur akt verifikim dhe akt konstatime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit brenda afatit të periudhës së auditimit në terren.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe Projektraportin e Auditimit dhe janë marrë në konsideratë observacione të cilat janë gjetur të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion argumentues shtesë. Problematikat e evidentuara sipas çështjeve të auditimit gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e Auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar.

I.b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

G J E T J E S	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFE REN CA	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
1.	Për vitin 2022 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për 18,500,000 mijë lekë, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën 22,469,292 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim në shumën 3,969,292 mijë lekë, ose 21.46% më shumë kundrejt planit të rimbursimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 14; Ligjin Nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", i ndryshuar dhe shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.3568 Prot., datë 23.02.2022 “Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022”, protokolluar në DPT me Nr.3185 Prot., datë 25.02.2022.	Pika 2.5	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për planifikim real të vlerës së rimbursimeve të TVSH-së, si dhe të marrë masat e nevojshme për monitorimin e këtij procesi, me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve.
2.	Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, nëpërmjet emailit të datës 07.02.2023, ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit në shumën 0 lekë në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2022, në zbatim të Udhëzimit Nr.8, të MFE “Për përgatitjen e pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendrore”. Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, rezultojnë 32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për 1,843,722 mijë lekë, të cilat megjithëse ka kaluar afati	Pika 2.5	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së, nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore, dhe raportimin e saktë në

	maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit në DPT më 31.12.2021 sipas vlerësimit të grupit të auditimit është më së paku në vlerën 1,843,722 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1, dhe VKM Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4.			MFE lidhur me këtë çështje.
3.	Procesi fillestar i detajimit të planit të të ardhurave tatimore për drejtoritë rajonale tatimore përkatëse nga ana e DPT konstatohet se ka zgjatur për një periudhë 3-mujore nga fillimi i vitit buxhetor dhe 2-mujore nga data e dërgimit të planit të të ardhurave tatimore në përgjegjësi të DPT nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, megjithëse gjatë kësaj periudhe është miratuar Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, i cili ka ndryshuar një pjesë të të ardhurave tatimore. Efektet e këtij plani të ndryshuar të të ardhurave tatimore nuk janë reflektuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kohë. Mos reflektimi në kohë i efektit të të ardhurave të ndryshuara sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, në planin e drejtorive rajonale tatimore është kushtëzuar edhe nga dërgimi me vonesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë i të ardhurave tatimore në përgjegjësi mbledhjeje të administratës tatimore sipas shkresës nr. 7088 prot. DPT datë 26.04.2022.	Pika 2.2	E lartë	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të miratohen rregullore/udhëzues në lidhje me afatet dhe procedurat e detajuara për detajimin e planit të dërguar nga MFE drejt Drejtorive Rajonale Tatimore në mënyrë që të ndërmerren veprimet operacionale në kohë për mbledhjen e tyre.
4.	Nga auditimi konstatohet se të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në shumën 183,9 miliard lekë dhe diferenca me raportimin e DPT qëndron në faktin se janë përfshirë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në të ardhura tatimore. Efekti i këtyre të ardhurave të rëkthshme me normë të reduktuar tatimore nga rivlerësimi sipas akt rëkthimeve të degëve të thesarit në rrethe me DRT dhe drejtoritë vendore të ASHK si dhe përmbledhëses së vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar raportohet në shumën 5,611,952,623.5 lekë ose rreth 2% e të ardhurave. Në krahasim me planin përfundimtar prej 193 miliard lekë, efekti i mos realizimit paraqitet në shumën 9 miliard lekë, megjithëse në raport me një vit më parë të ardhurat janë realizuar 15.2 miliard lekë më tepër.	Pika 2.2	E lartë	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet riklasifikimi përkundrejt planit i të ardhurave dytësore në raportin e performancës, me qëllim ruajtjen e trendit historik të raportimeve, si dhe nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore të drejtojnë burimet e kontrollit në sektorët që janë objekt i taksave kombëtare të konstatuara me mosrealizim për shkak të rënies së konsiderueshme të të dhënave për sasishtë e indeksuara me taksat kombëtare.
5.	Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) rezultoi se gjatë vitit 2022 nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore. Sipas komunikimit me subjektin arsyeja që nuk është arritur kryerja e inspektimeve në DRT është se nuk ka pasur staf të mjaftueshëm. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtitimit të detyrimeve tatimore të papaguara.	Pika 2.3	E lartë	Nga titullari i DPT të analizohet situata e kësaj Drejtorie duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të merren masa për plotësimin e vendeve vakantë të drejtorisë DMDTP sipas strukturës së miratuar Urdhrit e Kryeministrit Nr. 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, së bashku me hartimin e miratimin e programeve të inspektimit në mënyrë që DMDTP të realizojë inspektime në të gjithë rajonet.
6.	Gjendja e detyrimeve tatimore gjithsej të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën rreth 134,934 milion lekë, që i përket një numri prej 192,701 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej rreth 182,379 subjektsh debitorë. Pra rezultojnë një rritje prej rreth 11.8 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me një ulje prej 10,322 debitorëve në fund të vitit. Subjektet me status Aktiv janë në numër 64,543 subjekte ose 37 % e total numrit të subjekteve debitorë, me vlerë detyrimi të papaguar afërsisht 40.7 miliard lekë ose 28 % e total detyrimit të papaguar. Subjektet me status Pasiv janë numër 110,948 subjekte ose 63 % mbi numrin gjithsej të subjekteve debitor, me vlerë detyrimi të papaguar 105.9 miliard lekë ose 72 % mbi total detyrimin e papaguar. Krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë një rritje e subjekteve pasive në numër janë rritur afërsisht me 6 % dhe në vlerë janë rritur	Pika 2.3	E lartë	DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masa të menjëhershme për uljen e borxhit tatimor si dhe të luajnë një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit dhe marrjen e masave konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuara për uljen e borxhit tatimor si edhe duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të

	afërsisht 7 % e masës së detyrimit total të papaguar. Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2022 rezulton se peshën më të madhe të stokut të detyrimit e zënë detyrimet me moshë borxhi nga 2-5 vite me peshë 28 % të total detyrimit të papaguar dhe detyrimet me moshë borxhi mbi 5 vite zënë rreth 49% të total detyrimit të papaguar. Krahasuar me vitin paraardhës rezulton se borxhi me moshë 1-2 vjet është rritur me afërsisht 5 miliard lekë ose 4 % më shumë mbi totalin e detyrimit dhe borxhi më moshë mbi 5 vite me 18 miliard lekë ose 10 % më shumë mbi totalin e detyrimit, fashat e tjera të moshës së borxhit kanë një rritje me të vogël.			mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.
7.	Në vitin 2022 ka pasur ndryshim të prioriteteve dhe i vlerës në financimin e projekteve të investimit të kërkesë të AKSHI-t shkresa nr.1935 prot., datë 04.04.2022 për dy projekte, projekti me kod 18AV812 “Hapësira harduer për kapacitetin e serverave” është shtuar me 302,990 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA 2022-2024 dhe në ligjin e buxhetit 2022 që ishte planifikuar në vlerën 80,000 mijë lekë, pothuajse 5-fish më shumë. Listës së projekteve i është shtuar një projekt i ri investimi me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” në vlerën 24,000 mijë lekë, nuk është planifikuar në programin afatmesëm buxhetor për vitin 2022 si edhe në buxhetin e vitit 2022. Për realizimin e këtyre projekteve janë shtuar fondet me Aktit Normativ Nr.17, datë 01.12.2022 dhe me Aktit Normativ Nr.12, datë 29.07.2022 dhe janë pakësuar në masën 100 % fondet e planifikuara në PBA dhe në buxhetin e vitit 2022 për projektet; “Automatizim dhe monitorim aktiviteti për inspektorët për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” (22,000 mijë lekë), “Marrje informacioni për inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administratës tatimore” (22,000 mijë lekë).Si edhe pakësim pjesor në vlerën 76,991 mijë lekë për projektet ; “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT”, “Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan”, “Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020”, “Blerje pajisje zyre elektronike, kompjuterike” edhe projekti “Pajisje zyre”.	Pika 2.7	E lartë	Nga ana e DPT të mos pranohen projektet e rishikuara në vlerë nga AKSHI si pasojë e studimit të tregut përtej fondeve buxhetore të miratuara për projektet respektive. Në të njëjtën kohë DPT të mos paraqesë projekte në fushën e teknologjisë së informacionit në kushtet emergjence, por të përmirësojë procedurën e planifikimit buxhetor afatmesëm nëpërmjet strukturave të GMS në bashkëpunim me përfaqësuesin e AKSHI.
8.	Për 27 urdhër-shpenzimi nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës janë kryer likuidimet në tejkallim të afatit kohor 30 ditorë nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve “. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184. Nga auditimi u konstatuan angazhime të reja buxhetore jashtë afatit 15 tetor të vitit buxhetor.	Pika 2.7	E lartë	Titullari i DPT të marrë masa për përcaktimin e një rregulloreje të brendshme për disiplinimin e procesit të ekzekutimit të fondeve buxhetore në kohë dhe për konstatimet e faturave në fushën e teknologjisë së informacionit të reflektojë problematikën në marrëveshjet dhe procedurat në bashkëpunim me AKSHI.
9.	Për vitin 2022 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 346 kontrolle nga 2579 kontrolle të planifikuara ose rreth 13% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale. Konstatohet se për vitin 2022 DPT ka nxjerr vetëm planin operacional për turizimin, ndërkohë që duke ju referuar renditjes të aktiviteteve të cilët sipas rregullave të thyera të riskut të gjeneruar nga DMR zenë peshën më të madhe në %, mungojnë plane operationale të tjera për këto veprimtari për gjatë vitit 2022, për disa nga aktivitetet me më shumë rregulla të riskut të thyera.	Pika 2.6	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa që në aktivitetet e planifikimit për kontroll të reflektohet stoku i kontrolleve të mbartura nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me DRT të shkëmbejë në kohë informacion për problematikën e kontrolleve tatimore. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuara me VKM me qëllim arrijtjen e objektivave të institucionit. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të hartojë strategji dhe plane operationale të dedikuara për secilin nga sektorët të evidentuar me risk të lartë si pasojë e rregullave të thyera të evidentuara nga moduli i menaxhimit të riskut.
10	Nga auditimi konstatohet se realizimi i kontrolleve të planifikuara për vitin 2022 është në masën 57.5 %, me një mosrealizim të planit të kontrolleve për vitin 2022 në masën 42.5 %. Ndikimin më të madh në	Pika 2.6	E lartë	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të implementohen procedura rakordimi me DRT me

	<p>mosrealizimin e planit të kontrolleve e kanë DRT Tiranë me 29.1 % kontrolle të realizuara, DRT Kukës me 31 % kontrolle të realizuara, DRT Sarandë me 57.6 % kontrolle të realizuara, DRT Fier me 57.7 % kontrolle të realizuara, DRT Elbasan me 60 % kontrolle të realizuara dhe DRT Korçë me 60.3% kontrolle të realizuara. Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2022 në lidhje me kontrollet e papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, stoku i kontrolleve vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84, ku nga të dhënat e paraqitura, gjendja e kontrolleve të pezulluara, të pafilluara ose në proces në vitin 2022 prej 1140 kontrolle është rritur në krahasim me vitin 2021 prej 671 kontrolle, me një rritje të lartë të numrit të kontrolleve të pafilluara.</p>			<p>qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontrolleve sipas aktivitetit vjetor. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ngrihet grup pune për të analizuar shkaqet e performancës në rënie të zbulimeve nga kontrollet dhe të merren masa me qëllim përmirësimin e treguesve.</p>
11	<p>Nga auditimi i kërkesave të posaçme në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, u konstatua se, për të njëjtin pozicion, kërkesat e arsimit dhe përvojës në punë ishin të ndryshme. Një Inspektor ka si kriter pasjen e diplomës të nivelit “Master Shkencor”, si dhe me përvojë jo më pak se 2 vite në profesion, ndërsa një Inspektor tjetër, ka si kriter pasjen e diplomës “Master Profesional” dhe pa përvojë pune në profesion.</p> <p>Gjithashtu, nga auditimi u konstatua diferencim të kërkesave të posaçme, për arsim dhe përvojë pune, në pozicionin Inspektor, me kategori page të njëjtë, III-b, në DPT. Për pozicionin Inspektor, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kërkohet diplomë “Master Shkencor” në shkenca Ekonomi/Juridik dhe përvojë jo më pak se 2 vite punë në profesion, ndërsa në Sektorin e Koordinimit po në këtë drejtori, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kërkohet diplomë “Bachelor” në shkenca Ekonomi/Juridik dhe pa përvojë pune në profesion.</p> <p>Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, në Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës me strukturë (1+11), u konstatuan, me pozicionin Inspektor i Parë, kategori page III-b, 6 prej tyre kanë si kriter arsimor pasjen e diplomës “Master Shkencor” dhe 5 me diplomë “Master Profesional”. Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 9, pika nr. 5 dhe 6/a,</p>	Pika 2.8	E lartë	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kriterëve të posaçme për pozicionin e inspektorit në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kur detyrat funksionale janë të njëjta, me qëllim rritjen e performancës individuale dhe institucionale në këtë fushë.</p>
12	<p>Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, rezultoi se GMS nuk është mbledhur në asnjë takim gjatë vitit 2022, Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmët e Auditimit, si dhe nuk rezulton arkivimi i tyre. Institucioni nuk disponon Manualin e Proceeseve të Punës.</p> <p>Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet periodike, nuk janë publikuar në faqen e web-it të Institucionit ose të MFE-së, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.</p>	Pika 2.10	E lartë	<p>Titullari i Institucionit të marrë masa për kryerjen e mbledhjeve të GMS me pjesëmarrjen e nivelit drejtues të njësive, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.</p>
13	<p>Gjatë vitit 2022, nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjës të larguar nga puna në mënyrë të padrejtë, në vlerën 77,667,121 lekë. Kjo vlerë cilësohet si efekt negativ për buxhetin e shtetit, pasi për të njëjtin pozicion pune, paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i emëruar rishtaz në administratën tatimore. Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja ndaj përmbaruesve, në vlerën 7,955,809 lekë, nga të cilat janë paguar 7,208,415 lekë, kjo vlerë është kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Në fund të vitit 2022, vlera e detyrimeve të prapambetura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjësit e administratës tatimore është 137,268,674 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.</p>	Pika 2.8	E lartë	<p>Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore.</p>

I.c. Opinioni i auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), në lidhje me shkallën e zbatueshmërisë së ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar; ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën

e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 115/2021 “Për buxheti e vitit 2022”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe rregullatore mbi të cilët ushtron veprimtarinë DPT, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Opinion i modifikuar/kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë¹:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se, në veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinion”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin e mëposhtëm, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të shërbyer si bazë për opinionin tonë (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nënpopullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

- Mangësi nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku gjendja e detyrimeve të papaguara që i përket vitit 2022, është 147,767 milion lekë, si dhe stoku i detyrimeve tatimore gjatë vitit 2022 ka pësuar një rritje neto prej **11.8** miliard lekë krahasuar me një vit më parë;

- Nuk është respektuar plani i rimbursimit të TVSH-së i përcaktuar tabelën nr. 4, të ligjit nr. 115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, i cili është tejkalluar në shumën 4 miliardë lekë. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, rezultojnë **32** kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale prej **1.8 miliard** lekë, në tejkallim të afatit ligjor 60-ditor, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për vlerën **13 miliard lekë**, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor. Mangësi në trajtim të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuar sipas natyrës dhe llojit, pasi janë përfshirë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 “Mjete në ruajtje”, e cila përfaqëson arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemin e tyre, si dhe raportimi i gjobave dhe kamatëvonesave;

- Në realizimin e të ardhurave në raportim janë përfshirë edhe arkëtimet prej **5.6 miliard lekë** për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme me normë të reduktuar tatimore, të cilat paraqiten pa plan të ardhurash, pasi janë realizuar në formën e të ardhurave jo tatimore;

- Mangësi në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, ku rezultojnë parregullsi në plotësimin e vendeve vakante të cilat në fillim të vitit sipas planit paraqiten 135 për nëpunës

¹ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura.

civil dhe 22 për punonjës me Kod pune, në përshkrimet e punës, si dhe mangësi në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës e në administrimin e dosjeve të personelit. DPT ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës të larguar nga puna në vlerën totale **77.7 milion lekë**, vlerë e cila ka efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit;

- Mangësi në zbatimin e buxhetit institucional për shpenzimet operative dhe investimet publike për vitin 2022, që përfshijnë rishikimi i shpeshtë i projekteve të investimeve publike në vlerë, kontraktimi i fondeve buxhetore përtej afateve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, megjithëse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht. Sistemi nuk merr në konsideratë subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të cilat konstatohen në monitorimin periodik të punës së Drejtorive Rajonale Tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor, në përfundimin e kontrolleve dhe arkëtimin e detyrimeve, në mos përfundimin e kontrolleve për disa vite etj.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DPT-së:

Strukturat drejtuese të DPT, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore në përputhje me politikën, ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues dhe personeli i DPT ka përgjegjësi menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin e tij.

Drejtuesit e të gjitha niveleve janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, si dhe për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Drejtimi i DPT është përgjegjës ndër të tjera për aktivitetet e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, rimbursimin në kohë të TVSH-së, ushtrimin e kontrolleve nga drejtoritë përkatëse në DPT për zbatimin e procedurave tatimore nga tatimpaguesit me qëllim maksimizimin e të ardhurave tatimore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH në Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e DPT është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të DPT-së.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet t'i kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 284/1 prot., datë 03.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.04.2023 deri në datë 14.07.2023, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022 u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R G, Përgjegjës Grupi
2. A B, Auditues
3. B H, Audituese
4. E C, Audituese
5. E B, Audituese
6. R Xh, Auditues

Auditimi u krye me bazë risku, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit, duke përfshirë saktësinë e paraqitjes së të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë subjekti i audituar.

1. Objektivat e auditimit: Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë aktivitetin e huamarrjes dhe monitorimin e treguesve të borxhit gjatë procesit të realizimit të aktivitetit të tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor dhe kuadrin mbështetës në fuqi për mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe realizimin e aktivitetit tjetër të institucionit, në përmbushje të misionit që ka struktura e DPT.

2. Qëllimi i auditimit: Qëllimi lidhet me vlerësimin nëse aktivitetet e autorizimit, mbikqyrjes dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti.

3. Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, shpërndarja e tyre në Drejtoritë Rajonale Tatimore, hartimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor për vitin 2022, transaksionet ekonomike, planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike, monitorimi i masave të marra për mbledhjen e detyrimit tatimore, efektiviteti i strukturave të veçanta si, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Hetimit Tatimor, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, etj., si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit si delegimi i kompetencave, zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për punonjësit, plotësimi i vendeve vakante, apo përmirësime ligjore të nevojshme etj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-Drejtori i Përgjithshëm si (*Nëpunësi Autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale.

-Drejtori i Financës (*Nëpunësi Zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, i cili shprehet nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. ISSAI 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave të nevojshme për të siguruar dëshmi e evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionin tonë. Procedurat e kryera janë bazuar në gjykimin profesional të audituesve publikë, duke përfshirë vlerësimin e riskut të mospërputhjeve materiale, qofshin këto për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ne besojmë se provat e mbledhura të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionin tonë.

Audituesit e KLSH janë të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

6. Kriteret e vlerësimit: Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të procedurave tatimore.

- Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareve”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2020 “ Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Akte të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

7. Standardet e auditimit.

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.;
- Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë të miratuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.;

8. Metoda e auditimit përfshijnë auditimin me bazë rrisht dhe përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e rrisht, materialitetit, koston dhe efiçencës së auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe rast pas rasti janë aplikuar verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte, procedura analitike, teste detajesh dhe informacione.

9. Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, manualeve të auditimit: në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka

dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren) dhe ka plotësuar dokumentet standarde të auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, veç atyre që parashikohen në ligje të veçanta, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklaramit dhe, mbi këtë bazë, përcakton detyrimet tatimore shtesë të një tatimpaguesi, si dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara më tepër, nëse ka të tilla.

DPT drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, cili sipas strukturës së miratuar ka në varësi të tij tre Zëvendësdyretorë të Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë etj. Ky ligj, përcakton parimet bazë mbi të cilat mbështetet sistemi tatimor shqiptar dhe administrimi i tij. Sanksionohen të drejtat e tatimpaguesve, që në fakt janë një balancë e plotë përkundrejt detyrimeve të tyre kontributeve, në të hyrat e buxhetit të shtetit.

DPT ka funksionuar me rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të MFE, “Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”, në të cilën trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, etj. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe renditet si një nga institucionet ligj zbatuese më të rëndësishme në vend.

Funksionet kryesore të punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë si më poshtë:

1. Administron detyrimet tatimore në Republikën e Shqipërisë në nivel qendror për llojet e tatimeve dhe taksave të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Përgatit dhe miraton planin strategjik të objektivave dhe synimeve kryesore të administratës tatimore qendrore për një periudhë afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë si edhe monitoron zbatimin e tij.
3. Evidenton nevojat për ndryshime dhe paraqet propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me ndryshimet në ligjet tatimore, në aktet nën-ligjore të nxjerra në zbatim të tyre.
4. Përgatit dhe miraton procedura standarde pune operative, ku sigurohet se këto procedura promovojnë transparencën e duhur në marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesit, krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë tatimpaguesit dhe reduktojnë subjektivitetin e punonjësve tatimorë.
5. Ofron asistencë për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor, akteve nën-ligjore në zbatim të tij dhe manualeve operationale në Drejtorinë Rajonale Tatimore.
6. Përcakton, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, masa uniforme për matjen e performancës së punonjësve të administratës tatimore dhe krijon raporte standarde për të kontrolluar vlerësimin e performancës në nivel kombëtar, si dhe për çdo Drejtori

Rajonale Tatimore. Ndjek zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës për Administratën Tatimore Qendrore.

7. Siguron shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore në çdo Drejtori Rajonale Tatimore.

8. Bashkëpunon me të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, për të përgatitur plane vjetore pune, bazuar në numrin e personelit që është përcaktuar për çdo drejtori dhe në objektivat funksionale të performancës për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.

9. Harton dhe zbaton një program vjetor të vizitave të punës në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, për të ofruar asistencë dhe për të kryer vlerësime.

10. Miraton planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.

11. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Kodit të Etikës për punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me rregullat e etikës së administratës publike.

12. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore për parandalimin e konfliktit të interesit të nëpunësit të Administratës Tatimore qendrore.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të kësaj pike auditimi u kërkuar dokumentacioni administrativ ligjor nga përfaqësuesit e subjektit objekt auditimi në lidhje me rekomandimet e lëna për zbatim, sipas shkresës Nr.20/17 Prot., të Kryetarit të KLSH datë 19.09.2022, me lëndë “*Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për auditimin dhe në lidhje me rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi që: Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në bazë të Programit të Auditimit Nr.20/1 Prot., datë 14.01.2022, ndryshuar me shkresën Nr.20/2 Prot., datë 22.04.2022, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën Nr.121/45 Prot., datë 30.09.2022, “*Plani i masave Për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DPT njoftuar me shkresën Nr.20/17 Prot., datë 19.09.2022, protokolluar me tonën Nr.121/43 Prot., datë 20.09.2022*”, drejtuar KLSH është nisur plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit ligjor, prej 20 ditësh të vendosur nga KLSH**, veprim ky në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*”.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, ka kthyer përgjigje me anë të shkresës Nr.121/51 Prot., datë 14.07.2023 (protokolluar në KLSH me Nr.20/19 Prot., datë 17.07.2023, dokument ky që nuk është vendosur në dispozicion gjatë fazës së punës në terren nga përfaqësuesit e DPT-së), **jashtë afatit 6-mujor nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna**, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*”, **ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”**.

Në lidhje me masat e rekomanduara, gjendja në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

a. Masa Organizative:

Janë rekomanduar 34 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 31 masa, konkretisht nga të cilat 5 janë zbatuar plotësisht, 8 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces, 16 masa janë pa zbatuar dhe 3 masa janë pa pranuar.

b. Masa për Eliminimin e Paligjshmërive në Administrimin e Fondeve Publike dhe Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike.

Është rekomanduar 1 masë për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, ku nga verifikimi rezulton se është pranuar masa dhe është zbatuar pjesërisht.

c. Masa Disiplinore

Është rekomanduar masë disiplinore në kompetencë të Titullarit e cila është pranuar nga ana e subjektit dhe është në proces zbatimi.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së në mënyrë më të detajuar rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe të vijojë marrja e masave nga DPT për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe të pa zbatuara.

Qëndrimi i Subjektit: Nga ana e DPT-së, nuk ka shpjegim në lidhje me këtë rekomandim.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Në emailin e datës 06.07.2023 nga Znj. I K, në lidhje me sqarimet mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, nuk ka shpjegim për këtë rekomandim.

Statusi: I pa zbatuar.

2.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre lloj të të ardhurave, përfshirë dhe çështjet e planifikimit, me qëllim marrjen e masave për arritjen e objektivave të institucionit dhe shmangien e situatave të tilla në të ardhmen.

Qëndrimi i Subjektit: Me Urdhrin Nr.145, datë 14.10.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është ngritur grupi i punës për analizimin e shkaqeve që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave, i cili ka kryer analizën përkatëse.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i situatës edhe për vitin 2022, rezulton se ky rekomandim është i pa zbatuar.

Statusi: I pa zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim saktësimin e vlerës së të ardhurave gjithsej dhe atyre tatimore në mënyrë analitike sipas llojit të tatimeve/taksave të shprehur në raportimet e DPT-së.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria Kontabilitet Statistikë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve konfirmon që të gjitha të ardhurat që arkëtohen për llogari të buxhetit të shtetit janë tërësisht të identifikuar dhe të kontabilizuara në nivel 7 shifror të llogarive sipas përcaktimeve/kërkesave, të Planit Kontabël. Kontabilizimi i të ardhurave pasqyrohet dhe është i konfirmuar dhe nga Raporti Financiar i Sistemit Informatik të Qeverisë, sistem i cili është dhe sistemi i kontabilitetit të Qeverisë Shqiptare. Raportimet statistikore të DPT bëhen në referim dhe zbatim të kërkesave të ligjit për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi në terren i grupit të auditimit, konstatohet se në të ardhurat e raportuara nga DPT përfshihen sipas raportit të performancës përsëri llogaritë objekt rekomandimi nga KLSH, për këto arsye vlerësohet i pa zbatuar.

Statusi: I pa zbatuar.

4.1.Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masat për të luajtur një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit dhe marrjen e masave konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar për uljen e borxhit tatimor, i cili gjatë periudhës objekt auditimi paraqitet me një trend rritës.

- Titullari i DPT të marrë masat për të siguruar nga DRT-të informacionin analitik lidhur me subjektet debitorë, që i përket të dhënave statistikore të raportuara në total nga këto struktura pranë DMDTP, në mënyrë që të kryhet një analizë më e hollësishme nga ana e drejtorisë lidhur me numrin e subjekteve që përbëjnë stokun më të lartë të detyrimeve të papaguara; implementimin e masave shtrënguese nga ana e tyre, duke nxjerrë përgjegjësinë e zyrtarëve përkatës në këtë drejtim.

Qëndrimi i Subjektit: Theksojmë se, gjatë periudhës së audituar ka patur një rritje të borxhit si rezultat i kontroleve me metoda alternative nga zyra, të cilat janë më së shumti potencialisht të pambledhshme. Rritja ka qenë e përqendruar kryesisht në disa tatimpagues, ku vetëm 3 prej tyre e kanë shtuar borxhin me rreth 3.8 miliard lekë, të cilët pavarësisht rivlerësimit të bërë, probabiliteti për arkëtimin e tyre është pothuajse zero. Nëse e zhveshim rritjen nga këto tre raste, rezulton se rritja e borxhit është në terma më të ulëta. Sidoqoftë administrata tatimore gjatë vitit 2022, ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e procesit të mbledhjes së borxhit. Së pari: Është bërë një vlerësim më i detajuar i punës së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DPT ku është konstatuar një punë shumë e dobët e kësaj drejtorie. Për këtë arsye Drejtuesi i kësaj drejtorie është vlerësuar “Jo kënaqshëm” (4), kryesisht për mospasjen e një roli aktiv në monitorimin e mbledhjes së Borxhit. Është bërë një analizë mujore/3mujore ku janë analizuar të gjitha problematikat. Së dyti: Në vijim të sa më sipër, është proceduar me një investigim dhe audit nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA) dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror, e cila menaxhon 80% të borxhit total të administratës tatimore, për të vijuar më pas edhe me Drejtoritë e tjera Rajonale të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Gjithashtu është proceduar me një auditim të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm. Raportet e dala nga këto struktura kanë evidentuar problematika, të cilat janë adresuar për zgjidhje. Ndërkohë që janë referuar masa disiplinore për 23 punonjës. Lidhur me marrjen e masave për të siguruar nga DRT-të informacionin analitik sqarojmë se gjatë vitit 2022 e në vijim Drejtoritë Rajonale të Borxhit hartojnë raporte analitike 3 mujore të cilat diskutohen me Titullarin.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi është konstatuar se gjatë vitit 2022 nuk janë ndërmarrë masa konkrete nga DMDTP si edhe nuk janë përdorur të gjithë instrumentet ligjorë të parashikuar për uljen e borxhit. Konstatohet se gjatë vitit 2022 titullari i DPT nuk ka marrë masat për të siguruar nga DRT-të informacionin analitik lidhur me subjektet debitorë, që i përket të dhënave statistikore të raportuara në total nga këto struktura pranë DMDTP, në mënyrë që të kryhet një analizë më e hollësishme nga ana e drejtorisë lidhur me numrin e subjekteve që përbëjnë stokun më të lartë të detyrimeve të papaguara; implementimin e masave shtrënguese nga ana e tyre, duke nxjerrë përgjegjësinë e zyrtarëve përkatës në këtë drejtim. Ky rekomandim rezulton i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoritë e Kontrollit Tatimor pranë tyre dhe me inspektorët e kontrollit nga zyra të marrë masat për të hedhur në sistemin C@TS detyrimet prej 313,021,439 lekë, për të cilat ka module përkatëse në sistem, proces ky i monitoruar në DPT.

- Nga ana e DPT të merren masa që të ndiqen sipas dispozitave ligjore në fuqi ndjekja deri në arkëtim e detyrimeve të akcizës të mbajtura jashtë sistemit C@TS në shumën prej 2,107,792,556 lekë, që i përket 2 subjekteve të sipërpërmendur, për të cilët sistemi ekzistues nuk disponon modulin e posaçëm për hedhjen e këtij detyrimi.

Qëndrimi i Subjektit: Me Urdhrin Nr.146, datë 14.10.2022, pranë DPT është ngritur grupi i punës për trajtimin e problematikës së detyrimeve jashtë sistemit C@TS, i cili ka trajtuar problematikën në bashkëpunim me DRT.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi rezultoi DPT ka marrë masa për të hedhur në sistemin C@TS detyrimet të cilat janë jashtë sistemit. Me Urdhrin Nr.146, datë 14.10.2022, pranë DPT është ngritur grupi i punës për trajtimin e problematikës së detyrimeve jashtë sistemit C@TS. Afati i realizimit të detyrave sipas urdhërit është deri në datë 1.12.2022. Me shkresën nr.121/50 prot., datë 19.06.2023 është dërguar tek titullari i DPT MEMO mbi veprimtarinë e grupit të punës. Konstatohet se nuk është finalizuar i gjithë procesi i hedhjes së detyrimit në sistem sipas afatit të parashikuar për shkak të disa problematikave të dala. Rezulton se ky rekomandim është në proces.

Statusi: Në proces

6.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë Teknike Ligjore të marrin masat për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve të pagesës me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore, duke shqyrtuar mundësinë për të përfshirë në manualin ekzistues edhe procedurat përkatëse, apo reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të Drejtorive Rajonale Tatimore, ku Drejtoria e Kontrollit në DPT të kryejë rolin e saj si udhëheqëse metodologjike e funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimin e punës së DRT-ve për zbatimin, implementimin dhe cilësinë e kryerjes së kontrollit konform legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në kryerjen e rolit të saj si udhëheqëse metodologjike e funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimin e punës së DRT-ve për zbatimin, implementimin dhe cilësinë e kryerjes së kontrollit konform legjislacionit në fuqi, si dhe në zbatim të rekomandimit të mësipërm, ka hartuar dhe miratuar Manualin e ri të Kontrollit nga Zyra, midis të tjerave pika 5.8 “Marrëveshjet për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara” në lidhje me procedurat dhe mbajtjen e një evidence. Nga Drejtoria e Kontrollit në DPT në kuadër të kontrollit dhe monitorimit lidhur me Marrëveshjet merr informacion dhe raportime mujore të detajuara nga DRT-të, çdo datë 10 të muajit pasardhës. Evidencat mujore lidhur me Marrëveshjet me këste hartohen dhe raportohen sipas Formatit “Moduli 3” bashkëngjitur Manualit të kontrollit nga zyra.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit në DPT, konkretisht i “Manualit për Kontrollin nga Zyra” dhe anekseve bashkëngjitur atij, grupi i auditimit gjykon se ky rekomandim është zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar.

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat për finalizimin e inspektimeve për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, në përmbushje të planit operacional, si dhe të garantojë një mbulim sa më të plotë të këtij procesi në të gjithë rajonet.

Qëndrimi i Subjektit: Duke u bazuar në punën e dobët të konstatuar në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DPT, u vijua si fillim me një auditim të brendshëm për të parë më konkretisht se çfarë nuk funksiononte në këtë drejtori, për të vijuar më pas me inspektime në Drejtorinë Rajonale të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara dhe për të ndryshuar efektivisht performancën e këtyre strukturave.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve rezulton se nuk është marrë asnjë masë për realizimin e inspektimeve gjatë vitit 2022 në zbatim të planit operacional. Ky rekomandim rezulton i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar.

8.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të ndërmarrë masat e nevojshme për rishikimin e Rregullores së Drejtorisë së Rimbursimit, duke hequr: Kontrollin nr.2 dhe nr.4, me qëllim eliminimin e hallkave të tepërta në këtë proces e sjelljen e tij në kornizën ligjore. Gjithashtu, të hiqet edhe paragrafi i kontrollit nga zyra, në rastet kur subjektet me risk kalohen për kontroll **në vend** dhe për kontroll **nga zyra**, ku ky i fundit është thjesht formal, pasi nuk kryhet procesi i inventarizimit në subjekt, si një ndër proceset kryesore të kontrollit.

Qëndrimi i Subjektit: Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1 dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 75/1 "Mënyra dhe procedura për rimbursimin e TVSH-së së miratuar dhe për kompensimin e detyrimeve tatimore me TVSH-në, e rimbursueshme", parashikon se: “Rimbursimi i TVSH-së kryhet sipas një procedure të bazuar në analizën e riskut për rimbursim. Kriteret e riskut janë objektive dhe zbatohen me drejtësi për të gjithë tatimpaguesit. Trajtimi i kërkesave mund të ndryshojë në varësi të shkallës së riskut dhe vlerës së TVSH-së të kërkuar për rimbursim. Administrimi i procesit të rimbursimit të TVSH-së kryhet në përputhje me rregullat me bazë riskun, të vendosura në rregulloren e hartuar nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut pranë DPT-së dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve”. Bazuar në sa më sipër, Komiteti i Përbushjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka miratuar “Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut”, sipas Vendimit nr.27, datë 13.10.2021, protokolluar me nr.18395, datë 13.10.2021, dhe për analizën e riskut nga DRTVSH ka vlerësuar si element risku edhe Kontrollin nr.2 dhe 4 të cituara në pikën 8 si më sipër. Lidhur me kontrollin në vend apo kontrollin nga zyra, me implementimin e platformës dixhitale të rimbursimit të TVSH-së, kërkesat për rimbursim nuk kalohen më për kontroll nga zyra (bazuar në Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut, sipas Vendimit nr.27, datë 13.10.2021, protokolluar me nr.18395 datë 13.10.2021).

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi është konstatuar se nuk janë ndërmarrë masa për të rishikuar Rregulloren e Drejtorisë së Rimbursimit, për të hequr Kontrollin nr.2 dhe nr.4, me qëllim eliminimin e hallkave të tepërta në këtë proces e sjelljen e tij në kornizën ligjore si dhe për të hequr paragrafin e kontrollit nga zyra. Në përfundim shprehemi se ky rekomandim i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar.

9.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se mund të procedohet me kryerjen e pagesave, në bashkëpunim me MFE, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve të rimbursimit.

Qëndrimi i Subjektit: Plani i rimbursimeve vjen i miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pavarësisht nga propozimet që mund të bëjë Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së. Drejtoria e Rimbursimit ka për detyrë që të shqyrtojë të gjitha kërkesat për rimbursim pavarësisht planit të rimbursimit. DRTVSH shqyrton gjatë gjithë kohës mundësinë e mos tejkalimit të planit të rimbursimeve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i veprimtarisë së DRTVSH për periudhën 2022, ka rezultuar se kemi një tejkalim të planit të rimbursimeve, fakt ky që vërteton se nuk është zbatuar rekomandimi i lëna nga ana e KLSH-së.

Statusi: I pa zbatuar.

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore.

Qëndrimi i Subjektit: Nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së janë respektuar të gjitha afatet ligjore për procedurën e rimbursimit, të parashikuara në pikën 75/1.1) të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përbashkë bëjnë vetëm kërkesat për rimbursim për të cilat tatimpaguesit nuk kanë likuiduar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilët nuk mund të rimbursohen nga DRTVSH pavarësisht tejkalimit të afatit ligjor të rimbursimit, pasi sipas përcaktimeve ligjore në pikën 75/1.1) të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk mund të kompensohen nga shuma e TVSH-së së miratuar për rimbursim.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i veprimtarisë së DRTVSH për periudhën 2022, kanë rezultuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së, të pranuar, por të pa miratuara të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar dhe që përbëjnë stokun e rimbursimeve në datën 31.12.2022, fakt ky që vërteton se nuk është zbatuar rekomandimi i lëna nga ana e KLSH-së.

Statusi: I pa zbatuar.

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për:

- Të përditësuar dhe përmirësuar modulën e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore.
- Të përditësuar dhe përmirësuar modulën e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore për të zbuluar evazionin dhe mashtrimin tatimor.
- Plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.
- Standardizimin dhe dokumentimin e raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundësuar unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara. Në çdo rast të përgatiten raporte përgjithëse në mënyrë periodike me problematikat më të shpeshta të hasura dhe me mendime për përmirësimin e kriterëve të risqeve.

Qëndrimi i Subjektit: -Drejtorja e Menaxhimit të Riskut ka implementuar në modul rregull të reja risku në lidhje me identifikimin e tatimpaguesve që qëndrojnë pranë pragjeve të ndryshimit të përgjegjësisë, tatimpaguesve që ndërhyjnë me ulje në deklarimin e kontributeve në listëpagesa dhe tatimpagues me pagë të ulëta të deklaruara. Janë përmirësuar raportet në kryqëzimin e faturave në blerje e shitje për tatimpaguesit dhe janë identifikuar diferencat midis fiskalizimit dhe të dhënave të vetëdeklaruara në deklarata tatimore.

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka vijuar me kërkesën për shpallje të pozicioneve vakante pranë Departamentit të Administratës Publike për çdo vit. Për vitin 2022, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor është plotësuar një vend vakant Inspektor, me transferim të përhershëm si dhe rekrutim me shpallje një pozicion Përgjegjës Sektor i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit, sipas procedurave ligjore në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP.

Gjithashtu Drejtoria e Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 21953 Prot., datë 30.12.2022, ka përcjellë pranë DAP dhe MFE planifikimin për nevoja për pranimin në shërbimin civil për vitin 2023, ku përfshihen edhe pozicionet vakante për Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: - Nga përfaqësuesit e subjektit nuk u vendos në dispozicion dokumentacion justifikues për të vërtetuar zbatimin e dy pikave të para të rekomandimit.

- Organika nuk është plotësuar sepse nga auditimi janë konstatuar dy pozicioni ende vakant, pozicion përgjegjësi dhe inspektori.

- Nuk është kryer standardizimi dhe dokumentimi i raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundësuar unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara.

Statusi: I pa zbatuar.

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të ngrejë një grup pune për përmirësimin e Manualit të Kontrollit, ku të përcaktohen kriteret e përzgjedhjes dhe metodat e kampionimit të subjekteve për kontroll që në fazën e planifikimit.

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të urdhërojë përfundimin e kontrollit të ndërprerë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, në bazë të autorizimit nr. 16946, datë 17.09.2021, si dhe të marrë masat e nevojshme për realizimin e evadimit të kontroleve brenda afateve të përcaktuara.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Kontrollit, bazuar rekomandimit të mësipërm ka organizuar grup pune për rishikimin dhe përmirësimin e Manualeve të kontrollit nga Zyra dhe Operacionalit. Hartimi i manualit të ri të kontrollit nga zyra ka patur për qëllim analizën e elementëve të riskut dhe shtimin e kontroleve nga zyra, duke i lënë për kontroll Operacional ato kontrole që kanë risk më të lartë, kjo për arsye realizimin e maksimalizimit të përdorimit sa më efektiv dhe eficient të stafit të kontrollit nëpër DRT si dhe në uljen e orëve/kontroll. Për këtë është bërë ndryshim dhe përditësim në Manualin e Kontrollit nga Zyra duke shtuar pikën 6. Aktet e prodhuara nga Sektori i Kontrollit nga Zyra/raporti kontrollit nga zyra pika 6.2 Raporti i kontrollit nga zyra. Bazuar në Manualin e Ri të kontrollit nga Zyra dhe manualit të ri të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, po punohet për përmirësimin e Manualit të Kontrollit Tatimor. Në lidhje me përfundimin e kontrollit të ndërprerë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, në bazë të autorizimit nr. 16946, datë 17.09.2021, janë marrë masat e nevojshme për realizimin e këtij kontrolli (Raport Kontrolli Paraprak).

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe shpjegimeve të dhëna rezultojnë se:

- Është përfunduar rishikimi dhe përmirësimi i Manualit të Kontrollit nga Zyra por nuk është kryer rishikimi dhe përmirësimi i Manualit të Kontrollit Operacional;

- Nuk është përfunduar kontrolli i ndërprerë në DRT Tiranë, sepse është në fazë raport kontrolli paraprak. Grupi i audituesve të KLSH gjykon se ky rekomandim rezultojnë i zbatuar pjesërisht nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit Tatimor të hartojë praktika verifikimi nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga sistemi C@ts, nëpërmjet analizave të situatave kreditor-debitor të tatimpaguesve për sigurimet shoqërore; të zbatimit të procesit të rimbursimit; të gjendjes kreditore të TVSH-së; analiza për këstet e tatim fitimit për rastet që është ndërhyrë pas këstit që vendos sistemi, kryqëzimin me të dhënat nga sistemi doganor, etj, me qëllim identifikimin e problematikave dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Kontrollit bazuar rekomandimit të mësipërm ka hartuar praktika bazuar në raporte e të dhëna nga sistemi C@ts dhe CPCM. Çdo lloj praktike në lidhje me përpunimin dhe monitorimin e këtyre raporteve janë të përcaktuara qartë në Manualin e ri të Kontrollit nga Zyra. Monitorimi i tyre është proces që ndiqet për çdo muaj nga Drejtoritë e

Kontrollit nëpër Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit në DPT, konkretisht i “Manualit për Kontrollin nga Zyra” dhe anekseve bashkëngjitur atij, grupi i auditimit gjykon se ky rekomandim është zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar.

14.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e përealizuara me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të të gjitha Drejtorive Rajonale Tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Kontrollit në DPT bazuar rekomandimit të mësipërm ka marrë masa konkrete për analizimin dhe monitorimin me qëllim uljen e numrit të kontrolleve të përealizuara. Për këtë është bërë përditësimi dhe përmirësimi sa më eficient i evidencave raportuese mbi kryerje dhe rezultatet e kontrolleve. Drejtoria e Kontrollit si udhëheqje metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të të gjithë Drejtorive Rajonale Tatimore është në mbështetje të vazhdueshme për suport të kërkuar nga Drejtoritë e Kontrollit në Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit në DPT, na janë vendosur në dispozicion evidenca të kontrolleve ende të pa përfunduara sipas DRT përkatëse dhe ka një ulje në 65 kontrolle në total të pa mbyllura. Por Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve nuk ka marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e përealizuara. Në përfundim grupi i audituesve del në konkluzionin se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

15.1.Rekomandimi: DPT të marrë masa për hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim vijimin normal të punës në përmbushje të misionit dhe objektivit të krijimit të kësaj drejtorie.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Kontrollit të Specializuar ka propozuar ndryshimet ligjore në Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat janë miratuar në dhjetor të vitit 2022, në funksion të marrjes së kompetencave për kontrollin e individit. Drejtoria e Kontrollit të Specializuar ka hartuar “Strategjinë e Përmbushjes për Individët e Pasur”, e cila është miratuar nga Komiteti i Përmbushjes në 30 Maj 2022. Është hartuar “Manuali për Kontrollin e Individit”, i cili është miratuar nga Komiteti i Përmbushjes gjatë vitit 2023. Gjithashtu, nga Drejtoria e Kontrollit të Specializuar janë propozuar ndryshime në rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore, në funksion të detyrave funksionale të inspektorëve dhe drejtorit të Drejtorisë, të cilat priten të miratohen pas ristrukturimit të Administratës Tatimore.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të auditimit i dokumentacionit të vendosur në dispozicion ku përmendim Vendimin Nr.30, datë 02.06.2022 “Miratimin e Strategjisë së Përmbushjes për Individët e Pasur”, miratuar nga Komiteti i Përmbushjes, Vendimin Nr.35, datë 28.04.2023 “Miratimin e Manualit të punës së Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar”, miratuar nga Komiteti Operacional, ndryshimet ligjore në nenin 5 dhe 70 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, një raport kontrolli i kryer, së bashku me një raport përmbledhës të individëve të kontrolluar nga njësia speciale Anti-Infomalitet. Nga sa sqaruar më sipër grupi i auditimit gjykon se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Në proces.

16.1.Rekomandimi: DPT të shikojë mundësinë e vendosjes së një Software/Aplikacioni ku të jenë të integruar Live-Tracking System, GPS Position System dhe Live Camera System, me qëllim automatizimin dhe monitorimin e punës së inspektorëve të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT).

Qëndrimi i Subjektit: Nga analiza që i'u bë punës së DVKT në kohën gjatë së cilës përdorej sistemi GPS, është konstatuar që pavarësisht përdorimit të këtij sistemi (teknologjie), puna e DVKT-së ka patur shumë problematika, abuzime nga inspektorët, mungesë raportimi të gjetjeve etj. Për këtë arsye nga stafi drejtues i administratës tatimore, investimi në këtë teknologji, u konsiderua i tepërt dhe joefektiv, duke e zëvendësuar këtë me një metodologji të re pune të DVKT, e cila ka ulur abuzimet e inspektoreve, rritur efikasitetin duke rritur gjetjet në terren.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe nga komunikimi me subjektin, grupi i audituesve del në konkluzionin se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi të lënë nga kontrolli paraardhës i KLSH-së.

Statusi: I pa zbatuar.

17.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave për mos përsëritjen e parregullsive të konstatuara nga grupi i auditimit të ngrejë një grup pune për rishikimin e akteve të mbajtura nga inspektorët e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT) për vitin 2021.

Qëndrimi i Subjektit: Është ngritur grupi i punës me Urdhrin Nr.156, datë 09.11.2022, ku janë rishikuar praktikat e mbajtura nga inspektorët e DVKT për vitin 2021 dhe janë evidentuar problematika të tilla si: në lidhje me faktin se të gjitha grupet janë shprehur vetëm për deklarimin e punonjësve por nuk kanë administruar deklarata me shkrim për pagën reale të punonjësve të gjendur në subjekt në momentin e kontrollit; moslëshimi i kuponit tatimor duke mos u specifikuar se sa produkte janë konstatuar pa kupon, lloji i produktit dhe çmimi përkatës sipas listës së çmimeve të vetë subjektit; si dhe inventarizimin duke mos fiksuar faturën e fundit të blerjes dhe faturën e fundit të shitjes dhe nuk kanë administruar listën e çmimeve të subjektit bashkëlidhur inventarit. Për të gjitha problematikat e konstatuara do të merren masa për minimizimin e tyre.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi dokumentacionit të vendosur në dispozicion ku përfshihet Urdhri Nr.156, datë 09.11.2022 dhe relacioni përmbledhës i gjetjeve dhe problematikave të konstatuara nga grupi i punës, grupi i audituesve gjykon se ky rekomandim rezulton i zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar.

18.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të ngrejë një grup pune për analizimin e shkaqeve të inefficencës së DVKT, si dhe të shikohet mundësia e ristrukturimit të kësaj drejtorie me qëllim kalimin e saj në baza efikasiteti dhe efektiviteti.

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim është marrë në konsideratë në hartimin e strukturës së re organizative për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duke përfshirë edhe ristrukturimin e DVKT-së me qëllim që puna e kryer nga kjo drejtori të jetë më efektive dhe eficiente.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve ka rezultuar se nuk është ngritur një grup pune me qëllim analizimin e shkaqeve të inefficencës së DVKT. Ky rekomandim rezulton i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar.

19.1.Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me MFE të marrin masat për kryerjen e një planifikimi më efektiv në drejtim të disiplinimit të angazhimeve buxhetore me qëllim

shmangien e rishikimeve të shpeshta, ku pakësimi i fondeve për disa projekte investimi mund të shoqërohet me efekte financiare dhe risk të shtuar nëse nga ana e operatorëve ekonomikë do të kërkohet likuidimi për obligimet kontraktuale, pavarësisht se në rastin konkret nuk ka ndodhur.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka përcjell në mënyrë të vazhdueshme shqetësimet e saj në aspektin e fondeve buxhetore si dhe në pamjaftueshmërinë e fondeve buxhetore ashtu edhe në raport me projektet e kërkuara nga AKSHI për institucionin tonë për investime. Ky shqetësim vjen dhe më i lartë për vitin buxhetor 2022, rezultat i pakësimit të tyre nëpërmjet akteve normative dhe ndryshimit të vlerës së projekteve të përcjella nga AKSHI nga faza PBA-së në fazën e realizimit dhe konkludimit të procedurave.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve ka rezultuar se nuk është marrë asnjë masë me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta si edhe planifikim e saktë të buxhetit. Ky problem vijon të jetë edhe në vitin 2022. Ky rekomandim rezulton i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar.

20.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë DPT dhe AKSHI-t të rrisin bashkëpunimin ndër institucional, në mënyrë që të kryhet në mënyrë të plotë dhe të saktë planifikimi i fondeve që në fazën e hartimit të PBA-së për ato asete, procedurat e prokurimit të cilave do të kryhen nga AKSHI, në mënyrë që të shmangët fenomenin e ndërmarrjes së angazhimeve pa fonde në dispozicion nga ky i fundit, shoqëruar me efekte financiare apo rishikime të shpeshta të buxhetit të DPT.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka përcjell në mënyrë të vazhdueshme shqetësimet e saj në aspektin e fondeve buxhetore si dhe në pamjaftueshmërinë e fondeve buxhetore ashtu edhe në raport me projektet e kërkuara nga AKSHI për institucionin tonë për investime. Ky shqetësim vjen dhe më i lartë për vitin buxhetor 2022, rezultat i pakësimit të tyre nëpërmjet akteve normative dhe ndryshimit të vlerës së projekteve të përcjella nga AKSHI nga faza PBA-së në fazën e realizimit dhe konkludimit të procedurave.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve ka rezultuar se nuk është marrë asnjë masë konkrete ndërmjet DPT-AKSH me qëllim planifikim e sakte të buxhetit që në fazën e hartimit PBA-së për sistemet e IT që prokurohen nga AKSHI. Ky problem vijon të jetë edhe në vitin 2022. Ky rekomandim rezulton i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar.

21.1.Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në DPT, në zbatim të udhëzimeve të MFE për procedurat që duhet të ndiqen nga njësitë shpenzuese për zbatimin dhe monitorimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit për DPT për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Qëndrimi i Subjektit: Procesi i monitorimit realizohet në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qëndrore”. Pika III e këtij udhëzimi “Procedurat për procesin e monitorimit”, 3.1 “Përcaktimi i vitit korent” referon: “Viti i cili do të monitorohet, referuar këtej e tutje si viti korrent, është viti i parë i PBA-së që i korrespondon ligjit vjetor të buxhetit. Kur procesi i PBA-së të ketë përfunduar, për vitin korent janë përcaktuar: 30.1 Alokimet sipas programeve dhe zërave të klasifikimit ekonomik të shpenzimeve (artikujve) si dhe alokimi i këtyre për projektet, produktet dhe aktivitetet;

30.2 Produktet e parashikuara për secilin program. Në këto përcaktime është e qartë që kërkohet raportim monitorimi në nivel kod programi. Kjo rrjedhimisht sjell raportimin për gjithë DPT-në si strukturë pa ndarë më vete aparatin. Gjithashtu, në zbatim edhe të programit AFMIS për institucionet buxhetore monitorimi realizohet në nivel kod programi. Drejtorja e Financës dhe Buxhetit ka kërkuar bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku ne si institucion raportojmë çdo 4 muaj dhe ky lloj baze raportimi është pranuar dhe unifikuar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve ka rezultuar se raporti i monitorimit është hartuar sipas formateve dhe kriterëve të përcaktuar në Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 ” Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”. Ky rekomandim rezulton i zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar.

22.1.Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masat për iniciimin e procesit të inventarizimit për vitin 2021 dhe për çdo vit pasardhës për efekt të hartimit të pasqyrave financiare dhe jo periudhave të ndërmjetme, në mënyrë që të garantohet saktësia e informacionit të gjeneruar nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, në mos shpërdorimin dhe humbjet e tyre.

-Titullari i DPT, të marrë masat respektive për sistemimin e situatës së konstatuar për inventarizimin e vitit paraardhës, si dhe për finalizimin e procesit të ndjekur për aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi.

Qëndrimi i Subjektit: Për vitin 2021, është kryer procesi i inventarizimit, sipas Urdhrit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me Nr.8408 Prot., datë 19.05.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të DPT dhe magazinave të saj vitin 2021”. Gjithashtu është kryer procesi i vlerësimit të aseteve në zbatim të urdhrit të brendshëm Nr. 13801 Prot., datë 11.08.2022 për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e DPT dhe punonjësit e DPT.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve ka rezultuar se Titullari i DPT ka marrë masat për iniciimin e procesit të inventarizimit. Është ngritur komisioni i inventarizimit, komisioni i vlerësimit dhe komisioni i asgjësimit, sipas Urdhrit nr. 8408, datë 19.05.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të DPT dhe magazinave të saj vitin 2021”, Urdhrit nr. 13801, datë 11.08.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e DPT dhe punonjësit e DPT “ dhe Urdhrit nr.1380/5 prot., datë 20.09.2022 “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve në inventar të DPT”. Procesi i inventarizimit është kryer brenda vitit 2022. Nga verifikimi ky rekomandim rezulton i zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar.

23.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPT dhe AKSHI-t të marrin masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për kalimin e aseteve nga DPT tek AKSHI, me qëllim finalizimin sa më të shpejtë të këtij procesi.

Qëndrimi i Subjektit: - Është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Brendshëm nr.125, datë 29.09.2022, ku AKSHI të marr në ngarkim Aktivet për infrastrukturën hardware dhe sistemeve IT, në zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr.1, datë 19.10.2022, për AKSHI Nr. 6541 Prot., datë 19.10.2022 dhe DPT Nr. 13801/10 Prot., datë 19.10.2022.

-Është finalizuar procesi i kalimit të pajisjeve dhe software të sistemeve:

1. E-TAX

2. M-TAX

3. Fiskalizimi - “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”

4. AEOI - "Sistemi i shkëmbimit të informacionit"

Kalimi i aseteve konfirmohet me shkresën e AKSHI-t nr. 7535/1, datë 07.12.2022 për marrjen në dorëzim të aktiveve. Për sistemet NEXUS, Harta digitale dhe BI, është rënë dakord nga të dy institucionet, që nuk mund të bëhet kalimi i këtyre sistemeve tek AKSHI, për shkak të mungesës së kodit burim të software-ve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve ka rezultuar se është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Brendshëm nr. 125, datë 29.09.2022, ku AKSHI ka marr në ngarkim Aktivet për infrastrukturën hardware dhe sistemeve IT. Nga verifikimi rezulton se procesi i inventarizimit është bërë plotësisht për kalimin kapital por ka mbetur pa kaluar dhoma e serverit pasi AKSHI nuk kishte kushtet e duhura për ta zhvendosur si edhe sistemet NEXUS, Harta digitale dhe BI pasi nuk kanë kod në burim. Ky rekomandim rezulton i zbatuar pjesërisht nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar pjesërisht.

24.1.Rekomandimi: DPT t'i bëjë të ditur MFE që të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ku konkretisht Sektori i Kontabilitetit të kësaj drejtorie të marrë masat për shqyrtimin e situatës, në mënyrë që të përcaktohen edhe procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike.

Qëndrimi i Subjektit: Rekomandim i pa pranuar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandim i pa pranuar dhe pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: Pa pranuar, pa zbatuar.

25.1.Rekomandimi: Titullari i DPT të ngrejë një grup pune me përfaqësues nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikave, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, etj, i cili të marrë masat për verifikimin dhe kryerjen e analizave të ndryshimit të fondit neto për DRT-të, si dhe problematikat e tjera trajtuar më sipër, reflektuar në pasqyrën e konsoliduar, me qëllim marrjen e masave për një pasqyrim më të drejtë të situatës financiare dhe rezultatet e tyre të pasqyrohen në shënimet shpjeguese. Në kuadër të konsolidimit të pasqyrave financiare, titullari i DPT, nëpërmjet një sqarueseje apo guidë udhëzuese të përcaktojë afatet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga vetë DPT: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, nga Drejtoria e Pagesave dhe Kontabilitetit, si dhe nga DRT-të për pasqyrat financiare të hartuara nga këto njësi duke parashikuar edhe takime mes palëve. Gjithashtu, të shqyrtojë edhe mundësinë e ri organizimit të strukturave në rast konstatimit të mbivendosjes së përgjegjësive, për sa kohë autoriteti për miratimin e pasqyrave mbetet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të DPT.

Qëndrimi i Subjektit: Rekomandim i pa pranuar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandim i pa pranuar dhe pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: Pa pranuar, pa zbatuar.

26.1.Rekomandimi: DPT të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE, të shqyrtojë situatën e mësipërme duke parashikuar skemën e kontabilizimit të duhur, në mënyrë që të garantohet raportimi i të dhënave të plota dhe me vërtetësi në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT.

Qëndrimi i Subjektit: - Pasqyrat financiare të DPT-së, të konsoliduara përcillen në MFE, ku nga aty del edhe bilanci i konsoliduar i MFE-së, së bashku me drejtoritë e saj të varësisë ku një ndër to është edhe DPT. Asnjëherë nga MFE nuk kemi pasur asnjë propozim të ndryshimit të regjistrimeve apo paraqitjes së zërave në bilanc. Drejtoria e Harmonizimit është drejtori e

strukturës së MFE-së. Nqs do të kishte probleme të tilla do të ishin evidentuar. Kjo çështje është parashtruar nga KLSH edhe në vitin 2018, ku pretendimet e KLSH po nga kjo drejtori ranë poshtë. Të gjitha regjistrimet dhe pasqyrimi financiar ishin konform bazave ligjore dhe SKK-ve.

-Drejtoria Kontabilitet Statistikë konfirmon që skema e kontabilizimit për të ardhurat dhe pasqyrimi i tyre në Pasqyrat Financiare të DPT është në funksion dhe zbatim të plotë të Ligjit për Kontabilitetin, Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 për Procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit të PF vjetore të Qeverisjes së Përgjithshme, si dhe Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Drejtoria Kontabilitet Statistikë thekson se sistemi i kontabilitetit për të ardhurat i implementuar në sistemin tatimor E-Tax ka marrë vlerësim maksimal nga TADAT dhe FMN, shprehur kjo në raportin teknik të Gushtit 2022.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandim i pa pranuar dhe pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: Pa pranuar, pa zbatuar.

27.1.Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe strukturat përgjegjëse të marrin masat për alokimin e fondeve të nevojshme për këto shpenzime, reflektuar në tavanet përfundimtare të miratuara në buxhetin e DPT, apo dakordësimin e një tjetër zgjidhjeje optimale për këtë situatë në kushtet kur kemi të bëjmë me pagesa të kryera nëpërmjet dy institucioneve shtetërore.

Qëndrimi i Subjektit: Me shkresën nr.650 prot., datë 17.01.2023 dhe nr.2051 prot., datë 10.02.2022, DBF i është drejtuar MFE me një relacion narrativ mbi fondet buxhetore për shpenzimet kapitale duke bërë analizën dhe nxjerrë konkluzionin që lëvizjet e shpeshta të buxheteve vijnë si rezultat i nxjerrjes së shpeshtë të akteve normative, ku vetëm për vitin 2022, kanë dalë 3 akte normative, të cilat reflektojnë ndryshime në fondet buxhetore.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i grupit të audituesve u konstatua se nga DPT është përcjelle në MFE relacioni mbi fondet buxhetore dhe problematika lidhur me rialokimin e fondeve si edhe 3 AN me shkresën nr. 650, datë 17.01.2023. Por për këtë situatë nuk është dhënë një zgjidhje optimale e përbashkët nga dy institucionet. Nga verifikimi ky rekomandim rezulton i zbatuar pjesërisht nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I zbatuar pjesërisht.

28.1.Rekomandim: Titullari i DPT, në bashkëpunim edhe me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit Nr.33, datë 12.02.2020.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka vijuar me kërkesën për shpallje të pozicioneve vakante pranë Departamentit të Administratës Publike dhe deri aktualisht janë shpallur 53 pozicione të lira, nga të cilat disa janë ende në proces. Me shkresën nr. 21953 Prot., datë 30.12.2022 ka përcjellë pranë DAP dhe MFE planifikimin për nevoja për pranimin në shërbimin civil për vitin 2023.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi u konstatua se, DPT ka dorëzuar në DAP planifikimin vjetor, (për vitin 2022) të vendeve vakante, me emailin e datës 28.12.2021, ku në të gjithë ATQ rezultonin 135 pozicione vakante. DAP ka nxjerrë 45 shpallje për 48 pozicione vakante. Nga 135 pozicione vakante janë plotësuar 41 prej tyre ose 30.4%.

Statusi: I pa zbatuar.

29.1.Rekomandimi: Drejtoria e DBNJ të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për të minimizuar lëvizjet e shpeshta brenda strukturave, që do të çënonin mbarëvajtjen e punës dhe efektivitetin e tyre.

Qëndrimi i Subjektit: Administrata Tatimore Qendrore, për marrëdhëniet e punës të cilat rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, ka një Rregullore të miratuar, konkretisht Urdhrin nr.10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm “Për miratimin e Rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”, në të cilat janë të përcaktuara qartë procedura e rekrutimit për punonjësit me Kod Pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek dhe menaxhon procedurat e rekrutimit sipas rastit në përputhje me kriteret e përcaktuar në përshkrimet e punës për çdo pozicion pune.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Në rregulloren “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”, miratuar me Urdhrin Nr.10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, te detyrat e përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në nenin 72, pika nr. 4, përcakton: “Drejtori përgatit dhe zbaton strategjinë menaxhuese dhe planet operationale për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim, sipas vendeve të lira të krijuara, në bashkëpunim me Zv. Drejtorin e Përgjithshëm”. Ky plan operacional për strategjitë menaxhuese të burimeve njerëzore të administratës tatimore nuk është bërë.

Statusi: I pa zbatuar.

30.1.Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masa që të ndiqen procedurat dhe afatet e parashikuara në Kodin e Punës në RSH për ndërprerjen e njëanshme të marrëdhënies të punës, si dhe të mbështesë motivacionet e ndërprerjeve të punës në dokumentacion vërtetues, në rastet e ankesave dhe performancës së ulët.

Qëndrimi i Subjektit: Nga pranimi i këtij rekomandimi dhe deri aktualisht, në institucion nuk ka patur ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies së punës, si dhe është marrë në konsideratë rekomandimi për respektimin e procedurës dhe afateve ligjore dhe do të ndiqet në vijim.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi u konstatua se nuk janë ndjekur procedurat dhe afatet e parashikuara në nenin 143 të Kodit të Punës në R.SH.

- Nga ana e DPT është marrë në konsideratë respektimi i procedurës dhe afateve ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies të punës.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

31.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kriterëve arsimore kur detyrat funksionale janë të njëjta, si dhe që fituesit e procedurës së konkurrimit të kenë nivel dhe fushë arsimore në përputhje me kriteret e përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës.

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore të plotësojë dhe përditësojë të gjitha dosjet e punonjësve me dokumentacionin e nevojshëm.

Qëndrimi i Subjektit: Me miratimin e strukturës organizative me Urdhrin e Kryeministrit nr.33, datë 12.02.2020, janë miratuar edhe Përshkrimet e Punës për çdo pozicion pune sipas përcaktimeve ligjore nga Titullari i Institucionit, Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Administratës Publike. Në Administratën Tatimore Qendrore, kriteret janë përcaktuar në përshkrimet e punës sipas nivelit të pozicionit dhe kategorisë së pagës, rrjedhimisht ndikon dhe në përcaktimin e kriterëve arsimore për çdo pozicion pune. **Deri aktualisht ATQ nuk ka pësuar ndryshime strukturore, por si rekomandim do të mbahet në konsideratë me qëllim unifikimin e përshkrimeve të punës sipas rekomandimeve të lëna.** Në lidhje me pikën tjetër, pas aktit të emërimit nga Departamenti Administratës Publike për nëpunësit të cilët rekrutohen në shërbimin civil, si dhe për punonjësit për të cilët marrëdhëniet e punës

rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, njësia e burimeve njerëzore pas daljes së aktit të emërimit nga Titullari i Institucionit, vepron me njoftimin me anë të postës elektronike me Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë Rajonale, ose dhe me vetë punonjësit për plotësimin e dokumentacionit personal të dosjes së personelit, ku përfshihen dokumentat për njohjen e vjetërsisë në punë (*librezë pune, vërtetim për kontributin e sigurimeve shoqërore*), në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastin kur konstatohen mungesa në dokumentacion, punonjësit njoftohen për plotësimin dhe dorëzimin e tyre sipas specifikimit të mungesës së dokumentacionit. Drejtorja e Burimeve Njerëzore disponon korrespondencat elektronike për shkak të mungesave në dokumentacion, ku në mënyrë të njëpasnjëshme janë njoftuar punonjësit për problematikat që kanë lidhje me dorëzimin e tyre, aktualisht vijohet me njoftime elektronike për plotësim dokumentacioni.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi u konstatua se, nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masa për unifikimin e kritereve arsimore kur detyrat funksionale janë të njëjta. Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka plotësuar dhe po përditëson të gjitha dosjet e punonjësve me dokumentacionin e nevojshëm.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

32.1.Rekomandimi: GMS të zhvillojë mbledhjet në periodicitetin e përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përmbushjen e qëllimit për garantimin e funksionimit të komponentëve të MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut në institucion.

- Titullari i DPT të marrë masa për caktimin e NZ në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Qëndrimi i Subjektit: GMS në përmbushje të qëllimit për garantimin e funksionimit të komponentëve të MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut në institucion, është mbledhur dhe ka zhvilluar rregullisht mbledhje në periodicitete të cilat janë të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu me strukturën e re organizative janë marrë të gjitha masat për caktimin e NZ të jenë në përputhje me të gjitha përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi u konstatua se, GMS nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje gjatë vitit 2022. Me shkresën nr. 6889/1, datë 24.04.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, është përcjellë në DAP, propozimi me ndryshime, draft-struktura organizative, relacioni shoqëruar, si dhe organigrama e administratës tatimore me ndryshime.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

33.1.Rekomandimi: DAB marrë masa për bashkëpunimin me strukturat e tjera kontrolluese brenda DPT dhe me KLSH-në, me qëllim bashkërendimin dhe shkëmbimin e planeve të konsoliduar, duke synuar shmangien e mbivendosjeve të angazhimeve të auditimit, si dhe për planifikimin në mënyrë eficiente të angazhimeve të auditimit duke patur parasysh ndër të tjera ndarjen e ngarkesës mes audituesve.

- Drejtori i Përgjithshëm i DPT të marra masa në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, me qëllim plotësimin e vendit vakant të Përgjegjës të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit.

Qëndrimi i Subjektit: Me miratimin e planit vjetor të auditimit për vitin 2023 nga Titullari i Institucionit është njoftuar shkresërisht Drejtorja e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve mbi subjektet e planifikuara për auditim për vitin 2023, nga Drejtorja e Auditimit të Brendshëm. Në zbatim të manualit të auditimit të brendshëm nr. 100, Kapitulli III, pika 3.3, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në MFE përgatit planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor për të gjithë veprimtarinë e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, ja paraqet dhe KLSH-së në kuadër të shkëmbimit të informacionit të ndërsjellë. Nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm është synuar në

vazhdimësi shmangia e mbivendosjes të auditimeve me strukturat e tjera audituese. Lidhur me planifikimin në mënyrë efëcente të angazhimeve të auditimit janë marrë në konsideratë krahas të tjerave: madhësia e subjektit që do të auditohet, fushat dhe sistemet që do të auditohen, përvoja e secilit auditues etj. Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka përcjellë pranë DAP elektronikisht në datë 05.12.2022, për arsye të mosfunksionimit të sistemit online të DAP, njoftimin për shpalljen e pozicionit të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, referuar shpalljes me KOD 4396, kjo shpallje është ende në proces deri në përfundim të procedurës.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi se DAB nuk ka pasur bashkëpunime me njësi të tjera kontrolluese brenda DPT dhe me KLSH me qëllim bashkërendimin dhe shkëmbimin e planeve të konsoliduar, duke synuar shmangien e mbivendosjeve të angazhimeve të auditimit, si dhe për planifikimin në mënyrë efëcente të angazhimeve të auditimit, sepse ka ndryshime të planit të auditimeve dhe auditime të pa realizuara me argumentimin se janë në proces kontrolli nga KLSH. Gjithashtu nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT, nuk janë marrë masa për plotësimin e vendit vakant të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit. Nga sa më sqaruar më sipër grupi i auditimit gjykon se ky rekomandim rezulton i pa zbatuar nga ana e subjektit të audituar.

Statusi: I pa zbatuar.

34.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa të menjëhershme për monitorimin e procedurave të lëshimit të autorizimit, si dhe marrjen e masave për kontrollin e DRT lidhur me zbatimin e kërkesave të shkresës sqaruese Nr.4985/3 Prot., datë 04.03.2020, drejtuar DRT-ve.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtorja e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve bazuar rekomandimit të mësipërm, menjëherë ka organizuar Kontrolle tematike të vazhdueshme në çdo Drejtori Rajonale Tatimore mbi zbatimin korrekt të monitorimit të procesit të rindërtimit, bazuar dhe në shkresën sqaruese nr. 4985/3 Prot., datë 04.03.2020.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit në DPT, konkretisht i Raporteve Përfundimtare të Kontrollit në disa DRT si dhe janë vendosur në dispozicion nëpërmjet postës elektronike “Evidencat e Autorizimeve të rindërtimit”, grupi i auditimit gjykon se për këtë pjesë të rekomandimit rezulton i zbatuar nga ana e subjektit të audituar. Por theksojmë se Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve nuk ka ngritur një grup pune të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për parregullësitë e konstatuara.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1.Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masa për evidentimin e arsyeve të largimeve të padrejta nga puna me qëllim përmirësimin e procedurave të kryera gabim duke sjellë kështu minimizim të shpenzimeve gjyqësore në të ardhmen dhe përdorim me efektivitet të fondeve buxhetore.

Qëndrimi i Subjektit: Nga ana e strukturave përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kryesisht, të strukturës menaxhuese të burimeve njerëzore dhe strukturës e cila bën të mundur përfaqësimin e institucionit në proceset gjyqësore që kanë si objekt/fokus marrëdhëniet e punës ka patur bashkërendim të punës dhe bashkëpunim të shtuar me qëllim evidentimin e problematikave kryesore dhe përmirësimin/minimizimin e tyre në të ardhmen.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se në vitin 2022, numri i punonjësve të larguar nga administrata tatimore, është në

rënie, si pasojë e përmirësimit të punës së Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (DIBA), por jo nga procesi i ndjekur në të gjitha praktikatat, nga Komisioni i Posaçëm në DPT.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

C.MASA DISIPLINORE

Bazuar në Kreun X “Disiplina në Shërbimin Civil” të Ligjit Nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 57, 58 dhe 59, **i rekomandohet** Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënie masash disiplinore nga “**Vërejtje**” deri “**Largim nga shërbimi civil**”, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është në pritje të propozimeve konkrete nga Epror/ët Direkt i/ të nëpunësve/punonjësve të ngarkuar me përgjegjësi sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nga Titullari i Institucionit me qëllim ndjekjen e procedurave për fillimin e procedimit disiplinor. Kjo bazuar në shkresën nr. 121/48 Prot., datë 18.01.2023, “Për procedurë” drejtuar të gjitha drejtorive në DPT, ku në respektim të ligjit nr. 512/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo epror direkt duhet të bëjë vlerësimin e shkeljes së pretenduar për secilin nëpunës të strukturës që mbulon, mbështetur në gjetjet në raportin Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Me shkresën nr. 121/48 Prot, datë 18.01.2023, “Për procedurë” të Drejtorit të Përgjithshme, drejtuar të gjitha drejtorive në DPT, çdo epror direkt duhet të bëjë vlerësimin e shkeljes së pretenduar për secilin nëpunës të strukturës që mbulon, mbështetur në gjetjet e Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Statusi: Në proces.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacion.

Në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Tabela Statusi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Gjithsej	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
1	Masa Organizative	34	29	5	8	2	14
2	Masa për 3E	1	1		1		
3	Masa Disiplinore	1	1			1	
	Gjithsej	36	31	5	9	3	14

Titulli gjetjes:	Moszbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së.
Situata:	Për zbatimin e rekomandimeve të rekomanduara në auditimin e mëparshëm është konstatuar se DPT, ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr.121/51 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH me nr.20/19 prot., datë 17.07.2023 jashtë afatit 6-mujor, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm konstatohet se nga 36 rekomandime të lëna, subjekti ka pranuar 31 rekomandime, ose 86% e tyre dhe nuk ka pranuar 5 rekomandime. Janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime, janë zbatuar

	<p>pjesërisht 9 rekomandime, janë në proces 3 rekomandime dhe nuk janë realizuar 16 rekomandime ose 45.1 % e tyre, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga 34 “Masa Organizative”, janë pranuar 31 masa, nga të cilat 5 janë zbatuar plotësisht, 8 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces, 14 masa janë pa zbatuar dhe 5 masa janë pa pranuar. - Është rekomanduar 1 “Masë për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike”, ku nga verifikimi rezulton se është pranuar masa dhe është zbatuar pjesërisht. - Është rekomanduar “Masë Disiplinore” në kompetencë të Titullarit e cila është pranuar nga ana e subjektit dhe është në proces zbatimi.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, neni 15 dhe 30; - Shkresa Nr.20/17 prot., datë 19.09.2022, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”. - Shkresa Nr.121/45., Prot., datë 30.09.2022, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DPT njoftuar me shkresën Nr.20/17 Prot., datë 19.09.2022, protokolluar me tonën Nr.121/43 Prot., datë 20.09.2022”.
Ndikimi/Efekti:	Rekomandimet e papranuara, të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht ndikojnë në performancën e DPT-së, duke mos përmirësuar situatën e menaxhimit të fondeve dhe pasurisë publike.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore të Ligji Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e afatit ligjor në informacionin mbi ecurinë e zbatimit të masave të rekomanduara, si dhe për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe rikërkojmë të merren masa nga DPT për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, pjesërisht të zbatuara si dhe të pa zbatuara të dërguara me shkresën Nr. 20/17 Prot., të Kryetarit të KLSH datë 19.09.2022, konkretisht për masat organizative, rekomandimet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 18, 19, 20, 23, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe për masën për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, rekomandimin nr. 1.

2.2. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.

2.2.1. Mbi auditimin e planit të të ardhurave tatimore

- **Plani fillestar i të ardhurave tatimore për buxhetin e vitit 2022** është dërguar me shkresën nr. 1533 prot. DPT datë 01.02.2022 për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shumën totale 157,548 milion lekë neto, duke ndarë:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar 30,061 milion lekë.
- Tatimi mbi fitimin 35,586 milion lekë.
- Tatim mbi të ardhurat personale 45,161 milion lekë.
- Taksa nacionale dhe të tjera 46,740 milion lekë.

Në këtë shkresë janë detajuar të ardhurat për tu mbledhur të detajuara sipas muajve dhe progresiv. Në vijim me shkresë nr. 1531 prot. DPT datë 01.02.2022 është dërguar nga MFE

plani i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ku për DPT është përcaktuar në vlerën 108,100 milion lekë sipas llojeve të kontributeve për sigurime shoqërore dhe kontributeve për sigurime shëndetësore i ndarë në muaj. Nga auditimi konstatohet se dërgimi i planit të të ardhurave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është bërë në muajin shkurt, pa përfshirë planin e të ardhurave të muajit janar, megjithëse ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është miratuar që në datë 25.11.2021.

Nga MFE me shkresën nr. 3185 prot. DPT datë 25.02.2022 është dërguar plani i të ardhurave për administratën tatimore sipas zërave të mëparshëm për tatimin mbi vlerën e shtuar neto, tatimin mbi të ardhurat personale dhe taksa nacionale dhe të tjera, por duke detajuar vlerën e planifikuar të tatimit mbi vlerën e shtuar si më poshtë:

-Rimbursime në shumën 18,500 milion lekë

Në këtë shkresë, përveç përcaktimit të shumës së rimbursueshme është detajuar edhe plani i taksave nacionale dhe të tjera sipas zërave analitikë së të ardhurave sipas natyrës.

Me Vendim nr. 23 datë 23.03.2022 nga Komiteti Operacional është miratuar plani i të ardhurave për DRT për vitin 2022 në vijim të Urdhrit të Drejtorit të DPT nr. 2968 datë 23.02.2022 “Për detajimin e planit së të ardhurave për vitin 2022”. Ky plan i përcaktuar në nivel DRT-je në muaj dhe sipas llojit të tatimit është dërguar në DRT përkatëse me shkresën nr. 2968 datë 24.03.2022 ku është cituar “bashkëlidhur po ju dërgojmë planin vjetor së të ardhurave të periudhës Janar – Prill 2022”. Nga auditimi konstatohet se megjithëse i referohet planit vjetor, në drejtoritë rajonale tatimore është dërguar plani i të ardhurave tatimore vetëm për periudhën Janar-Prill 2022, duke mos përfshirë të gjithë periudhën vjetore. Procesi fillestar i detajimit të planit së të ardhurave tatimore për drejtoritë rajonale tatimore përkatëse nga ana e DPT konstatohet se ka zgjatur për një periudhë 3-mujore nga fillimi i vitit buxhetor dhe 2-mujore nga data e dërgimit të planit së të ardhurave tatimore në përgjegjësi të DPT nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nga auditimi konstatohet se gjatë kësaj periudhe është miratuar Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, i cili ka ndryshuar një pjesë të të ardhurave tatimore, të cilat janë trajtuar në mënyrë të detajuar në vijim. Efektet e këtij plani të ndryshuar të të ardhurave tatimore nuk janë reflektuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duke qenë se janë bazuar në detajimin fillestar të të ardhurave tatimore sipas shkresave nr. 1531 dhe 1533 prot. DPT datë 01.02.2022 dhe vlerës së rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar të dërguar në 25.02.2022.

Mos reflektimi në kohë i efektit të të ardhurave të ndryshuara sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, në planin e drejtorive rajonale tatimore është kushtëzuar edhe nga dërgimi me vonesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë i të ardhurave tatimore në përgjegjësi mbledhjeje të administratës tatimore sipas shkresës nr. 7088 prot. DPT datë 26.04.2022 në të cilin është paraqitur ndryshimi i planit si më poshtë:

-Tatimi mbi vlerën e shtuar 31,861 milion lekë.

-Tatimi mbi fitimin 37,586 milion lekë

-Tatim mbi të ardhurat personale 47,161 milion lekë

-Taksa nacionale dhe të tjera 43,740 milion lekë

Efekti i mos pasqyrimit të saktë dhe në kohë në planin e të ardhurave për DRT sipas kësaj shkrese vlerësohet në rritje në shumën 1,800 milion lekë për të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar bruto dhe neto (duke qenë se rimbursimi i tatimit mbi vlerën e shtuar nuk ka ndryshuar), në rritje në shumën 2,000 milion lekë për të ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe në rritje në shumën 2,000 milion lekë nga tatimi mbi të ardhurat personale. Megjithëse tatimi mbi vlerën e shtuar në terma neto është rritur me 1,800 milion lekë, nuk është reflektuar rritje në vlerën e parashikuar për tu rimbursuar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me mos ndryshim përgjatë gjithë vitit për vlerën e rimbursimit, me ndikim në treguesit e realizuar për këto zëra. Nga auditimi konstatohet se edhe pas kësaj shkrese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi Aktin Normativ nr.3 datë 12.03.2022 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

nuk është reflektuar ndryshimi në të ardhura tatimore, deri në efektet e ndryshimeve me Aktin Normativ nr. 12 datë 11.08.2022.

-Me shkresë nr. 13863 prot. DPT datë 12.08.2022 është dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit normativ nr. 12 datë 11.08.2022. Nga DPT me shkresë nr. 13863/1 datë 18.08.2022 është kërkuar plani i detajuar i Taksave Nacionale dhe të tjera sipas zërave përkatës si dhe plani i rimbursimit për vitin 2022. Në vijim, me shkresë nr. 13863/3 datë 09.12.2022 është dërguar plani i ndryshuar i të ardhurave për vitin 2022 në zbatim të Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022, duke e detajuar planin sipas DRT-ve përkatëse rreth 4 muaj pas daljes së aktit normativ. Nga auditimi konstatohet se edhe në këtë rast, megjithëse nga legjislativi ishte miratuar Akti Normativ nr. 17 datë 01.12.2022 me efekte në ndryshimin e të ardhurave tatimore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është shpërndarë pas daljes së këtij akti në drejtoritë rajonale tatimore, efekti në planin e të ardhurave i Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022. Përveç vonesës nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shpërndarjen e planit të të ardhurave, mos reflektimi në kohë i efekteve të Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022 është kushtëzuar edhe nga dërgimi me vonesë i planit të të ardhurave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

-Me shkresën nr. 21811 prot. DPT datë 29.12.2022 është dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit normativ nr. 17 datë 01.12.2022. Pra plani i të ardhurave është dërguar me rreth një muaj vonesë nga akti normativ për ndryshimin e të ardhurave dhe vetëm dy ditë përpara mbylljes së vitit buxhetor, duke bërë të pamundur reflektimin e veprimeve operacionale për zbatimin e tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Efektet e ndryshimit që ka pasqyruar ky akt vlerësohen në rritje për 500 milion lekë për tatimin mbi vlerën e shtuar në terma neto dhe në rritje për 2,000 milion lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për tu mbledhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga ana e DPT me shkresën nr. 21811/1 datë 04.01.2023 i është kërkuar MFE-së detajimi i planit të të ardhurave të ndryshuar për vitin 2022 për zërin Taksa Nacionale e të tjera, plan i cili rezultoi i pa detajuar edhe në vijim të kërkesës nr. 13863/1 datë 18.08.2022 nga DPT pas ndryshimit të të ardhurave sipas Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022. Konstatohet se në muajin Janar të vitit 2023, kohë në të cilën mundësitë për realizimin e të ardhurave tatimore janë ezauruar, nuk janë qartësuar ende çështje që lidhen me planin e të ardhurave tatimore për vitin e mbyllur buxhetor 2022.

Nga DPT, me shkresën nr. 21811/4 datë 16.01.2023 është dërguar në drejtoritë rajonale tatimore për vitin 2022 plani i të ardhurave të ndryshuara sipas Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, që përfaqëson planin përfundimtar të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit.

Plani fillestar së bashku me ndryshimet përgjatë vitit me akte normative, për të cilat janë dërguar efektet e ndryshimeve në të ardhura tatimore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1 Plani i të ardhurave fillestar dhe me ndryshimet gjatë vitit 2022,

Në mijë lekë

	EMERTIMI	Plani fillestar	A.N 3	A.N 12	A.N 17
Rd.		2022	12.03.2022	29.07.2022	01.12.2022
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	284,148,000	286,948,000	306,155,000	308,655,000
	(Tatimet + Rimbursime + Kontributet)				
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)	176,048,000	178,848,000	192,500,000	193,000,000
1	Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	48,561,000	50,361,000	55,500,000	56,000,000

	- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	30,061,000	31,861,000	37,000,000	37,500,000
	- Rimbursimi T.V.SH.-se	18,500,000	18,500,000	18,500,000	18,500,000
2	Tatim mbi Fitimin	35,586,000	37,586,000	46,000,000	46,000,000
3	Ardhura Personale	45,161,000	47,161,000	47,000,000	47,000,000
4	Taksat Nacionale	19,260,000	43,740,000	18,900,000	18,900,000
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	23,400,000		23,400,000	23,400,000
6	Kazinot dhe Lodrat	4,080,000		1,700,000	1,700,000
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	157,548,000	160,348,000	174,000,000	174,500,000
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	108,100,000	108,100,000	113,655,000	115,655,000
D=B+C	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	265,648,000	268,448,000	287,655,000	290,155,000

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 është miratuar edhe Akti Normativ nr. 19 datë 29.12.2022, vetëm 2 ditë përpara mbylljes së vitit buxhetor, me anë të të cilit janë miratuar ndryshime në të ardhurat e buxhetit të shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore, për të cilat plani buxhetor ka ndryshuar nga 102,525 milion lekë në 104,009 milion lekë. Të ardhurat e programuara për tu mbledhur nga kontributet e sigurimeve shëndetësore konstatohet se nuk kanë ndryshuar. Efekti i këtyre ndryshimeve sipas shpjegimit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk është reflektuar në ndryshim plani të të ardhurave tatimore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Miratimi i planit fillestar të të ardhurave së bashku me ndryshimet përgjatë vitit në nivel drejtorie rajonale tatimore paraqiten sipas tabelës së mëposhtme për katër versionet e planit të të ardhurave tatimore përgjatë vitit buxhetor 2022:

Tabela nr. 2 Miratimi i planit fillestar të të ardhurave së bashku me ndryshimet përgjatë vitit.

Në mijë lekë

Aktet ligjore	Ligji nr.115/2021	AN nr.3 date 12.03.2022	AN nr. 12 date 29.07.2022	AN nr. 17 date 01.12.2022	Ndryshimi plan perf. – plan fillestar	Ndryshimi ne %
DRT Bruto (tatime + rimbursime+kontribute	284,148,000	286,948,000	306,155,000	308,655,000	24,507,000	9%
D. R. T. Berat	3,695,000	3,745,000	4,079,000	4,081,000	386,000	10%
D. R. T. Diber	3,354,000	3,454,000	4,486,000	4,491,000	1,137,000	34%
D. R. T. Durres	15,260,000	15,785,000	17,027,000	17,397,000	2,137,000	14%
D. R. T. Elbasan	7,320,000	7,480,000	7,974,000	7,982,000	662,000	9%
D. R. T. Fier	8,521,000	8,735,000	9,367,000	9,427,000	906,000	11%
D. R. T. Gjirokaster	2,734,000	2,755,000	2,810,600	2,822,600	88,600	3%
D. R. T. Korce	5,692,000	5,802,000	6,237,000	6,244,000	552,000	10%
D. R. T. Kukes	1,932,000	1,937,000	2,113,000	2,115,000	183,000	9%
D. R. T. Lezhe	3,825,000	3,955,000	4,279,000	4,284,000	459,000	12%
D. R. T. Sarande	2,041,000	2,106,000	2,297,000	2,320,000	279,000	14%
D. R. T. Shkoder	6,113,000	6,373,000	6,875,000	6,880,000	767,000	13%
D. R. T. Tirane	109,110,000	110,490,000	115,140,000	116,783,000	7,673,000	7%
D. R. Tatimpaguesit e medhenj	108,891,000	108,531,000	117,348,400	117,648,400	8,757,400	8%
D. R. T. Vlore	5,660,000	5,800,000	6,122,000	6,180,000	520,000	9%

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se në raport në ligjin fillestar, të ardhurat janë ndryshuar në rritje në total për 24,507 milion lekë të planifikuara për tu mbledhur nga administrata tatimore deri në efektet e planit sipas Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022. Në vlerë absolute, efektet më të mëdha për mbledhjen e këtyre të ardhurave janë përfshirë për Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me rritje prej 7,673 milion lekë dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj me rritje prej 8,757.4 milion lekë, të cilët përbëjnë edhe peshën më të madhe në raport me totalin e të ardhurave. Nga ana tjetër, në peshë specifike në raport me planifikimin fillestar rritja më e madhe në planin e të ardhurave i atribuohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër me 34% dhe në vijim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës dhe Sarandë me 14%, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër me 13%, etj.

2.2. Realizimi i të ardhurave tatimore

Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2022, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 308.7 miliard lekë dhe janë realizuar 308.0 miliard lekë, me mosrealizim në vlerë prej 0.6 miliard lekë ose 0.2 % më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, me realizim të ardhurash 274.9 miliard lekë, rritja e të ardhurave tatimore është 33.1 miliard lekë më shumë ose 12.0 % më shumë. Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë dhe sipas paraqitjes në evidencën e raportit të performancës të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rezultojnë:

Tabela nr. 3 Realizimi i të ardhurave tatimore.

Në mijë lekë

	EMERTIMI	FAKTET		PLANI përfundimta r	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2022-2021	
		2021	2022		+ ose -	Përqin	+ ose -	Përqindj
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	274,974,889	308,041,399	308,655,000	(613,601)	-0.20%	33,066,509	12.03%
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	168,708,730	189,576,226	193,000,000	(3,423,774)	-1.77%	20,867,497	12.37%
1	TVSH (bruto)	54,461,470	57,068,399	56,000,000	1,068,399	1.91%	2,606,929	4.79%
	- TVSH (neto)	30,359,542	34,530,079	37,500,000	(2,969,921)	-7.92%	4,170,536	13.74%
	- Rimbursimi i kryer	24,102,122	22,481,061	18,500,000	3,981,061	21.52%	(1,621,061)	-6.73%
2	Tatim mbi Fitimin	35,664,554	47,796,671	46,000,000	1,796,671	3.91%	12,132,116	34.02%
3	Ardhura Personale	43,801,087	50,695,820	47,000,000	3,695,820	7.86%	6,894,733	15.74%
4	Taksat Nacionale	13,429,961	13,666,033	18,900,000	(5,233,967)	-27.69%	236,072	1.76%
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	19,706,202	18,249,964	23,400,000	(5,150,036)	-22.01%	(1,456,238)	-7.39%
6	Lojrat e Fatit	1,534,803	1,972,682	1,700,000	272,682	16.04%	437,879	28.53%
7	Dënimet Administrative	110,653	126,659	0	126,659		16,006	14.47%
B	Te Ardhurat Tatimore (neto)	144,606,607	167,095,166	174,500,000	(7,404,834)	-4.24%	22,488,558	15.55%
C	Kontributet e Sigurimeve	106,266,160	118,465,172	115,655,000	2,810,172	2.43%	12,199,012	11.48%
D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	250,872,767	285,560,338	290,155,000	(4,594,662)	-1.58%	34,687,571	13.83%

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se të ardhurat tatimore nga tatimet dhe taksat e tarifave kombëtare paraqiten me mosrealizim në terma neto prej 7.4 miliard lekë ndërkohë që janë tejkalluar të ardhurat nga kontributet me 2.8 miliard lekë, që në total kanë sjell një efekt me mos realizim prej rreth 4.6 miliard lekë. Mos realizimet më të mëdha paraqiten në zërin e të ardhurave nga taksat, tarifave nacionale dhe të tjera në shumën 5.2 miliard lekë si dhe taksa e qarkullimit rrugor me mos realizim në shumën 5.15 miliard lekë. Efekt negativ në realizimin e të ardhurave tatimore ka sjellë edhe tejkallimi i rimbursimit të miratuar me rreth 4 miliard lekë si pasojë e kryerjes së rimbursimeve përtej vlerës së autorizuar me ligjin nr. 115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar.

Të ardhurat tatimore për vitin 2022 janë rakorduar me shkresën nr. 1304 datë 27.01.2023 me Degën e Thesarit Tiranë në përputhje me kërkesat rregullore për kryerjen e rakordimeve me bazë vjetore në lidhje me të ardhurat progresive. Në këtë rakordim janë përfshirë të ardhurat në nivel analitik. Në bazë të rakordimit të raportit të nxjerrë nga sistemi c@ts me konfirmimin e të ardhurave të raportuara dhe kontabilizuara edhe nga Dega e Thesarit Tiranë në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë janë kryer testime në lidhje me llogaritë analitike sipas çdo lloji të tatimit të raportuar. Në këtë mënyrë, e analizuar sipas llojit përkatës të tatimit dhe shpërndarjes së zërave analitike të të ardhurave, situata paraqitet me rregullimet e mëposhtme:

Tabela nr. 4 Të ardhurat tatimore analitike

Në lekë

	Lloji i te ardhurave	Fakti 2022 Statistikore ne leke
A	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto) pa rivlerësim (Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	302,429,444,905.90
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim) <i>Nga te cilat:</i>	183,965,015,853.90
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	57,068,398,814.00
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	34,587,337,872.00
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	22,481,060,942.00
2	Tatim mbi Fitimin	47,796,670,663.00
3	Ardhura Personale	45,084,608,950.90
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale	13,666,033,206.00
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	18,249,963,768.00
6	Lojrat e Fatit	1,972,681,567.00
7	Te tjera pa identifikuar	
8	Dënimet Administrative	126,658,885.00
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	161,483,954,911.90
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	118,465,172,156.00
	- Tarifa jo Tatimore	3,295,493,117.00
E	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto) pa rivlerësim	279,949,127,067.90
	" - Tatim fitimi I thjeshtuar	59,431,163.00
	Totali I te ardhurave ne E TAX	305,784,369,185.90
	Te ardhura nga Rivlerësimi	5,611,952,623.50
	Totali Bruto për efekt realizim Plani	308,041,397,529.40
	Rimbursimi	22,481,060,942.00
	Totali Neto për efekt realizim Plani	285,560,336,587.40

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Me qëllim ndjekjen e analizës së realizimit të të ardhurave sipas planit përkatës të përcjellë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar me akte normative përgjatë vitit, u kryqëzuan të dhënat e paraqitura nga DPT për efekt të realizimit të planit me ato të paraqitura në akt rakordim me thesarin si dhe bazuar në detajimin e shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Nga auditimi konstatohet se sipas rakordimit me degën e thesarit mbi arkëtimet në sistemin e-tax në shumën totale 305,784,369,185.9 lekë janë përfshirë edhe arkëtimet për tarifën jo tatimore në shumën 3,295,493,117 lek ose rreth 1% e të ardhurave, të cilat nuk kanë një plan për tu mbledhur nga administrata tatimore dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në shumën 59,431,163 lekë për të cilat administrata tatimore vepron në rolin e agjentit të mbledhjes së tyre për llogari të të tretëve. Llojet e tarifave jo tatimore analitike të cilat nuk janë të shoqëruara me plan për mbledhjen e tyre përfshijnë:

Tabela nr. 5 Lloji i tarifave

Në lekë

Kodi i te ardhurave	Pershkrimi	Shuma
7110101	Tarife per Sherbimet Konsullore	350,301,984
7110102	Tarife Per paisjen me Dëshmi Aftesie per Drejtim Automjeti	329,722,675
7110115	Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me avion	872,971,396
7110117	Tarife sherbimi per sherbimet e radiokomunikacionit	460,005,491
7110119	Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve televizive	1,282,491,571
	Shuma	3,295,493,117

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

-Në treguesit e realizimit të të ardhurave nga DPT, janë përfshirë për efekt të analizës së tyre për vitin buxhetor 2022 të ardhurat e realizuara nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme sipas të përcaktimit të legjislacionit të përkohshëm të ligjit nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar për stimulimin e rivlerësimit të pronave nga pronarët individë apo tatimpagues të regjistruar. Ky proces është realizuar duke i trajtuar këto të ardhura si të ardhura dytësore për të cilat nuk është plotësuar një deklaratë e të ardhurave tatimore nga ASHK me drejtoritë vendore përkatëse në rolin e agjentit tatimor, sikurse trajtohen arkëtimet normale nga tatimi mbi fitimin e realizuar nga fitimi kapital si pasojë e rritjes së vlerës së pasurive të paluajtshme. Efekti i këtyre të ardhurave të përkohshme me normë të reduktuar tatimore nga rivlerësimi sipas akt rakordimeve të degëve të thesarit në rrethe me DRT dhe drejtoritë vendore të ASHK si dhe përmbledhëses së vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar raportohet në shumën 5,611,952,623.5 lekë ose rreth 2% e të ardhurave. Efekti i përkohshëm i ligjit të mësipërm është përcaktuar në nenin 5 të tij ku është përcaktuar efekti deri në 30 prill 2022.

Si pasojë e këtyre elementëve të mësipërm, efekti në mos realizimin e të ardhurave tatimore është më i madh se ai i raportuar në evidencën e të ardhurave në DPT.

Për këto arsye, nga grupi i auditimit është rindërtuar tabela e realizimit të të ardhurave tatimore sipas planit të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duke e krahasuar me të dhënat e realizimit të planit pasi janë marrë në konsideratë edhe faktorët e mësipërm. Në vijim janë analizuar në mënyrë analitike llogaritë nga të cilat përbëhet secili zë i të ardhurave të raportuara, është krahasuar me pjesën përkatëse të raportuar në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe janë paraqitur argumente të cilat gjatë vitit buxhetor 2022 kanë ndikuar në tejkalimin apo mosrealizimin e të ardhurave tatimore në përgjegjësi mbledhje të administratës tatimore. Tabela e rindërtuar sipas shpërndarjes vetëm për të ardhurat tatimore pa përfshirë efektin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqitet:

Tabela nr. 6 Të ardhurat sipas llojit

Në lekë

Te ardhurat sipas llojit		Fakti 2021	Plani final 2022	Fakti 2022	Plan- fakt	% e realizimit	Fakt 2022- fakt 2021
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	168,708,730	193,000,000	183,965,016	-9,034,984	-4.7%	15,256,286
1	TVSH (bruto)	54,461,470	56,000,000	57,068,399	1,068,399	1.9%	2,606,929
	- TVSH (neto)	30,359,542	37,500,000	34,587,338	-2,912,662	-7.8%	4,227,796
	- Rimbursimi i kryer	24,102,122	18,500,000	22,481,061	3,981,061	21.5%	-1,621,061
2	Tatim mbi Fitimin	35,664,554	46,000,000	47,796,671	1,796,671	3.9%	12,132,117
3	Ardhura Personale	43,801,087	47,000,000	45,084,609	-1,915,391	-4.1%	1,283,522
4	Taksat Nacionale	13,429,961	18,900,000	13,666,033	-5,233,967	-27.7%	236,072
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	19,706,202	23,400,000	18,249,964	-5,150,036	-22.0%	-1,456,238
6	Lojrat e Fatit	1,534,803	1,700,000	1,972,682	272,682	16.0%	437,879
7	Dënimet Administrative	110,653	0	126,659	126,659		16,006
	Te Ardhurat Tatimore (neto)	144,606,607	174,500,000	161,483,955	-13,016,045	-7.5%	16,877,348

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A. Të Ardhurat Tatimore.

Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2022, të ardhurat tatimore janë programuar 193.0 miliard lekë dhe janë realizuar 189.6 miliard lekë, me një mosrealizim prej 3.4 miliard lekë ose 1.8% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën të ardhurat u realizuan 168.7 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 20.9 miliard lekë ose 12.4 % më shumë. Nga auditimi konstatohet se të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në shumën 183,9 miliard lekë dhe diferenca me raportimin e DPT qëndron në faktin se janë përfshirë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në të

ardhura tatimore, trajtuar më hollësisht më sipër. Në krahasim me planin përfundimtar prej 193 miliard lekë, efekti i mos realizimit paraqitet në shumën 9 miliard lekë, megjithëse në raport me një vit më parë të ardhurat janë realizuar 15.2 miliard lekë më tepër. Në terma neto, të ardhurat janë realizuar në shumën 161.5 miliard lekë, përkundrajt planit prej 174.5 miliard lekë, me një mos realizim në shumën 13 miliard lekë e ndikuar nga tejkalimi i rimbursimeve të kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar më tepër se plani për rreth 4 miliard lekë. Të analizuara sipas llojit të tatimeve, me përjashtim të tatimit mbi fitimin, problematika paraqiten në drejtim të mos realizimit me ndikim më të madh nga taksat nacionale dhe taksa e qarkullimit rrugor.

A.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar. Për 12 mujorin 2022, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (bruto) ishin programuar në vlerën prej 56.0 miliard lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 57.1 miliard lekë, me një realizim në vlerë prej 1.1 miliard lekë ose 1.9% me shumë. Krahasimi i tatimit mbi vlerën e shtuar me planin dhe në raport me një vit më parë duke marrë në konsideratë edhe rimbursimin paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 7 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Në mijë lekë

Lloji i te ardhurës	Fakti 2021	Plani përfundimtar 2022	Fakti 2022	Diferenca nga plani	% e realizimit	Diferenca nga fakti 2021
TVSH (bruto)	54,461,470	56,000,000	57,068,399	1,068,399	1.9%	2,606,929
- TVSH (neto)	30,359,542	37,500,000	34,587,338	-2,912,662	-7.8%	4,227,796
- Rimbursimi i kryer	24,102,122	18,500,000	22,481,061	3,981,061	21.5%	-1,621,061

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuan 54.5 miliard lekë, të ardhurat nga TVSH-ja, janë arkëtuar 2.6 miliard lekë ose 4.8% më shumë.

Për 12 mujorin 2022 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 18.5 miliard lekë dhe është realizuar në vlerën 22.5 miliard lekë me një realizim prej 4 miliard lekë ose 21.5% më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 në të cilën janë rimbursuar 24.1 miliard lekë, rimbursimet janë realizuar me 1.6 miliard lekë ose 6.7% më pak.

Nga auditimi konstatohet se në terma neto, të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar paraqiten me mos realizim në shumën 2.9 miliard lekë, duke qenë se efekti i rimbursimit të kryer përtej planit të miratuar me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar prej 4 miliard lekë është më i madh se tejkalimi prej 1.1 miliard lekë në të ardhurat bruto nga tatimi mbi vlerën e shtuar të arkëtuara nga administrata tatimore sipas planit të ndryshuar përfundimtar.

Në terma bruto, konstatohet se realizimi i të ardhurave tatimore në krahasim me një vit më parë është vetëm 2.6 miliard lekë më shumë, duke mos reflektuar rritjen në të ardhura tatimore shtesë të efekteve të inflacionit të përgjithshëm në nivelin e çmimeve si tregues real i nivelit të qarkullimit të realizuar. Ky konkluzion vjen pasi rritja në të ardhura tatimore nga tatimi mbi vlerën e shtuar vlerësohet të jetë rreth 4.8% në krahasim me një vit më parë ndërkohë që inflacioni mesatar i raportuar është 6.7%.

Të ardhurat bruto nga tatimi mbi vlerën e shtuar bruto janë raportuar në shumën 57,068 milion lekë, të cilat përfshijnë llogaritë analitike të të ardhurave nga tvsh, kamatvonesat dhe depozitimet e përkohshme në formën e paraarkërtimit, pa efektin e rimbursimeve të kryera, sipas llogarive të mëposhtme:

Tabela nr. 8 Të ardhurat bruto nga tatimi mbi vlerën e shtuar

Në lekë

Kodi i te ardhurave	Përshkrimi	Shuma
7030100	Tatimi mbi vlerën e shtuar	34,341,606,744.00
7090102	Kamat vonesa nga Tatimi mbi vlerën e shtuar	73,275,875.00

4665504	<i>Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar</i>	184,223,821.00
Shuma		34,599,106,440.00

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në treguesit fiskalë të konsoliduar dhe në kryqëzimin e të dhënave të raportuara me ato të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, tvsh në terma bruto raportohet në shumën 56,995 milion lekë ndërkohë që në terma neto raportohet në shumën 34,514 milion lekë. Diferenca në terma bruto konstatohet se i përket përfshirjes së raportimit të kamatvonesave sipas llogarisë 7090102 “Kamatvonesa nga tatimi mbi vlerën e shtuar” në shumën 73,275,875 lekë për efekt të realizimit të planit nga ana e drejtorisë së përgjithshme të tatimeve. Ndërkohë, depozitimet e përkohshme në llogarinë 4665504 janë raportuar në të dyja rastet si e ardhur për efekt të realizimit të të ardhurave tatimore përgjatë vitit buxhetor. Për sa i përket diferencës në të ardhura neto të raportuara konstatohet se ajo vjen edhe si pasojë e rimbursimit të kryer nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Rimbursimet e kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar nga aparati qendror i DPT raportohen në shumën 22,469,292,374 lekë ndërkohë që nga drejtoritë rajonale tatimore është rimbursuar shuma prej 11,768,568 lekë, në total rimbursuar në shumën 22,481,060,942 lekë. Kjo vlerë e rimbursimit në total të kryer për vitin buxhetor 2022 rakordon me shumën e paraqitur në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për buxhetin e shtetit të vitit 2022.

Rimbursimet e kryera nga Drejtoritë Rajonale Tatimore të cilat kanë kaluar nëpërmjet llogarisë 7030100 “TVSH mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit” në shumën 11,768,568 lekë paraqiten sipas aneksit 3.

Për pagesat e raportuara si rimbursim TVSH, konstatohet se përfshijnë pagesa në zbatim të vendimeve të gjykatave apo pagesa të kryera për pagesa të kryera më tepër, të cilat nuk duhet të kryhen nga ana e drejtorive rajonale tatimore duke qenë se rimbursimi kryhet që nga viti 2015 i qendëruar nëpërmjet drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së në njësinë shpenzuese drejtorinë e përgjithshme të tatimeve.

A. 2. Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, sipas raportimit të DPT janë programuar 46.0 miliard lekë dhe janë arkëtuar 47.8 miliard lekë, me një realizim prej 1.8 miliard lekë ose 3.9% më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuan 35.7 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 12.1 miliard lekë ose 34.0% më shumë. Këto të ardhura përfshijnë llogaritë analitike të të ardhurave, kamatvonesat dhe depozitimet e përkohshme sipas llogarive të mëposhtme:

Tabela nr. 9 Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin

Në lekë

Kodi i te ardhurave	Përshkrimi	Shuma
7001100	<i>Tatimi mbi Fitimin nga Ndërmarrjet e Sektorit Publik</i>	1,409,210,047.00
7001200	<i>Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat</i>	12,005,652,931.00
7001300	<i>Tatimi mbi fitimin nga Subjektet e "Lojrave te Fatit"</i>	236,050,533.00
7090106	<i>Kamat vonesa nga Tatim Fitimi</i>	103,875,360.00
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	34,041,881,792.00
Shuma		47,796,670,663.00

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se sipas llogarive analitike akumulimi i gjendjes së të ardhurave nga tatimi mbi fitimin është realizuar në pjesën më të madhe nga parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin në formën e depozitimeve të përkohshme për deklaratën e tatimit mbi fitimin. Efekti i të ardhurave të pritshme më të larta nga tatimi mbi fitimin e kompanive është reflektuar në kohë në rritjen e planit në ndryshim nga projeksionet fillestare të bëra me ligjin nr.115/2021, nëpërmjet akteve normative gjatë vitit, ndikuar nga krahasimi i parapagimeve të mëparshme me deklaratat e tatim fitimit përfundimtare të dorëzuara nga tatimpaguesit në mars të vitit 2022 dhe kjo ka sjellë automatikisht edhe rishikimin në rritje të kësteve të

parapagimit të tatim fitimit për vitin fiskal 2022. Klasifikimi i kësteve të tatimit mbi fitimin në llogarinë 4665503 “*Depozitime të përkohshme për deklaratën e tatimit mbi fitimin*” në shumën 34,041,881,792 lekë konstatohet se krijon detyrime për mjete në ruajtje në konsolidim sipas pasqyrave financiare të konsoliduara. Me raportimin e pagesës së kësteve të tatim fitimit në llogarinë e parapagimeve si veprimi i parë për njohjen në formën e të ardhurës si dhe me dorëzimin e deklaratave në mbyllje të vitit financiar (kontabilizimin e tyre në llogarinë 7001 “*Tatimi mbi fitimin*”) rezulton se nuk kryhet veprimi i anulimit të parapagimeve të cilat kalojnë në të ardhura dhe netimi i llogarive të kreditorëve të mjeteve në ruajtje. Konstatohet se procesimi i transaksioneve financiare për pagesat të cilat kryhen për tatimin mbi fitimin, nuk kontabilizohen në llogarinë e të ardhurave sipas klasës 7 dhe në të njëjtën kohë praktika aktuale nuk bën netimin e llogarisë së parapagimeve me dorëzimin e deklaratës finale të tatimit mbi fitimin nga ana e tatimpaguesit.

-Nga auditimi mbi rakordimin me të dhënat e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar konstatohet se janë raportuar të ardhura nga tatimi mbi fitimin shuma prej 47,683 milion lekë. Efekti i mosrakordimit me të dhënat e paraqitura nga DPT vlerësohet në rreth 114 milion lekë. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në mosrakordim konstatohet se janë përfshirja e kamatvonesave si e ardhur dhe mos evidentimi i kthimeve të këtij tatimi të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore. Nga krahasimi i llogarive analitike të të ardhurave konstatohet se në raportim nga DPT nuk janë përfshirë kthimet e tatim fitimit të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi fitimin të cilat zvogëlojnë tepricën e llogarisë 7001200 “*Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat*” në shumën 14,383,565 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 10 Llog. “*Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat*”

Në lekë

Kod inst	Institucion	Accrual
1010040	Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane (3535)	(90,000)
1010047	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës (0707)	(9,890,326)
1010049	Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (0909)	(874,932)
1010055	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë (1515)	(3,034,279)
1010076	Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore (3737)	(494,028)
Shuma		(14,383,565)

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Faktori i dytë që ndikon në mosrakordimin e të dhënave të raportuara nga DPT me atë të treguesve fiskalë të konsoliduar konstatohet se është teprica e llogarisë 7090106 “*Kamatvonesa nga tatim fitimi*” në shumën 104 milion lekë që për efekt të planit është raportuar si e ardhur tatimore nga DPT ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar është raportuar në zërin e të ardhurave jo tatimore. Përsa i përket depozitimeve të përkohshme për tatimin e fitimit konstatohet se është raportuar në të dyja rastet si e ardhur tatimore që lidhet me arkëtimet e vitit buxhetor.

A.3. Tatimi mbi të Ardhurat Personale është programuar 47.0 miliard lekë dhe është realizuar 50.7 miliard lekë sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me një realizim prej 3.7 miliard lekë ose 7.9% më shumë sipas raportimit në raportin e performancës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 43.8 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 6.9 miliard lekë ose 15.7% më shumë. Në treguesit fiskalë të konsoliduar sipas buxhetit të konsoliduar të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë raportuar në shumën 44,983 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se diferenca prej rreth 5.7 miliard lekë vjen në pjesën më të madhe si pasojë e të ardhurave nga rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme të cilat në zbatim të udhëzimit nr. 2727 datë 04.02.2020 “*Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit*”. Këto të ardhura në shumën 5,611,952,623.5 lekë janë përcjellë me evidencat analitike të konfirmuara

edhe nga DRT dhe degët e thesarit sipas shkresës nr. 1765 datë 06.02.2023 të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës në llogaritë analitike 7020400 “Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve” në shumën 290,359,990.68 lekë dhe llogarisë 7020800 “Të ardhura nga rivlerësimi” në shumën 5,321,592,632.82 lekë. Bazuar në këtë faktor ndikues në mos rakordim, për përcaktimin e shumës së saktë të raportueshme sipas planit të përcjellë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë lloj tatimi, auditimi u detajua në drejtim të llogarive analitike të tjera të përfshira në raportimin për tatimin mbi të ardhurat personale. Sipas llogarive analitike të të ardhurave të cilat janë konfirmuar me degën e thesarit Tiranë, raportohen të realizuara sipas natyrës në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 11 Llogaria analitike e të ardhurave

Në lekë

Kodi i te ardhurave	Përshkrimi	Shuma
7000100	Nga te punësuarit e Sektorit Buxhetor dhe Publik	10,054,675,066
7000100	Ditar manual nga Dega thesarit Tirane	743,104
7000200	Nga te punësuarit e Sektorit privat	18,200,281,968
7000300	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	2,198,300,121
7000400	Tatim mbi te Ardhurat nga Qiratë	4,625,442,876
7000500	Tatim mbi Fituesit e Lojrave te Fatit	83,937,995
7000600	Tatim mbi te ardhurat personale biz vogël	1,495,997
7000700	Tatim për Deklaratën Individuale Vjetore te te Ardhurave	1,033,690,626
7000900	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	2,628,743,129
7009100	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet	4,242,746,890
7009200	Tatim mbi te Drejtën e Autorit dhe Pronësinë Intelektuale	344,594,581
7021100	Tatim, shitja e pasurisë se paluajtshme	1,451,346,492
7021200	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi	39,879,031
7090112	Kamat vonesa nga Tatim ne Burim	22,962,901
7090114	Kamat vonesa nga Tatim DIVA	6,097,004
7090115	Kamat vonesa nga TABV	50,211
7090116	Kamat vonesa nga Tatim mbi te ardhurat nga punësimi	22,627,885
7115652	Gjoha për deklarim Tatim ne burim	45,906,630
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	81,086,444
Shuma		45,084,608,951

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se shuma e mësipërme prej 45,084.6 milion lekë nuk rakordon me shumën e raportuar në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

- ditar manual në llogarinë 7000100 “nga të punësuarit e sektorit buxhetor dhe publik” e evidentuar në rakordimin e kryer nga DPT me degën e thesarit Tiranë në shumën 743 mijë lekë.

- kthimit të tatimit që është realizuar nga DRT për llogarinë 7000900 “Të tjera tatime mbi të ardhurat në burim” sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

DRT	Shuma
Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane Vipat	(3,339,162)
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat (0202)	(89,128)
Shuma	(3,428,290)

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

-raportimit nga ana e DPT të kamatvonesave në llogaritë 7090112-7090116 në shumën totale 97,644.6 mijë lekë për efekt të realizimit të planit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Përsa i përket depozitimeve të përkohshme për deklaratën e tatimit në burim, në të dy raportimet është klasifikuar si e ardhur tatimore.

Nga auditimi mbi krahasimin me planin analitike sipas zërave të tatimit mbi të ardhurat personale, krahasimi paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12 Tatimi mbi të ardhurat personale

Në lekë

		Plani përfundimtar	Fakti 2022	Diferenca	% realizimit
A.	Tatimi mbi të ardhurat personale	47,000,000	44,905,135	-2,094,866	-4.46%
1	Tatimi mbi pagë nga listëpagesa	26,695,794	28,254,957	1,559,163	5.84%
I,1	Nga të punësuarit e Sektorit Publik	10,211,197	10,054,675	-156,521	-1.53%
I,2	Nga të punësuarit e Sektorit Privat	16,484,597	18,200,282	1,715,684	10.41%
2	Tatim mbi të Ardhurat nga Interesat	2,198,849	2,198,300	-549	-0.02%
3	Tatim mbi të Ardhurat nga Qeratë	4,618,245	4,625,443	7,198	0.16%
4	Tatim mbi Fituesit e Lojrave të Fatit	58,482	83,938	25,456	43.53%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogël me xhiro 2-8 mln leke	-	1,496	1,496	
6	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	2,844,429	2,628,743	-215,686	-7.58%
7	Tatimi mbi të ardhurat nga Dividentët dhe Aksionet	4,031,437	4,242,747	211,310	5.24%
8	Tatim mbi të Drejtën e Autorit dhe Pronësise Intelektuale	281,319	344,595	63,275	22.49%
9	Tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave	1,129,675	1,033,691	-95,985	-8.50%
10	Tatim, shitja e pasurisë së paluajtshme	5,128,618	1,451,346	-3,677,272	-71.70%
11	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi	13,152	39,879	26,728	203.23%

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se ky zë nuk është realizuar për rreth 2 miliard lekë me efektin më të madh nga të ardhura nga mos realizimi i tatimit nga shitja e pasurisë së paluajtshme duke qenë se për pjesën më të madhe të vitit kanë qenë në fuqi efektet e përkohshme të ligjit nr. 90/2019 të trajtuara më sipër. Ndër zërat analitikë që kanë ndikuar pozitivisht në tatimin mbi të ardhurat personale paraqitet performanca e mirë e tatimit nga listëpagesat për sektorin privat e ndikuar kryesisht nga operacionet e administratës tatimore në drejtim të rritjes së nivelit real të deklarimit të të ardhurave nga punësimi. Ky tregues paraqitet se ka ndikuar në rritje me rreth 1.7 miliard lekë, pavarësisht se gjatë vitit 2022 është ndryshuar me ligjin 113/2021 tabela e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi e përcaktuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, me efekt lehtësues së barrës tatimore si pasojë e ndryshimit të pragjeve të taksueshme dhe normave të aplikuar me efekt nga data 01.07.2023, dhe në vijim me Aktin Normativ nr. 4, datë 12.3.2022 efekti i aplikimit të këtyre ndryshimeve është përcaktuar data 01.04.2022.

A.4. Taksa kombëtare dhe të tjera

A.4.1. Taksat Kombëtare dhe Tarifa. Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 18.9 miliard lekë dhe janë arkëtuar 13.7 miliard lekë, me një mosrealizim 5.2 miliard lekë ose 27.7% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuar 13.4 miliard lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 0.2 miliard lekë ose 1.8 % më shumë. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në lidhje me realizimin sipas çdo komponenti të taksave dhe tarifave kombëtare për të cilat është paraqitur plan nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë paraqiten të dhënat e mëposhtme:

Tabela nr. 13 Taksat dhe Tarifa Kombëtare

Në mijë lekë

Pershkrimi	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan fillestar 2022	Plan final 2022	Plan final - fakt 2022	% realizimit planit 2022
TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	13,429,960	13,666,033	19,260,000	18,900,000	(5,233,967)	-27.69%
Tarifa Kombëtare	917,555	908,818	1,272,000	1,272,000	(363,182)	-28.55%
Taksa Kombëtare	12,512,406	12,757,215	17,988,000	17,628,000	(4,870,785)	-27.63%
Tarife shërbimi per Qarkullimin e Automjeteve te Huaja	64,069	77,707	100,000	100,000	(22,293)	-22.29%
Tarife per rregjistrimin e Lojrave te Fatit , Llotarive , Kazinovave etj	130,140	142,289	0	0	142,289	
Tarife shërbimi per licensat radiotelevizive	13,350	10,930	22,000	22,000	(11,070)	-50.32%

Takse nacionale per lejen e ushtrimit te veprimtarise se peshkimit	23,414	22,745	35,000	35,000	(12,255)	-35.02%
Takse nacionale e karbonit per benzinën, benzolin dhe gazoilin	2,935,722	2,276,150	4,000,000	4,000,000	(1,723,850)	-43.10%
Takse nacionale per ambalazhet plastike te lengjeve te ambalazhuara	2,185,032	1,964,780	3,200,000	3,200,000	(1,235,220)	-38.60%
Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit shteteror	960	1,429	2,000	2,000	(571)	-28.54%
Taksë mbi Primet e shkruara	1,453,885	1,540,201	2,300,000	2,300,000	(759,799)	-33.03%
Taksa per regjistrim fillestar per automjete luksoze	153,343	150,290	250,000	250,000	(99,710)	-39.88%
Taksa e pervitshme per automjetet luksoze	247,772	265,384	400,000	400,000	(134,616)	-33.65%
Takse per automjetet e perdorura te transportit	4,437,223	5,419,441	6,000,000	5,860,000	(440,559)	-7.52%
Taksa portuale	662	807	1,000	1,000	(193)	-19.30%
Taksa e Akteve dhe e Pulles	206,529	155,653	300,000	300,000	(144,347)	-48.12%
Taksa e rentes minerare	864,641	958,902	1,500,000	1,280,000	(321,098)	-25.09%
Tarife per Regjitrime ne arsimin e Larte	143,300	159,214	250,000	250,000	(90,786)	-36.31%
Tarifa per pasaporte lundrimi te personave	1,438	1,127	0	0	1,127	0.00%
Tarifa per aktet administrative	563,376	516,555	900,000	900,000	(383,445)	-42.60%
Taksa e rentes per Hidrokarbure	0	116	0	0	116	
Tarife , gjoha, interesa	1,882	997	0	0	997	
Taksa te tjera , gjoha, interesa	3,223	1,317	0	0	1,317	

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi mbi performancën e taksave dhe tarifave kombëtare konstatohet se mosrealizimi prej 5.2 miliard lekë ka ardhur në pjesën më të madhe si pasojë e mos realizimit të taksës nacionale të karbonit (për benzinën, benzolin dhe gazoilin) si dhe taksës nacionale për ambalazhet plastike, me efekt në total prej rreth 3 miliard lekë. Efekt tjetër negativ në mos realizim paraqesin edhe taksa mbi primet e shkruara për policat e sigurimit, taksa e rentës minerare si dhe taksa për automjetet e përdorura të transportit rrugor, me efekt në total prej 1.5 miliard lekë. Përsa i përket tarifave kombëtare konstatohet se mos realizimi ka ardhur kryesisht si pasojë e mungesës së realizimit të tarifave për aktet administrative me efekt prej rreth 0.4 miliard lekë.

A.4.2. Taksa e Qarkullimit Rrugor. Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 23.4 miliard lekë, janë arkëtuar 18.2 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 5.2 miliard lekë ose 22.0% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuan 19.7 miliard lekë, të ardhurat janë realizuar me ulje prej 1.5 miliard lekë ose 7.4 % më pak.

A.4.3. Të ardhurat nga lojrat e fatit raportohen se janë realizuar në shumën 1,972,682 mijë lekë, me një tejkalim prej 272,682 mijë përkundrejt planit përfundimtar prej 1,700,000 lekë. Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura paraqiten në rritje prej 437,879 mijë lekë. Llogaritë analitike për të cilat janë raportuar në total të ardhura nga lojrat e fatit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 14 Të ardhurat nga lojrat e fatit

Në lekë

Kodi I te ardhurave	Përshkrimi	Shuma
7032100	Takse mbi lotaritë	14,876,676
7032200	Takse mbi Bingot dhe Lojrat Aritmetike	21,194,286
7032300	Takse mbi Automatet e Lojrave te Fatit dhe Bingot	4,724,874
7032400	Takse mbi Kazinote	1,930,888,304
7090105	Kamat vonesa nga Tatim mbi lojrat e fatit	851,865

7115650	Gjoha per deklarim te vonuar lojra fati	30,000
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	115,562
		1,972,681,567

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Pavarësisht se paraqiten me tejkalim përgjatë vitit 2022, të krahasuar me planin fillestar prej rreth 4 miliard lekë, këto të ardhura paraqiten në realizim me diferenca prej rreth 2 miliard lekë. Shkaku i këtyre diferencave në raport me planin fillestar i cili është reflektuar në ndryshimin me akte normative përgjatë vitit, konstatohet se ka ardhur si pasojë e mos implementimit në kohë të legjislacionit në lidhje me legalizimin e veprimtarisë së lojrave të fatit për sektorë të cilët ishin mbyllur më parë.

Në konkluzion, mosrealizimi më i madh në grupin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare të raportuara në tabelën e treguesve fiskalë si një komponent i taksave nacionale dhe të tjera është shkaktuar nga mos realizimi i taksës së qarkullimit rrugor dhe taksës së karbonit, të cilat janë taksa të indeksuara me sasinë e konsumuar të produkteve dhe nënprodukteve të naftës. Sipas statistikave fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgjatë vitit 2022, importi i karburanteve të cilat janë subjekt i këtyre taksave në sasi ka rënë në raport me një vit më parë sipas tabelës së mëposhtme:

Në ton

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2021	39,753	39,607	46,660	49,105	54,056	56,133	56,775	66,805	53,012	50,744	49,046	49,651	611,346
2022	45,001	42,947	39,194	42,893	44,399	45,280	51,686	58,023	49,780	43,263	46,308	47,951	556,724

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Ulja e konsumit të këtyre mallrave me peshë në të ardhurat buxhetore vlerësohet në 54,622 ton ose 9 % në raport me vitin 2021, të cilat ë kuadër të taksave fikse të indeksuara mbi sasinë e aplikueshme, kanë sjellë një performancë jo të mirë me efekt në mos realizimin e të ardhurave të përgjithshme tatimore në përgjegjësi mbledhje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore. Për vitin 2022, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 115.7 miliard lekë dhe janë realizuar 118.5 miliard lekë, me një rritje prej 2.8 miliard lekë ose 2.4% më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ku këto të ardhura ishin 106.3 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 12.2 miliard lekë ose 11.5 % më shumë. Nga auditimi konstatohet se llogaritë analitike të të ardhurave paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 15 Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Në lekë

Kodi I te ardhurave	Pershkrimi	Shuma
7090101	Kamat vonesa te kontributeve te sig. shoqerore	118,186,207
7090104	Kamat vonesa te kontributeve te sig. shendetsore	20,574,673
7E+06	Gjoha te sigurimeve shoqerore nga punedhenesi	310,611,031
7E+06	Gjoha te sigurimeve shendetsore nga punedhenesi	52,289,145
7E+06	Gjoha per mosdeklarim punonjesish	100,608,973
7E+06	Gjoha per deklarim te vonuar Sig Shoq.shend,dhe tap	73,852,689
75	Kontributet e Sigurimeve Gjithsej	117,633,342,108
750	Kontribute nga te punesuarit	45,065,622,620
7500	Kontribute te sektorit buxhetor te punesuar	16,803,665,795
7500100	Sigurime shoqerore	12,932,812,074
7500200	Sigurime shendetsore	2,402,623,359
7500400	Kontribute suplementar	1,468,230,362
7501	Kontribute te sektorit shteteror te punesuar	2,564,039,658
7501100	Sigurime shoqerore	2,151,671,417
7501200	Sigurime shendetsore	400,839,383

7501400	Kontribute suplementar	11,528,858
7502	Kontribute te sektorit Privat te punesuar	25,697,917,167
7502100	Sigurime shoqerore	20,911,187,742
7502200	Sigurime shendetesore	4,725,722,385
7502400	Kontribute suplementar	61,007,040
751	Kontribute nga te punedhenesi	68,191,075,318
7510	Kontribute te sektorit buxhetor te punedhenes	22,859,007,855
7510100	Sigurime shoqerore	20,442,882,955
7510200	Sigurime shendetesore	2,404,544,476
7510400	Kontribute suplementar	11,580,424
7511	Kontribute te sektorit shteteror te punedhenes	3,809,078,401
7511100	Sigurime shoqerore	3,395,784,190
7511200	Sigurime shendetesore	400,992,810
7511400	Kontribute suplementar	12,301,401
7512	Kontribute te sektorit Privat te punedhenes	41,522,989,062
7512100	Sigurime shoqerore	36,723,946,963
7512200	Sigurime shendetesore	4,724,419,552
7512400	Kontribute suplementar	74,622,547
752	Kontribute nga te vetpunesuarit	4,376,644,170
7520	Kontribute nga te vetpunesuarit	4,376,644,170
7520100	Sigurime shoqerore	3,408,291,528
7520200	Sigurime shendetesore	968,352,642
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën	155,707,330
Shuma		118,465,172,156

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në raportimin e të ardhurave nga kontributet konstatohet se janë përfshirë edhe depozitimet e përkohshme dhe kamatvonesat e gjobat për listëpagesat të cila nuk lidhen vetëm me kontributet por edhe me tatimin mbi të ardhurat personale, si element i listëpagesës për efekt të realizimit të planit. Pa marrë parasysh efektet e mësipërme, të dhënat mbi llojet e kontributeve sipas sektorëve paraqiten:

Tabela nr. 16 Llojet e kontributeve sipas sektorëve.

Në lekë

Kontributet	Buxhetor	Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Totali
Sigurime shoqërore	33,375,695,029	5,547,455,607	57,635,134,705	3,408,291,528	99,966,576,869
Sigurime shëndetësore	4,807,167,835	801,832,193	9,450,141,937	968,352,642	16,027,494,607
Kontribute suplementar	1,479,810,786	23,830,259	135,629,587	155,707,330	1,794,977,962
Totali	39,662,673,650	6,373,118,059	67,220,906,229	4,532,351,500	117,789,049,438

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Pjesa më e madhe e kontributeve realizohen nga sektori privat në rreth 67.2 miliard lekë i ndjekur nga ai buxhetor me 39.7 miliard lekë dhe më tej shtetëror në rreth 6.37 miliard lekë e të vetpunësuarit në rreth 4.53 miliard lekë. Sigurimet shoqërore raportohen të jenë realizuar në rreth 100 miliard lekë, sigurimet shëndetësore në rreth 16 miliard lekë dhe kontributet suplementare në rreth 1.79 miliard lekë. Gjatë vitit 2022 konstatohet se kanë dhënë efekt në rritjen e të ardhurave nga kontributet ndryshimet e bëra në vlerën e pagës minimale në shkallë vendi të cilat kanë ndikuar edhe kufirin e poshtëm edhe kufirin maksimal të deklarimit të kontributeve të sigurimeve, të cilat kanë sjellë rritje të tyre dhe tejkalim të planit. Këto ndryshime janë reflektuar me VKM nr. 158 datë 12.03.2022 ku paga minimale është miratuar në nivelin e 32,000 lekëve (nga 30,000 lekë) dhe me VKM nr. 604 datë 14.09.2022 ku paga minimale është miratuar në nivelin e 34,000 lekëve (nga 32,000 lekë). Këto ndryshime kanë dhënë efekt në rritjen e të ardhurave nga kontributet në kategorinë e të vetëpunësuarve dhe kryesisht në sektorin privat. Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave nga

kontributet për sektorin shtetëror dhe atë buxhetor përgjatë vitit 2022 vlerësohen të jenë edhe politikat në rritjen e pagave sipas vendimmarrjeve të vitit 2022 për sektorë të caktuar të administratës publike dhe mbështetja me fonde të jashtëzakonshme për përbalimin e efekteve të inflacionit për kategori të caktuara. Në të njëjtën kohë me rritjen e të ardhurave buxhetore nga tatimi mbi të ardhurat personale mbi listëpagesën vlerësohet të ketë ndikuar edhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me strategjinë për rritjen e deklarimit real të pagës së të punësuarve.

Në konkluzion, mbi realizimin e të ardhurave tatimore në total konstatohet se raportohen si të ardhura të realizuara për efekt të planit, gjopa të sistemit tatimor në shumën 706,686,752 lekë, me përjashtim të gjobave të tjera të cilat janë raportuar në dënimet administrative në shumën 122,837,286 lekë në kundërshtim Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Llogaria 70 “Tatime dhe taksat”, ku citohet “Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njëjtit të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimore”. Referuar tatimit në të cilin janë shpërndarë, efekti i deklarimit të gjobave në të ardhura paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 17 Gjopa të sistemit tatimor.

Në lekë

Nr. Llogarise	Pershkrimi llogarise	Shuma	Raportuar si e ardhur
7115	Gjopa te sistemit Tatimor	706,686,752	
7115101	Gjopa te sigurimeve shoqerore nga punedhenesi	310,611,031	Kontribute
7115118	Gjopa te sigurimeve shendetsore nga punedhenesi	52,289,145	Kontribute
7115119	Gjopa per mosdeklarim punonjesish	100,608,973	Kontribute
7115499	Te tjera gjopa	122,837,286	
7115650	Gjopa per deklarim te vonuar lojra fati	30,000	Tatime lojrat e fatit
7115651	Gjopa per deklarim te vonuar Tarifa kombetare	83,963	Taksa dhe tarifa nacionale
7115652	Gjopa per deklarim Tatim ne burim	45,906,630	TAP
7115653	Gjopa per deklarim te vonuar Taksa kombetare	467,035	Taksa dhe tarifa nacionale
7115654	Gjopa per deklarim te vonuar Sig Shoq,shend,dhe tap	73,852,689	Kontribute

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Gjithashtu, përveç shumave të raportuara si më sipër, konstatohet se raportohen si e ardhur edhe gjobat e vendosura nga inspektorët tatimorë si pasojë e kontroleve të realizuara në tatimpagues, pasi elementët përbërës të tatim të munguar si pasojë e rivlerësimeve tatimore përfshijnë detyrimin për tatimin dhe gjobën përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Një konkluzion i tillë arrihet pasi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin nuk janë raportuar në asnjë llogari analitike të të ardhurave gjopa, ç’ka sjell raportim të gabuar të të ardhurave referuar kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- Nga auditimi konstatohet se në realizimin e të ardhurave tatimore janë raportuar për efekt realizimi parapagimet e bëra nga tatimpaguesit për tatime të ndryshme përgjatë vitit 2022, në total në shumën 34,473,704,161 lekë, me përjashtim të deklarimeve të përkohshme për gjobat në shumën 3,821,599 lekë raportuar në dënime administrative dhe depozitime të përkohshme për deklaratën e për tatim fitimin e thjeshtuar në shumën 4,365,831 lekë. Referuar tatimit në të cilin janë shpërndarë, efekti i deklarimit të parapagimeve në të ardhura paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 18 Gjoha të sistemit tatimor.

Në lekë

Nr. Llogarise	Pershkrimi llogarise	Shuma	Raportuar si e ardhur
4665	Depozitime te tjera (per tu sistemuar ne te Ardhmen)	34,473,704,161	
4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje , Te vitit ushtrimor	-	
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	81,086,444	TAP
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit Fitimit	34,041,881,792	TF
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	184,223,821	TVSH
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	713,214	Taksa dhe tarifa nacionale
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	492,367	Taksa dhe tarifa nacionale
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	115,562	Tatime lojrat e fatit
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	1,296,201	Taksa dhe tarifa nacionale
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjodat	3,821,599	
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën	155,707,330	Kontribute
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	4,365,831	

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Efekti më i madh i këtyre parapagimeve vlerësohet në deklaratimet për deklarimin e tatimit mbi fitimin në shumën 34,041,881,792 lekë. Konstatohet se përdorimi i kësaj llogarie për tatimet e tjera përveç tatimit mbi fitimin, për realizim të të ardhurave tatimore është jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pasi nuk plotësohen kushtet për klasifikimin si të ardhur duke qenë se nuk lidhen me një pagesë pa kthim. Përsa i përket parapagimeve për tatimin mbi fitimin, konstatohet se përdorimi i llogarisë 466 në momentin e arkëtimit sjell si pasojë nevojën për kryerjen e veprimeve rregulluese në periudhën paraardhëse me qëllim anulimin e efektit të përkohshëm të mbajtjes në ruajtje të mjeteve monetare për pagesa të kryera nga tatimpaguesit. Referuar pasqyrave financiare të konsoliduara dhe komponentit të drejtorisë së kontabilitetit konstatohet se teprica e llogarisë së parapagimeve rezulton për vitin 2022 në rreth 177 miliard lekë, me një rritje prej 34.4 miliard lekë nga viti 2021 ku teprica e llogarisë ishte në shumën 142.7 miliard lekë.

Në lekë

Nr. Llogarise	Pershkrimi llogarise	2022	2021	Burimi
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	177,103,547,953.00	142,654,830,174	Konsoliduar
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	177,113,113,826.00	142,663,396,572	Drej. kontab

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Duke qenë se rritja vjetore e llogarisë është në rreth 34 miliard lekë, e njëjte me shumën e raportuar si depozitime të përkohshme në formën e parapagimeve dhe që vjen në pjesën më të madhe si rezultat i parapagimit për tatim fitimit konstatohet se veprimet rregulluese në lidhje me kalimin e këtyre të mjeteve monetare në ruajtje për efekt të të ardhurave nuk janë realizuar. Si rrjedhojë, kontabilizimi në klasën 4 i parapagimeve për tatim fitimin dhe mos kryerja e veprimeve rregulluese ka sjellë si pasojë akumulimin e gjendjes së lartë të klasës 4 në rreth 177 miliard lekë.

Për problematikat e mësipërme mbajnë përgjegjësi znj. M S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës dhe z. C K, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe është mbajtur me përfaqësuesit e subjektit të audituar Akt konstatimi nr.1 datë 14.07.2023.

Për konstatimet në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë paraqitur observacionet e mëposhtme:

Pretendimi i subjektit:

-për vonesën në shpërndarjen e planit të të ardhurave, ... Grupi i punes merr ne shqyrtim dhe finalizon shpërndarjen e planit te te ardhurave ne nivel DRT-je vetem pasi është njohur zyrtarisht me shkresë/a të MFE per detajim te planit me baze mujore dhe progressive. Per vitin 2022 informacioni zyrtar me shkresa nga MFE ka filluar me date 31.01.2022 dhe eshte plotesuar me date 23.02.2022 me detajimin planit sipas zerave per taksa dhe tarifa kombetare.

Me date 23.02.2022 është ngritur Grupi i punës për detajimin e planit për cdo DRT.

Me date 23.03.2022 Komiteti operacional ka miratuar planin e të ardhurave në nivel DRT-je për vitin 2022 sipas kuotave mujore të përcaktuara nga MFE.

Me date 24.03.2022 Grupi i punës me shkresë nr 2968 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar _ Prill 2022** .

Me date 12.05.2022 Grupi i punës me shkresë nr 7088/1 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Maj 2022, ku është reflektuar ndryshimi i planit sipas shkrësës së MFE nr 7676 date 26.04.2022.**

Me date 03.06.2022 prot 7676/1, Drejtoria kontabilitet Statistike referuar shkresës nga Grupi i punës nr 7088 prot dt 29.04.2022 , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Qershor 2022.**

Me date 30.06.2022 prot 7088/2, Drejtoria kontabilitet Statistike referuar shkresës nga Grupi i punës nr 7088 prot dt 29.04.2022 , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Korrik 2022.**

Me date 29.07.2022 prot 7088/3, Drejtoria kontabilitet Statistike referuar shkresës nga Grupi i punës nr 7088 prot dt 29.04.2022 , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Gusht 2022.**

Me date 06.09.2022 Drejtoria kontabilitet Statistike me shkresë nr 13863/1 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Shtator 2022**, ku është reflektuar ndryshimi i planit sipas AN 12 date 29.07.2022 derguar me shkresë nga MFE nr 15208 ; 15210 date 11.08.2022 protokolluar me tonen nr 13863 dhe 13827 prot dt 12.08.2022 . Theksojme se ndryshimi i planit të të ardhurave sipas AN 12 date 29.07.2022, nga MFE nuk është shoqëruar me detajimin e planit për Taksa nacionale dhe tarifa kombëtare . DPT me shkresën nr 13863/1 prot dt 18.08.2022 ka kërkuar nga MFE detajimin e këtij plani pasi ndryshim sipas AN nr 12 dt 29.07.2022 prek dhe taksat kombëtare në total dhe me bazë mujore nga muaji Mars deri në Dhjetor 2022. Nga ana e MFE ky detajim nuk ka ardhur zyrtarisht asnjëherë deri më 31.12.2022.

Me date 05.10.2022 Drejtoria kontabilitet Statistike me shkresë nr 13863/2 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Tetor 2022**, ku është reflektuar ndryshimi i planit sipas AN 12 date 29.07.2022 derguar me shkresë nga MFE nr 15208 ; 15210 date 11.08.2022 protokolluar me tonen nr 13863 dhe 13827 prot dt 12.08.2022 .

Me date 31.10.2022 Drejtoria Kontabilitet Statistike me shkresë nr 15208/1 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Nëntor 2022**, ku është reflektuar ndryshimi i planit sipas AN 12 date 29.07.2022 derguar me shkresë nga MFE nr 15208 ; 15210 date 11.08.2022 protokolluar me tonen nr 13863 dhe 13827 prot dt 12.08.2022 .

Me date 09.12.2022 Drejtoria Kontabilitet Statistike me shkresë nr 13563/3 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Dhjetor 2022**, ku është reflektuar ndryshimi i planit sipas AN 12 date 29.07.2022 derguar me shkresë nga MFE nr 15208 ; 15210 date 11.08.2022 protokolluar me tonen nr 13863 dhe 13827 prot dt 12.08.2022 .

Me date 16.01.2023 Grupi i punës me shkresë nr 21811/4 prot , ka njoftuar DRT me shkresë zyrtare për planin e të ardhurave **Janar – Dhjetor 2022, ku është reflektuar ndryshimi i planit sipas AN 17 date 01.12.2022 sipas shkrësës së MFE nr 23744 date 27.12.2022 protokolluar me tonen nr 21811 prot dt 29.12.2022.**

Ritheksojme se ndryshimi i planit të të ardhurave sipas AN 17 date 01.12.2022, nga MFE nuk është shoqëruar me detajimin e planit për Taksa nacionale dhe tarifa kombëtare. DPT me shkresën nr 21811/1 prot dt 04.01.2023 ka kërkuar nga MFE detajimin e këtij plani. Nga ana e MFE ky detajim nuk ka ardhur zyrtarisht asnjëherë deri më 16.01.2023, ku Grupi i punës ka derguar versionin final të planit mujor dhe progresiv DRT me shkresën nr 21811/4 dt 16.01.2023.

-për realizimin e të ardhurave tatimore, Referuar konstatimit tuaj për rrillogaritje të realizimit të planit të të ardhurave pa përfshirë në këtë realizim të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive nuk është i drejtë. Të ardhurat nga rivlerësimi janë të ardhura tatimore për të cilat DPT është ngarkuar me plan të ardhurash sipas ligjit për buxhetin e vitit 2022. Për sa më sipër lutem referojuni publikimit të treguesve fiskal ku gjendet të përfshira në fakt dhe plani i këtyre të ardhurave. Për sa më lart tabela e rishikuar të të ardhurave për zerin Tatim mbi të ardhurat personale nuk është e saktë. Për pasoje dhe analizimi i metejshëm duke përjashtuar këto të ardhura në realizimin faktik për DPT, çon në konkluzione të gabuara lidhur me shifrat e realizuara nga DPT për 2022.

-për kontabilizimin e kësteve të tatim fitimit,..... Funksionimi i kesaj llogarie eshte tipike per Administraten Tatimore , pasi pagesat per tatim fitimin jane paraprake dhe detyrimi (maturimi) sipas deklarates behet ne vitin pasardhes fiskal e buxhetor. Ne keto kushte specifikisht per AT eshte pranuar qe kontabilizimi i kesaj pagese te behet ne llogarine 4665503 si mjet ne ruajtje e pasqyruar kjo dhe ne Sistemin Informatik Financiar te Qeverise, sistem i cili eshte dhe Sistemi i Kontabilitetit per Qeverine Shqiptare. Kontabilizimi gjate vitit dhe mbartja e saj ne SIFQ eshte konform rregullave te ligjit per Menaxhimin Financiar dhe Udhezimit nr 8 date 09.03.20018 Per procedurat e mbylljes se llogarive vjetore te njesive qendrore te qeverisjes se pergjithshme. Udhezimi nr 8 percakton per kontabilizimin te ardhurave per tatim fitimi skemen :

Debi llogaria 4665503 Mjete ne ruajtje per Tatim fitimi.

Kredi llogaria 520 Disponibilitete ne thesar.

Pra kontabilizimi eshte konform kerkesave te Udhezimit nr 8 date 09.03.2018. Theksojme se ky udhezim i ndryshuar dhe me udhezimin nr 5 date 21.02.2022 per disa ndryshime te udhezimit nr 8 , nuk parashikon ne asnje rast veprime rregulluese te ketyre llogarive. Nderkohe theksoj se ne sistemin E Tax kjo llogari eshte dinamike dhe vetem me dorezimin e deklarates vjetor per Tatim fitimit teprica e mbetur e pagesave te kryera ne kete llogari shkojne kredi te llogarise 467 Kreditore te tjere per tatim fitimin.

- Për përfshirjen në realizim të ardhurash të kamatvonesave dhe gjobave, Bazuar ne ligjin baze te AT, per Procedurat Tatimore , DPT perfshin ne realizim te te ardhurave sipas llojit te tatimit ne evidencat e saj statistikore dhe arketimet nga kamate vonesat dhe gjobat qe lidhen me nje deklaratë tatimore bazuar ne Ligj i cili percakton se **“Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj,** neni 6 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar. Ne kete kendveshtrim nuk mund te gjykohet mbi realizimin e te ardhurave duke marre ne konsiderate parashikimet e Udhezimit nr 8 date 09.03.2018 Per procedurat e pergatitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore te njesive te qeverisjes se pergjithshme. Udhezimi nr 8 eshte udherrefyese per veprime kontabel te te ardhurave sipas natyres ekonomike e shprehur ne nivel 7 shifror te klasifikimit buxhetor.

Per sa me lart te ardhurat ne sistemin tatimor E Tax kontabilizohen dhe informacioni dergohet per kontabilizim te metejshem ne Sistemin Informatik Financiar te Qeverise duke respektuar plotesisht te gjitha percaktimet dhe parashikimet ligjore te Udhezimit nr 8 date 09.03.2018 per procedurat e pergatitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore te njesive te qeverisjes se pergjithshme. Bashkelidhur ketij observacioni keni pasqyrat financiare te kuadruara ku pasqyrohen te ardhurat dhe detyrimet sipas posteve te llogarive kontabel per te ardhurat tatimore dhe kontributet e DPT per vitin 2022 e shoqeruar kjo me akt rakordimin me strukturat e te ardhurave ne Degen e Thesarit Tirane ku DPT eshte e rregjistruar si njesi shpenzuese. Per sa me siper nuk ka vend per veprime rregulluese ne llogarine 4665503.

Qëndrimi grupit të auditimit: Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë se:

- për pjesën e planifikimit të të ardhurave, në konstatim është reflektuar qartësisht në dy raste mos detajimi i planit të të ardhurave për DRT pas efekteve të aktit normativ përkatës dhe në të njëjtën kohë edhe problematikat e shkaktuara nga mos reflektimi në kohë nga MFE i këtyre efekteve.

-për pjesën e realizimit të të ardhurave sqarojmë se përfshirja në realizim të të të ardhurave nga rivlerësimi është pikërisht konstatimi për diferencën nga treguesit e konsoliduar fiskalë të publikuar nga MFE dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-për pjesën e gjobave dhe kamatvonesave, referimi në ligjin për procedurat tatimore nga ana juaj percakton konceptin e “detyrimit tatimor” dhe jo “të ardhurës tatimore”, për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-për pjesën e kontabilizimit në llogarinë 466, sqarojmë se mos kryerja e veprimeve rregulluese për këto transaksione pasqyrojnë vetëm momentin e arkëtimit të mjeteve në ruajtje dhe referuar pikës 49 të udhëzimit nr.8 ku citohet *“Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për*

gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.”, e ekspozon DPT ndaj riskut të kundravleftës prej 177 miliardë lekë në llogari bankare të thesarit si kundërparti e cila nuk është dhe nuk disponohet nga DPT. Së dyti, duke qenë se arkëtimi i kësteve kontabilizohet në llogarinë 466 dhe pjesa tjetër me deklaratën në llogaritë e klasës 7, në llogaritë e klasës 7 kalon vetëm pjesa e mbetur pa këstet, duke denaturuar paraqitjen e informacionit financiar. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë përcjellë observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 me përmbajtje si në vijim:

Në lidhje me planifikim e të ardhurave tatimore janë përcjellë observacione me pretendime si në fazën e akt konstatimeve duke konkluduar seTheksojmë se çdo ndryshim i planit të të ardhurave nga MFE i shtrin efektet dhe për periudha të mbyllura raportuese, prandaj dhe DPT ka shpërndarë jo vetëm plan mujor por edhe progresiv duke përfshirë dhe ndryshimet e planit për periudhat e mbyllura në raportim. ...Për sa më sipër, ju kemi dërguar me shkresë nr. 5749/18 datë 18.07.2023, fotokopje të të gjitha shkresave të cituara më lart si dhe planet e të ardhurave sipas kronologjisë me data përkatëse dhe ndryshimet që ai ka pësuar në bazë mujore/progresive sipas zërave.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave tatimore,tarifat buxhetore dhe tatim fitimi i thjeshtuar janë të ardhura të evidentuara në sistemin tatimor etax, të cilat janë pjesë e akt rakordimit vjetor të të ardhurave në sistemin informatik financiar të qeverisë por nuk përfshihen në raportimin statistikor të realizimit të planit të të ardhurave për DPT. Për sa më sipër, konkluzioni i grupit të audituesve për përfshirje të përlllogaritjes për efekt të realizimit të planit i të ardhurave nga tarifat buxhetore dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk qëndron. Referuar konstatimit tuaj për rilllogaritje të realizimit të të ardhurave pa përfshirë në këtë realizim të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë nuk është i drejtë. Të ardhurat nga rivlerësimi janë të ardhura tatimore për të cilat DPT është ngarkuar me plan të ardhurash sipas ligjit për buxhetin e vitit 2022 (pjesë e planit për tatimin mbi të ardhurat). Përsa më sipër lutem referohuni publikimit të treguesve fiskal ku gjenden të përfshira si në fakt dhe në plan këto të ardhura. Përsa më lart, tabela e rishikuar të të ardhurave për zërin tatim mbi të ardhurat personale nuk është e saktë. Për pasojë dhe analizimi i mëtejshëm duke përjashtuar këto të ardhura në realizimin faktik për DPT çon në konkluzione të gabuara lidhur me shifrat e realizuara nga DPT për vitin 2022.

Lidhur me konstatimin se kontabilizimi i arkëtimeve në llogarinë 4665503 krijon detyrime për mjete në ruajtje sqarojmë se Funksonimi i kësaj llogarie është tipike për administratën tatimore pasi pagesat për tatim fitimin janë paraprake dhe detyrimi (maturimi) sipas deklaratës bëhet në vitin pasardhës fiskal e buxhetor. Në këto kushte specifikisht për administratën tatimore është pranuar që kontabilizimi i kësaj të ardhure të bëhet në llogarinë 4665503 si mjet në ruajtje e pasqyruar kjo dhe në SIFQ, sistem i cili është dhe sistemi i kontabilitetit për qeverinë shqiptare.Ndërkohë theksojmë se në sistemin etax kjo llogari është dinamike dhe vetëm me dorëzimin e deklaratës vjetore për tatim fitimin teprica e mbetur e pagesave të kryera në këtë llogari shtojnë kredi të llogarisë 467, kreditorë të tjerë për tatim fitimin.

Lidhur me raportimin e të gjobave dhe kamatvonesave. DPT përfshin në realizim bazuar në nenin 6, pika3 e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar “Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatvonesat si dhe gjobat për rastet e parashikuara nga ky ligj”. Në këtë këndvështrim nuk mund të gjykohet mbi realizimin e të ardhurave duke marrë në konsideratë parashikimet e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 I cili është udhërrëfyes për veprime kontabël të të ardhurave sipas natyrës ekonomike e shprehur në nivel 7 shifror të klasifikimit buxhetor të shprehura në pasqyrat financiare, formati f2 performanca financiare. ...DPT raporton të ardhurat në pasqyrat financiare sipas parashikimeve ligjore e për rrjedhojë nuk ka vend për veprime rregulluese në mbyllje të vitit ushtrimor.

Qëndrimi grupit të auditimit: Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se konstatimet mbi ndryshimet e planit të të ardhurave bazohen në shkresat të cilat janë vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar dhe janë shqyrtuar gjatë formulimit të konstatimeve mbi vonesat e shkaktuara në detajimin e planit sipas akteve normative mbi ndryshimin e buxhetit, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me pretendimet për tarifatat buxhetore dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin sqarojmë se nuk janë bërë konstatime për përfshirje të tyre për efekt realizimi të planit, por për pjesën e të ardhurave nga rivlerësimi i pasurisë, për të cilat konstatimi është bërë mbështetur në udhëzimin përkatës të ligjit për rivlerësimin e pasurive. Për këto arsye observacioni për këtë pikë nuk merret në konsideratë.

Për konstatimet me llogarinë 466 nuk janë paraqitur argumente shtesë mbi ato të paraqitura në fazën e akt konstatimeve dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për përfshirjen e kamatvonesave dhe gjobave në realizim të ardhurash sqarojmë se pretendimi i subjektit të audituar i referohet termit “detyrim” dhe jo e ardhur tatimore sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, për këto arsye observacionet nuk merren në konsideratë.

Titulli:	Vonesa në detajimin e planit të të ardhurave për drejtoritë rajonale tatimore.
Situata:	<p>Plani fillestar i të ardhurave tatimore për buxhetin e vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 1533 prot. DPT datë 01.02.2022 për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shumën totale 157,548 milion lekë neto. Me Vendim nr. 23 datë 23.03.2022 nga Komiteti Operacional është miratuar plani i të ardhurave për DRT për vitin 2022 në vijim të Urdhrit të Drejtorit të DPT nr. 2968 datë 23.02.2022 “Për detajimin e planit të të ardhurave për vitin 2022”. Ky plan i përcaktuar në nivel DRT-je në muaj dhe sipas llojit të tatimit është dërguar në DRT përkatëse me shkresën nr. 2968 datë 24.03.2022 ku është cituar <u>“bashkëlidhur po ju dërgojmë planin vjetor të të ardhurave të periudhës Janar – Prill 2022”</u>. Nga auditimi konstatohet se megjithëse i referohet planit vjetor, në drejtoritë rajonale tatimore është dërguar plani i të ardhurave tatimore vetëm për periudhën Janar-Prill 2022, duke mos përfshirë të gjithë periudhën vjetore. Procesi fillestar i detajimit të planit të të ardhurave tatimore për drejtoritë rajonale tatimore përkatëse nga ana e DPT konstatohet se ka zgjatur për një periudhë 3-mujore nga fillimi i vitit buxhetor dhe 2-mujore nga data e dërgimit të planit të të ardhurave tatimore në përgjegjësi të DPT nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nga auditimi konstatohet se gjatë kësaj periudhe është miratuar Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, i cili ka ndryshuar një pjesë të të ardhurave tatimore. Efektet e këtij plani të ndryshuar të të ardhurave tatimore nuk janë reflektuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kohë. Mos reflektimi në kohë i efektit të të ardhurave të ndryshuara sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, në planin e drejtorive rajonale tatimore është kushtëzuar edhe nga dërgimi me vonesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë i të ardhurave tatimore në përgjegjësi mbledhjeje të administratës tatimore sipas shkresës nr. 7088 prot. DPT datë 26.04.2022. Nga auditimi konstatohet se edhe pas kësaj shkrese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi Aktin Normativ nr.3 datë 12.03.2022 nga ana e Drejtorisë së</p>

	<p>Përgjithshme të Tatimeve nuk është reflektuar ndryshimi në të ardhura tatimore, deri në efektet e ndryshimeve me Aktin Normativ nr. 12 datë 11.08.2022, sipas shkresës nr. 13863/3 datë 09.12.2022 drejtuar DRT-ve, duke e detajuar planin sipas DRT-ve përkatëse rreth 4 muaj pas daljes së aktit normativ. Nga auditimi konstatohet se edhe në këtë rast, megjithëse nga legjislativi ishte miratuar Akti Normativ nr. 17 datë 01.12.2022 me efekte në ndryshimin e të ardhurave tatimore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është shpërndarë pas daljes së këtij akti në drejtoritë rajonale tatimore, efekti në planin e të ardhurave i Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022.</p> <p>Me shkresën nr. 21811 prot. DPT datë 29.12.2022 është dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit normativ nr. 17 datë 01.12.2022. Pra plani i të ardhurave është dërguar me rreth një muaj vonesë nga akti normativ për ndryshimin e të ardhurave dhe vetëm dy ditë përpara mbylljes së vitit buxhetor, duke bërë të pamundur reflektimin e veprimeve operacionale për zbatimin e tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Nga ana e DPT me shkresën nr. 21811/1 datë 04.01.2023 i është kërkuar MFE-së detajimi i planit të të ardhurave të ndryshuar për vitin 2022 për zërin Taksa Nacionale e të tjera, plan i cili rezultoi i pa detajuar edhe në vijim të kërkesës nr. 13863/1 datë 18.08.2022 nga DPT pas ndryshimit të të ardhurave sipas Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022. Konstatohet se në muajin Janar të vitit 2023, kohë në të cilën mundësitë për realizimin e të ardhurave tatimore janë ezauruar, nuk janë qartësuar ende çështje që lidhen me planin e të ardhurave tatimore për vitin e mbyllur buxhetor 2022. Nga DPT, me shkresën nr. 21811/4 datë 16.01.2023 është dërguar në drejtoritë rajonale tatimore për vitin 2022 plani i të ardhurave të ndryshuara sipas Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, që përfaqëson planin përfundimtar të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mos reflektim në kohë i përgjegjësive të DRT-ve për grumbullimin e të ardhurave.
Shkaku:	Ndryshimet e shpeshta me akt normativ, mos reflektimi në kohë i planit nga MFE, shpërndarja e planit në baza mujore nga DPT.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të miratohen rregullore/udhëzues në lidhje me afatet dhe procedurat e detajuara për detajimin e planit të dërguar nga MFE drejt Drejtorive Rajonale Tatimore në mënyrë që të ndërmerren veprimet operacionale në kohë për mbledhjen e tyre.

Titulli:	Mosrealizim të ardhurash në përgjegjësi mbledhjeje dhe raportim si realizim i të ardhurave nga rivlerësimi të cilat paraqiten në formën e të ardhurave dytësore.
Situata:	Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2022, të ardhurat tatimore janë programuar 193.0 miliard lekë dhe janë realizuar 189.6 miliard lekë, me një mosrealizim prej 3.4 miliard lekë ose 1.8% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën të ardhurat u realizuan 168.7 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 20.9 miliard lekë ose 12.4 % më shumë. <u>Nga auditimi konstatohet se të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në shumën 183,9</u>

	<p>miliard lekë dhe diferenca me raportimin e DPT qëndron në faktin se janë përfshirë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në të ardhura tatimore. <u>Efeki i këtyre të ardhurave të përkohshme me normë të reduktuar tatimore nga rivlerësimi sipas akt rakordimeve të degëve të thesarit në rrethe me DRT dhe drejtoritë vendore të ASHK si dhe përmbledhëses së vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar raportohet në shumën 5,611,952,623.5 lekë ose rreth 2% e të ardhurave.</u></p> <p>Në krahasim me planin përfundimtar prej 193 miliard lekë, efekti i mos realizimit paraqitet në shumën 9 miliard lekë, megjithëse në raport me një vit më parë të ardhurat janë realizuar 15.2 miliard lekë më tepër. Në terma neto, të ardhurat janë realizuar në shumën 161.5 miliard lekë, përkundrajt planit prej 174.5 miliard lekë, me një mos realizim në shumën 13 miliard lekë e ndikuar nga tejkalimi i rimbursimeve të kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar më tepër se plani për rreth 4 miliard lekë. Të analizuar sipas llojit të tatimeve, me përjashtim të tatimit mbi fitimin, problematika paraqiten në drejtim të mos realizimit me ndikim më të madh nga taksat nacionale dhe taksa e qarkullimit rrugor.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga auditimi konstatohet se në terma neto, të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar paraqiten me mos realizim në shumën 2.9 miliard lekë, duke qenë se efekti i rimbursimit të kryer përtej planit të miratuar me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar prej 4 miliard lekë është më i madh se tejkalimi prej 1.1 miliard lekë në të ardhurat bruto nga tatimi mbi vlerën e shtuar të arkëtuara nga administrata tatimore sipas planit të ndryshuar përfundimtar. - Nga auditimi mbi performancën e taksave dhe tarifave kombëtare konstatohet se mosrealizimi prej 5.2 miliard lekë ka ardhur në pjesën më të madhe si pasojë e mos realizimit të taksës nacionale të karbonit (për benzinën, benzolin dhe gazoilin) si dhe taksës nacionale për ambalazhet plastike, me efekt në total prej rreth 3 miliard lekë. Efekt tjetër negativ në mos realizim paraqesin edhe taksa mbi primet e shkruara për policat e sigurimit, taksa e rentës minerare si dhe taksa për automjetit e përdorura të transportit rrugor, me efekt në total prej 1.5 miliard lekë. - Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 23.4 miliard lekë, janë arkëtuar 18.2 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 5.2 miliard lekë ose 22.0% më pak. <p>Në konkluzion, mos realizimi më i madh në grupin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat kombëtare të raportuara në tabelën e treguesve fiskalë si një komponent i taksave nacionale dhe të tjera është shkaktuar nga mos realizimi i taksës së qarkullimit rrugor dhe taksës së karbonit, të cilat janë taksa të indeksuara me sasinë e konsumuar të produkteve dhe nënprodukteve të naftës. Sipas statistikave fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgjatë vitit 2022, importi i karburanteve të cilat janë subjekt i këtyre taksave në sasi ka rënë në raport me një vit më parë. Ulja e konsumit të këtyre mallrave me peshë në të ardhurat buxhetore vlerësohet në 54,622 ton ose 9 % në raport me vitin 2021, të cilat në kuadër të taksave fikse të indeksuara mbi sasinë e aplikueshme, kanë sjellë një performancë jo të mirë me efekt në mos realizimin e të ardhurave të përgjithshme tatimore në përgjegjësi mbledhje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti:	Mos realizim të ardhurash
Shkaku:	Klasifikim i gabuar i të ardhurave dytësore, tejkalim i kufijve të rimbursimit dhe rënie e konsumit për mallrat objekt taksë kombëtare
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet riklasifikimi përkundrejt planit i të ardhurave dytësore në raportin e performancën me qëllim ruajtjen e trendit historik të raportimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore të drejtojnë burimet e kontrollit në sektorët që janë objekt i taksave kombëtare të konstatuara me mosrealizim për shkak të rënies së konsiderueshme të të dhënave për sasi të indeksuara me taksat kombëtare.

Titulli:	Mbivlerësim i realizimit të të ardhurave tatimore nga raportimi si e ardhur të gjobave si dhe nga depozitimet e përkohshme në formën e parapagesave për taksat.
Situata:	Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave tatimore, konstatohet se raportohen si të ardhura të realizuara për efekt të planit, gjoba të sistemit tatimor në shumën 706,686,752 lekë, me përjashtim të gjobave të tjera të cilat janë raportuar në dënimet administrative në shumën 122,837,286 lekë në kundërshtim Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Llogaria 70 “Tatime dhe taksat”, ku citohet <i>“Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njërive të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimore”</i> . Përveç shumave të raportuara si më sipër, konstatohet se raportohen si e ardhur edhe gjobat e vendosura nga kontrollet e realizuara në tatimpagues, pasi elementët përbërës të tatim të munguar si pasojë e rivlerësimeve tatimore përfshijnë detyrimin për tatimin dhe gjobën përkatëse. Një konkluzion i tillë arrihet pasi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin nuk janë raportuar në asnjë llogari analitike të të ardhurave gjoba, çka sjell raportim të gabuar të të ardhurave referuar kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018. - Gjithashtu konstatohet se, në realizimin e të ardhurave tatimore janë raportuar për efekt realizimi parapagimet e bëra nga tatimpaguesit për tatime të ndryshme përgjatë vitit 2022, në total në shumën 34,473,704,161 lekë. Efekti më i madh i këtyre parapagimeve vlerësohet në deklaratimet për deklaratën e tatimit mbi fitimin në shumën 34,041,881,792 lekë. Konstatohet se përdorimi i kësaj llogarie për tatimet e tjera përveç tatimit mbi fitimin, për realizim të të ardhurave tatimore është jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 <i>“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”</i> , pasi nuk plotësohen kushtet për klasifikimin si të ardhur duke qenë se nuk lidhen me një pagesë pa kthim. Përsa i përket parapagimeve për tatimin mbi fitimin, konstatohet

	<p>se përdorimi i llogarisë 466 në momentin e arkëtimit sjell si pasojë nevojën për kryerjen e veprimeve rregulluese në periudhën paraardhëse me qëllim anulimin e efektit të përkohshëm të mbajtjes në ruajtje të mjeteve monetare për pagesa të kryera nga tatimpaguesit. Referuar pasqyrave financiare të konsoliduara dhe komponentit të drejtorisë së kontabilitetit konstatohet se teprica e llogarisë së parapagimeve rezulton për vitin 2022 në rreth 177 miliard lekë, me një rritje prej 34.4 miliard lekë nga viti 2021 ku teprica e llogarisë ishte në shumën 142.7 miliard lekë. Konstatohet se përdorimi i llogarisë 466 krijon detyrime për mjete në ruajtje në konsolidim sipas pasqyrave financiare të konsoliduara. Me raportimin e pagesës së kësteve të tatim fitimit në llogarinë e parapagimeve si veprimi i parë për njohjen në formën e të ardhurës si dhe me dorëzimin e deklaratave në mbyllje të vitit financiar (kontabilizimin e tyre në llogarinë 7001 “Tatimi mbi fitimin”) rezulton se nuk kryhet veprimi i anulimit të parapagimeve të cilat kalojnë në të ardhura dhe netimi i llogarive të kreditorëve të mjeteve në ruajtje. Konstatohet se procesimi i transaksioneve financiare për pagesat të cilat kryhen për tatimin mbi fitimin, nuk kontabilizohen në llogarinë e të ardhurave sipas klasës 7 dhe në të njëjtën kohë praktika aktuale nuk bën netimin e llogarisë së parapagimeve me dorëzimin e deklaratës finale të tatimit mbi fitimin nga ana e tatimpaguesit.</p>
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Mbi vlerësim i realizimit të të ardhurave si pasojë e gjobave dhe mbivlerësim i llogarisë 466.
Shkaku:	Raportimi i gabuar i të ardhurave analitike
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet ripublikimi i treguesve të të ardhurave në raportin e performancës duke hequr komponentin e gjobave nga realizimi dhe në të njëjtën kohë të bëhet në raportim ndarja e të ardhurave nga detyrimi kryesor dhe gjoba shoqërues e detyrimet për rivlerësimet tatimore të deklaratave në përfundim të kontrollit tatimor.</p> <p>Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhen veprimet rregulluese në lidhje me depozitimet e përkohshme për deklaratën e tatim fitimin në momentin e dorëzimit të deklaratës së tatim fitimit nga ana e tatimpaguesve me qëllim shmangien e akumulimit të tepricës së pa stornuar të kësaj llogarie.</p>

2.3. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve tatimore sipas deklarimeve të tatimpaguesve. Në rastin kur pagesat nuk realizohen në kohë sipas afateve për pagesën në bazë të vetëdeklarimit, detyrimi tatimor kalon për ndjekje nga strukturat e ngarkuara për mbledhje e detyrimeve në DRT.

Nenet 88-103 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktojnë përgjegjësinë ligjore të Administratës Tatimore për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Mbledhja e detyrimeve

të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në DPT, procesi i koordinimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore kryhet nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, megjithatë, është nën përgjegjësinë e DPT që nëpërmjet drejtorive të saj të garantojë udhëheqjen metodologjike dhe strategjike, zhvillimin e politikave dhe procedurave në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, zhvillimin e planeve operacionale, përcaktimin dhe monitorimin e targetave operacionale dhe varësinë funksionale mbi Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet sipas përcaktimeve në manualin e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara. Ky Manual i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara mbështet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë nën 135, paragrafet “3” dhe “4”. Ky Manual është detyruar për administratën tatimore. Strukturat e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT dhe Rajone, kanë për detyrë të zbatojnë procedurat e përshkruara në këtë Manual. Ky rol në DPT realizohet nëpërmjet **Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP)** e cila është e organizuar me një strukturë prej 12 punonjësish dhe funksionon si vijon:

Tabela nr. 19 Struktura e Drejtorisë DMDTP

Struktura e Drejtorisë	2022		
	Plan	Fakt	vakanca
Drejtor Drejtorie	1	1	
Spektori i Analizës dhe Monitorimit për masat shtrënguese.			
- Përgjegjës sektori	1	1	
- Inspektor	2	1	1 vakant
Spektori i Zbatimit në Terren të masave shtrënguese.			
Përgjegjës sektori	1	-	1 vakant
- Inspektor	3	3	
Spektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë			
- Përgjegjës sektori	1	1	
- Inspektor	3	-	3 vakant
- Totali	12	7	5 vakant (42 %)

Burim: DPT, përpunim grupi auditues

Siç vërehet nga tabela e mësipërme deri në fund të vitit 2022, DMDTP ka funksionuar me strukturë jo të plotë, me **5 vende të lira/vakante** konkretisht: 3 inspektorë në Sektorin e Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë dhe 1 inspektor në Sektorin e Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese, si dhe 1 Përgjegjës Sektorin e Zbatimit në Terren të masave shtrënguese. Struktura faktike është jo në përputhje me strukturën organike, miratuar me urdhrin e Kryeministrit Urdhri Nr. 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, ku struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është përcaktuar me 12 punonjës (42% e strukturës e paplotësuar). Personeli i pamjaftueshëm në këtë funksion kyç të administratës tatimore ndikon negativisht në objektivat e mbledhjes së detyrimeve tatimore, si edhe në menaxhimin e rasteve të reja të borxhit të cilat duhen trajtuar sa më herët me procedurën e mbledhjes në mënyrë që të arkëtohen sa më shpejt. Nga auditimi konstatohet se, deri në muajin tetor 2022, Drejtor i Drejtorisë DMDTP ka qenë znj. Sh K, të cilës më pas i janë shkëputur marrëdhëniet e punës me DPT. Me shkresën nr. 19072/2 prot, datë 18.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është bërë transferimi i përkohshëm i z. N Xh, në pozicionin drejtor i komanduar.

Për vitin 2022, plani operacional i DMDTP si pjesë e Planit Operacional të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është përcjellë me vendim nr. 22, datë 29.12.2022 të Drejtorit të

Përgjithshëm të Tatimeve në rolin e Kryetarit të Komitetit Operacional duke përcaktuar drejtimit e më poshtme, në zbatim të të cilave janë marrë edhe masat respektive:

1. Përmirësim i raporteve të menaxhimit, Afati tre mujori i parë.
2. Përmirësim i procedurave për rikuperimin e detyrimeve tatimore të papaguara. Afati gjatë gjithë vitit .

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në zbatim të planit operacional, drejtorja DMDTP ka përmirësuar raportet në sistem:

1. Përmirësuar raporti ekzistues në modulën e borxhit në sistemin C@ts “Lista Analitike e Debitorëve”
2. Dizenjuar raport i ri “Pasqyra e Gjendjes së Debitorëve”
3. Dizenjuar raport i ri “Klasifikimi sipas Moshës së Borxhit”
4. Përmirësuar në manual lidhur me masën e sigurimit të detyrimit tatimor (Pezullim të Aktivitetit në Doganë)
5. Ndjekur me prioritet të lartë të detyrimet tatimore të papaguara në zërin kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme nga ana e drejtorive të mbledhjes në rajone mbi situatën dhe masat e marra.

Mbi Inspektimet e Kryera për Mbledhjen e Detyrimeve Tatimore të Papaguara

Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtori të Përgjithshme duhet të garantojnë që të gjithë Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve në Rajone, të kenë planet e punës dhe objektiva operacionale për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Këto plane dhe objektiva duhet të jenë në përputhje me planin strategjik të DPT dhe rregulloren e brendshme. Gjithashtu Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtori të Përgjithshme duhet të përgatisin plane inspektimi për të kontrolluar nëse Rajonet kanë:

- zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale,
- mbajtur regjistra të saktë, të plotë dhe të azhurnuar të debitorëve,
- ndjekur procedura të përcaktuara të masave shtrënguese,

Së bashku me planet e inspektimeve, mund të kryejë inspektime të posaçme që nxiten nga shqetësime që lindin nga raportet e Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone.

Për inspektimet e kryera dhe për çdo vizitë inspektimi duhet të hartohet Raporti ku të trajtohen zbulimet e inspektimit, dhe duhet të përfshihen:

- shpjegime për çdo ndryshim nga plani dhe/ose objektivat,
- çdo parregullësi procedurale të identifikuar,
- çdo çështje teknike të identifikuar,
- çdo nevojë specifike për trajnim të identifikuar,
- rekomandimet për veprim.

Nga auditimi i veprimtarisë së drejtorisë DMDTP rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është kryer asnjë inspektim në asnjë rajon për të kontrolluar apo monitoruar rajonet nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale, nëse kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhurnuar të debitorëve, nëse kanë ndjekur procedurat e përcaktuara për masat shtrënguese. Duke cënuar realizimin e objektivit të saj që është udhëheqja metodologjike dhe strategjike, zhvillimi i politikave dhe procedurave në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, zhvillimi e planeve operacionale, përcaktimin dhe monitorimin e targetave operacionale dhe varësinë funksionale mbi Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, me qëllim maksimizimin e arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që të sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve duke zbatuar me korrektësi legjislacionin tatimor në fuqi. Sipas komunikimit me subjektin arsyeja që nuk është arritur kryerja e inspektimeve në rajone është se nuk ka pasur staf të mjaftueshëm. Nga auditimi rezulton se

nga drejtori i Drejtorisë DMDTP nuk është marrë asnjë masë apo përcjellë e ky problem pranë titullarit të institucionit të DPT.

Për sa më lart konstatohet se është vepruar në kundërshtim me Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara , Kreu 2.1.1”Inspektimi”, përcakton se Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtori të Përgjithshme duhet të garantojnë që të gjithë Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve në Rajone të kenë planet e punës dhe objektiva operacionale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara duke kryer plane inspektimi për të kontrolluar nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale; kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhurnuar të debitorëve; kanë ndjekur procedura të përcaktuara të masave shtrënguese. Për inspektimet e kryera dhe për çdo vizitë inspektimi duhet të hartohet Raporti ku të trajtohen zbulimet e inspektimit. Nga informacioni i vënë në dispozicion me shkresën nr.284/5 prot., date 26.07.2023 nga Znj.Sh.K. me detyre ish-drejtor DMDTP konfirmon se nga ana e saj është propozuar kryerja e inspektimeve për vitin 2022 por, nuk është aprovuar nga komiteti operacional. Gjithashtu konfirmon se kanë mbetur pa u finalizuar projekt raportet për shkak të mos firmosje nga titullari i DPT, projekt raporti datë 25.02.2022 mbi inspektimet e kryera ne rajonet Rajoni Qendror kryer inspektimi me datë 05.10.2021, Raporti përfundimtarë Rajoni Veri kryer inspektimi ne date 16.12.2021. Programi i inspektimi për DMDTP në DTM nuk është trajtuar dhe firmosur nga titullari i DPT.

Mbi vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese

Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, çështja 4.4.6 “Njoftimi për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese”, përcakton se me qëllim sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, administrata tatimore duhet të vendosë për marrjen e masave të sigurimit për ekzekutimin e detyrimit duke vendosur masa sigurimi të pasurisë nëpërmjet barrëve siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se struktura përgjegjëse në DPT ka planifikuar fond për Barre Hipotekore në programin buxhetor për vitin 2022 për çdo DRT.

Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara

Në seksionin 3.3.1 “Kërkesat për evidentim dhe analizë” të Manualit përcaktohet se çdo muaj Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, përgatit raporte dhe analiza lidhur me situatën e detyrimeve tatimore të papaguara të cilat dërgohen brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës në rrugë elektronike dhe brenda datës 14 në rrugë zyrtare pranë DMDTP në DPT, e cila më pas përpunon materialin përmbledhës për të gjitha drejtoritë rajonale si dhe raporton te strukturat drejtuese mbi ecurinë e këtyre detyrimeve.

Situata e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 20 Detyrimet tatimor të papaguar për vitin 2022 (në vlerë)

Në mijë lekë

Rajonet	Gjendja e detyrimeve në fillim të vitit (a)	Detyrime te shtuara (b)	Subjekte të Transferuar (c)	Arketuar Gjithsej (ç)	Subjekte të Transferuar (d)	Kthyer për Sistemim (e)	Detyrime ne fund te vitit
Qendror	100,147,377	21,392,563	1,226,545	13,759,767	117,464	469,973	108,419,281
VIP	13,208,882	8,134,525	119,808	5,958,192	2,643,339	377,081	12,484,603
JUG	8,986,928	3,589,992	643,426	2,175,813	-	194,523	10,850,010
VERI	12,591,494	3,982,656	773,367	2,331,080	2,343	-	15,014,094
DPT	134,934,681	37,099,737	2,763,146	24,224,851	2,763,146	1,041,577	146,767,990

Burimi: nga te dhenat e DPT

Tabela nr. 21 Detyrimet tatimor të papaguar për vitin 2022 (në numër)

Në numër

Rajonet	Gjendja e detyrimeve në fillim të vitit (a)	Detyrime te shtuara (b)	Subjekte të Transferuar (c)	Arketuar Gjithsej (ç)	Subjekte të Transferuar (d)	Kthyer për Sistemim (e)	Detyrime ne fund të vitit
Qendror	117,285	264,109	26	165,291	26	5,963	123,482
VIP	308	1,855	30	1,858	38	40	257
JUG	32,588	21,222	6	14,048	-	941	38,827
VERI	42,520	17,135	5	39,843	4	-	19,813
DPT	192,701	304,321	67	221,040	68	6,944	182,379

Burimi: nga te dhenat e DPT

Tabela nr.22 Detyrimi tatimor i papaguar në proces gjyqësor

Në mijë lekë

Rajonet	Në Proces Gjyqësor		Në Proces Apelimi	
	nr.subj.	shuma	nr.subj.	shuma
Qendror	1,135	9,247,334	-	-
VIP	90	2,433,769	11	111,653
JUG	166	401,436	-	-
VERI	-	969,786	-	-
Totali	1,391	13,052,325	11	111,653

Burimi: nga te dhenat e DPT

Shënim: Rajoni Jugor përfshin DRT- Fier, Vlore, Sarandë, Gjirokastrë, Berat

Rajoni Verior përfshin DRT- Shkodër, Lezhe, Kukës, Dibër


VIP -Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Rajoni Qendror DRT- Tirane, Elbasan, Korce, Durrës

Referuar treguesve të mësipërme, gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën rreth 134,934 milion lekë që i përket një numri prej 192,701 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej rreth 182,379 subjektsh debitorë. Pra, rezulton një rritje prej rreth 11.8 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me një ulje prej 10,322 debitorëve të pakësuar në fund të vitit. Krahasuar me një vit më parë stoku i borxhit ka të njëjtin nivel rritje (ku rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2021 në 21.12.2021 ishte me rreth 12 miliard lekë dhe 23,1850 subjekte debitorë). Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2022 janë 37 miliard lekë ose afërsisht 4 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2021, ku detyrimet e shtuara ishin 33 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 24 miliard lekë, krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 18 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 5 miliard lekë më shumë.

Për sa i përket subjekteve në proces gjyqësor rezultojnë 1,391 subjekte me detyrim total 13 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2021 kemi rreth 200 subjekte më pak me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuar në gjykatë prej rreth 1 miliard lekë më pak. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuar prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,135 subjekte, ndjekur nga VIP me rreth 2 miliard lekë për 90 subjekte.

Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara progresive sipas muajve përgjatë vitit 2022 krahasuar me vitin paraardhës, ecuria sipas muajve rezulton si më poshtë:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Siç vërehet nga grafiku, detyrimet e papaguara në muajin Janar 2022 janë afërsisht 5 miliard lekë më shumë se në muajin Janar 2021 dhe detyrimet e papaguara në dhjetor 2022 janë afërsisht 11.8 miliard lekë më shumë se në muajin dhjetor 2021. Niveli më i lartë i detyrimeve të papaguara në vitin 2022 ka arritur në muajin Gusht me një vlerë detyrimesh të papaguara prej rreth 144 miliard lekë. Nga krahasimi i stokut të detyrimeve mujore me vitin paraardhës konstatohet se viti 2022 çdo muaj ka një stok me të lartë. Konkretisht muaji nëntor ka një rritje neto afërsisht 12 miliardë lekë më shumë se muaji nëntor i vitit 2021 më pas vijon muajin dhjetor me rritje neto 11 miliard lekë më shumë. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2022 janë 39.9 miliard lekë afërsisht 6 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2021 detyrimet e shtuara ishin 33 miliard lekë.

Nga dokumentet e vëna në dispozicion lista e debitorëve për të gjithë rajonet, rezulton se janë 18 subjekte me vlerë detyrimi i papaguar në fund të vitit 2022 mbi 100 miliard lekë afërsisht 30 % e total detyrimit të papaguar. Nga këto, 13 subjekte janë pasive me vlerë detyrimi të papaguar 35 miliard lekë dhe 5 subjekte janë Aktive me detyrim të papaguar në vlerën 8 miliard lekë.

Tabela nr.23 Debitorët që zënë peshën më të madhe në masën e detyrimit tatimor të papaguar
Në lekë

	Nipti	Subjekti	DRT	STATUSI	Detyrimt
1	J.....D	A.	DRT Tiranë	Pasiv	8,869,574,082
2	L.....E	T...	DRT Durrës	Pasiv	6,801,662,489
3	L.....C	D...	DRT Tiranë	Pasiv	5,058,306,709
4	K.....H	O...	DTM	Aktiv	5,011,833,611
5	L.....I	L....	DRT Tiranë	Pasiv	4,261,239,826
6	K.....C	E....	DRT Tiranë	Pasiv	3,818,330,793
7	K.....P	T...	DTM	Pasiv	2,165,073,831
8	K.....H	"K...	DRT Lezhë	Pasiv	1,788,016,660
9	K.....H	T...	DRT Tiranë	Pasiv	1,766,869,353
10	L.....Q	G...	DRT Tiranë	Aktiv	1,322,452,034
11	K.....T	B...	DRT Tiranë	Aktiv	1,058,487,631
12	J.....H	S....	DRT Fier	Aktiv	577,174,093
13	K.....A	A....	DRT Vlorë	Aktiv	336,748,486
14	L.....T	K....	DRT Fier	Pasiv	197,454,615
15	L.....F	D...	DRT Fier	Pasiv	188,342,491
16	L.....Q	B....	DRT Sarandë	Pasiv	148,222,523
17	L.....G	A....	DRT Fier	Pasiv	114,543,491
18	L.....U	P....	DRT Vlorë	Pasiv	113,012,636
			Gjithësej		43,597,345,354


Burimi :Nga të dhënat e DPT

Tabela nr.24 Stoku i detyrimeve sipas rajoneve.

Në milion lekë

Renditja	Rajoni	Gjendja në fillim të vitit		Gjendja në fund të vitit		Rritje/ Ulje c (b-a)	Pesha %
		Nr.Subjekte	Detyrimi total (a)	Nr.Subjekte	Detyrimi total (b)		
1	QENDROR	117,285	100,147	123,482	108,419	8,272	70%
2	VERI	42,520	12,591	19,813	15,014	2,423	20%
3	JUG	32,588	8,987	38,827	10,850	1,863	16%
4	VIP	308	13,209	257	12,485	(724)	-6%
	Totali	192,701	134,935	182,379	146,768	11,833	100%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT




Për sa i përket stokut të detyrimeve tatimore te papaguara sipas rajoneve siç vërehet nga tabela e mësipërme rajoni Qendror ka peshën më të madhe të rritjes së detyrimeve të papaguara afërsisht me 70 % të total detyrimit ose 8,272 milion lekë rritje. Rezultoni se në rajonin Qendror afërsisht 30% të total detyrimit të papaguar e zënë 6 subjekte me status Pasiv me vlerë detyrimi 30.5 miliard lekë. Më pas vjen rajoni VERI me rritje prej 2,423 milion lekë rritje ose 20 % e total rritjes së detyrimit të papaguar, dhe rajoni JUG ka pësuar një rritje me 1.863 milion lekë ose 16 % e total rritjes. Konstatohet se rajoni VIP është i vetmi rajon që ka ulur detyrimet e papaguara me 724 milion lekë ulje ose 6 % e total detyrimit është ulur nga ky rajon.

Tabela nr.25 Detyrimi tatimor i papaguar i ndarë sipas moshës

Në mijë lekë

MOSHA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA NE AFAT DERI NË 31.12.2022							
Periudha	Detyrimet deri 3 muaj	Detyrimet 3 - 6 muaj	Detyrimet 6-12 muaj	Detyrimet nga 1-2 vjet	Detyrimet nga 2-5 vjet	Detyrimet mbi 5 vjet	Total
Detyrime të papaguara në afat	5,021,840	4,884,079	8,426,803	15,773,670	41,382,415	71,279,214	146,767,991
Pesha specifike në %	3 %	3 %	6 %	11 %	28 %	49 %	100 %

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2022 vërehet se peshën më të madhe të stokut të detyrimit sipas moshës e zënë detyrimet me moshë borxhi nga 2-5 vite me peshë 28 % dhe detyrimet mbi 5 vite zënë rreth 49% të total detyrimit. Krahasuar me vitin paraardhës siç shikohet edhe nga grafiku borxhi me moshë 1-2 vjet është rritur me afërsisht 5 miliard lekë ose 4 % më shumë mbi totalin e detyrimit dhe borxhi më moshë mbi 5 vite me 18 miliard lekë ose 10 % më shumë mbi totalin e detyrimit, fashat e tjera të moshës së borxhit kanë një rritje me të vogël.

Për sa i përket moshës së detyrimeve sipas llojit të tatimit, situata paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.26 Detyrimi tatimor i papaguar sipas llojit dhe moshës

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Tatim mbi të ardhurat personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	176,842	853,329	1,898,343	1,488,359	604,966	5,021,840
borxhi nga 3 - 6 muaj	62,856	1,433,712	1,561,593	1,299,324	526,594	4,884,079
borxhi nga 6-12 muaj	88,863	3,967,853	2,320,047	1,397,176	652,863	8,426,803
borxhi nga 1-2 vjet	92,487	5,428,791	7,008,209	2,325,997	918,185	15,773,670
borxhi nga 2-5 vjet	485,783	13,921,178	13,060,152	5,016,542	8,898,759	41,382,415
borxhi mbi 5 vjet	1,194,434	17,091,097	26,236,836	8,926,291	17,830,556	71,279,214
TOTALI	2,101,264	42,695,956	52,085,176	20,453,682	29,431,913	146,767,991

Burimi: nga të dhënat e DPT

Mosha e detyrimeve tatimore sipas llojit në bazë rajoni.

Tabela nr. 27 Mosha e detyrimeve – Rajoni Qendror

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Kontribute	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	147,861	192,872	830,922	852,574	484,200	2,508,429
borxhi nga 3 - 6 muaj	51,194	1,049,745	988,227	791,719	432,855	3,313,740
borxhi nga 6-12 muaj	70,686	1,270,833	1,725,206	930,472	477,354	4,474,551
borxhi nga 1-2 vjet	60,349	3,809,755	5,705,714	1,512,161	687,309	11,775,287
borxhi nga 2-5 vjet	438,921	8,311,511	9,066,476	3,831,430	7,916,399	29,564,737
borxhi mbi 5 vjet	974,136	13,258,971	20,122,148	7,200,627	15,226,656	56,782,538
TOTALI	1,743,147	27,893,688	38,438,693	15,118,982	25,224,772	108,419,283

Burimi: nga të dhënat DPT

Tabela nr.28 Mosha e detyrimeve – Rajoni VIP

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Kontribute	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	22,512	149,547	208,736	52,461	14,813	448,070
borxhi nga 3 - 6 muaj	7,687	262,627	277,549	39,772	19,033	606,669
borxhi nga 6-12 muaj	6,640	2,442,909	128,907	20,406	17,621	2,616,482
borxhi nga 1-2 vjet	11,389	773,462	156,029	40,573	24,798	1,006,251
borxhi nga 2-5 vjet	7,247	3,964,301	1,493,086	40,115	377,206	5,881,956
borxhi mbi 5 vjet	6,475	1,070,796	637,300	13,357	197,248	1,925,177
TOTALI	61,951	8,663,643	2,901,607	206,683	650,720	12,484,604

Burimi: nga të dhënat e DPT-së

Tabela nr.29 Mosha e detyrimeve – Rajoni Jugor

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Kontribute	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	6,409	105,847	157,066	413,578	82,568	765,468
borxhi nga 3 - 6 muaj	3,120	105,078	182,892	364,587	57,131	712,808
borxhi nga 6-12 muaj	11,334	75,665	220,664	322,541	83,974	714,178
borxhi nga 1-2 vjet	19,170	120,191	475,389	433,618	120,755	1,169,123
borxhi nga 2-5 vjet	36,756	668,927	1,315,641	518,345	384,905	2,924,574
borxhi mbi 5 vjet	142,456	902,102	1,749,889	690,579	1,078,833	4,563,859
TOTALI	219,245	1,977,810	4,101,541	2,743,248	1,808,166	10,850,010

Burimi: nga të dhënat e DPT-së

Tabela nr. 30 Mosha e detyrimeve – Rajoni Verior

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Kontribute	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	60	405,062	701,619	169,746	23,386	1,299,873
borxhi nga 3 - 6 muaj	855	16,262	112,925	103,246	17,574	250,862
borxhi nga 6-12 muaj	203	178,446	245,271	123,758	73,914	621,592
borxhi nga 1-2 vjet	1,579	725,382	671,078	339,646	85,324	1,823,009
borxhi nga 2-5 vjet	2,859	976,439	1,184,949	626,652	220,248	3,011,147
borxhi mbi 5 vjet	71,367	1,859,228	3,727,499	1,021,728	1,327,819	8,007,641
TOTALI	76,921	4,160,815	6,643,335	2,384,768	1,748,255	15,014,094

Burimi: nga të dhënat e DPT-së

Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesve

Tabela nr.31 Detyrimet tatimore të papaguara sipas statusit Aktiv/ Pasiv

Në lekë

Rajone	Subj.Aktiv		Subj.Pasiv		Total Detyrimi		Subj.Aktiv		Subj. Pasiv	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Qendror	45,493	22,263,588,495	77,990	86,155,693,554	123,483	108,419,282,049	37%	21%	63%	79%
VIP	246	8,890,914,022	11	3,593,689,779	257	12,484,603,801	96%	71%	4%	29%
JUG	11,315	4,259,920,843	20,623	6,590,809,544	31,938	10,850,730,387	35%	39%	65%	61%
VERI	7,489	5,368,861,806	12,324	9,645,231,847	19,813	15,014,093,653	38%	36%	62%	64%
Totali	64,543	40,783,285,166	110,948	105,985,424,724	175,491	146,768,709,890	37%	28%	63%	72%

Burimi: DPT, përpunim grupi auditues

Subjekte me status Aktive janë në numër 64,543 ose 37 % e total numrit të subjekteve debitore, me vlerë detyrimi 40.7 miliard lekë ose 28 % e total detyrimit të papaguar.

Subjektet me status Pasive janë numër 110,948 subjekte ose 63 % mbi numrin gjithsej të subjekteve, me vlerë 105.9 miliard lekë ose 72 % mbi total detyrimin e papaguar.

Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje në numrin e subjekteve me status pasiv ose kërkesë për c'regjistrim, në 2021 subjektet me status Pasiv ishin 57 % e numrit total të subjekteve dhe 65 % e masës së detyrimit total. Siç vërehet nga tabela e mësipërme në

Rajonin Qendror vlere e detyrimit të papaguar nga subjektet me status Pasiv zënë 79 % e total detyrimit për këtë rajon. Numri më i lartë i subjekteve pasiv që përbejnë pjesën më të konsiderueshme të detyrimeve të papaguara, është një tregues edhe për vështirësinë në mbledhjen e këtyre detyrimeve, për sa kohë këto subjekte nuk vijnë aktivitetin e tyre.

Detyrimet sipas llojit të Tatimit për vitin 2022


Detyrimi tatimor i papaguar i ndarë sipas llojit të tatimit paraqitet në tabelën e mëposhtme :

Tabela nr.32 Detyrimi tatimor i papaguar sipas llojit të tatimit

Në mijë lekë

LLOJI I TATIMIT	Gjendja e detyrimeve ne fillim te vitit	Detyrime te shtuara gjate vitit	Detyrime te pakësuara gjate vitit			Vlera gjithsej e detyrimeve ne fund te vitit 2022	Nga këto ne proces gjyqësor
			Arkëtime gjate vitit	Sistemime gjate vitit	Transferime gjate vitit		
Tatim Fitimi	38,753,426	10,253,408	5,110,742	399,459	845,622	42,651,012	2,553,822
TVSH	47,689,506	10,207,753	4,601,610	141,909	1,068,566	52,085,174	8,178,471
Sig.Shoqerore	17,743,515	14,343,756	11,419,938	127,120	94,294	20,445,917	1,005,715
TAP	2,230,008	1,006,212	950,438	153,221	23,530	2,109,030	152,307
DIVA	298,324	742,883	463,106	37,651	-	540,450	18,019
Tatimi në burim	4,682,784	1,835,815	1,194,283	63,688	60,882	5,199,746	276,931
Te tjera	23,537,119	1,428,112	484,733	118,527	670,251	23,691,719	867,060
Totali	134,934,682	39,862,883	24,224,851	1,041,575	2,763,146	146,767,991	13,052,325

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT




Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, rezulton se zëri TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 36% me një vlerë prej rreth 52,085 milion lekë, ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% ose në vlerën prej rreth 42,651 milion lekë, e më pas zëri “Të Tjera” me 16% ose në vlerën prej rreth 23,691 milion lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 14% ose në vlerën prej rreth 20,445 milion lekë., dhe zëri Tatim ne Burim me rreth 4%, ose në vlerën prej rreth 5,199 milion lekë.

Në zërin të tjera, për vitin 2022 u vendos në dispozicion edhe një detajim më i hollësishëm, krahasuar me vitin paraardhës ku përfshihet zëri gjoba, taksa e rentës minerare, taksa e tarifa kombëtare, lojërat e fatit, akciza, tatimi mbi të ardhurat personale BV, taksa e rrugës.

Krahasuar me një vit më parë, sikundër vërehet në tabelën e mëposhtme, kemi një rritje pothuajse të njëtrajtshme në të gjitha llojet e tatimit:

Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2022 vs 2021



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Më hollësisht për zërin e Tatim Fitimit, gjendja e detyrimeve në vitin 2022 rezultoi 3,942 milion lekë më shumë se viti paraardhës ose me 10% rritje (në vitin 2021 këto detyrime paraqiten në vlerën 38,753 milion lekë); zëri i TVSH-së rezultoi 4,395 milion lekë më shumë ose me 9 % rritje (në vitin 2021 këto detyrime paraqiten në vlerën 47,689 milion lekë); zëri i Sigurimeve Shoqërore 2,710 milion lekë më shumë ose 15 % rritje (në vitin 2021 këto detyrime paraqiten në vlerën 17,743 milion lekë); zëri TAP 128 milion lekë më pak ose 6 % ulje (në vitin 2021 këto detyrime paraqiten në vlerën 2,230 milion lekë) dhe zëri të tjera 913 milion lekë më shumë ose 3% rritje (në vitin 2021 këto detyrime paraqiten në vlerën 28,518 milion lekë).

Tabela nr.33 Borxhi i ndare sipas Detyrim/Gjobe/Interes

Në mijë lekë

DRT	Detyrim (a)	Pesha (a/d)	Gjobe(b)	Pesha (b/d)	Interes(c)	Pesha(c/d)	Total (d)
Qendror	68,949,194	64%	35,501,043	33%	3,969,046	4%	108,419,282
VIP	5,053,086	40%	6,058,336	49%	1,373,182	11%	12,484,604
JUG	6,477,256	60%	3,797,946	35%	574,808	5%	10,850,010
VERI	9,059,355	60%	4,844,729	32%	1,110,010	7%	15,014,094
TOTAL	89,538,890	61%	50,202,053	34%	7,027,046	5%	146,767,990

Burimi: DPT, përpunim nga grupi auditues

Referuar të dhënave në dispozicion lidhur me detyrimet e papaguara deri në fund të vitit 2022, specifikuar sipas zërave përbërës, pesha më e madhe këtyre detyrimeve për secilin zë përbëhet nga rajoni qendror. Në total për të gjithë rajonet, principali i detyrimeve tatimore të akumuluarua përbën rreth 61% të vlerës totale të detyrimeve tatimore, për t'u ndjekur më pas nga penalitetet (gjobat) me 34% dhe 5% kamatëvonesat (interesat).

Për sa i përket borxhit të ndarë në detyrim, gjobë dhe interes për secilin lloj të detyrimit, situata për çdo rajon paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.34 Detyrimi tatimor i papaguar i ndarë sipas rajoneve

Në mijë lekë

Lloji i Tatimit		Qendror	VIP	JUG	VERI	Total
TAP	Detyrim	1,240,437	50,401	125,761	37,277	1,453,877
	Gjobe	337,733	9,037	63,660	20,215	430,645
	Interes	164,977	2,513	29,824	19,429	216,743
	Totali	1,743,147	61,951	219,245	76,921	2,101,264
Tatim Fitim	Detyrim	18,020,439	3,688,814	1,205,970	2,927,534	25,842,757
	Gjobe	9,084,964	3,706,150	651,083	1,039,505	14,481,702
	Interes	788,285	1,268,679	120,757	193,776	2,371,497
	Totali	27,893,688	8,663,643	1,977,810	4,160,815	42,695,956
TVSH	Detyrim	22,276,348	1,087,224	2,400,016	3,865,164	29,628,752

	<i>Gjobe</i>	14,535,046	1,744,705	1,491,003	2,035,911	19,806,665
	<i>Interes</i>	1,627,299	69,678	210,522	742,260	2,649,758
	Totali	38,438,692	2,901,607	4,101,541	6,643,335	52,085,175
SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE	<i>Detyrim</i>	11,403,677	147,134	2,050,588	1,768,143	15,369,542
	<i>Gjobe</i>	3,029,158	49,302	518,099	479,260	4,075,819
	<i>Interes</i>	686,146	10,248	174,561	137,365	1,008,320
	Totali	15,118,982	206,683	2,743,248	2,384,768	20,453,682
Te Tjera	<i>Detyrim</i>	16,008,292	79,513	694,921	461,237	17,243,963
	<i>Gjobe</i>	8,514,142	549,142	1,074,101	1,269,838	11,407,223
	<i>Interes</i>	702,338	22,065	39,144	17,180	780,727
	Totali	25,224,773	650,720	1,808,166	1,748,255	29,431,913
Totali		108,419,282	12,484,604	10,850,010	15,014,094	146,767,990

Burim : Nga te dhenat e DTP, perpunim nga grupi i auditimit

Tabela nr.35 Borxhi sipas burimit të krijimit

Në mijë lekë

DRT	Shtesa e borxhit sipas evidencave	Borxh i krijuar nga vetedeklarimi	Borxh i krijuar nga kontrollet, detyrimet e vlerësuara nga administrata tatimore (njoftim vlerësime, gjoba sistemi etj)
Qendror	21,392,563	12,197,779	9,194,784
VIP	8,134,525	4,459,472	3,675,053
JUG	3,589,992	3,002,881	587,111
VERI	3,982,656	2,136,304	1,846,352
Totali	37,099,736	21,796,436	15,303,300

Burimi: Nga te dhenat e DPT

Në seksionin 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” të Manualit përcaktohet se administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara. Kjo mundësohet nga Sistemi C@TS, në të cilin ekzekutohet në gjitha veprimet automatike lidhur me menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara pa ndërhyrje manual nga zyrtarët e tatimeve. Funkzioni i mbledhjes me forcë kryhet në secilën nga DRT që përfshihen në 4 rajonet. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar parashikojnë instrumentet që DPT duhet dhe mund të përdorë për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor. Për vitin 2021, ka vijuar zbatimi i procedurës në kuadër të rikuperimit të detyrimeve të vetë deklaruara pa u kthyer në borxh në bashkëpunim me Qendrën e Thirrjeve për tatimpaguesit debitorë me qëllim vetë përmbushjen e detyrimit nga ana e tatimpaguesve. Masat shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe arkëtimet gjatë vitit 2022 paraqiten si më poshtë:

Për sa i përket masave shtrënguese nga rajonet, situatë paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.36 Masat shtrënguese ne Rajonin Veri

Në mijë lekë

DMDTP RAJONI VERIOR							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Të Liruara	
		nr.raste	shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,272	6,941,797	55	168,660	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	1,093	8,534,857	85	66,086	20	61,821
3	Urdhër ekzekutime	252	106,201	3	1,019	-	-
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurorese	1,195	10,855,298	1	3,325	74	5,274
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurorese	1,195	10,855,298	-	-	74	5,275
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	1,195	10,855,298	-	-	69	7,268
7	Njoftim për vendosjen e barrës sigurorese	1,195	10,855,298	-	-	69	7,269
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e	-	-	-	-	-	-

	treta në zbatim të nenit 98						
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	1,020	9,411,304	71	89,720	35	6,935
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	913	9,204,884	2	794	9	2,708
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore (urdhra pune)	124	72,900	118	20,440	-	-
15	Konfiskim I 50% te xhiros ditore (njoftime)	839	1,604,669	955	335,172	-	-
	TOTALI	10,293	79,297,804	1,290	685,216	350	96,552

Burimi: nga te dhenat e DPT

Siç vërehet edhe nga tabela rezulton se në Rajonin Veri masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 1,272 raste dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98”, Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”.

Tabela nr. 37 Masat shtrënguese në Rajonin DTM

Në mijë lekë

DMDTP RAJONI DTM							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Të Liruara	
		nr.raste	shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	656	7,830,456	636	2,088,356	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	80	8,448,191	49	829,783	40	478,734
3	Urdhër ekzekutime	52	590,376	52	576,532	-	-
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurorese	9	2,149,595	-	-	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurorese	7	5,252,700	-	-	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	7	5,252,700	-	-	-	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës sigurorese	7	5,252,700	-	-	3	12,977
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	10	5,308,366	-	-	-	-
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	9	5,248,332	-	-	-	-
14	Konfiskimi i 50% i Xhiros Ditore	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	837	45,333,416	737	3,494,671	43	491,711

Burimi: nga të dhënat e DPT

Siç vërehet edhe nga tabela nga të dhënat për Rajonin DTM, masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 656 raste dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98”, Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”.

Tabela nr. 38 Masat shtrënguese në Rajonin Jugor

Në mijë lekë

DMDTP RAJONI JUGOR							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Të Liruara	
		nr.raste	shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	4,107	5,923,669	3648	781,023	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	2,184	5,464,815	2080	940,907	231	127,562
3	Urdhër ekzekutime	238	2,743,799	211	67,787	-	-

4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	474	3,185,179	643	98,888	88	22,578
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	918	4,376,922	118	59,959	73	48,149
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	865	3,925,192	57	28,644	213	93,861
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	854	3,969,491	190	76,355	257	109,303
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	470	2,392,965	325	115,787	24	7,984
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	222	635,022	96	6,463	-	-
14	Konfiskim i 50% të xhiros ditore	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	10,332	32,617,054	7,368	2,175,813	886	409,437

Burimi: nga te dhenat e DPT

Siç vërehet edhe nga tabela për Rajonin JUG, masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 4,107 raste dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”.

Tabela nr.39 Masat shtrënguese në Rajonin Qëndror

Në mijë lekë

DMDTP RAJONI QENDROR							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Të Liruar	
		nr.raste	shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	11,719	5,078,298	1,978	1,456,207	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	7,965	12,158,094	3,428	2,852,342	1,586	1,518,725
3	Urdhër ekzekutime	1,050	198,212	935	152,062	-	-
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	-	-	-	-	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	833	2,789,554	283	325,246	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	948	12,975,274			62	15,100
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	109	2,550,027	49	54,355	71	35,510
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	940	2,244,436	172	121,755	43	27,150
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	1,360	2,768,298	291	336,502	55	30,658
14	Konfiskim i 50% të xhiros ditore	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	24,924	40,762,193	7,136	5,298,469	1,817	1,627,143

Burimi: nga te dhënat e DPT

Siç vërehet edhe nga tabela nga të dhënat për Rajonin Qendror, masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 11,719 raste dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”, “Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese”. Nga sa më sipër rezulton se nuk janë përdorur të gjithë masat shtrënguese në rajone për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara sipas legjislacionit tatimor.

Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim, gjendja e detyrimeve me 31.12.2022, jashtë sistemit C@TS, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 40 Detyrimi tatimor i papaguar jashtë sistemit c@ts

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrimet tatimore gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2019	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2020	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2021	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2022	Diferenca 2022-2021
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	58,993,901	58,993,901.00	56,844,018	4,542,205	(52,301,813)
7001	Tatim mbi fitimin	2,883,175	2,772,290.00	2,772,290	1,945,256	(827,034)
7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogël	63,750	63,750.00	63,750	1,017,655	953,905
7009	Tjera tatime	17,556,858	17,556,858.00	18,655,210	12,754,490	(5,900,720)
7030	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	10,609,113	10,609,113.00	10,609,113	6,194,564	(4,414,549)
7031	Akciza	2,107,792,556	2,107,792,556.00	2,107,792,556	2,106,993,328	(799,228)
7032	Takse mbi shërbimet specifike (Lojëra fati)	0	-	-	0	-
7033	Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	0	-	-	0	-
7050	Taksa e rrugës	331,675	165,000.00	165,000	165,000	-
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	0	-	-	0	-
7115	Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	10,113,513	10,113,513.00	10,113,513	10,113,513	-
75	Sigurime shoqërore e shëndetësore	217,302,943	217,302,943.00	213,798,546	208,922,741	(4,875,805)
	Sigurime shoqërore	178,924,414	178,924,414.00	175,781,514	171,565,365	(4,216,149)
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	142,287,358	148,345,324.00	105,016,303	77,419,400	(27,596,903)
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	36,136,855	30,579,090.00	70,765,211	94,145,965	23,380,754
	Sigurime shëndetësore	38,378,529	38,378,529.00	38,017,032	37,357,376	(659,656)
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	34,283,457	34,031,663.00	35,524,103	29,601,812	(5,922,291)
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	4,095,072	4,346,866.00	2,492,929	7,755,564	5,262,635
	Të tjera	60,562,530	60,562,530.00	3,468,220		(3,468,220)
	Shtypshkrime	1,125,267	1,144,724.00	861,694		(861,694)
	1 % Grante	795,254	1,273,976.00	1,593,423	1,076,062	(517,361)
	Pulla (me çmim blerje)	307,582,788	321,467,297.00	288,222,896		
	Totali	2,795,713,322	2,809,818,452	2,714,960,228	2,353,724,814	(361,235,414)

Burimi: DPT dhe përpunuar nga grupi i auditimit

Pra, nga auditimi rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,353,724,814 lekë, i cili paraqiten me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 361,235,414 lekë. Sipas informacionit të dhënë, situata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo te gjitha deklaratat tatimore ishin te informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin ne ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore si agjent tatimorë. Pjesën me te madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohej dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,106,993,328 lekë i përket vetëm 1 tatimpaguesi, “A” SHA me Nipt J.....D sipas informacionit nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem. Diferenca tjetër përfaqëson detyrim të ndryshime të papaguara të akumuluar ndër vite për disa subjekte që nuk kanë qenë të regjistruar në sistem tatimor. Në zbatim të Urdhrit Nr. 146, datë 14.10.2022 “Për trajtimin e detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit” nga titullari i institucionit, pranë DPT është ngritur grupi i punës për trajtimin e problematikës së detyrimeve jashtë sistemit C@TS, i cili ka trajtuar problematikën në bashkëpunim me DRT. Grupi i punës përbëhet nga : Z. J Sh (Kryetar), Znj. FH (Anëtare), Znj. L T (Anëtare), Znj.A B (Anëtare). Në këtë urdhër është përcaktuar afati i realizimit të detyrave nga grupi i punës deri me data 1.12.2022. Pas verifikimit të situatës dhe

informacionit analitikë të marrë nga DRT, me anë të Memos nr. 121/50 prot., datë 19.06.2023 është dërguar relacioni përmbledhës mbi veprimtarinë e grupit të punës tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Nga analiza e kryer nga grupi i punës është identifikuar një listë subjektësh sipas problematikave; subjekte pa Nipt ose që nuk kanë gjeneralitet e mjaftueshme për tu regjistruar në sistem, subjektet me status PASIV/C' rregjistruar, subjekte me detyrim të papaguar Akcize dhe subjekte që sipas pretendimeve të DRT nuk mund të regjistrohen në sistem. Subjekti "A" SHA me vlerë 2,106,993,328 lekë lloji i detyrimit Akcizë për të cilin nuk ka modul për hedhje në sistem. Lista e debitorëve që nuk kanë gjeneralitet e nevojshme (pa nipt) për tu hedhur në sistem janë 762 subjekte me vlerë 58,740,342 lekë. Këto subjekte janë të penalizuar nga inspektorët e verifikimit në terren nga viti 2005-2011 për mosregjistrim aktiviteti, për të cilët janë kontabilizuar jashtë sistemit dhe sigurime shoqërore. Detyrimi i ndarë sipas llojit të tatimit jepet sipas tabelës:

Tabela nr.41 Detyrimi jashtë sistemit c@ts sipas llojit të tatimit

Në lekë

Lloji i Tatimit	Detyrimi Total
Tatim Fitimi	1,782,928
TVSH	6,184,358
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	35,838,566
TAP	435,997
Tatimi ne Burim	7,873,493
Denim pa tatim	6,925,000
TOTALI	58,740,342

Burimi : nga të dhëntat DPT

Nga analiza e kryer listës analitike rezultojnë 491 subjekte me vlerë 63,237,812 leke me status PASIV për të cilët nuk mund të bëhet hedhja në sistem sipas pretendimeve të Drejtorive Rajonale.

Tabela nr. 42 Detyrimi jashtë sistemit c@ts me status Pasiv sipas llojit të tatimit

Në lekë

Lloji i Tatimit	Detyrimi Total
TF	305,448
TVSH	31,796
Sigurime Shoqërore	59,920,444
TAP	2,666,174
Tatimi mbi Te ardhurat personale te Biznesit te Vogel	57,150
Taksa Kombëtare	165,000
Gjoha	91,800
TOTAL	63,237,812

Burimi : nga të dhëntat DPT

Nga analiza e kryer listes analitike rezultojnë 55 subjekte me status Çrregjistruar që zënë vlerën 3,725,089 lekë vlera e të cilëve do të ngelet në kontabilitete ndarë sipas llojit të detyrimit:

Në lekë

Lloji i Tatimit	Detyrimi Total
S. Shoq.	3,723,809
TAP	1,280
TOTAL	3,725,089

Burimi : nga të dhëntat DPT

Vlera prej 187,253,811 leke e ndarë sipas llojit të tatimit në tabelën më poshtë për 479 subjekte nuk do të hidhet në sistemin tatimor c@ts sipas pretendimeve të paraqitura nga Drejtoritë Rajonale.

Tabela nr. 43 Detyrimi jashtë sistemit c@ts sipas llojit të tatimit

Në lekë

Lloji i Tatimit	Detyrimi Total
TF	1,028,813
TVSH	5,278,594
Sigurime	117,369,939
TAP	1,289,271
Tatimi mbi Te ardhurat personale te Biznesit te Vogel	53,261,590
Tatimi ne Burim	7,131
DIVA	8,951,473
GJOBA	67,000
Total	187,253,811

Burimi : nga të dhëntat DPT

Nga sa më sipër rezulton se realizimi i detyrës së grupit të punës të përcaktuara në urdhër nuk është bërë në respektim të afatit (deri më datë 1 dhjetor 2022) si edhe procesi i hedhjes në sistem të detyrimeve nuk është finalizuar për shkak të problemeve të identifikuar nga grupi i punës. Rezulton se pas verifikimit të situatës dhe informacionit analitikë të marrë nga DRT nga grupi i punës dhe pas dërgimit të Memos nr. 121/50 prot., datë 19.06.2023 ku është dërguar relacioni përmbledhës mbi veprimtarinë e grupit të punës tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve nuk është dhënë një zgjidhje se si do të vijohet më tej me problematikat e identifikuar.

Titulli i gjetjes:	Gjatë vitit 2022 Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguar në DPT nuk ka kryer asnjë inspektim në DRT.
Situata:	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) rezultoi se gjatë vitit 2022 nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore. Sipas komunikimit me subjektin arsyeja që nuk është arritur kryerja e inspektimeve në DRT është se nuk ka pasur staf të mjaftueshëm. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara. Konstatohet se mungesa e kryerjes së inspektimeve është në kundërshtim me Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara , Kreu 2.1.1”Inspektimi”, Nuk janë kontrolluar apo monitoruar rajonet nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale, nëse kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhornuar të debitorëve, nëse kanë ndjekur procedurat e përcaktuara për masat shtrënguese. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara. Mos kryerja e inspektimeve është në kundërshtim me Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara , Kreu 2.1.1”Inspektimi”, ku përcaktohet se “ <i>Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtori të Përgjithshme duhet të garantojnë që të gjithë Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve në Rajone të kenë planet e punës dhe objektiva operacionale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara duke kryer plane inspektimi për të kontrolluar nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale; kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhornuar të debitorëve; kanë ndjekur procedura të përcaktuara të masave shtrënguese. Për inspektimet e kryera dhe për çdo vizitë inspektimi duhet të hartohet Raporti ku të trajtohen zbulimet e inspektimit</i> ”.
Kriteri:	Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, KREU XI, ”Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar ”, neni 88 ” Autoriteti dhe kompetencat për të

	<i>mbledhur detyrimet tatimore të papaguara</i> ”, nenin 135, paragrafet “3” dhe “4”. Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara , Kreu 2.1.1” <i>Inspektimi</i> ”.
Ndikimi:	Kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.
Shkaku	Vendet vakante në strukturën e drejtorisë DMDTP si edhe mosdakordësi për programet e inspektimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga titullari i DPT të analizohet situata e kësaj Drejtorie duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të merren masa për plotësimin e vendeve vakantë të drejtorisë DMDTP sipas strukturës së miratuar Urdhrit e Kryeministrit Nr. 33 datë 12.02.2020 “ <i>Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore</i> ”, sëbashku me hartimin e miratimin e programeve të inspektimit në mënyrë që DMDTP të realizojë inspektime në të gjithë rajonet.

Titulli gjetjes:	Detyrimet tatimore të papaguara jashtë sistemit tatimorë c@ts në vlerën 2,353,724,814 lekë.
Situata:	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,353,724,814 lekë, i cili paraqitet me ulje krahasuar me vitin paraardhës për vlerën 361,235,414 lekë. Situata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo të gjitha deklaratat tatimore ishin të informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin në ndjekje dhe administrim nga Administrata Tatimore si agjentë tatimorë.</p> <p>Pjesën më të madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,106,993,328 lekë i përket vetëm 1 tatimpaguesi, vlerë e cila sipas informacionit nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem. Diferenca tjetër përfaqëson detyrime të ndryshme të papaguara të akumuluar ndër vite për disa subjekte që nuk kanë qenë të regjistruar në sistem tatimor. Në zbatim të Urdhrit Nr.146, datë 14.10.2022, pranë DPT është ngritur grupi i punës për trajtimin e problematikës së detyrimeve jashtë sistemit C@TS, i cili ka trajtuar problematikën në bashkëpunim me DRT.</p> <p>Lista e debitorëve që nuk kanë gjeneralitetet e nevojshme (pa NIPT) për t’u hedhur në sistem përbëhet nga 762 subjekte me vlerë gjithsej 58,740,342 lekë. Këto subjekte janë të penalizuar nga inspektorët e verifikimit në terren nga viti 2005-2011 për mos regjistrim aktiviteti, për të cilët janë kontabilizuar jashtë sistemit dhe sigurime shoqërore gjë që ka sjellë mangësi në raportimin e të dhënave lidhur me debitorët për sa kohë një pjesë e tyre mbahen në sistem, dhe një pjesë jashtë sistemit. Gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes së mbledhjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>

Kriteri:	- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, KREU XI, ”Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar ”, neni 88 ” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimit tatimorë të papaguar ”. - Ligji nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. - Urdhri i brendshëm nga titullari i DPT, Urdhri Nr.146, datë 14.10.2022, pika 2 dhe pika 3.
Ndikimi:	Ekzistenca e detyrimeve tatimore jashtë sistemit aktual sjell mangësi në raportimin e të dhënave lidhur me debitorët për sa kohë një pjesë e tyre mbahen në sistem, dhe një pjesë jashtë sistemit; gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT.
Shkaku	Mangësitë e identifikuara në drejtim të hedhjes në sistem të këtyre detyrimeve si edhe mungesa e moduleve në sistem për hedhjen e detyrimeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPT të marrë masa për trajtimin e rasteve sipas problemeve të identifikuara nga grupi i punës së ngritur në DPT në mënyrë që këto detyrimet tatimore të papaguara të trajtohen me procedurën e mbledhjes së borxhit tatimorë që të rritet mundësia e vjeljes së detyrimit.

Titulli gjetjes:	Stoku i detyrimit tatimorë të papaguar në vitin 2022 është rritur me 11.8 miliard lekë.
Situata:	Gjendja e detyrimeve tatimore gjithsej të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën rreth 134,934 milion lekë, që i përket një numri prej 192,701 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej rreth 182,379 subjektsh debitorë. Pra rezulton një rritje prej rreth 11.8 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me një ulje prej 10,322 debitorëve në fund të vitit. Subjektet me status Aktiv janë në numër 64,543 ose 37 % e total numrit të subjekteve debitorë, me vlerë detyrimi të papaguar afërsisht 40.7 miliard lekë ose 28 % e total detyrimit të papaguar. Subjektet me status Pasiv janë numër 110,948 subjekte ose 63 % mbi numrin gjithsej të subjekteve debitor, me vlerë detyrimi të papaguar 105.9 miliard lekë ose 72 % mbi total detyrimin e papaguar. Krahasuar me vitin e kaluar rezulton një rritje e subjekteve pasive në numër janë rritur afërsisht me 6 % dhe në vlerë janë rritur afërsisht 7 % e masës së detyrimit total të papaguar. Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2022 rezulton se peshën më të madhe të stokut të detyrimit e zënë detyrimet me moshë borxhi nga 2-5 vite me peshë 28 % të total detyrimit të papaguar dhe detyrimet me moshë borxhi mbi 5 vite zënë rreth 49% të total detyrimit të papaguar. Krahasuar me vitin paraardhës rezulton se borxhi me moshë 1-2 vjet është rritur me afërsisht 5 miliard lekë ose 4 % më shume mbi totalin e detyrimit dhe borxhi më moshë mbi 5 vite me 18 miliard lekë ose 10 % më shume mbi totalin e detyrimit, fashat e tjera të moshës së borxhit kanë një rritje me të vogël. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2022 janë 37 miliard lekë ose afërsisht 4 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2021, ku detyrimet e shtuara ishin 33 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 24 miliard lekë,

	<p>krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 18 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 5 miliard lekë më shumë. Për sa i përket subjekteve në proces gjyqësor rezultojnë 1,391 subjekte me detyrim total 13 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2021 janë rreth 200 subjekte më pak me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuara në gjykatë prej rreth 1 miliard lekë më pak. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuara prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,135 subjekte, ndjekur nga DTM me rreth 2 miliard lekë për 90 subjekte. Për sa i përket stokut të detyrimeve tatimore të papaguara sipas rajoneve rezulton se rajoni Qendror ka peshën më të madhe të rritjes së detyrimeve të papaguara, afërsisht me 70 % të total detyrimit tatimorë të papaguar ose 8,272 milion lekë rritje. Rezulton se në rajonin Qendror afërsisht 30% të total detyrimit tatimorë të papaguar e zënë 6 subjekte me status pasiv me vlerë detyrimi 30.5 miliard lekë. Rritja e stokut të detyrimeve tatimore të papaguara e bën më të vështirë menaxhimin e detyrimit tatimor të papaguar në drejtim të reagimit sa më të shpejtë që të jetë e mundur ndaj borxheve të reja, pasi ndërhyrja e hershme rrit gjasat për mbledhjen e borxhit tatimor. Rritja e detyrimeve tatimore përgjatë vitit 2022 nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 1, neni 88 të Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar ku përcaktohet se “<i>Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor</i>” dhe përcaktimeve të manuali të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku në hyrje përcakton se “<i>Ky manual del në ndihmë të inspektorëve tatimorë gjatë punës së tyre për mbledhjen e detyrimeve të papaguara</i>”.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “ <i>Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë</i> “, i ndryshuar, pika 1 neni 88 . Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara .
Ndikimi:	Rritja e stokut të detyrimeve tatimore të papaguara e bën më të vështirë menaxhimin e detyrimit tatimor të papaguar në drejtim të reagimit sa më të shpejtë që të jetë e mundur ndaj borxheve të reja, pasi ndërhyrja e hershme rrit gjasat për mbledhjen e borxhit tatimor.
Shkaku	Mangësi në masat shtrënguese të implementuara për arkëtimin e detyrimeve të papaguara dhe në drejtim të procesit të monitorimit të borxhit nga momenti i krijimit të tij, deri në mbledhjen me forcë të borxhit tatimor në DRT si edhe shtesat e detyrimeve tatimore nga vlerësimet dhe rivlerësimet e Administratës Tatimore; Numri i lartë i debitorëve pasiv, apo me moshë të konsiderueshme të këtij detyrimi; DMDTP është kryesisht e përqendruar në monitorim dhe raportim dhe jo në marrjen e një roli aktiv në përmirësimin e efektivitetit të fushave operacionale të drejtorisë si edhe në identifikimin e rasteve të borxhit me risk të lartë që kërkojnë menaxhim proaktiv.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masa për uljen e borxhit tatimor, si dhe të luajnë një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit dhe marrjen e masave konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të

parashikuar për uljen e borxhit tatimor, si edhe duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Znj.Sh.K. në pozicionin Drejtor Drejtoria e Mbledhjes Detyrimit Tatimor të papaguara për periudhën Janar 2022-Tetor 2022, z.N.Xh në pozicionin Drejtor i komanduar, Drejtoria e Mbledhjes Detyrimit Tatimor të papaguara për periudhën Nëntor 2022 e në vijim dhe z.C.K në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar DPT dhe Znj.Sh K ish drejtoresha e drejtorise së DMDTP me shkresën nr. 284/5 prot., datë 26.07.2023 dhe me shkresë nr. 284/8 prot.,me date 06.09.2023, janë bërë komente dhe shpjegime për konstatimet, të cilat shkurtimisht paraqiten:

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër, duke u nisur si nga rekomandimet e mëparshme të KLSH-së ashtu edhe nga planet e punës së realizuara nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, rezultatet kanë treguar se këto masa kanë qene jo-efektive dhe jo-reale. Asnjë nga masat e ndërmarra nuk ka pasur ndikim pozitiv në maksimizimin e arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara. Për këtë arsye është vendosur te aplikohen metodologji te reja dhe janë marre masa te reja te menjëhershme duke filluar me shkarkimin nga detyra te Drejtorit të DMDTP dhe Drejtorit te DMDTP-RQ për mosmbushje të detyrave funksionale të cilat kanë për qellim bazë “*Maksimizimin e mbledhjes se detyrimeve Tatimore të Papaguara, duke siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe respektimin e të drejtave të tatimpaguesve*”. Duhet të evidentohet se zëvendësimi i tyre ka dhënë efekte të menjëhershme në përmirësimin e rezultateve.

-Për të rritur eficientën e kësaj Drejtorie janë angazhuar edhe 2 struktura te tjera siç është D.I.B.A dhe Drejtoria e Auditit te Brendshëm. Është proceduar me një investigim dhe audit nga këto 2 drejtori ndaj DMDTP dhe DMDTP-RQ, për të vijuar më pas edhe me Drejtoritë e tjera Rajonale të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Nepermjet Konstatimit nr. 5293 Prot.,date 02.03.2023 pergatitur nga DIBA si dhe Raportit perfundimtar I auditit nr. 18998/5 Prot.,date 09.06.2023:

-Jane evidentuar në menyre të qarte dhe të paster problematikat e kësaj Drejtorie në mënyrë që në të ardhmen masat e reja që do te merren të jenë më të plota dhe më efektive.

-Jane referuar dhe jane marre masa disiplinore per 23 punonjes me “shkelje shume të rëndë”.

-Inspektimet ne cdo rajon do të rifillojnë sërish vetëm pas zbatimit të masava disiplinore që janë marrë nga DIBA dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm.

.....Me datë 20.07.2023 kam marrë në dorëzim Akt-konsattimin nr.2 nëpërmjet sistemit postar...Në lidhje me konstatimin se gjatë vitit 2022 nuk është kryer asnjë inspektim ju bejmë me dije se në manual është përcaktuar kryerja e inspektimeve, kjo nuk do të thotë që inspektimet mund te kryhen cdo vit për sa kohë DPT vepron me bazën e një plani operacional të miratuar nga Komiteti Operacional, me kryetar titullarin e DPT. Në planin operacional të vitit 2022 nuk u miratua kryerja e inpektimeve pavarësisht se një gjë e tillë u propozua nga DMDTP në DPT, u dërgua neprëmjet emailit të datës 21.12.2021 dhe u relatua ne komitetin operacional. Komiteti miratoi vetem objektivat që ai gjykoi të arsyeshme. Nga DMDTP është kryer inspektimi ne rajonin Qendror per vitin 2021 por projekt raporti i datës 25.02.2022, është kryer inspektimi ne rjonin Verior për periudhen 01.08.2020-30.08.2022, projekt raportet nuk janë firmosur nga titullari i DPT. Si mund të shkoja për inspektim tjeter ne rajonin qëndror kur nuk është mbyllur një inspektim....Ne rajonin Jug dhe ne rajonin DTM nuk është kryer inspektim pasi eshte kryer auditimi nga KLSH...Me date 26.08.2022 kam përgatitur programin e inspektimit per DMDTP ne DTM por nuk u trajtua dhe nuk u firmos nga Titullari i DPT. Në lidhje me rritjen e detyrimeve tatimore të papaguara , DMDTP nuk është përgjegjëse për krijimin konstatimin apo shtimin e detyrimeve tatimore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Grupi i Auditimit pasi shqyrtoi observacionin Tuaj të cilat janë të njëjtat si në akt konstatim sqaron se: Nga auditimi i dokumenteve dhe i veprimtarisë së drejtorisë gjatë vitit 2022 rezultoi se nuk është marrë asnjë mase në drejtim të menaxhimit të detyrimit të papaguar

tatimorë. Masat e cituara nga ju në observacion janë marrë gjatë vitit 2023 për këtë arsye nuk merren në konsideratë për periudhën objekt auditimi.

Gjithashtu, mbi pjesën e dytë të observacioneve sqarojmë:

Në lidhje me objeksionet e sjella me shkresën nr. 284/5, datë 26.07.2023 informacioni mbi planet operationale dhe planet e inspektimit është reflektuar që në fazën e projekt raportit. Sqarojmë se pavarësisht se në manualin e mbledhjes nuk është përcaktuar frekuenca e kryerjes së inspektimeve, kjo nuk ju zhvesh nga përgjegjësia e moskryerjes së inspektimeve, nëpërmjet inspektimit shikohet zbatueshmeria e procedurës së mbledhjes së detyrimit tatimor në rajon, që të kenë planet e punës dhe objektiva operationale për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Këto plane dhe objektiva duhet të jenë në përputhje me planin strategjik të DPT dhe rregulloren e brendshme. Inspektimi është një element kyç për arketimin e detyrimeve tatimore të papaguara. Në lidhje me rritjen e stokut të detyrimeve tatimore të papaguara si edhe justifikimit të dhënë se DMDTP nuk është përgjegjëse për krijimin dhe shtimin e detyrimeve tatimore, sqarojmë se përgjegjësia për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara si edhe autoriteti dhe kompetenca për ta ushtruar këtë funksion është bazuar në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, kreu XI, neni 88, “Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar”, pika 2 “Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor” dhe pika 5 “Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.

2.4. Mbi deklarin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH.

Çështjet e audituara:

- Detajimi i “Planit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore (ISSH);
- Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (FSDKSH);
- Dërgimi në ISSH, të listëpagesave me të dhëna statistikore dhe të kontributeve të paguara.

Nga auditimi rezultoi se,

Në zbatim të nenit 4 dhe 14, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve. Të ardhurat nga kontributet, nënkuptojnë të ardhurat nga pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për auditimin e kësaj çështje u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, si dhe të dhëna të detajuara, marrë nga sistemi c@ts, mundësuar nga AKSHI, në lidhje me listëpagesat e deklaruara dhe të paguara për kontributet, me të dhëna për vitin 2022 dhe progresive.

Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

“Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është detajuar me shkresën nr. 1678 prot., datë 31.01.2022 të MFE, protokolluar me nr. 1531 prot., datë 01.02.2022 në DPT. Referuar kësaj

shkresë plani i të ardhurave për ISSH dhe FSDKSH-në për vitin 2022, është në vlerën **108,100,000 mijë lekë**.

Me Aktin Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, nuk ka ndryshim të planit së të ardhurave krahasuar me planifikimin fillestar.

Me shkresë nr. 13863 prot, në DPT datë 12.08.2022, është dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndryshimi i planit së të ardhurave vjetore, sipas **Aktit normativ nr. 12 datë 29.07.2022** “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar. Konstatohet se plani i të ardhurave është në vlerën **113,655,000 mijë lekë**, në rritje krahasuar me planifikimin fillestar me 5,555,000 mijë lekë ose në masën 1 %.

Me shkresën nr. 21811 prot, në DPT datë 29.12.2022, është dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas **Aktit normativ nr. 17 datë 01.12.2022** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar. Konstatohet rritje në planin e të ardhurave, në vlerën **115,655,000 mijë lekë**, në rritje me planifikimin fillestar me 7,555,000 mijë lekë ose në masën 1.07 %.

Të ardhurat tatimore për vitin 2022, janë rakorduar me shkresën nr. 1304, datë 27.01.2023 me Degën e Thesarit Tiranë, në përputhje me kërkesat rregullatore për kryerjen e rakordimeve me bazë vjetore në lidhje me të ardhurat progresive. Në këtë rakordim janë përfshirë të ardhurat në nivel analitik. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat mbliidhen nga DPT, për llogari të ISSH-së dhe FSDKSH- së.

Tabela nr. 44 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të sig. shoqërore dhe shëndetësore

Në mijë lekë

Emërtimi	Realizimi Faktik 2022	Plani 2022 referuar Ligjit 115/2021 të Buxhetit	Plani 2022 sipas Aktit Normativ nr. 12 datë 29.07.2022	Plani 2022 sipas Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022	Diferenca	%
	1	2	3	4	5=4-2	
Kontributet e Sigurimeve	118,465,172	108,100,000	113,655,000	115,655,000	7,555,000	1.07%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Mbështetur në udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT, me shkresën nr. 290 prot, datë 10.01.2023, ka dërguar në ISSH, si dhe me shkresën nr. 291 prot, datë 10.01.2023, ka dërguar në FSDKSH, treguesit mbi realizimin e të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në vlerën 117,633,342 mijë lekë, së bashku me vlerën 118,135,003 mijë lekë, të cilat janë të ardhura nga kamatvonesat dhe gjobat, vlera të detajuara në tabelën më poshtë e të saktësuar sipas sistemit C@ts.

Tabela nr. 45 Të ardhurat nga kamatëvonesat dhe gjobat.

Në mijë lekë

Llogaria	Përshkrimi	Vlera
7090101	Kamat vonesa të kontrib të sig. shoqërore	118,186,207
7090104	Kamat vonesa të kontrib të sig. shëndetësore	20,574,673
7115101	Gjoba të sigurimeve shoqërore	310,611,031
7115118	Gjoba të sigurimeve shëndetësore	52,289,145
	Totali i Përgjithshëm	118,135,003

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se, DPT në rakordimin me Thesarin përfshin si të ardhur nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, edhe të ardhurat nga kamatëvonesat dhe gjobat, të cilat janë të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe vlerën 155,707,330 lekë, të llogarisë 466 “Kreditorë mjete në ruajtje”, nënlllogaria 4665510

“Depozitime të përkohshme për Listëpagesën”, e cila përfaqëson detyrimin e paguar për kontributet i cili ka mbetur pezull, pa u kontabilizuar ende, në llogarinë përkatëse së të ardhurës, e detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 46 Të ardhurat nga kamatëvonesat dhe gjobat.

Në mijë lekë

Llogaria	Përshkrimi	Vlera
7090101	Kamat vonesa të kontrib të sig. shoqërore	118,186,207
7090104	Kamat vonesa të kontrib të sig. shëndetësore	20,574,673
7115101	Gjopa të sigurimeve shoqërore	310,611,031
7115118	Gjopa të sigurimeve shëndetësore	52,289,145
7115119	Gjopa për mos deklarim punonjësish	100,608,973
7115654	Gjopa për deklarim të vonuar sig. shoq, shënd dhe tap	73,852,689
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sigurime shoqërore, shendetesore dhe TAP)	155,707,330
	Totali i Përgjithshëm	831,830,048

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e të dhënave rezulton se, vlera e raportuar si e ardhur nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për 118,465,172 mijë lekë, është e përbërë nga Të ardhura nga kontributet, në vlerën për 117,633,342 mijë lekë dhe Të ardhura të tjera për llogari të kontributeve, për vlerën 831,830 mijë lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka dërguar evidencën për të ardhurat Tatimore dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, mbi të ardhurat e realizuara për periudhën Janar - Dhjetor 2022, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë në shumën 118,465,172 mijë lekë, të detajuara në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 47 Llogaritë analitike të të ardhurave nga kontributet.

Në lekë

A=1+2+3	75	Kontributet e Sigurimeve Gjithsej	117,633,342,108
1	750	Kontribute nga të punësuarit	
	7500	Kontribute të sektorit buxhetor të punësuar	
	7500100	Sigurime shoqërore	12,932,812,074
	7500200	Sigurime shëndetësore	2,402,623,359
	7500400	Kontribute suplementar	1,468,230,362
1.1	7501	Kontribute të sektorit shtetëror të punësuar	
	7501100	Sigurime shoqërore	2,151,671,417
	7501200	Sigurime shëndetësore	400,839,383
	7501400	Kontribute suplementar	11,528,858
1.2	7502	Kontribute të sektorit Privat të punësuar	
	7502100	Sigurime shoqërore	20,911,187,742
	7502200	Sigurime shendetesore	4,725,722,385
	7502400	Kontribute suplementar	61,007,040
2	751	Kontribute nga të punëdhënësi	
2.1	7510	Kontribute të sektorit buxhetor të punëdhënës	
	7510100	Sigurime shoqërore	20,442,882,955
	7510200	Sigurime shëndetësore	2,404,544,476
	7510400	Kontribute suplementar	11,580,424
2.2	7511	Kontribute të sektorit shtetëror të punëdhënës	
	7511100	Sigurime shoqërore	3,395,784,190
	7511200	Sigurime shëndetësore	400,992,810
	7511400	Kontribute suplementar	12,301,401
2.3	7512	Kontribute të sektorit Privat të punëdhënës	

	7512100	Sigurime shoqërore	36,723,946,963
	7512200	Sigurime shëndetësore	4,724,419,552
	7512400	Kontribute suplementar	74,622,547
	7512999	Kontribute të paidentifikuara	
3	752	Kontribute nga të vetpunësuarit	
3.1	7520	Kontribute nga të vetpunësuarit	
	7520100	Sigurime shoqërore	3,408,291,528
	7520200	Sigurime shëndetësore	968,352,642
B=5+6+7		Të ardhura të tjera për llogari të kontributeve	831,830,048
5		Gjoha dhe kamatvonesa të kontributeve shoqërore	
	7090101	Kamatvonesa të kontributeve të sigurimeve shoqërore	118,186,207
	7115101	Gjoha të sigurimeve shoqërore	310,611,031
6		Gjoha dhe kamatvonesa të kontributeve shëndetësore	
	7090104	Kamatvonesa të kontributeve të sigurimeve shëndetësore	20,574,673
	7115118	Gjoha të sigurimeve shëndetësore	52,289,145
7		Të ardhura të pa klasifikuara	
	7115654	Gjoha për deklarim të vonuar Sig shoq, shënd. dhe tap	73,852,689
	7115119	Gjoha për mosdeklarim punonjësish	100,608,973
	4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (Kontribute dhe TAP)	155,707,330
A+B		Totali i Përgjithshëm	118,465,172,156

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa më sipër, si dhe referuar Raportit të DPT për vitin 2022, të ardhurat nga Kontributet janë në vlerën **118,465 milion lekë**.

Tabela në vijim paraqet realizimin faktik së të ardhurave nga kontributet për periudhën 2020-2022.

Tabela nr. 48 Realizimi faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2020-2022.

Në mijë lekë

E M Ë R T I M I	Realizimi Faktik 2020	Realizimi Faktik 2021	Realizimi Faktik 2022
Të ardhura nga Kontributet e Sigurimeve	94,116,872	106,266,160	118,465,172

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se në vitin 2022, të ardhurat nga kontributet, krahasuar me vitin 2021, janë rritur në vlerën 12,199,012 mijë lekë. Ndërsa nga të dhënat e deklaruara në Raportin Vjetor 2022, të veprimtarisë së ATQ, të publikuar në faqen zyrtare të Institucionit, diferenca e realizimit të vitit 2021 me 2022, të të ardhurave nga sigurimet shoqërore & shëndetësore, sipas sektorëve të punësimit paraqitet në vlerën 12,343,706 mijë lekë, me një diferencë prej 114,694 lekë, të detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 49 Të ardhurat nga sig. shoqërore & shëndetësore, sipas sektorëve të punësimit .

Në mijë lekë

Sektori i punësimit	12 muji 2021	12 muji 2022	Diferenca	%
në Sektorin e Ndërtimit	6,313,608	7,268,830	955,222	15.1%
në Sektorin e Prodhimit	16,472,591	18,731,802	2,259,212	13.7%
në Sektorin e Shërbimit	64,569,969	70,496,317	5,926,348	9.2%
në Sektorin e Transportit	2,652,475	3,351,011	698,536	26.3%
në Sektorin e Tregtisë	16,144,336	18,648,725	2,504,389	15.5%
Totali	106,152,979	118,496,685	12,343,706	11.6%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizim e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të drejtorive rajonale, nga të cilat në bazë të legjislacionit mbliidhen nga DPT.

Tabela nr. 50 Plani dhe realizimi i të ardhurave të sig. shoqërore dhe shëndetësore

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2022, ndryshuar me AN nr. 17	Realizimi Faktik 2022	Në %
Berat	2,700,000	2,608,828	97%
Dibër	2,370,000	2,243,837	95%
Durrës	10,065,000	10,354,313	103%
Elbasan	5,100,000	4,982,219	98%
Fier	5,900,000	5,982,553	101%
Gjirokastrë	1,910,000	1,945,928	102%
Korçë	4,020,000	4,021,445	100%
Kukës	1,450,000	1,478,711	102%
Lezhe	2,730,000	2,715,314	99%
Sarandë	1,340,000	1,359,676	101%
Shkodër	4,670,000	4,537,709	97%
Tiranë	42,800,000	44,933,126	105%
DTM	26,850,000	27,444,738	102%
Vlorë	3,750,000	3,856,776	103%
Totali	115,655,000	118,465,172	102%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Në analizë së të dhënave të mësipërme, konstatohet se, nuk kanë performancë të mirë në realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për vitin 2022, DRT Berat me 97%, Dibër me 95%, Elbasan me 98%, Lezhe me 99% e Shkodër 97%.

Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (FSDKSH)

“Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është detajuar me shkresën e MFE nr.1678 prot., datë 31.01.2022, protokolluar në DPT nr.1531 prot., datë 01.02.2022. Referuar këtij plani, me shkresën nr. 4969 prot, datë 30.03.2022, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka përcjellë planin e të ardhurave për FSDKSH, për vitin 2022, në vlerën për **14,580,000 mijë lekë**.

- Akti Normativ nr. 12, datë 11.08.2022 “Për disa ndryshime në ligjin 115/2021, datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, është dërguar i detajuar me shkresën e MFE nr. 15210 prot, datë 11.08.2022, i protokolluar në DPT me nr. 13827, datë 12.08.2022. Referuar këtij plani, me shkresën nr. 14210/1 prot datë 07.09.2022, të DPT, është dërguar plani i detajuar i të ardhurave për kontributet shëndetësore, në FSDKSH për vitin 2022, në vlerën për **15,355,000 mijë lekë**.

- Akti Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022, të ndryshuar”, është dërguar i detajuar me shkresën e MFE nr. 23744 prot, datë 27.12.2022, i protokolluar në DPT me nr. 21811, datë 29.12.2022. Me shkresën nr. 21811/3 prot, datë 12.01.2023 është dërguar plani i detajuar i të ardhurave për kontributet shëndetësore, në FSDKSH për vitin 2022, në vlerën për **15,613,000 mijë lekë**. Tabela në vijim, paraqet planifikimin dhe realizimin e planit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale.

Tabela nr. 51 Plani dhe realizimi i planit të kontributeve shëndetësore, sipas DRT

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2022, ndryshuar me AN nr. 17	Realizimi Faktik 2022	Diferenca Fakt-Plan	Realizimi në %
Berat	364,493	353,739	-10,754	97%
Dibër	319,942	283,053	-36,889	88%
Durrës	1,358,749	1,393,975	35,226	103%
Elbasan	688,489	674,822	-13,666	98%
Fier	796,486	814,678	18,191	102%
Gjirokastrë	257,846	253,089	-4,757	98 %
Korçë	542,694	545,341	2,647	100%
Kukës	195,746	184,387	-11,359	94%

Lezhë	368,542	365,714	-2,827	99%
Sarandë	180,898	190,834	9,937	105%
Shkodër	630,437	601,123	-29,314	95%
Tiranë	5,777,825	6,093,548	315,723	105%
DTM	3,624,614	3,826,508	201,895	106%
Vlorë	506,240	519,546	13,306	103%
Totali	15,613,000	16,100,358	487,358	103%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar planifikimit së të ardhurave nga kontributet rezulton se, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore për vitin 2022, janë realizuar në masën 103%. Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2022, si dhe krahasimi me vitin paraardhës.

Tabela nr. 52 Realizimi i kontributeve shëndetësore sipas DRT, krahasuar me vitin 2021

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2021	Realizimi Faktik 2022	Diferenca	%
Berat	331,358	353,739	22,381	107%
Dibër	259,935	283,053	23,118	109%
Durrës	1,217,472	1,393,975	176,503	114%
Elbasan	632,749	674,822	42,074	107%
Fier	745,437	814,678	69,241	109%
Gjirokastër	242,083	253,089	11,007	105%
Korçë	514,524	545,341	30,817	106%
Kukës	172,027	184,387	12,359	107%
Lezhë	340,120	365,714	25,594	108%
Sarandë	171,807	190,834	19,028	111%
Shkodër	559,336	601,123	41,787	107%
Tiranë	5,287,294	6,093,548	806,254	115%
DTM	3,491,156	3,826,508	335,352	110%
Vlorë	470,748	519,546	48,798	110%
Totali	14,436,047	16,100,358	1,664,312	112%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi i planit për vitin 2022, krahasuar me vitin paraardhës, rezulton në rritje me 1,664,312 mijë lekë, ose me 12% më shumë. Nga të dhënat e mësipërme, evidentohet se efektin më të madh në realizimin e planit e ka DRT Tiranë në masën 115% dhe që përfaqëson 37.9% së të ardhurave, e ndjekur nga DRT Durrës në masën 114% të planit së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore (ISSH)

“Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është detajuar me shkresën e MFE nr.1678 prot., datë 31.01.2022, protokolluar në DPT nr.1531 prot., datë 01.02.2022. Referuar këtij plani, me shkresën nr. 4970 prot, datë 30.03.2022, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka përcjellë planin e të ardhurave për ISSH, për vitin 2022, në vlerën për **93,520,000 mijë lekë**.

- Akti Normativ nr. 12, datë 11.08.2022 “Për disa ndryshime në ligjin 115/2021, datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, është dërguar i detajuar me shkresën e MFE nr. 15210 prot, datë 11.08.2022, i protokolluar në DPT me nr. 13827, datë 12.08.2022. Referuar këtij plani, me shkresën nr. 14207/1 prot datë 07.09.2022, të DPT, është dërguar plani i detajuar i të ardhurave për kontributet shoqërore, në ISSH për vitin 2022, në vlerën **98,300,000 mijë lekë**.

- Akti Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022, të ndryshuar”, është dërguar i detajuar me shkresën e MFE nr. 23744 prot, datë 27.12.2022, i protokolluar në DPT me nr. 21811, datë 29.12.2022. Me

shkresën nr. 21811/2 prot, datë 12.01.2023 është dërguar plani i detajuar i të ardhurave për kontributet shoqërore, në ISSH për vitin 2022, në vlerën për **100,042,000 mijë lekë**. Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2022, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore është realizuar në masën **102,364,814 mijë lekë**. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

Tabela nr. 53 Planifikimi dhe realizimi i planit të kontributeve shoqërore, viti 2022

Në mijë lekë

Emërtimi	Plani 2022 referuar ligjit të buxhetit	Plani 2022 Akti normativ nr. 12	Plani 2022 Akti normativ nr. 17	Realizimi Faktik 2022	Ndryshim në %
Kontributet Sig.shoqërore	93,520,000	98,300,000	100,042,000	102,364,814	102%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2022 dhe krahasimi me vitin paraardhës.

Tabela nr. 54 Realizimi i kontributeve shoqërore sipas DRT, krahasuar me vitin 2021

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2022	Realizimi Faktik 2021	Diferenca	%
Berat	2,255,089	2,104,404	150,685	107%
Dibër	1,960,784	1,790,293	170,491	110%
Durrës	8,960,284	7,827,272	1,133,012	114%
Elbasan	4,307,397	4,036,585	270,812	107%
Fier	5,167,875	4,694,752	473,124	110%
Gjirokastrë	1,692,839	1,624,869	67,969	104%
Korçë	3,476,104	3,268,434	207,670	106%
Kukës	1,294,324	1,209,213	85,110	107%
Lezhe	2,349,600	2,190,235	159,365	107%
Sarandë	1,168,895	1,056,691	112,204	111%
Shkodër	3,936,586	3,621,656	314,930	109%
Tiranë	38,839,578	33,873,950	4,965,628	115%
DTM	23,618,230	21,498,151	2,120,079	110%
Vlorë	3,337,230	3,033,608	303,622	110%
Totali	102,364,814	91,830,113	10,534,701	111%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi i planit për vitin 2022, krahasuar me vitin paraardhës, rezulton në rritje me 10,534,701 mijë lekë, ose me 11% më shumë. Nga të dhënat e mësipërme, evidentohet se efektin më të madh në realizimin e planit, e ka DRT Tiranë në masën 115% dhe që përfaqëson 37.9% së të ardhurave, e ndjekur nga DRT Durrës në masën 114% të planit, së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

Tirana dhe Durrësi janë qytetet me numrin më të madh të popullsisë në vend, si dhe me lëvizjen më të madhe demografike të tyre, prandaj dhe konstatohet tejkalim më i madh i planit së të ardhurave shëndetësore e shoqërore nga DRT Tiranë e DRT Durrës.

Mbi dorëzimin e listëpagesave në ISSH.

Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe marrëdhëniet e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me Drejtoritë Rajonale Tatimore mbështeten në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”. Ndër të tjera, në kreun VI, “Shkëmbimi i informacionit për kontributet dhe pagesat”, është përcaktuar se DPT dërgon në ISSH, të gjithë të dhënat statistikore dhe të kontributeve të paguara, bazuar

në procedurën e komunikimit “online”, midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet. Bazuar në këto dispozita, dhe mbështetur në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr. 1422, datë 19.05.2017, në tabelën më poshtë janë detajuar listëpagesat e deklaruara dhe të dërguara në ISSH, të përpunuara nga sistemi c@ts, për vitin 2022.

Tabela nr. 55 Listëpagesa të deklaruara dhe dërguara në ISSH, në vitin 2022

Periudha	Listëpagesa totale 1 = 2+3	Normale	Ndryshime	Pa Deklaruar	Paguar plotësisht (përveç TAP)	Dërguar në ISSH
	1	2	3	4	5	6
Janar	128,139	118,862	9,277	2,746	119,042	119,026
Shkurt	127,284	119,628	7,656	2,600	118,191	118,180
Mars	127,476	120,200	7,276	2,558	118,322	118,311
Prill	129,721	120,801	8,920	2,778	119,954	119,940
Maj	128,601	121,603	6,998	2,643	118,802	118,787
Qershor	129,930	123,153	6,777	2,611	119,912	119,897
Korrik	129,936	122,975	6,961	2,741	119,612	119,587
Gusht	129,310	123,139	6,171	2,636	118,863	118,833
Shtator	129,816	123,012	6,804	2,348	119,061	119,006
Tetor	127,271	122,440	4,831	2,548	115,871	115,822
Nëntor	126,329	122,322	4,007	2,413	114,821	114,760
Dhjetor	126,037	122,500	3,537	2,503	114,186	114,127
Totali	1,539,850	1,460,635	79,215	31,125	1,416,637	1,416,276

Burimi: Drejtoria TIK (AKSHI) në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi konstatohen 1,460,635 deklarata normale, 79,215 deklarata me ndryshime, si dhe 31,125 listëpagesa të padeklaruara. Nga të dhënat, rezultojnë se nga ana e DPT janë dërguar elektronikisht 1,416,276 listëpagesa në ISSH, për vitin 2022, me një diferencë prej 43,998 listëpagesa nga totali. Për sa më sipër, konstatohet se mungesa e transferimit të listëpagesave në ISSH është bërë në kundërshtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr. 1422, datë 19.05.2017, me efekt mospaspqyrimi në kohë, të kontributeve të deklaruara e të paguara.

Tabela në vijim paraqet vlerën totale të detyrimeve të kontributeve shoqërore e shëndetësore, sipas grupeve punëdhënës e punëmarrës, nga detyrimet e akumuluar në vite, deri më 31.12.2022.

Tabela nr. 56 Deklarimet e kontributeve sipas punëdhënësve e punëmarrësve, në vitin 2022

Në mijë lekë

Llog.	Emërtimi	Detyrime gjendje më 31.12.2022	Detyrime të vitit 2022	Detyrime të periudhës para vitit 2022
		1= 2+3	2	3
75021	Kontribute shoqërore punëmarrës	8,734,121,496	1,037,402,785	7,696,718,711
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	9,194,247,734	2,879,323,880	6,314,923,854
A	Shuma Sigurime Shoqërore	17,928,369,230	3,916,726,665	14,011,642,565
75122	Kontribute shëndetësore punëmarrës	1,071,784,623	348,378,248	723,406,375
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	1,219,787,297	352,685,138	867,102,159
B	Shuma Sigurime Shëndetësore	2,291,571,920	701,063,386	1,590,508,534
A+B	Shuma Totale	20,219,941,150	4,617,790,051	15,602,151,099

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, vlera e detyrimeve për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në fund të vitit 2022, është në shumën 20,219,941 mijë lekë nga të cilat, detyrimet për kontributet shoqërore janë në vlerën 17,928,369 mijë lekë dhe detyrime për kontributet shëndetësore janë në vlerën 2,291,572 mijë lekë.

Titulli i Gjetjes 1:	Mostransferimi i listëpagesave të kontributeve nga DPT në ISSH.
Situata:	Mbështetur në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, kreu VI, “Shkëmbimi i

	<p>informacionit për kontributet dhe pagesat”, DPT dërgon në ISSH, të gjithë të dhënat statistikore dhe të kontributeve të paguara, bazuar në procedurën e komunikimit “online”, midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se për vitin 2022, nga DPT janë dërguar elektronikisht 1,416,276 listëpagesa në ISSH, me një diferencë prej 43,998 listëpagesa nga totali. Për sa më sipër, konstatohet se mungesa e transferimit të listëpagesave në ISSH është bërë në kundërshtim me VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, si dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1422, datë 19.05.2017 dhe nr. 4473/1, datë 23.05.2017.</p>
Kriteri:	<p>Kreun VI, “Shkëmbimi i informacionit për kontributet dhe pagesat”, i VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”;</p> <p>Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr. 1422, datë 19.05.2017.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mospasqyrimi në kohë i kontributeve të deklaruara e të paguara për përfituesit e pensioneve.
Shkaku:	Mosdërgimi i listëpagesave në ISSH
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	DPT të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës të marrë masa për dërgimin në ISSH, së të gjithë listë-pagesave të kontributeve të deklaruara e të paguara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. C.K., Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, znj. M.S., Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT.

Për sa trajtuar më sipër, është mbajtur Projekt Raporti nr. 284/7 prot, datë 02.08.2023, protokolluar në DPT me nr. 13072 prot, datë 03.08.2023. Subjekti i audituar, nuk ka paraqitur observacion për këtë pikë të programit të auditimit.

2.5. Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.

Për auditimin e këtij drejtimi të auditimit në Drejtorinë e Rimbursimit u shqyrtua dokumentacioni:

- Regjistri i kërkesave për rimbursimin e TVSH-së sipas sistemit C@TS dhe sistemit Excel të mbajtur manualisht;
- Lista mujore e rimbursimeve dhe evidenca statistikore mbi rimbursimin e TVSH-së 12 mujore të DRTVSH-së dërguar për Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit/Spektori i Analizës dhe Statistikës në DPT;
- Raportim mbi gjendjen e stokut të rimbursimit në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit,
- Shkresat e Drejtorisë së Thesarit Tiranë;

Rimbursimi i TVSH-së: Drejtorja e Rimbursimit të TVSH-së (DRTVSH) është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.

Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:

- Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSH-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
- Të kryejë procedurën e rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut;
- Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim të TVSH-së është bërë:

Kërkesat për rimbursim në DRTVSH: Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, pranë DRTVSH-së, janë regjistruar **2027 kërkesa** për rimbursim nga **1,643 kërkesa** të regjistruara në 2021, me vlerë totale **38,163 milion lekë** nga **21,726 milion lekë** në 2021. Gjithsej **janë pranuar 1483 kërkesa** nga **1,220 kërkesa** të pranuar në 2021, me një rritje në numër rreth 21.5% krahasuar me 2021, me vlerë **28,577 milion lekë** nga **16,496 milion lekë** në 2021, me një rritje në vlerë rreth 73.2% krahasuar me 2021, dhe **544 kërkesa** me vlerë **9,585 milion lekë** nga **423 kërkesa** në 2021, me vlerë **5,230 milion lekë**, **nuk janë pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjore. Klasifikimi sipas kategorisë së aktivitetit:

- Nga 1,483 kërkesa të pranuar, **104 kërkesa me vlerë 929 milion lekë**, janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si **eksportues me risk zero**, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohet automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,483 kërkesa të pranuar, **776 kërkesa me vlerë 13,118 milion lekë**, janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si **eksportues**, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,483 kërkesa të pranuar, **603 kërkesa me vlerë 14,528 milion lekë**, janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si **jo-eksportues**, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës.

Rimbursimet: Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, janë rimbursuar në total (*FIFO+Këste*) **22,469 milion lekë nga 24,101 milion lekë të rimbursuar në vitin 2021 ose rreth 6.8 % më pak se në 2021**. Janë miratuar dhe rimbursuar **1,499 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO, nga **1,244 kërkesa** të pranuar në 2021, me një rritje në numër me rreth **20.5%** krahasuar me 2021, me vlerë totale për rimbursim **25,890 milion lekë nga 13,347 milion lekë në 2021**, pra me një rritje në vlerë rreth **94%** më shumë krahasuar me 2021. *Theksojmë se pjesa më e madhe vlerës së rimbursuar, rreth 61.8 % është dhënë për tatimpaguesit e DTM.*

Koha e Rimbursimit: Në lidhje me kohën e procesimit (Koha mesatare e miratimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së, nga data e kërkesës deri në datën miratimit të kërkesës), për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë miratuar dhe rimbursuar **1,520 kërkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka qenë **45 dite nga 67 ditë** që ishte për 2021, ku **30 %** të kërkesave janë procesuar brenda **30 ditëve**. Rreth **61 %** e kërkesave janë procesuar brenda afatit **60-ditorë**. Sqarojmë se për vetëm **2%** e kërkesave janë procesuar mbi **120 ditë** dhe kryesisht arsyeja ka qenë mospagimi i detyrimeve për **“1900-Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”**, nga ana e tatimpaguesve.

Mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2022 në zërin Rimbursimi TVSH-së. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2022 bazuar në Ligjin Nr.115/2021 "Për Buxhetin e vitit 2022", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të TVSH-së, me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.3568 Prot., datë 23.02.2022 "Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022", protokolluar në DPT me Nr.3185 Prot., datë 25.02.2022. Për vitin 2022 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për **18,500,000 mijë lekë**, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën **22,469,292 mijë lekë** duke rezultuar me tejkalim në shumën **3,969,292 mijë lekë, ose 21.46%** më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

Në mijë lekë

Emërtimi	Realizimi Faktik 2021	Plani 2022 referuar Ligjit të Buxhetit	Realizimi Faktik 2022	Diferenca Fakt-Plan	% ndaj Planit
Rimbursimi	24,100,603	18,500,000	22,469,292	3,969,292	21.46%

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Tabela nr. 57 Realizimi mujor I rimbursimit të TVSH-së kundrejt planit të miratuar

Në mijë lekë

Nr	Periudha	Plani 2022	Realizimi Faktik	Diferenca Fakt/Plan	Diferenca %
1	Janar	700,000	711,336.48	11,336	2%
2	Shkurt	1,525,000	989,928.60	- 535,071	- 35%
3	Mars	1,560,000	1,109,078.29	- 450,922	- 29%
4	Prill	1,604,000	1,041,731.97	- 562,268	- 35%
5	Maj	1,654,000	1,716,385.63	62,386	4%
6	Qershor	1,654,000	1,804,908.47	150,908	9%
7	Korrik	1,649,000	1,874,018.60	225,019	14%
8	Gusht	1,649,000	2,221,339.25	572,339	35%
9	Shtator	1,649,000	2,283,610.47	634,610	38%
10	Tetor	1,643,000	1,010,480.05	- 632,520	- 38%
11	Nëntor	1,636,000	857,541.58	- 778,458	- 48%
12	Dhjetor	1,577,000	6,848,933.01	5,271,933	334%
Totali		18,500,000	22,469,292	3,969,292	21.46%

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se plani i rimbursimit mujor është tejkaluar ndjeshëm në 7 muaj të vitit 2022, konkretisht në muajt: Janar +2%, Maj +4%, Qershor +9%, Korrik +14%, Gusht +35%, Shtator + 38% dhe Dhjetor +334%, ndërsa kemi mosrealizim të planit të rimbursimit në muajt Shkurt -35%, Mars -29%, Prill -35%, Tetor -38% dhe Nëntor -48%. Tabela në vijim paraqet realizimin faktit të rimbursimit të TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, kundrejt planit të buxhetit.

Tabela nr. 58 Realizimi faktit të rimbursimit të TVSH-së sipas DRT


Në mijë lekë

Nr	DRT Tatimore	Plani 2022	Realizimi Faktik	Diferenca Fakt/Plan	Diferenca %
1	DRT Berat	350,000	267,396	- 82,604	-23.60%
2	DRT Dibër	171,000	256,197	85,197	49.82%
3	DRT Durrës	1,705,000	2,028,020	323,020	18.95%
4	DRT Elbasan	420,000	387,996	- 32,004	-7.62%
5	DRT Fier	1,015,000	876,962	- 138,038	-13.60%
6	DRT Gjirokastrë	120,000	104,363	- 15,637	-13.03%
7	DRT Korçë	273,000	364,934	91,934	33.68%
8	DRT Kukës	60,000	128,172	68,172	113.62%
9	DRT Lezha	120,000	210,740	90,740	75.62%
10	DRT Saranda	163,000	112,865	- 50,135	-30.76%
11	DRT Shkodra	278,000	280,553	2,553	0.92%
12	DRT Tirana	2,355,000	3,136,837	781,837	33.20%
13	DRT Mëdhenj	10,950,000	13,894,827	2,944,827	26.89%
14	DRT Vlora	520,000	419,431	- 100,569	-19.34%
Totali		18,500,000	22,469,292	3,969,292	21.46%

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Sa më sipër konstatohet se, në 8 Drejtori Rajonale Tatimore është tejkaluar ndjeshëm plani i rimbursimit, konkretisht në DRT Tiranë, DTM, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Lezhë dhe

Dibër, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale për 4,388,280 mijë lekë, ose ka tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, ndërsa 6 DRT, konkretisht DRT Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Sarandë nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për 418,987 mijë lekë. Referuar të dhënave si më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën për 13,894,827 mijë lekë, ose 61.84 %, të totalit të realizimit faktik të Rimbursimit të TVSH-së në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezultoi me një realizim të planit në masën +126.89% e ndjekur më pas nga DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 3,136,837 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 133.20%, duke tejkaluar në shumën 781,837 mijë lekë.



Në konkluzion: Shpenzimet e Rimbursimeve të TVSH-së, për të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, janë tejkaluar dukshëm në krahasim me planin e rimbursimeve, veprime këto në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr.115/2021 "Për Buxhetin e vitit 2022", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Tatimpagues të rimbursuar me metodën FIFO dhe me Këste.

Në periudhën ushtrimore 2022, janë miratuar dhe rimbursuar **1,520 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO me vlerë totale **25,890,000 mijë lekë** nga të cilat **3,420,708 mijë lekë** janë rimbursuar nëpërmjet metodës së kompensimit dhe **22,469,292 mijë lekë** janë rimbursuar me thesar. Tabela në vijim paraqet kërkesat e aprovuara për Rimbursimin e TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale për vitin 2022:

Tabela nr. 59 Rimbursimi sipas DRT

Në mijë lekë

Rimbursuar sipas DRT-ve (000 Lekë)			
Nr	Drejtoria Tatimore	Kërkesa të aprovuara	Vlera e miratuar
1	DRT Berat	56	267,396
2	DRT Dibër	23	256,197
3	DRT Durrës	365	2,028,020
4	DRT Elbasan	67	387,996
5	DRT Fier	135	876,962
6	DRT Gjirokastrë	29	104,363
7	DRT Korçë	82	364,934
8	DRT Kukës	9	128,172
9	DRT Lezha	33	210,740
10	DRT Saranda	24	112,865

11	DRT Shkodra	65	280,552
12	DRT Tirana	291	3,136,837
13	DRT Mëdhenj	241	13,894,827
14	DRT Vlora	100	419,431
Totali		1,520	22,469,292

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Marrëveshjet me këste: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në mbështetje të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të VKM Nr.146, datë 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste të tatimit mbi vlerën e shtuar, të miratuar për rimbursim", ka miratuar Urdhrin Nr.20, datë 02.03.2020, për miratimin e formatit të projekt-marrëveshjes "Për pagesën me këste të tatimit mbi vlerën e shtuar, të Miratuar për rimbursim". *Nga auditimi është konstatuar dhe marrë konfirmimi me email se përgjatë vitit 2022, nuk ka pasur marrëveshje me këste me tatimpaguesit.*

Kërkesat në proces: Deri në datë 31.12.2022 në Drejtorinë e Rimbursimit rezultojnë se janë në proces në total rreth **171 kërkesa** nga **202 kërkesa** që rezultonin në 31.12.2021, me një rënie në numër kërkesash me rreth 16% krahasuar me 2021, kurse në vlerë ka rritje me rreth 51.5% krahasuar me vitin 2021, nga **5,818 milion lekë në 3,841 milion lekë** në 31.12.2021.

Tabela nr. 60 Kërkesat në proces

Në mijë lekë

Kërkesat në proces të regjistruara sipas viteve (000 Lekë)		
Viti	Numri i kërkesave	Vlera e kërkesave
2018	1	5
2019	2	45
2020	4	11,193
2021	11	36,766
2022	153	5,770,041
Total	171	5,818,050

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Mbi stokun e rimbursimit të TVSH-së.

Stoku i rimbursimit të TVSH-së më datë 31.12.2022: Stoku i rimbursimeve për kërkesat e miratuara dhe të pa likuiduara nga administrata tatimore, i raportuar nga DRTVSH më datë 31.12.2022, është **0 lekë**. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, me anë të email datë 07.02.2023, të Z. Gj.S, Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, **ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit të TVSH-së, deri në 31.12.2022, në shumën 0 lekë**, në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabiliteti për datën 31.12.2022. Ky raportim në këtë Drejtori dhe në MFE, është në zbatim të Udhëzimit Nr.8, të MFE "Për përgatitjen e pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendrore".

Nëse do të kërkojmë një kartelë analitike të subjektit ku të paraqitet gjendja e stokut të rimbursimit të TVSH-së, vlera e miratuar për rimbursimin e TVSH-së, pagesat si dhe gjendja në fund e llogarisë së tatimpaguesit, kjo e dhënë nuk sigurohet nga sistemi C@TS, pasi në momentin e miratimit përfundimtar të kërkesës për rimbursim, kjo shumë del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim. Të gjitha të dhënat në lidhje subjektet të cilëve ju është miratuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së mbahen nga jashtë sistemit C@ts, në format Excel nga Drejtori i Rimbursimit të TVSH-së dhe inspektorët përkatës. Fakt ky që ndërpret vijueshmërinë e gjurmës së auditimi, është format lehtësisht i manipulueshëm si dhe ka risk të lartë gabimi njerëzor gjatë mbartjes së informacionit.

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në mbyllje të periudhës ushtrimore **nuk mban akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me detyrimin e konstatuar për rimbursimin e TVSH-së**, në mbyllje të periudhës ushtrimore me qëllim vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiarë, në zbatim të Udhëzimit të

MFE, Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare të NJQP”, konkretisht:

3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 30 ku citohet: Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve.

Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, rezultojnë **32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 1,843,722 mijë lekë, të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar**, veprime këto në kundërshtim me:

Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika:

*Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së”. **Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.** Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mos pagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.*

VKM Nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3 dhe 4 të nenit 10, ku citohet:

3. Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t’i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.

4. Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikën 1 t këtij neni, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës duke ju nënshtruar procedurës së analizës së riskut.

Konkluzion: Referuar Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se, **i gjithë procesi i Rimbursimit të TVSH-së, duhet të zgjasë jo më shumë se 60 ditë dhe mos likuidimin brenda këtij afati i kërkesave të pranuar por jo të miratuara në vlerën 1,843,722 mijë lekë, pavarësisht kryerjes ose jo të procesit të kontrollit tatimor, konsiderohet si një detyrim i pa paguar dhe duhet të përshihet dhe raportohet në stokun e detyrimeve të prapambetura. Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit më 31.12.2022, sipas gjykimit të grupit të audituesve të KLSH, më së paku është 1,843,722 mijë lekë.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Ligji Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji Nr.115, datë 25.11.2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”, i ndryshuar;

VKM Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Udhëzimi Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar;

Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së, miratuar më urdhrin Nr.19/1, datë 28.04.2020, ndryshuar;

me Vendimin Nr.27, datë 13.10.2021, hyrë në fuqi më 09.11.2021.

Shkresa e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.3568 Prot., datë 23.02.2022 “Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022”, protokolluar në DPT me Nr.3185 Prot., datë 25.02.2022.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

Z. Gj.S., në cilësinë e Drejtor i DRTVSH, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

Z. C.K., në cilësinë e Drejtorit i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.13072/2 Prot dhe datë 31.08.2023 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit Nr.284/7 Prot., datë 02.08.2023”, protokolluar në KLSH me Nr.284/8 Prot., datë 06.09.2023, nga përfaqësuesit e DPT, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Pasi u njohëm me Projekt Raportin e Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr.284/7 Prot., datë 02.08.2023, protokolluar me tonën Nr.13072 Prot., datë 03.08.2023, në respektim të kërkesave të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 29, pika 1 dhe 2, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

VIII. DREJTORIA E RIMBRSIMIT TË TVSH-SË:

Konstatimi: DPT, ka tejkaluar dukshëm planin e rimbursimeve të TVSH-së.

Komenti: Plani i rimbursimeve vjen i miratuar nga MFE pavarësisht nga propozimet që mund të ketë bërë Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së. Kërkesat për rimbursim nga subjektet bëhen në mënyrë të vazhdueshme dhe Drejtoria e Rimbursimit ka për detyrë që t’i shqyrtoj të gjitha këto kërkesat pavarësisht planit të rimbursimit. DRTVSH shqyrton gjatë gjithë kohës mundësinë e mos tejkalimit të planit të rimbursimeve.

Konstatimi: Pasaktësi në raportimin e stokut të rimbursimeve.

Komenti: Siç është theksuar edhe në këtë projekt raport, **stoku i rimbursimit të TVSH-së më datë 31.12.2022 për kërkesat e miratuara dhe të palikuiduara nga administrata tatimore, i raportuar nga DRTVSH më datë 31.12.2022, është zero lekë.** Pra më datë 31.12.2022 DRTVSH nuk ka patur detyrime të palikuiduara lidhur me TVSH-në e miratuar për rimbursim, e për rrjedhojë nuk janë mbajtur edhe akte rakordimi me tatimpaguesit. Lidhur me stokun e vlerësuar sipas mënyrës së Grupit të Auditimit të KLSH-së, DRTVSH nuk është dakort, sepse është në kundërshtim me definicionin e “STOKUT” ku **“STOKU i rimbursimit të TVSH-së është vlera e TVSH-së e aprovuar për t’u rimbursuar nga administrata tatimore, në pritje për t’u kaluar në Degën e Thesarit.** Pra, stoku i llogaritur sipas metodës së Grupit të Auditimit të KLSH-së merr në vlerësim edhe kërkesat të cilat janë në proces, të pa miratuara për rimbursim, detyrimi i të cilave është i pamaturuar ku teprica kreditore është e lirë dhe e përdorshme nga tatimpaguesi (në shume raste është përdorur pjesërisht ose plotësisht, për kompensim automatik të detyrimit të TVSH-së, sipas përcaktimeve të nenit 75 të Ligjit

nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar dhe pikës 75.3 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, sipas të cilit “kompensimi nga teprica kreditorë i detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kryhet automatikisht nga sistemi informatik”. Stoku i rimbursimit të TVSH-së duhet të llogaritet sipas definicionit: Stoku në fund të periudhës = Stoku në çelje + kërkesat e miratuara gjatë periudhës – kompensimet - rimbursimet e kryera. Me futjen e Platformës Dixhitale tatimpaguesi është i informuar në kohë realë në cilin status është kërkesa e tij. Për sa i përket konstatimit tuaj më sipër sqarojmë se: Pika 75/1.1) e Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, parashikon se: “Personi i tatueshëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit për TVSH-në, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëpërmjet kërkesës për rimbursim. Gjithashtu, me kërkesën për rimbursim, përcaktohet shuma që do të kalojë për kompensim të detyrimeve tatimore të papaguara, nëse ka të tilla, përveç detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shumën që do t’i rimbursohet nëpërmjet thesarit”. Pra, sipas përcaktimeve ligjore të mësipërme, nga TVSH-ja për rimbursim nuk mund të kompensohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore & shëndetësore. Për pasojë, bazuar në sa më sipër, kërkesat për rimbursim për të cilat tatimpaguesit nuk kanë likuiduar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore & shëndetësore, nga DRTVSH nuk mund të rimbursohen pavarësisht tejkallimit të afatit 60 ditorë të rimbursimit. Gjithashtu DRTVSH-së është e detyruar të presë përfundimin e akteve të kontrollit nga DRT-të përkatëse për subjektet që i nënshtrohen kontrollit tatimor. Këto janë rastet që përbëjnë 32 kërkesat për rimbursim të TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 1,843,722 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Grupi i Auditimit pasi shqyrtoi observacionin Tuaj sqaron se: - Në lidhje me pikën 1 të observacionit se misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore për financimin e buxhetit të shtetit, duke ju referuar planit të miratuar nga MFE. Kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë. - Në lidhje me pikën 2 të observacionit sqarojmë Grupi i Auditimit i qëndron arsyetimit të shprehur në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me vlerën prej 1,843,722 mijë lekë si stok të rimbursimit të TVSH-së, në mbyllje të periudhës ushtrimore dhe sqarojmë se referuar Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1 dhe VKM Nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3, neni 10, vërehet se i gjithë procesi i rimbursimit të TVSH-së, *duhet të përfundojë brenda 60 ditëve. Pra pas përfundimit të afatit ligjor tatimpaguesit i lind një e drejtë e konstatuar për rimbursimin e TVSH-së*. Në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit (SKK 1) “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” citohet: “Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraaja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në Pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Për sa shpjeguar më lart, në vlerësimin e audituesve të KLSH-së, kjo vlerë duhet t’i shtohet shumës së stokut të rimbursimit të TVSH-së dhe të paraqitet në pasqyrat financiare të institucionit. Kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes:	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka tejkalluar dukshëm planin për shpenzimet e rimbursimit të TVSH-së.
Situata:	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2022, bazuar në Ligjin Nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të TVSH-së, me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022”, protokolluar në DPT me nr.3185 prot., datë 25.02.2022. Për vitin 2022 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është

	<p>programuar në shumën për 18,500,000 mijë lekë, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën 22,469,292 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim në shumën 3,969,292 mijë lekë, ose 21.46% më shumë kundrejt planit të rimbursimit.</p> <p>Ka rezultuar se plani i rimbursimit mujor është tejkaluar ndjeshëm në 7 muaj të vitit 2022, konkretisht në muajt: Janar +2%, Maj +4%, Qershor +9%, Korrik +14%, Gusht +35%, Shtator + 38% dhe Dhjetor +334%, ndërsa ka pasur mosrealizim të planit të rimbursimit në muajt e tjerë: Shkurt -35%, Mars -29%, Prill -35%, Tetor -38% dhe Nëntor -48%.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se në 8 Drejtori Rajonale Tatimore është tejkaluar ndjeshëm plani i rimbursimit, konkretisht në DTM, DRT Tiranë, , Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Lezhë dhe Dibër, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale për 4,388,280 mijë lekë, ose kanë tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, ndërsa 6 DRT, konkretisht DRT Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Sarandë nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për 418,987 mijë lekë. Referuar të dhënave del se peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj (DTM) në vlerën për 13,894,827 mijë lekë, ose 61.84 %, të totalit të realizimit faktik të rimbursimit të TVSH-së në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën +126.89% e ndjekur më pas nga DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 3,136,837 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 133.20%, tejkalim në shumën 781,837 mijë lekë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 14; Ligjin Nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", i ndryshuar dhe shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022”, protokolluar në DPT me Nr.3185 prot., datë 25.02.2022.</p>
Kriteri:	<p>Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 14;</p> <p>Ligjin Nr.115/2021 "Për Buxhetin e vitit 2022", i ndryshuar;</p> <p>Shkresa e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.3568 Prot., datë 23.02.2022 “Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022”, protokolluar në DPT me Nr.3185 Prot., datë 25.02.2022.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mosrealizim i planit të të ardhurave të miratuar nga MFE në terma bruto dhe neto.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit tatimor në fuqi.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për planifikim real të vlerës së rimbursimeve të TVSH-së, si dhe të marrë masat e nevojshme për monitorimin e këtij procesi, me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve.
Titulli gjetjes:	Pasaktësi në raportimin e stokut të rimbursimit.
Situata:	Drejtorja e Rimbursimit të TVSH-së, nëpërmjet emaili-t të datës 07.02.2023, ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit në shumën 0 lekë në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2022, në zbatim të Udhëzimit Nr.8, të MFE “Për përgatitjen e

	pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendrore”. Nga auditimi është konstatuar se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, rezultojnë 32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për 1,843,722 mijë lekë, të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit të TVSH-së në DPT më 31.12.2021, sipas vlerësimit të grupit të auditimit është më së paku në vlerën 1,843,722 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1, dhe VKM Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4.
Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1; VKM Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3, neni 10, pika 4.
Ndikimi/Efekti:	Mospasqyrimi i saktë i vlerës së stokut të TVSH në datën 31.12.2022.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit tatimor në fuqi.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së, nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore, dhe raportimin e saktë në MFE lidhur me këtë çështje.

2.6. Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale.

2.6.1 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

Në zbatim të pikës nr. 6 të programit të auditimit “*Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale*” u shqyrtua dokumentacioni si poshtë:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.
- Analiza të Drejtorisë së menaxhimit të riskut;
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT

Nga të dhënat dhe dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se:

Në bazë të organizimit, funksionimit dhe drejtimit të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut përgjatë vitit 2022 ajo ka funksionuar në bazë të Urdhrit nr. 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në organigramën e DPT-së është në varësi të Drejtorisë së Hartimit të Programeve, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së MR dhe është e organizuar në 2 sektorë.

-Sektori i Analizës së Riskut me 1 Përgjegjës dhe 10 Specialistë (1 pozicion vakant - përgjegjës i sektorit).

-Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialistë. Objektivi parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi. Konstatohet se kjo drejtori nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës.

Sistemi i Menaxhimit të Riskut ka për qëllim të ndikojë në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave të parashikuara duke siguruar:

-Menaxhimin eficient dhe transparent të ardhurave tatimore;

-Evidentimin dhe zvogëlimin e risqeve të mos përmbushjes së objektivave të administratës tatimore;

-Inkurajimin dhe rritjen e shkallës së zbatimit dhe respektimit vullnetar të përmbushjes së detyrimeve tatimore, si dhe sigurimin e nxitjes së besimit publik ndaj integritetit dhe efikasitetit të Administratës Tatimore;

Objektivat e Drejtorisë për vitin 2022

1.Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut.

2.Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;

3.Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e riskut.

4.Hartimi i analizave cilësore që fokusohet në risqe specifike.

5.Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.

6.Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash.

- Aktivitetet e programuara dhe të realizuara gjatë vitit 2022 në funksion të arritjes së objektivave kanë qenë realizimi i trajnimeve nga ekspertë të FMN-së lidhur me Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes si dhe trajnime për programin e përpunimit të të dhënave me volum të madh (R Studio). Drejtorja e Menaxhimit të Riskut në DPT është përgjegjëse për menaxhimin e përzgjedhjes automatike të tatimpaguesve për kontroll, bazuar në kriteret e miratuara të riskut. Hartimi i planeve mujore të kontrollit, planifikim i rasteve për rimbursim referuar shkresave të DRTVSH dhe hedhja e evidencave të kontrollit në një plan-fakt të përbashkët për 14 DRT. Drejtorja e Menaxhimit të Riskut përzgjedh 70% të tatimpaguesve për kontroll tatimor të plotë në vend sipas të dhënave të regjistrit elektronik të riskut me përjashtim të DTM ku përzgjedhja për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë përfshin 50% të totalit të planit mujor të kontrollit.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut ka si objektiv parësor nëpërmjet modulit të riskut identifikimin mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

Tatimpaguesit renditen duke filluar nga vlerësimi më i lartë tek ai më i ulët. Subjektet që kanë numrin më të lartë të kritereve të thyera të riskut vlerësohen më riskun më të lartë dhe listohen të parët në *Dokumentin e listës së subjekteve*. Janë kryer ekzekutimet e modulit të riskut për projektet sektoriale, për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash.

Gjate vitit 2022 janë kryer:

- 4 ekzekutime të Modulit të Riskut për Rimbursimin e TVSH-së.

- 2 ekzekutime të Modulit të Riskut për Planet e Kontrollit.

DMR ka kryer 4 (katër) herë për vitin 2022 ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut, kriteret për rimbursimin e TVSH-së, si më poshtë:

1. Rimbursim TVSH-je, shkurt-prill 2022, datë 09.02.2022
2. Rimbursim TVSH-je, maj-korrik 2022, datë 11.05.2022
3. Rimbursim TVSH-je, gusht-tetor 2022, datë 10.08.2022
4. Rimbursim TVSH-je, nëntor 2022-janar, 2023 datë 24.11.2022.

DMR ka ekzekutuar modulën e riskut 2 herë në vit çdo 6 muaj dhe bazuar në rezultatet e tij dhe renditjen e tatimpaguesve planifikon kontrollin tatimore mujore për pjesën e 70%, si më poshtë:

1. Plan Kontrolli janar - qershor 2022, datë 17.01.2022;
2. Plan Kontrolli korrik - dhjetor 2022, datë 18.07.2022.

Përmirësime të Modulit të Riskut: Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Në kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave dhe përshtatjes me ndryshimin e Pragut të TVSH-së dhe Tatimit Fitimit, pas testimeve të vazhdueshme për evidentimin e problematikave të tyre, DMR ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumentit.

Në bashkëpunim me specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin janë analizuar të dhënat nga Modeli i Riskut.

Përzgjedhja e subjekteve përgjatë kësaj periudhe për tu kontrolluar është bërë duke marrë në konsideratë si variabël kryesor orët në dispozicion për kontroll nga ana e secilës Drejtori Rajonale Tatimore. Ky është faktori i parë kufizues në përzgjedhjen e subjekteve për kontroll, ndërkohë që nga ana e Drejtorisë së Kontrollit ky variabël përkthehet në numër subjektësh për tu kontrolluar bazuar në eksperiencat e mëparshme për kohën mesatare të shpenzuar për një kontroll.

Konstatohet se për vitin 2022 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 346 kontrole nga 2579 kontrole të planifikuara ose rreth 13% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë dhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale.

Referuar manualit të riskut, Drejtoritë Rajonale Tatimore i dërgojnë Drejtorisë së Kontrollit në DPT, brenda datës 10 të çdo muaji, raportin mbi aktivitetin e kontrollit të muajit të kaluar, përfshirë kontrollet e plota dhe vizitat fiskale. Drejtoria e Kontrollit në DPT përpilon raportin mujor i cili shqyrtohet dhe nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut për qëllime të objektit të punës në lidhje me kriteret e riskut. Mbi këtë bazë Drejtoria e Menaxhimit të Riskut raporton rregullisht brenda datës 20 të çdo muaji te nëndrejtori i Përgjithshëm i varësisë.

Nga auditimi konstatohet mungesa e dokumentimit të raportimit mujor të DMR-së.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pas marrjes së konfirmimit për realizueshmërinë e kontrolleve duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve si variabël ka realizuar përzgjedhjen automatike të atyre subjekteve të cilat janë renditur më lart në bazë të Modulit të Menaxhimit të Riskut (**CRM) Compliance Risk Management**, pjesë përbërëse e sistemit të informatizuar të deklaramentit të tatimeve nga ana e tatimpaguesve.

Në të gjitha rastet, tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll sipas Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut në DPT janë referuar për kontroll të plotë sipas Modulit të Menaxhimit të Riskut dhe planeve sektoriale.

Nga grupi i kontrollit u përzgjedhën nga 3 subjekte për çdo DRT të renditur për kontroll në bazë të Modulit të Menaxhimit të Riskut (**CRM) Compliance Risk Management**, me qëllim verifikimin e kriterëve të përzgjedhjes, të detajuar sipas listës së mëposhtme:

Tabela nr. 61 Subjektet e kontrolluar për kriteret e riskut

NR	DRT	Subjekti	TVSH (periudha)	Zgjedhje Automatike nga Sistemi
1	BERAT	R	12/2019-11/2021	1
2	BERAT	L	12/2019-11/2021	1
3	BERAT	K	01/2020-12/2021	1
4	DIBËR	E	01/2020-11/2021	1
5	DIBËR	A	12/2019-11/2021	1
6	DIBËR	U	01/2020-12/2021	1
7	DTM	E	01/2020 - 12/2021	1
8	DTM	B	01/2020 - 12/2021	1
9	DTM	D	01/2020 - 12/2021	1
10	DURRËS	L	03/2020-02/2022	1
11	DURRËS	" S	03/2020-02/2022	1
12	DURRËS	R	03/2020-09/2020	1
13	ELBASAN	4 V	05/2020 - 04/2022	1
14	ELBASAN	A	05/2020 - 04/2022	1
15	ELBASAN	F	05/2020 - 04/2022	1
16	FIER	A	01/2020-12/2021	1
17	FIER	I	02/2020 - 01/2022	1
18	FIER	M	02/2020 - 01/2022	1
19	GJIROKASTËR	A	07/2020 - 06/2022	1
20	GJIROKASTËR	G	07/2020 - 06/2022	1
21	GJIROKASTËR	E	08/2020 - 07/2022	1
22	KORÇË	F	12/2019-11/2021	1
23	KORÇË	P	02/2020-11/2021	1
24	KORÇË	V	09/2020-12/2021	1
25	KUKËS	Q	7/2020-03/2022	1
26	KUKËS	C	4/2020-03/2022	1
27	KUKËS	S	4/2020-03/2022	1
28	LEZHË	R	06/2020-05/2022	1
29	LEZHË	I	06/2020-05/2022	1
30	LEZHË	"B	07/2020-06/2022	1
31	SARANDË	M	07/2020-06/2022	1
32	SARANDË	T	01/2020 - 11/2021	1
33	SARANDË	S	01/2020 - 11/2021	1
34	SHKODËR	G	12/2019-11/2021	1
35	SHKODËR	"S.	12/2019-12/2020	1
36	SHKODËR	S	12/2019-11/2021	1
37	TIRANË	T	02/2020-01/2022	1
38	TIRANË	F	02/2020-01/2022	1
39	TIRANË	S	02/2020-01/2022	1
40	VLORË	V	08/2020-07/2022	1
41	VLORË	E	01/2021-07/2022	1
42	VLORË	B	08/2020-07/2022	1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Konstatohet se edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën Drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë:

-Subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale.

-Renditjen e subjekteve me të njëjtin numër rregullash të thyera.

Në analizat e kryera është bërë e mundur evidentimi i numrit të kriteve që thyhen nga sektorët si dhe numrit të “shmangies potenciale” e shprehur në pikë. Me anë të këtij informacioni i cili gjenerohet automatikisht, është bërë e mundur analizimi dhe trajtimi i sektorëve më me risk ose prioritar. Në tabelën e mëposhtme janë renditur 10 aktivitetet me risk nga 556 aktivitetet gjithsej:

Tabela nr. 62 Top 10 aktivitetet me risk

Nr	Kodi	Aktiviteti	Nr i rregullave te thyera	% ndaj totalit te rregullave
1	I5630	Aktivitetet e shërbimit të pijeve	13,471	6%
2	G4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan	7,929	3%
3	G4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar	7,745	3%
4	G4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara	7,071	3%
5	F4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale	6,657	3%
6	G4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara	5,092	2%
7	I5610	Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	5,075	2%
8	G4773	Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara	5,001	2%
9	H4941	Transporti rrugor i mallrave	4,166	2%
10	I5510	Hotele dhe struktura të ngjashme	4,085	2%
11	F4399	Të tjera punime të specializuara ndërtimi p.k.t.	3,929	2%
12	G4730	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar	3,898	2%
13	S9602	Flokët dhe trajtime të tjera të bukurisë	3,606	2%
14	F4110	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale	3,558	1%
15	G4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	3,217	1%
16	S9411	Aktivitetet e shoqatave e organizimeve ekonomike dhe punëdhënësve	3,075	1%
17	G4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara	3,028	1%
18	G4639	Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan	2,924	1%
19	M6910	Aktivitetet juridike	2,901	1%
20	J6209	Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit	2,774	1%
	Te tjera		141,028	59%
	Totali		240,230	100%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Në bazë të zgjedhjes së tatimpaguesve për kontroll realizohet nëpërmjet hartimit të listave përfundimtare për kontroll bazuar në rezultatet e gjeneruara nga Moduli i Riskut Tatimore ato dërgohen të nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm jo më vonë se data 25 e çdo muaji për kontrollet që do të ushtrohen në muajt pasardhës. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka realizuar hartimin e listave për tatimpaguesit e zgjedhur për kontroll si më poshtë:

Tabela nr. 63 Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 1 / 70%)

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	290	1/11/2022	Shkrese percjellese
Shkurt	2900	2/23/2022	Shkrese percjellese
Mars	3240	2/28/2022	Shkrese percjellese
Prill	4809/1	3/25/2022	Shkrese percjellese
Maj	6849/1	4/26/2022	Shkrese percjellese
Qershor	8802/1	5/26/2022	Shkrese percjellese
Korrik	10874/1	6/27/2022	Shkrese percjellese
Gusht	12735/1	7/25/2022	Shkrese percjellese
Shtator	14392/1	9/6/2022	Shkrese percjellese
Tetor	16160/1	9/26/2022	Shkrese percjellese
Nëntor	18210/1	10/25/2022	Shkrese percjellese
Dhjetor	20080	11/25/2022	Shkrese percjellese

Tabela nr. 64 Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 2/ 30%)

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	290	1/11/2022	Shkrese percjellese
Shkurt	2900	2/23/2022	Shkrese percjellese
Mars	3240	2/28/2022	Shkrese percjellese
Prill	4809/1	3/25/2022	Shkrese percjellese
Maj	6849/1	4/26/2022	Shkrese percjellese

Qershor	8802/1	5/26/2022	Shkrese percjellese
Korrik	10874/1	6/27/2022	Shkrese percjellese
Gusht	12735/1	7/25/2022	Shkrese percjellese
Shtator	14392/1	9/6/2022	Shkrese percjellese
Tetor	16160/1	9/26/2022	Shkrese percjellese
Nëntor	18210/1	10/25/2022	Shkrese percjellese
Dhjetor	20080	11/25/2022	Shkrese percjellese

Tabela nr. 65 Kontrollat planifikuara sipas DRT viti 2022

Raste kontrolli/DRT	BR	DB	DTM	DR	EL	FR	GJI	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Tot
Raste 1 nga 70% (nga moduli , rimbursimet dhe palët e treta)	52	65	326	162	191	258	45	151	46	20	33	160	358	116	1,983
Raste 2 nga 30%	17	14	226	48	29	54	9	38	12	3		37	62	24	573
Raste 3 nga prokuroria				8	5								9	1	23
TOTALI	69	79	552	218	225	312	54	189	58	23	33	197	429	141	2579

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga analiza e tabelës së mësipërme rezulton janë planifikuar për kontroll 2579 subjekte, nga të cilët 1983 janë të propozuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut (1273 subjekte për thyerjen kritereve të riskut dhe 710 subjekte kërkesë për rimbursim), 573 subjekte janë propozuar nga Drejtoritë Rajonale dhe 23 raste janë referuar nga organi i prokurorisë për fillim kontrolli. Drejtoritë Rajonale që zënë peshën më të madhe janë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 552 kontrolle ose rreth 21% të totalit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me 429 kontrolle ose rreth 17% të kontrolle totale të planifikuara.

Gjatë vitit 2022 kërkesat kanë ardhur për tre mujorin e parë të vitit të cilat janë 245 kërkesa për rimbursim të cilat janë për 245 tatimpagues të ndryshëm. Më poshtë tabela e specifikuar sipas muajve të vitit 2022:

Tabela nr. 66 Kërkesat për rimbursim për 3 mujorin e parë.

Muaji	Numri i kërkesave të ardhurave	Numri i tatimpaguesve që kërkojnë Rimbursim Tvsh-je	Numri i tatimpaguesve që propozohen për kontroll bazuar në Analizën e Riskut
JANAR	69	69	26
SHKURT	103	103	18
MARS	73	73	30
TOTALI	245	245	74

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Në vijimësi prej muajit prill 2022 kërkesat vijnë nëpërmjet sistemit C@TS në formë pop up dhe me e-mail automatik nga sistemi.

Gjatë vitit 2022, nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut u hartua Plani Sektorial i Turizmit, miratuar me vendimin nr. 29, datë 24.05.2022.

Plani i Turizmit është zhvilluar për periudhën Maj- Gusht 2022 për të gjitha subjektet që operojnë në fushën e turizmit dhe Bar-Restorante.

1. Plani Sektorial i Turizmit

Objektivat kryesore të Planit Sektorial të Turizmit renditen si më poshtë:

-Tatimpaguesit e vijës së parë të bregdetit të zonave kryesore turistike të informohen më anë të letrave të dërguara nga D.V.K.T në mënyrë individuale në adresën e subjektit.

-Dërgimi i mesazheve Pop-up për gjithë subjektet në sektorin e turizmit.

-Kryerjen e verifikimeve për TP me Xhiro më të ulët se 20,000 lekë dhe për ata TP të cilët kanë pasur rënie xhiro për periudhën korrik 2022 krahasuar me periudhën korrik 2021 mbi 500 mijë lekë.

-Kryerjen e telefonatave nga DRT për subjektet me xhiro më pak se 20,000 lekë në ditë.

-Kryerjen e telefonatave nga DRT për subjektet të cilat kanë 70% ose më shumë të të punësuarve me pagë minimale dhe subjektet të cilat kanë 40% ose më shumë të të punësuarve me pagë nën minimalen dhe mund të përfitojnë nga kategoritë e ndryshme të deklarimit nga listëpagesa Qershor 2022. Nga analiza lidhur mbi rezultatet e Planit Sektorial të Turizmit të vitit 2022 rezulton se tatimpagues të rinj të hapur gjatë sezonit turistik maj-gusht 2022 paraqiten ne tabelën si vijon:

Tabela nr. 67 Subjekte të regjistruara maj-gusht 2022

Nr	Aktivite e hapura gjatë 2022	Numri I subjekteve të regjistruara
1	Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	47
2	Akomodime të tjera	48
3	Aktivite të shërbimit të pijeve	572
4	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira	31
5	Hapesirat per kampinge dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	10
6	Hotele dhe struktura të ngjajshme	92
7	Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	204
	Totali	1004

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Tatimpaguesit e vijës së parë të bregdetit të zonave kryesore turistike u informuan me anë të letrave të dërguara nga D.V.K.T në mënyrë individuale në adresën e subjektit. Plotësimi i një database (Google Form) me të dhënat e detajuara për çdo subjekt i cili operon në zonat turistike, të dhënat të cilat u pasqyruan janë: NIPT-I i subjektit, Emër tregtar, numër punonjësish prezent në punë, numër çadrash, numër shezllonesh , numër dhomash për 2,315 tatimpagues të ndarë sipas rajoneve si më poshtë:

Tabela nr. 68 Subjekte të regjistruara në Google Form sipas çdo DRT-je

Nr	DRT	Nr. i Nipt-ve
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	439
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	15
3	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	71
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	29
5	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	241
6	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	28
7	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	237
8	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	540
9	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	715
	Totali	2315

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Janë ndryshuar përgjegjësitë tatimore për TVSH-në për 66 tatimpagues gjatë periudhës Maj-Gusht 2022 të ndara sipas DRT-ve, për DRT Durrës, Korçë, Lezhë, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë për periudhën 06.22-08.22 , nga popullata e turizmit, kanë hyrë në skemën e TVSH-së 66 tatimpagues.

Tabela nr. 69 Ndryshimi i përgjegjësive tatimore të TVSH-së sipas çdo DRT-je

Nr	DRT	Nr. i Nipt-ve	%
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	12	18%
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	2	3%

3	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	6	9%
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	12	18%
5	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	3	5%
6	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	3	5%
7	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	28	42%
	Totali	66	100%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

DRT me numrin më të lartë të tatimpaguesve të futur në skemë është DRT Vlorë me 28 tatimpagues (42%), e ndjekur nga DRT Durrës me 12 tatimpagues (18%), DRT Sarandë 12 tatimpagues (18%).

Nga krahasimi i totalit të listëpagesave të dorëzuara për popullatën e turizmit për periudhën qershor, korrik, gusht të vitit 2022 ka një rritje prej +5 % në pagën për kontribute në korrik dhe + 8% në gusht krahasuar kjo me muajin qershor.

E përkthyer kjo në numër të të punësuarve ka një shtim me 3133 punonjës për muajin korrik dhe 2177 punonjës për muajin gusht.

Tabela nr. 70 Krahasimi i numrit të të punësuarve Gusht 2022-2021

Numri total Gusht 2021	Numri total Gusht 2022	Diferenca nr i punonjësve Gusht 2022-2021	Diferenca në %	Nr i punonjësve me pagë bruto për efekt kontributësh 0-30,000 (gusht 2021)	Nr i punonjësve me pagë bruto për efekt kontributësh 0-32,000 (gusht 2022)	Diferenca nr i punonjësve pagë minimale Gusht 2022-2021	Diferenca në %
40,763	41,529	766	2%	32,421	25,619	-6,802	-21%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga të dhënat e listëpagesave të muajit gusht 2021-2022 vihet re një rritje e numrit të punonjësve me 2% ndërsa numri i punonjësve me pagë minimale ka pasur ulje me 21%. Gjithashtu në bashkëpunim me strukturat e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren janë verifikuar 476 tatimpagues, ku kanë rezultuar me shkelje 78 subjekte me vlerën e shkeljeve 3,150,000 lekë.

Nga 7,247 subjekte pjesë e planit të Turizmit (Bar-Restorante, Struktura Akomoduese, Agroturizëm) rreth 1,834 janë me përgjegjësi për TVSH-në.

Janë analizuar të dhënat e deklaratave të TVSH-së gusht - korrik 2022 nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe vihet re se nga krahasimi i qarkullimit ka një rritje prej 16.6 %, ndërkohë që TVSH e detyrueshme për tu paguar ka një rritje prej 17% . Nga krahasimi i të dhënave të deklaratave të TVSH-së qershor, korrik, gusht 2021 me qershor, korrik, gusht 2022 ka rritje të qarkullimit me 33% për të gjitha DRT në total, ndërkohë që TVSH e detyrueshme për tu paguar ka një rritje me 28%.

Nga grupi i auditimit konstatohet se për vitin 2022 DPT ka nxjerr vetëm planin operacional për turizmin, ndërkohë duke ju referuar renditjes të aktiviteteve të cilët sipas rregullave të thyera të riskut të gjeneruar nga DMR zënë peshën më të madhe në % me numër rregullash të thyera duhet të planifikonte edhe plane operationale të tjera për këto veprimtari për gjatë vitit 2022, disa nga aktivitetet me më shumë rregulla të riskut të thyera paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 71 Aktivitetet me % më të lartë të riskut.

Nr	Kodi	Aktiviteti	Nr i rregullave të thyera	% ndaj totalit të rregullave
1	I5630	Aktivitete të shërbimit të pijeve	13,471	6%
2	G4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan	7,929	3%
3	G4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar	7,745	3%
4	G4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara	7,071	3%
5	F4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale	6,657	3%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin Nr.5.1, datë 14.07.2023 dhe

të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 mbi ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ekzekutimi i Modullit të Riskut ka qëllim primar evidentimin e tatimpaguesve për kontroll të plotë dhe nga lista e tatimpaguesve të propozuar për kontroll të plotë nga DMR për vitin 2022 pjesa më e madhe e tatimpaguesve janë nga kategoria e atyre që rezultojnë me më shumë rregulla të thyera konkretisht Tregtia me shumicë jo e specializuar e 63 TP ose 5% dhe Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale me 41 Tp ose 3.2% e totalit të tatimpaguesve të dërguar për kontroll të plotë. Tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitetin në këto kode ekonomike rezultojnë me më shumë rregulla risku të thyera dhe në mënyre automatike sistemi i konsideron me riskun e mos përmbushjes.

Për kodet e tjera ekonomike si “Aktivitete të shërbimit të pijeve”, “Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan” dhe “Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara” janë tatimpagues që kryesisht janë aktivitete me qarkullim me të vogël por në analizat periodike mujore të realizuara nga DMR dhe dërguar periodikisht në çdo Drejtori Rajonale Tatimore për këta sektorë ekonomik.

Oëndrimi i grupit auditues: Kundërshtimet e paraqitura në observacion nuk i referohen konstatimit të grupit të auditimit por i referohen aktivitetit të DMR-së, grupi auditues gjykon që çështjet e trajtuara nuk merren në konsideratë.

Titulli:	Konstatohen stok i prapambetur i kontrolleve tatimore të planifikuara por të pa filluara, mungesë hartimi të planeve operationale dhe të strategjive për sektorët me numër të lartë rregullash risku të thyer përveç turizmit.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 346 kontrolle nga 2579 kontrolle të planifikuara ose rreth 13% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale. Drejtorja e Menaxhimit të Riskut nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës.</p> <p>Konstatohet se edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale.</p> <p>Konstatohet se për vitin 2022 DPT ka nxjerr vetëm planin operacional për turizmin, ndërkohë që duke ju referuar renditjes të aktiviteteve të cilët sipas rregullave të thyera të riskut të gjeneruar nga DMR zënë peshën më të madhe në %, mungojnë plane operationale të tjera për këto veprimtari për gjatë vitit 2022, për disa nga aktivitetet me më shumë rregulla te riskut të thyera.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, neni 33: Manuali i Menaxhimit të Riskut; Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore

Ndikimi/Efekti:	Mangësi në marrjen e masave efikase për kryerjen e kontrolleve në bazë risku dhe në kohë, nëpërmjet përcaktimit të detyrave të strukturave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre, arritjen e objektivave, përmirësimet ligjore në lidhje me përmirësimin e sistemit të riskut.
Shkaku:	Mungesë e bashkëveprimit midis DMR dhe DRT-ve
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa që në aktivitetet e planifikimit për kontroll të reflektohet stoku i kontrolleve të mbartura nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me DRT të shkëmbejë në kohë informacion për problematikat e kontrolleve tatimore. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të hartojë strategji dhe plane operacionale të dedikuara për secilin nga sektorët të evidentuar me risk të lartë si pasojë e rregullave të thyera të evidentuara nga moduli i menaxhimit të riskut.

Për problematikat e mësipërme është mbajtur Akt Konstatimi nr. 5.1, datë 14.07.2023 me z. O.L. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve, z. I.K. në cilësinë e Drejtorit të Menaxhimit të Riskut dhe z. C.K. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe janë paraqitur observacione nga subjekti.

2.6.2 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ushtron funksionet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.33 datë 12.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës së Organizative dhe numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

Strukturat e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë njësi të specializuara zbatimi në përbërje të administratës tatimore qendrore dhe që kanë si funksion parësor:

- a. *Marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.*
- b. *Zbatimin e masave shtrënguese.*

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është e organizuar në nivel qendror dhe rajonal në përbërje të DPT, si më poshtë:

- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT;*
- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior;*
- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Qendror;*
- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor;*

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, ka në përbërje të saj 3 (tre) sektor:

- a. *Spektori i Trajtimin të Ankesave;*
- b. *Spektori i Verifikimit dhe Monitorimit (Task-Forcë);*
- c. *Spektori i Koordinimit;*

-Qëllim kryesor i veprimtarisë së kësaj drejtorie është nxitja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve dhe të parandalimi, zbulimi dhe dënimi për shkeljet e legjisllacionit tatimor të kryera nga tatimpaguesit, nëpërmjet ushtrimit të kontrolleve dhe verifikimeve në vend të aktivitetit të tyre.

-Drejtimet kryesore të punës, konsistojnë në marrjen dhe aplikimin e masave (dënimeve) administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave dalë në zbatim të tij, që kanë të bëjnë me verifikimin dhe konstatimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomiko-tregtare pa u regjistruar; Mbajtjen, transportimin përdorimin dhe tregtimin e mallrave pa dokumentacionin e duhur tatimor; Punonjës të padeklaruar në organin tatimor etj., pa u kufizuar vetëm në to; Zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin tatimor në bashkëpunim me strukturat përkatëse të mbledhjes së borxhit tatimor, me qëllim mbledhjen e tatimeve dhe taksave të papaguara.

-Objekti i veprimtarisë dhe drejtimet kryesore të punës për strukturat e zbatimit janë verifikimi në terren i regjistrimit ose çregjistrimit; Verifikimi i deklarimit të punonjësve në organin tatimor; verifikimi i instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit; verifikimi i mbajtjes së dokumentacionit tatimor dhe i pajisjes së mallrave me faturë tatimore dhe Verifikimi i përmbushjes së detyrimeve të tjera ligjore të tatimpaguesve.

Gjatë vitit 2022, puna e *Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren* është bazuar në planet e punës që ka miratuar Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së, paraqitur si më poshtë:

1. **Për periudhën 01-05 Shkurt 2022, Plani Punës Nr.1560 Prot., datë 01.02.2022.** Ku objekti i punës është:
 - a. *Verifikimi në subjekte tregtare me veprimtari tregti karburanti.*
2. **Për periudhën 28 Mars-31 Maj 2022, Plani Punës Nr.4825 Prot., datë 28.03.2022.** Ku objekti i punës është:
 - a. *Garantimi i përmbushjes vullnetare dhe zbatimi i legjislacionit tatimor.*
 - b. *Verifikime në terren në zbatim dhe në përputhshmëri të procesit të fiskalizimit*
 - c. *Trajtimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali i Bashkëqeverisjes dhe Stop Informalitetit.*
 - d. *Verifikimi i listave të tatimpaguesve të ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe DRT.*
3. **Për periudhën 31 Mars- 2 Prill 2022, Plani Punës Nr.5027 Prot., datë 31.03.2022.** Ku objekti i punës është:
 - a. *Kontroll në subjektet me aktivitet Tregti Celularësh, aksesorësh dhe riparimi i tyre.*
4. **Për periudhën 06-15 Prill 2022, Plani Punës Nr.5340 Prot., datë 06.04.2022.** Ku objekti i punës është:
 - a. *Kontroll në subjektet me aktivitet Farmaci dhe depo Farmaceutike.*
5. **Për periudhën 07-17 Prill 2022, Plani Punës Nr.5341 Prot., datë 06.04.2022.** Ku objekti i punës është:
 - a. *Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari tregti karburanti në lidhje me abuzimet e çmimeve të vendosura nga Bordi i Transparencës dhe kufizimit të përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë / pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit në zbatim të aktit Normativ nr.05, datë 12.03.2022.*
6. **Për periudhën Prill 2022, Plani Punës Nr.5348 Prot., datë 07.04.2022.** Ku objekti i punës është:
 - a. *Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari ekonomike tregti me shumicë/pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera lidhur me to, në zbatim të aktit normativ nr.07, datë 18.03.2022.*
 - b. *Monitorimi i çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to sipas listës miratuar nga Bordi.*

7. **Për periudhën 01 Qershor-30 Shtator 2022, Plani Operacional Nr.9355/1 Prot., datë 02.04.2022.** Ku objekti i punës është:
- Garantimi i përmbushjes vullnetare dhe zbatimi i legjislacionit tatimor.
 - Kontrolle në të gjitha zonat turistike në subjektet që ushtrojnë aktivitetet të lartë ekonomik për të garantuar zbatimin e legjislacionit tatimor dhe ndjekjen e procesit të fiskalizimit, verifikimin e faturave tatimore për transaksionet me para në dorë.
 - Rritja e xhiros së deklaruar, deklarimi i të punësuarve.
 - Trajtimi i rasteve abuzive dhe shkresave të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen.
8. **Për periudhën 03 Tetor-30 Nëntor 2022, Plani Punës Nr.16562/1 Prot., datë 29.09.2022.** Ku objekti i punës është:
- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari ekonomike tregti me shumicë/pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera lidhur me to, në zbatim të aktit normativ nr.07, datë 18.03.2022.
 - Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari tregti karburanti në lidhje me abuzimet e çmimeve të vendosura nga Bordi i Transparencës dhe kufizimit të përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë / pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit në zbatim të aktit Normativ nr.05, datë 12.03.2022.
 - Trajtimi i rasteve abuzive dhe shkresave të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen.
 - Monitorimi i xhiros së subjekteve sipas sektorëve me risk nëpërmjet sistemit CPCM.
9. **Për periudhën 01-31 Dhjetor 2022, Plani Punës Nr.20019 Prot., datë 25.1.2022.** Ku objekti i punës është:
- Verifikimi i listave të tatimpaguesve ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.
 - Verifikimi i listave të ardhur nga Drejtoritë Rajonale.
 - Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari ekonomike tregti me shumicë/pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera lidhur me to, në zbatim të aktit normativ nr.07, datë 18.03.2022.
 - Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari tregti karburanti në lidhje me abuzimet e çmimeve të vendosura nga Bordi i Transparencës dhe kufizimit të përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë / pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit në zbatim të aktit Normativ nr.05, datë 12.03.2022.
 - Trajtimi i rasteve abuzive dhe shkresave të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen.

Nga grupi i auditimit konstatohet se për planin e punës me Nr.20019 Prot., datë 25.11.2022 janë përcaktuar drejtimit në të cilat do të operojnë grupet e kontrollit në teren ku një nga pikat do të jetë edhe inventari me përzgjedhje gjatë kontrollit. Nga verifikimi i urdhrave të punës të dalë për këtë planë pune konstatohet se kjo pikë verifikimi nuk është përcaktuar në urdhër pune në asnjë rast gjatë periudhës 01-31 Dhjetor 2022. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin nr 18, datë 28.04.2020 lidhur me zbatimin e manualit për verifikimin dhe koordinimin në terren, kapitulli 1, seksioni përgjegjësitë për zbatimin e manualit. Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit në Terren, Z. T. T.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin Nr.5.1, datë 14.07.2023 dhe të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ju sqarojmë se bazuar në Planin e Punës me nr.20019 Prot. datë 25.11.2022 janë kryer gjithsej 145 kontrolle në terren, ku në 49 (dyzet e nëntë) prej tyre janë kryer inventarë fizik nga grupet

e punës, sipas përcaktimit në pikën nr.7 të urdhrimit të punës “Inventarizimi fizik me përzgjedhje të mallrave gjendje”.

Oëndrimi i grupit auditues: Gjetjet e konstatuara i referohen verifikimeve të urdhrave të punës të cilat janë paraqitur gjatë fazën së auditimit në terren ku nga verifikimi i tyre ka rezultuar se nuk është zbatuar programi i Planit të Punës.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjatë vitit 2022 Sektori Task Forcë ka kryer 1858 verifikime në terren dhe ka vendosur penalitete për 148 raste në shumën 11,335,000 lekë.

Tabela nr. 72 Realizimi i Planit Operacional Taskë Force Janar – Dhjetor 2022.

Nr.	Lenda	Prot	Dt.	Subjekte të kontrolluara	Subjekte me shkelje	Numri i shkeljeve	Shkelje në Vlerë
1	Plan vjetor pune Janar-Dhjetor 2022	23249/1	29.12.2021	448	33	37	2,250,000
2	Plan pune per periudhen 02-05 Shkurt 2022	1560	02.02.2022	23	6	6	450,000
5	Plan pune per periudhen 28 Mars-31 Maj 2022	4825	28.03.2022	344	39	42	2,610,000
6	Plan pune per periudhen 28 Mars-02 Prill 2022	5027	31.03.2022	23			
10	Plan Pune per periudhen 01 Qershor-30 Shtator 2022	9355/1	02.06.2022	609	39	43	3,490,000
11	Plan Pune per periudhen 03 Tetor-30 Nentor 2022	16562/1	29.09.2022	266	14	15	1,335,000
12	Plan Pune per periudhen 01-31 Dhjetor 2022	20019	25.11.2022	145	2	2	1,200,000
	Totali			1.858	133	145	11,335,000

Burimi: DVKT në DPT.

Tabela nr. 73 Realizimi i Planit Operacional Taskë Force (Analitik) Janar – Dhjetor 2022.

Në Lekë

Llojet e shkeljeve	Nr i shkeljeve	Shkelje ne Vlere
Mosinstalim i sistemit te fiskalizimit (BM)	22	1,650,000
Mosinstalim i sistemit te fiskalizimit (BV + TVSH)	5	250,000
Mosinstalim i sistemit te fiskalizimit (BV)	3	75,000
Mosleshim Fature (rasti I dyte) BV	1	50,000
Mosleshim Fature (rasti pare bi) BM	14	1,050,000
Mosleshim Fature (rasti pare bi) BV	25	625,000
Mosleshim Fature (rasti pare bi) BV+TVSH	2	100,000
Punonjes i padeklaruar BM	18	5,000,000
Punonjes i padeklaruar BV	34	2,200,000
Mall pa fature tatimore BV	3	75,000
Mall pa fature tatimore BV+TVSH	2	100,000
Subjekt I parregjistruar ne organin tatimor	5	
Mosleshim te biletave te sherbimit	1	10,000
Mosperditesim te dhena per rregjistrim, BM	3	45,000
Mosperditesim te dhena per rregjistrim, BV	4	45,000
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BV	1	10,000
Mosafishim te listes se çmimeve BV	1	50,000
Referim Hetimi	2	
Riaktivizim NIPT	1	
Administrim blloqesh jotatimore	1	
Totali	148	11,335,000

Burimi: DVKT në DPT.

Nga grupi i auditimit janë kërkuar dosjet fizike për planet e punës si më poshtë:

- 1-Plan pune për periudhën 02-05 Shkurt 2022
- 2- Plan pune për periudhën 21-28 Mars 2022

3- Plan Pune për periudhën 03 Tetor-30 Nëntor 2022

4- Plan Pune për periudhën 01-31 Dhjetor 2022

Rezulton se janë kryer gjithsej 434 verifikime në teren dhe janë vendosur gjithsej 21 penalitete nga të cilat janë verifikuar 11 praktika të cilat nuk rezultojnë me shkelje.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e sektorit të task force, grupi i auditimit nuk ka konstatuar problematika në kryerjen e veprimtarisë së këtij sektori.

Nga auditimi konstatohet se Programi “E-Inspektor” i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, pranë DPT dhe në Rajone, dhe nëpërmjet këtij programi kryhet kontrolli, identifikimi dhe regjistrimi i subjekteve të tatueshme është jashtë funksionit që prej datës 17.09.2021, datë në të cilën ka përfunduar kontrata me Nr.3815 prot., datë 18.08.2020, e lidhur midis është lidhur midis Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI-t) në rolin e autoritetit kontraktor dhe bashkimit të operatorëve “I” Shpk dhe “I” SHPK. Të cilat sipas nenit 1 të kontratës kontraktuesi merr përsipër realizim e kontratës me objekt “Blerje shërbim automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët” për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Vlera e kontratës është përcaktuar sipas nenit 2 të kontratës dhe është 99,891,000 lekë pa tvsh dhe 119,869,200 lek me tvsh dhe kohëzgjatja e kontratës është 13 muaj në total ku 1 muaj është faza përgatitore për shërbimin dhe instalimin dhe 12 muaj kohëzgjatja e shërbimit nga nënshkrimi i kontratës.

- Qëllimi i këtij projekti është sigurimi i një shërbimi për automatizimin dhe monitorimin e inspektorëve të Administratës Tatimore në terren. Me anë të këtij procesi synohet të rris edhe efikasitetin e vetë inspektorëve duke i dhënë mundësinë këtyre të fundit të kenë informacionin e duhur në momentin e duhur mbi urdhrat e punës si dhe informacionin e nevojshëm mbi subjektet tatimpaguese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Objekti kryesor i këtij shërbimi është automatizimi dhe monitorimi i inspektimeve në terren në administratën tatimore. Ky projekt synon të thjeshtojë dhe informatizojë punën e përditshme të inspektorëve në zbatimin e urdhrave të punës si dhe në arritjen e objektivave të administratës tatimore në lidhje me luftën kundër informalitetit.

- Të faktojë orën e fillimit të punës mbi një urdher pune si dhe vendodhjen me GPS të kryerjes së inspektimit.

- Të faktojë për çdo inspektim të kryer, subjektin tatimor të inspektuar, orën e fillimit të inspektimit, orën e përfundimit të inspektimit si dhe vendodhjen me GSP të kryerjes së inspektimit.

- Siguron funksionimin normal të gjithë strukturës së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, nga qendra në rajone, në mënyrë që çdo punonjës të njohë dhe të zbatojë detyrat e tij funksionale;

Lidhur me përfundimin e kontratës për Programin “E-Inspektor” nga Drejtori i Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, me anë të shkresës nr.1234 prot, datë 26.01.2022 është vënë në dijeni Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve z. C K se inspektorët e DVKT nuk mund të logohen në programin “E-Inspektor” pasi nuk kanë akses.

b) Sektori i Trajtimit të Ankesave.

Nga auditimi u konstatua se puna e Sektorit të Trajtimit të Ankesave, është pjesë e planeve vjetore të cilat dalin nga DVKT, por funksionimi i sektorit nuk bazohet kryesisht në një plan pune konkrete, kjo për vetë natyrën dhe specifikën e sektorit, por është në varësi të numrit të denoncimeve që vijnë. Funkcioni i Sektorit të Trajtimit të Ankesave është që të mbledhë informacionin e të dhënave për rastet abuzive që vijnë nga ankesat dhe burime të ndryshme denoncimi, për shkelje administrative tatimore të kryera nga veprimtaria e tatimpagueseve apo dhe shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksionit nga punonjësit e Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren në marrëdhënien me tatimpaguesin. Bazuar dhe në Manualin e DVKT, STA përgatit informacione të evidentuara dhe të detajuara sipas çdo Rasti

Abuziv dhe ankesë që ka administruar duke e raportuar këtë gjë tek Drejtori i DVKT sa herë që kërkohet, me qëllim përcaktimin e mënyrës dhe sektorin përkatës për ndjekjen e mëtejshme të verifikimit, marrjen e masave administrative tatimore për shkeljet e konstatuara dhe raportimin e ankesës, me qëllim rritjen e efektivitetit në kontrollin e zbatimit e Legjislacionit Tatimor dhe në respektim të bashkëpunimit dhe shërbimit ndaj qytetarit. Sektori i Trajtimit të Ankesave është i organizuar vetëm në nivel qendror, në përbërje të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Marrja e informacionit për ankesën/rastin abuziv/denoncimin vijnë në forma të ndryshme si më poshtë vijon:

- Në rrugë elektronike (Telefon, E-mail, Whatsapp, Viber) linja e gjelbërt 0800 14 14, Adresa elektronike e DPT denoncime@tatime.gov.al
- Në rrugë postare (Adresa postare e DPT)
- Nga komunikimet e drejtpërdrejta (Takime në DPT)
- Aplikacioni "Stop Informaliteti" pranë Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT.
- Portali "Platforma e Bashkëqeverisjes"

Për vitin 2022 nga ana e Sektorit të Trajtimit të Ankesave janë mbajtur evidencat në lidhje me denoncimet e ardhura, më konkretisht:

- 1- Raste Abuzive me burim informacioni nga E-maili i denoncimeve, Whatsapp, Viber, Takime, Telefon, Adresë Postare.

Tabela nr. 74 Format e Denoncimit

Forma e Denoncimit	Denoncimeve të ardhura	Denoncimeve të trajtuara	Denoncimeve në ndjekje
Linja Gjelbër (08001414) + Whats Up + Viber	358	358	0
Adresa Elektronike e DPT (denoncime@tatime.gov.al)	207	204	3
Aplikacioni "Stop Informaliteti"	640	640	0
Adresa Postare e DPT-së	53	53	0
Takime të drejtpërdrejta në DPT	15	14	1
Portali "Platforma e Bashkëqeverisjes"	69	67	2
Total	1342	1336	6

Nga verifikimi i rasteve për denoncime të ardhura, rezulton se nga 1342 raste të ardhura pranë sektorit të trajtimit të ankesave për vitin 2022, janë trajtuar brenda vitit 1336 raste dhe 6 raste janë në proces ndjekje. Nga auditimi nuk janë konstatuar raste të ardhura dhe të patrajuara nga ana e këtij sektori.

Rezulton se 6 rastet në ndjekje janë në proces hetimi nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

Titulli:	Nga auditimi konstatohet se jo në të gjitha rastet megjithëse në planin e punës është parashikuar kryerje e inventarit fizik, kjo nuk është reflektuar në urdhrat e punës të DVKT si dhe aktiviteti operacional i drejtorisë nuk është kryer nëpërmjet programit e-inspektor.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se programi "E-Inspektor" i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës, monitorimin e inspektorëve së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren dhe kryerjen e kontrollit, identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatueshme, është jashtë funksionit që prej datës 17.09.2021, datë në të cilën ka përfunduar kontrata. Referuar qëllimeve të implementimit të këtij programi që përfshijnë rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit në procesin e kryerjes së inspektimeve nga administrata tatimore, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit, konstatohet se nuk është vepruar në drejtim të rritjes së performancës së institucionit. Konstatohet se për planin e punës me Nr.20019 Prot., datë 25.11.2022

	janë përcaktuar drejtimet në të cilat do të operojnë grupet e kontrollit në terren, ku një nga pikat do të jetë edhe inventari me përzgjedhje gjatë kontrollit. Nga verifikimi i urdhrave të punës të dalë për këtë plan pune konstatohet se kjo pikë verifikimi jo në të gjitha rastet është përcaktuar në urdhër pune gjatë periudhës objekt auditimi.
Kriteri:	Urdhri nr 18, datë 28.04.2020 lidhur me zbatimin e manualit për verifikimin dhe koordinimin në terren, kapitulli 1, seksioni përgjegjësitë për zbatimin e manualit. Udhëzimi Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren. Mos plotësim i objektivave të planifikuara për kontroll në subjekt.
Shkaku:	Mungesa e lidhjes së kontratave të mirëmbajtjes për funksionimin e sistemeve informatike të investuara në bashkëpunim me AKSHI. Mangësi në zbatimin e pikave të programit të punës Nr.20019 Prot., datë 25.11.2022.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për vendosjen në funksionim të Programit “E-Inspektor” i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren me qëllim rritjen e transparencës dhe monitorimit në kryerjen e kontrolleve tatimore, si dhe të reflektohen në urdhrat e punës, parashikimet e bëra për kontrolle të inventarit fizik sipas planeve të miratuara.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

z. T T, në cilësinë e Drejtorit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

c. Sektori i Koordinimit

Sektori i koordinimit në terren kryen drejtimin metodologjik të veprimtarisë së sektorit të koordinimit dhe monitorimit në DPT dhe në sektorët e verifikimit dhe monitorimit në terren në rajone si dhe ndjek veprimtarinë e këtyre strukturave në terren.

Ky sektor kryen mbledhjen e informacionit të verifikimeve ditore nga sektorët e koordinimit në rajone. Nga auditimi është verifikuar periodiciteti i korrespondencës së këtij sektori me sektorët në varësi, ku nuk janë konstatuar problematika.

Grupi i auditimit ka analizuar dhe krahasuar informacionet periodike të përpunuara nga ky sektor si rrjedhojë e informacione ditore të raportuara nga sektorët rajonalë, ku nuk janë konstatuar problematika.

Një nga detyrat e veprimtarisë së këtij sektori lidhet me monitorimin nëpërmjet sistemit e-inspektor të vendndodhjes së grupeve të punës sipas orientimeve të përgjegjësit të sektorit. Kjo detyrë nuk është realizuar si pasojë e përfundimit të kontratës për sistemin e-inspektor në datën 17.09.2021, për të cilën jemi shprehur më lart lidhur me arsyet dhe personat përgjegjës.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e sektorit të koordinimit, grupi i auditimit nuk ka konstatuar problematika në kryerjen e veprimtarisë së këtij sektori.

2.6.3 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion.

Në zbatim të pikës nr. 6 të programit të auditimit “*Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operationale*” u shqyrtua dokumentacioni si poshtë:

Objektivat e punës të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm janë:

- Administrimi eficient i informacionit dhe kryerja e investigimeve për punonjësit aktualë dhe të mëparshëm të administratës tatimore;
- Parandalimi e zbulimi i akteve e praktikave korruptive në administratën tatimore;
- Investigimi i praktikave abuzive, korruptive e arbitrare;
- Identifikimi i punonjësve të administratës tatimore, të cilët, me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi;
- Përgatitja e rekomandimeve me masat ndëshkuese për çështjet që investigohen, përfshirë dhe llojin e masave administrative ndaj autorëve;
- Përgatitja në kohë sa më të shkurtër dhe me të gjitha elementët e nevojshëm të dosjeve për prokurorinë në rastet e referimeve për ndjekje penale;
- Standartizimi i praktikave investiguese dhe hetimore, shkëmbimi i eksperiencave investiguese ndërkombëtare në luftë kundër korrupsionit dhe formave të tij.

Për realizimin e misionit dhe objektivave të saj, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA) harton dhe vë në zbatim planin e punës vjetor, të ndarë në dy 6-mujorë dhe plane strategjike afat-gjatë.

DIBA është e organizuar bazuar në Nenin 16 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar përcakton që Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me Departamentin e Administratës Publike. Organigrama e administratës tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Me Urdhrin Nr.126 Datë 02.08.2016 është bërë miratimi i strukturave organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe është vendosur që Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) është strukturë nën varësinë direkte të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA) ka pavarësi në mbledhjen dhe administrimin e informacionit dhe kryerjen e investigimeve dhe raporton për punën e saj tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

- Gjatë vitit 2022 drejtoria e DIBA ka operuar me 8 punonjës të ndarë sipas strukturës në Drejtori i Drejtorisë (1), Inspektorët e Investigimit (7), të cilët janë me status të nëpunësit civil.

Funksionet kryesore të DIBA janë sigurimi i një sistemi me bazë të gjerë për mbledhje informacioni lidhur me shkeljet e legjislacionit tatimor dhe procedurave apo kodit të etikës nga ana e punonjësve të administratës tatimore; Investigimi i sjelljeve të këqija, konfliktit të interesit dhe shkeljeve administrative nga punonjësit e administratës tatimore, siç është marrja e ryshfeteve, mashtrimi apo keqpërdorimi i të drejtave dhe detyrave, aksesit i paautorizuar në informacion; Propozimi i Drejtorit të Përgjithshëm, sipas rastit, i masave administrative për punonjësit e administratës tatimore që shkelin ligjet apo kodin e etikës, në rastet kur këto shkelje nuk përbëjnë vepra penale.

- Planet dhe urdhrat e punës të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për vitin 2022, janë 6, të detajuar si më poshtë:

- Plan Pune nr. 2362 prot., datë 01.02.2022, me afat nga 01.02.2022; deri në 28.02.2022;
- Plan Pune nr. 5113 prot., datë 01.04.2022, me afat nga 01.04.2022; deri në 31.05.2022;
- Plan Pune nr. 9245 prot., datë 01.06.2022, me afat nga 01.06.2022; deri në 30.06.2022;
- Plan Pune nr. 11450 prot., datë 04.07.2022, me afat nga 04.07.2022; deri në 31.08.2022;
- Plan Pune nr. 15061 prot., datë 07.09.2022, me afat nga 07.09.2022; deri në 31.10.2022;
- Plan Pune nr. 18642 prot., datë 02.11.2022, me afat nga 02.11.2022; deri në 31.12.2022.

Planet e punës janë me objektin e kryerjes së verifikimit për:

1. Verifikimi i denoncimeve të ardhurave në DIBA
2. Kontrollin e DRT-ve, verifikimin e zbatimit të normave të Kodit të Etikës dhe prezencës në punë.
3. Ndjekjen e planit Kundër Korrupsionit 2020-2022.
4. Verifikimin e kryerjes së detyrave funksionale nga Drejtoria e V.K.M.T në DPT dhe në rajone me qëllim shmangien e praktikave korruptive gjatë kryerjes së detyrave funksionale.
5. Të ushtrohen kontrole sipas planeve operacionale të miratuara.
6. Verifikim të problematikave të tjera të dala gjatë punës.
7. Konsultimi i të dhënave të përmbledhura në DIBA.
8. Përgatitja e Raport Kontrollit për Drejtorin e Përgjithshëm.

Veprimtaria e drejtorisë gjatë vitit 2022 si dhe çështjet e trajtuara nga kjo strukturë pasqyrohen në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Tabela nr. 75 Veprimtaria e drejtorisë gjatë vitit 2022

Nr	Drejtoria	Çështjet e vitit 2021	Çështjet e vitit 2022	Çështje të trajtuara gjatë vitit 2022	Raste për mosfillim	Çështje të referuara në Komision Disiplinor	Punonjës të konstatuar me shkelje disiplinore	Çështje të referuara në Prokurori	Çështje në fund të vitit 2022 (në proces)
1	Tiranë	1	31	17	14	4	5	0	6
2	Elbasan	0	10	4	6	3	5	0	0
3	Sarandë	0	8	4	4	0	0	0	0
4	Vlorë	0	6	2	4	1	3	0	0
5	Fier	0	6	0	6	0	0	0	0
6	Durrës	0	5	2	3	0	0	0	0
7	Korçë	0	5	3	2	1	1	0	0
8	Shkodër	0	3	1	2	0	0	0	0
9	Gjirokastër	0	2	1	1	1	1	0	0
10	Lezhë	0	1	0	1	0	0	0	0
11	Dibër	0	1	0	1	0	0	0	0
Total		1	78	34	44	10	15	0	6

Në fillim të vitit 2022 kjo drejtori ka 1 çështje të mbartuar nga viti i kaluar e cila ka qenë në proces.

Në lidhje me masat e mëtejshme me qëllim parandalimin dhe goditjen e rasteve korruptive, bazuar dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH”, (i ndryshuar), Neni 105/1 i tij, dhe akteve të tjera nënligjore dalë në zbatim të tij, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT, gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2022, ka kryer verifikimin dhe investigimin për 77 (33 çështje janë regjistruar dhe investiguar + 44 mos fillim) raste të denoncuar, nga këto:

- 33 (tridhjetë e tre) çështje janë regjistruar dhe investiguar.

- 10 (dhjetë) çështje të referuara në Komisionin e Disiplinës në DPT.
- 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të Administratës Tatimore, janë konstatuar me shkelje ligjore dhe janë referuar në Komisionin e Disiplinës në DPT, Nga këto, 13 raste kanë qenë për punonjës të shërbimit civil dhe 2 raste punonjës, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet me Kodin e Punës. Sipas vendimit të marrë pas trajtimit të rasteve, ato grupohen në:
 - Ndërprerje e ecurisë disiplinore – 7 raste;
 - Vërejtje me shkrim – 1 rast;
 - Pezullim ngritje në detyrë 6 muaj – 1 rast;
 - Pezullim ngritje në detyrë 2 vjet – 3 raste;
 - Largim nga shërbimi civil – 3 raste.
- 6 (gjashtë) çështje të regjistruar gjatë vitit 2022, janë në proces investigimi dhe kanë kaluar në regjistrin e vitit 2023.

Gjithashtu, në lidhje me informacionet e ardhura për ndjekje nga burime të ndryshme të informimit në DIBA, janë gjithsej 44 (dyzetë e katër) raste të verifikuara/investiguara, të cilat nuk përmbajnë dhe nuk plotësojnë kushtet e mjaftueshme për t'u regjistruar si çështje.

Nga grupi i auditimit të KLSH-së nga 11 Drejtori me raste të trajtuara për vitin 2022 nga DIBA u përzgjedh kampioni si më poshtë: DRT Elbasan, Vlorë dhe Sarandë, ku u verifikuan rastet për të cilat janë konkluduar shkelje administrative.

Për DRT Elbasan, gjatë vitit 2022, nga DIBA, janë investiguar 10 (dhjetë) ankesa nga të cilat për 3 ankesa janë konstatuar shkelje disiplinore dhe 5 punonjës janë referuar pranë Komisionit të Disiplinës në DPT.

Rasti nr. 1, ka ardhur me e-mail, në datë 09.02.2022, dhe me e-mail datë 11.02.2022, ku pretendohet se punonjës të DRT Elbasan kanë abuzuar me procedurat e kontrollit në lidhje me një subjekt tregtar. DIBA ka regjistruar çështjen nr.7, datë 15.02.2022, ku në përfundim të verifikimeve ka rezultuar se pretendimet e ngritura në ankesë qëndrojnë. Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 3 punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr. 4677 prot., datë 23.03.2022, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Rasti nr. 2, ka ardhur me e-mail, në platformën qeveritare "Stop Informalitetit" në datë 05.05.2022, ku pretendohet se Drejtori i Tatimeve Elbasan, në mënyrë të vazhdueshme bën presione firmave dhe pronareve të firmave gjatë dhe pas përfundimit të kontrolleve. DIBA ka regjistruar çështjen nr.12, datë 05.05.2022, ku në përfundim të verifikimeve ka rezultuar se pretendimet e ngritura në ankesë qëndrojnë. Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 1 (një) punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr. 10205/1 prot., datë 10.06.2022, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Rasti nr. 3, ka ardhur nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Qendror, me shkresë nr.11221prot., datë 30.06.2022. DIBA ka regjistruar çështjen nr.13, datë 04.07.2022, ku në përfundim të verifikimeve ka rezultuar se pretendimet e ngritura në ankesë qëndrojnë. Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 1 (një) punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr. 11221/2 prot., datë 18.07.2022, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Për DRT Vlorë, gjatë vitit 2022, nga DIBA, janë investiguar 6 (gjashtë) ankesa nga të cilat për 1 (një) ankese është konstatuar shkelje disiplinore dhe 3 punonjës janë referuar pranë Komisionit të Disiplinës në DPT.

Rasti nr. 1, ka ardhur me e-mail, në datë 30.03.2022, nga Drejtori Rajonal i DRT Vlorë, për procedura të parregullta të kryera nga znj.A.Q. DIBA ka regjistruar çështjen nr.10, datë

30.03.2022, ku në përfundim të verifikimeve ka rezultuar se pretendimet e ngritura në ankesë qëndrojnë. Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 3 punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr. 4885/2 prot., datë 10.05.2022, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Për DRT Sarandë, gjatë vitit 2022, nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT, janë investiguar 8 ankesa ku dy prej tyre kanë rezultuar me shkelje.

Rasti nr. 1 - Nga KLSH u administruan në mënyrë specifike dosjet me ankesa për Hotel Portanova Sarandë, rast i cili ka ardhur në DIBA me shkresën nr. 416, datë 12.09.2022, me lëndë: Informacion mbi aktin abuziv”. DIBA ka regjistruar çështjen nr. 22, datë 13.09.2022. Për verifikimin e plotë të rastit DIBA ka kërkuar bashkëpunim me Drejtorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, të cilët kanë ushtruar kontroll ndaj subjektit Hotel P Sarandë. Ndaj këtij subjekti janë vendosur masa administrative për parregullsitë e konstatuara gjatë kontrollit. Në lidhje me punonjësën S.L., nuk është konstatuar asnjë shkelje apo konflikt interesi që bije në kundërshtim me detyrat e tij funksionale në DRT Sarandë. Çështja është mbyllur nga DIBA me raport për Drejtorin e Drejtorisë në datë 17.10.2022.

Rasti nr. 2 - DIBA ka regjistruar çështjen nr.28, datë 14.11.2022, për punonjësën S.L., ku pretendohet se ky i fundit nuk qëndron në punë gjatë orarit zyrtar, por punon në subjektin Hotel Portanova Sarandë, i cili sipas pretendimeve në ankesë është në pronësi të tij. Informacioni ka ardhur me shkresën nr.19231prot., datë 14.11.2022. DIBA ka verifikuar rastin ku në përfundim të tyre ka rezultuar se pretendimet e ngritura në ankesë nga denoncuesi K.K., nuk qëndrojnë. Çështja është mbyllur nga DIBA me raport për Drejtorin e Drejtorisë në datë 02.12.2022. Në lidhje me rastin, me shkresën nr.19637/1 prot., datë 21.12.2022, me lëndë: Kthim përgjigje, DIBA i ka kthyer përgjigje edhe KLSH .

Nga auditimi i planeve vjetore operacionale konstatohet është hartuar plani vjetor operacional për vitin 2022, por nuk është kryer hartimi i planeve operacionale vjetore të punës në bazë 6-mujore dhe planeve strategjike afatgjatë për aktivitetin e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm. Gjithashtu konstatohet raportimi vjetor me rezultatet e detajuara të punës për vitin paraardhës është kryer në tejkalim të afateve ligjore, kjo në kundërshtim me Manualin e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) pika 6.3.2. “*Brenda muajit Janar të çdo viti, Drejtori i DIBA-s i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, Raportin Vjetor me rezultatet e detajuara të punës për vitin paraardhës*”.Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin Nr.5.1, datë 14.07.2023 dhe të njejtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Drejtorja e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion), për vitin 2022 ka kryer Plane Pune Operacionale të ndarë në dy 6-mujor të cilët janë “**Konfidencial**”, Gjithashtu, ka kryer edhe “*Evidencë mbi punën e kryer nga DIBA për periudhën Janar-Dhjetor 2022*”, me nr. 07 prot., datë 24.03.2023, “**Konfidencial**”.

Oëndrimi i grupit auditues: Gjetjet e konstatuara i referohen mos përgatitjes së raporteve përmbledhëse për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve mbi punën e bërë në baza 6-mujore dhe vjetore si dhe nuk është kryer raportimi vjetor me rezultatet brenda muajit Janar të çdo viti. *Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.*

Titulli:	Mungesë e hartimit të planeve operacionale, planeve strategjike afatgjatë dhe raportimit vjetor me rezultatet e detajuara të punës.
Situata:	Nga auditimi i planeve vjetore operacionale konstatohet është hartuar

	plani vjetor operacional për vitin 2022, por nuk është kryer hartimi i planeve operationale vjetore të punës në bazë 6-mujore dhe planeve strategjike afatgjatë për aktivitetin e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm. Gjithashtu konstatohet raportimi vjetor me rezultatet e detajuara të punës për vitin paraardhës është kryer në tejkallim të afateve ligjore, kjo në kundërshtim me Manualin e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) pika 6.3.2. <i>“Brenda muajit Janar të çdo viti, Drejtori i DIBA-s i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, Raportin Vjetor me rezultatet e detajuara të punës për vitin paraardhës”.</i>
Kriteri:	Manuali i Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion).
Ndikimi/Efekti:	Mungesë monitorimi në kohë të aktivitetit të drejtorisë
Shkaku:	Mos kryerja e raportimeve dhe planifikimeve
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion të hartohen dhe raportohen sipas frekuencës së kërkuar në manualin e punës, planet vjetore dhe strategjike si dhe të kryhet raportimi në kohë mbi rezultatet e punës.

Për problematikat e mësipërme mbajnë përgjegjësi z. K.M., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion dhe z. C.K. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

2.6.4 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor.

Në zbatim të pikës nr. 6 të programit të auditimit *“Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operationale”* u shqyrtua dokumentacioni si poshtë:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit.
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT dhe DRT

Nga auditimi dhe dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se:

- Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në të gjitha DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.
- Objektivi kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale. Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është miratuar me Urdhrin nr. 79 datë 27.03.2020, nr. 1181/6 Prot datë 27.03.2020.

Drejtorja e Kontrollit tatimor përbëhet si më poshtë:

1. Drejtori i Drejtorisë
2. Sektori i Kontrollit Tatimor (1+5)
3. Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit (1+5)
4. Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave (1+2)

Në zbatim të nenit 117-118 të Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në planin operacional të vitit 2022 ka programuar për kontroll 2 Drejtori Rajonale Tatimore lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe përmbushjen e kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshëm.

Në bazë të planit operacional Drejtoria e Kontrollit Tatimor ka planifikuar Drejtoritë Rajonale si më poshtë:

- DRT Lezhë me autorizim nr. 8514 Prot, datë 20.05.2022;
- DRT Elbasan me autorizim nr. 8513 Prot, datë 20.05.2022;

Gjithashtu Drejtoria e Kontrollit Tatimor për vitin 2022 ka përfunduar kontrollet të cilat në fillim të vitit 2022 janë kontrolle të mbartura nga viti 2021 për DRT si më poshtë.

- DRT Kukës me autorizim nr. 3992 date 03.03.2021;
- DRT Vlore me autorizim nr. 16945/1, date 01.10.2021;
- DRT Dibër me autorizim nr. 22248 date 02.11.2018;

Të cilat janë trajtuar nga ana e grupit të auditimit të KLSH-së në auditimin paraardhës.

Nga verifikimi i kontrolleve të ushtruara në drejtoritë rajonale nga inspektorët e kontrollit të D.K.T (sektori i kontrollit tatimor dhe sektori i procedurave të kontrollit dhe monitorimit sipas programeve të kontrollit të miratuara), për zbatimin e legjislacionit tatimor konstatohet si më poshtë vijon:

1.DRT Elbasan me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 8513, datë 20.05.2022 dhe program kontrolli nr. 8513/1, datë 20.05.2022 për periudhën Korrik 2019 –Prill 2022.

Inspektor: N.M., P.M.

Aktet e Inspektoreve: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 8513/5 prot., datë 13.10.2022 dhe shkresa nr. 8513/6 prot., datë 22.11.2022 për dërgimin e Raport Kontrolli Përfundimtar së bashku për detyrat e rekomanduara për zbatim.

Kontrolli është realizuar nga data 23.05.2022 deri 06.09.2022, me memo nr. 8513/2, datë 04.08.2022 drejtuar Drejtorit të Kontrollit është kërkuar zgjatje e afateve të kontrollit deri në datën 06.09.2022 lidhur nga problematikat e konstatuara deri në këtë fazë, kërkesa për shtyrje të kontrollit është miratuar me shkresën nr. 8513/3, datë 15.09.2022. **Konstatohet se miratimi i kërkesës për zgjatjen e afateve të kontrollit është miratuar pasi ka përfunduar kontrolli në DRT Elbasan.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin datë 14.07.2023 dhe të njejtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ky miratim është kryer nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, dhe në Manualin e Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit. Data e protokollimit është e lidhur me periudhën Gusht-Shtator 2022, kur një pjesë e stafit ka qenë me leje të zakonshme.

Oëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas trajtimit të argumenteve të paraqitura për sa më lartë, i cilëson si të paargumentuara dhe nuk ndryshon qëndrimin e tij lidhur me problematikën e konstatuar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin se:

-Me mbylljen e kontrollit tatimor, në raportin përfundimtar të kontrollit, të pasqyrohen jo vetëm zbulimet, por edhe niveli i ri (ndryshimi) i treguesve fiskal/llojeve të tatimit pas kontrollit (ishte-bëhet).

-Për diferencat dogana - tatime që evidentohen, të njoftohen edhe subjektet si dhe të bëhet me dije edhe kontrollit operacional.

-Analiza e posteve të bilancit, nuk duhet të ketë karakter formal, por duke analizuar/shprehur për faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e tyre sipas periudhave nën kontroll dhe justifikimi i ndryshimeve, mbi bazë dokumentacioni.

-Huatë apo overdraft-et dhe ndryshimi i vlerës së tyre nga njëra periudhë objekt kontrolli në tjetrën, të trajtohen në mënyre analitike, duke u shoqëruar/referuar me dokumentacion justifikues, si pjesë e dokumentacionit të raportit përfundimtar të kontrollit tatimor.

-Plotësimi i deklaratave mujore të ndiqet në mënyre të pandërprerë dhe nëse konstatohen pasaktësi, të bëhet menjëherë me dije tatim paguesit.

-Analiza e qarkullimit të parasë (cash floë), duhet të bëhet në mënyrë të detajuar, lidhur me verifikimin e saktësisë së të ardhurave dhe shpenzimeve pra me gjenerimin dhe përdorimin e parasë, për periudhën nën kontroll.

-Për tatimpaguesit me përgjegjësi tatimore TVSH, të bëhet në vazhdimësi krahasimi i të dhënave të transmetuara nga fiskalizimi me FDP-të mujore dhe për rastet kur të dhënat e kasave fiskale janë më të mëdha sesa deklaratimet në FDP-të mujore të njoftohet dhe të rakordohet me tatimpaguesin dhe në rastet kur gjykohe për mosdeklarim të bëhen vlerësimet përkatëse.

-Në kontrollet e plota duhet të trajtohen të gjitha metodikat e përfshira në Manualin e Kontrollit Tatimor. Në mjaft raste nuk bëhet inventarizimi i likuiditeteve (arkë dhe bankë) dhe analiza e qarkullimit.

-Duhet të analizohen në mënyrë të detajuar llogaritë klient-furnitor.

-Duhet të zbatohet Ligi Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në RSh. "I ndryshuar, udhëzimit në zbatim të tij, neni 30 deri në nenin 38, nene në të cilat janë përcaktuar të drejtat e tatimpaguesit, neni 80.3, neni 81. 1/1, neni 83 dhe neni 84.

-Observacionet e tatimpaguesit duhet të reflektohen në Raportin Përfundimtar të Kontrollit në mënyrë të detajuar duke dhënë të gjitha arsyet e pranimit apo mospranimit të kundërshtimeve të tatimpaguesit.

-Vizitat fiskale duhet të trajtohen në vazhdimësi nga ana procedurale, si kontroll i plotë, pasi duhet të ndiqet procedura e Raportit Paraprak dhe Raportit Përfundimtar.

-Të monitorohet në mënyrë të menjëhershme dhe në vazhdimësi qarkullimi i tatimpaguesve në mënyrë që kur të arrijnë kufirin në lidhje me TVSH ose Tatim fitimin të regjistrohen menjëherë.

2.DRT Lezhë me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 8514 prot. datë 20.05.2022 dhe program kontroll nr.8514/1 prot., datë 20.05.2022 për periudhën Korrik 2019 –Prill 2022. Kontrolli është realizuar nga data 23.05.2022 deri 25.07.2022

Inspektor: A.Ll., E.P.

Aktet e Drejtorisë së Kontrollit: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr.8514/2 prot., datë 22.08.2022, Raporti i kontrollit nr.8514 prot., datë 12.10.2022.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin se:

-Konstatohen kontrole të prapambetura vit pas viti, ka zbulueshmëri të ulët lidhur me vizitat fiskale.

-Mangësi në bashkëpunimin midis sektorëve.

-Shpërndarje e kontroleve të inspektorët jo në mënyrë të argumentuar, nivel i ulët zbulimi lidhur me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

-Procesi i fiskalizimit duhet të ndiqet me korrektësi dhe me përparësi. Në mënyrë të vazhdueshme, si grupi i punës ashtu edhe inspektorët e kontrollit të njihen në kohë reale me të rejtat e procesit dhe të ndjekin të gjitha etapat deri në vënien në efikasitet të plotë të këtij sistemi.

-Problematika në mos azhurnimin e faturave të fiskalizuar në kohë si dhe mos shfaqjen e tyre në librat e blerjes dhe të shitjes.

-Inspektorët e kontrollit nga zyra nuk kanë plane për analizë me tematika të caktuara që dalin nga përpunimi i raporteve të deklarimit të tatimpaguesve siç janë analiza mbi kredinë e TVSH-së, analiza mbi rënien e xhiros, si dhe tatimpaguesit me xhiro të lartë dhe numër të ulët punonjësish.

- Nga të dhënat dhe dokumentacioni i Sektorit Cilësisë dhe Standardizimit për vitin 2022 konstatohet se:

- ndjek planet e kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, nga DMR (70% të modulit 1 të DMR si dhe 30% e propozuara nga DRT dhe të miratuara) mbi bazën e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji.

- analizon dhe përpunon vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale,

- mban evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR,

- të gjitha të dhënat e raportuara nga DRT-të, mbas analizimit dhe përpunimit i dërgohen Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, në DPT.

Tabela nr. 76 Realizimi i kontrolleve për vitin 2022 të detajuar sipas DRT-ve.

Në mijë lekë

Nr	Rrethet	Nr. Kontrollë të planifikuara gjithsej			Nr. Kontrollë të kryera gjithsej			Zbulimet sipas llojeve të tatimeve				
		Plotë	V.fiskale	Totali	Plotë	V.fiskale	Totali	TVSH	T.Fitimi	Sig Shoq	Të tjera	Gjithsej
1	Berat	56	13	69	46	15	61	17,513	10,560	156	4,702	32,930
2	Dibër	73	6	79	59	12	71	16,077	8,027	2,423	500	27,027
3	Durrës	140	78	218	121	69	190	195,618	193,900	13,899	12,730	416,147
4	Elbasan	200	25	225	151	27	178	41,266	25,542	3,333	7,845	77,986
5	Fier	254	58	312	193	59	252	102,873	59,409	6,851	43,842	212,975
6	Gjirokastrë	49	5	54	41	12	53	12,704	6,001	100	868	19,673
7	Korçë	165	24	189	157	27	184	50,416	20,820	601	6,887	78,724
8	Kukës	52	6	58	33	5	38	3,809	3,208	158	215	7,390
9	Lezhë	11	12	23	36	9	45	965,809	639,801	730	6,776	1,613,116
11	Sarandë	13	20	33	14	21	35	4,733	3,820	0	965	9,518
12	Shkodër	179	18	197	127	17	144	200,672	44,785	307	1,622	247,387
13	Vlorë	107	34	141	91	32	123	107,860	22,900	3,593	3,202	137,555
14	Tiranë	313	116	429	212	200	412	844,094	694,739	5,558	113,391	1,657,783
15	DTM	446	106	552	329	111	440	868,625	2,796,601	35,420	79,569	3,780,216
	Shuma	2,058	521	2,579	1,610	616	2,226	3,432,069	4,530,113	73,130	283,115	8,318,427

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Bazuar në tabelën e mësipërme evidentohet se numri i kontrolleve të planifikuara gjatë vitit 2022 është 2,579 kontrolle, ku 2,058 kontrolle janë kontrolle të plota dhe 521 kontrolle janë vizita fiskale. Kontrollët e realizuara janë 2,226, ku 1,610 kontrolle janë të plota dhe 616 kontrolle janë vizita fiskale. Konstatohet një mosrealizim kontrollesh në numër prej 353 kontrollesh ose rreth 14% e totalit.

Tabela nr. 77 Numri i kontrolleve të kryera për vitin 2022 e krahasuar me vitin 2021(70+30%)

Emërtimi	Totali i rasteve të kontrollit		Zbulimet në vlerë		Tatimet sipas zërave / Totalin e zbulimeve	Tatimet sipas zërave / Totalin e zbulimeve	Numri i kontrolleve e në %	Zbulimet sipas zërave në %,
	2022	2021	2022	2021				
2.Kontroll fakt B.M	2,226	1,856	8,318,427	4,323,437	100%	100%	120%	192%
2.1. TVSH	2,169	1,720	3,432,069	2,085,330	41%	48%	126%	164%
2.2. Tatim fitimi	1,614	1,079	4,530,113	1,796,449	54%	42%	72%	92.00%
2.3. Sigurime Shoq e Shën	1,652	1,151	73,130	53,137	0.88%	1.20%	74%	58%
2.4. Tatim mbi te ardhurat	1,235	946	9,458	13,476	0.16%	0.31%	55%	51%
2.5. Akcizë	2	14	257	0	0.00%	0.00%	0.09%	0.75%
2.7. Taksa nacionale	12	4	3,746	18,826	0.05%	0.44%	0.54%	0.22%

2.8. Të tjera	1,602	1,161	269,653	356,168	3%	8%	72%	62%
----------------------	-------	-------	---------	---------	----	----	-----	-----

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga KLSH

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se realizimi i numrit të kontrolleve për periudhën 12 mujore të vitit 2022 e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 është realizuar në masën 120 % të kontrolleve ndërsa realizimi i zbulimeve është në masën 192 %, e krahasuar me vitin 2021.

Tabela nr. 78 Evidenca progresive për realizimin e planit të kontrollit 12 mujor 2022 (70+30%)

Nr.	DRT	Kontrolle plan.12 mujori 2022			Kontrolle fakt 12 mujori 2022			Realizimi i planit kontrolleve %		
		Te plota	V.fiskale	Gjithsej	Te plota	V.fiskale	Gjithsej	Gjithsej	Te plota	v. fiskale
1	Berat	56	13	69	40	10	50	72.46%	71.43%	76.92%
2	Dibër	73	6	79	50	10	60	75.95%	68.49%	166.67%
3	Durrës	140	78	218	92	71	163	74.77%	65.71%	91.03%
4	Elbasan	200	25	225	110	25	135	60.00%	55.00%	100.00%
5	Fier	254	58	312	129	51	180	57.69%	50.79%	87.93%
6	Gjirokastrë	49	5	54	34	8	42	77.78%	69.39%	160.00%
7	Korçë	165	24	189	90	24	114	60.32%	54.55%	100.00%
8	Kukës	52	6	58	16	2	18	31.03%	30.77%	33.33%
9	Lezhë	11	12	23	9	7	16	69.57%	81.82%	58.33%
10	Sarandë	13	20	33	2	17	19	57.58%	15.38%	85.00%
11	Shkodër	179	18	197	105	17	122	61.93%	58.66%	94.44%
12	Vlorë	107	34	141	71	23	94	66.67%	66.36%	67.65%
13	Tiranë	313	116	429	45	80	125	29.14%	14.38%	68.97%
14	DTM	446	106	552	253	92	345	62.50%	56.73%	86.79%
	TOTALI	2,058	521	2,579	1,046	437	1,483	57.50%	50.83%	83.88%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se realizimi i kontrolleve të planifikuara për vitin 2022 është në masën 57.5 %, kemi një mosrealizim të planit të kontrolleve për vitin 2022 në masën 42.5 %, ndikimin më të madh në mosrealizimin e planit të kontrolleve e kanë DRT Tiranë me 29.1 % kontrolle të realizuara, DRT Kukës me 31 % kontrolle të realizuara, DRT Sarandë me 57.6 % kontrolle të realizuara, DRT Fier me 57.7 % kontrolle të realizuara, DRT Elbasan me 60 % kontrolle të realizuara, DRT Korçë me 60.3% kontrolle të realizuara.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin datë 14.07.2023 dhe të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion grupit të kontrollit të KLSH-së sipas kërkesës, baza e evidencës është vetëm me treguesit që i përkasin Vitit 2022, specifikisht planifikimi i bërë në total për vitin 2022 dhe realizimi i pjesës që i përket vetëm këtij planifikimi. Tabela nuk përfshin gjendjen e kontrolleve të përealizuara deri në datën 01.01.2022, të cila janë mbyllur përgjatë vitit 2022.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit i referohet numrit të kontrolleve të realizuara nga ato të planifikuara për vitin 2022 ku rezulton të jetë në shifrat e 57.5 %, nëse kjo vjen si pasojë e stokut të vitit paraardhës është përgjegjësia e Drejtorisë së Kontrollit për

të planifikuar saktë kohën dhe orët që ka në dispozicion gjatë vitit për të planifikuar kontrollet për vitin në vijim, pas trajtimit të argumenteve të paraqitura për sa më lartë, i cilëson si të paargumentuara dhe nuk ndryshon qëndrimin e tij lidhur me problematikën e konstatuar.
Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Analiza e kontrolleve që janë kryer sipas Moduleve 1, 2,3, e konkretisht:

Tabela nr. 79 Moduli 1 (70% DMR)

Në mijë lekë

Nr	DRT	Kontrolle të kryera raste 1				Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime të tjera	Totali
		Gjithsej	Me zbulime	Pa zbulime	Pa zbulime në %					
1	Berat	36	33	3	8.33%	13,841	8,381	-	2,756	24,978
2	Dibër	49	44	5	10.20%	10,573	3,799	2,030	500	16,902
3	Durrës	132	76	56	42.42%	37,356	16,276	397	925	54,954
4	Elbasan	111	102	9	8.11%	27,121	13,277	1,211	2,890	44,499
5	Fier	147	128	19	12.93%	40,931	22,160	6,497	5,115	74,703
6	Gjirokastrë	37	34	3	8.11%	10,613	3,340	42	342	14,337
7	Korçë	92	74	18	19.57%	12,892	6,296	312	1,738	21,238
8	Kukës	14	14	0	0.00%	1,624	1,607	-	15	3,246
9	Lezhë	12	7	5	41.67%	12,588	951	-	155	13,694
10	Sarandë	19	5	14	73.68%	-	93	-	465	558
11	Shkodër	101	100	1	0.99%	134,174	25,519	232	1,336	161,261
12	Vlorë	80	79	1	1.25%	69,104	14,488	1,011	675	85,278
13	Tiranë	104	65	39	37.50%	54,809	7,729	1,114	1,613	65,265
14	DTM	213	150	63	29.58%	289,871	104,810	35,066	9,261	439,008
Totali		1,147	911	236		715,497	228,726	47,912	27,786	1,019,921

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga KLSH

Nga 1,147 kontrolle të kryera sipas propozimit të Drejtorisë së Menaxhimit të riskut, konstatohet se 236 kontrolle ose rreth 20.5 % e totalit rezultojnë pa zbulime nga ana e inspektorëve të kontrollit.

Zbulimi për kontroll është 889 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 1,768 mijë lekë, krahasuar me vitin 2021 konstatohet se kemi rënie të zbulimit për kontroll në masën 50.2 %;

Tabela nr. 80 Moduli 2 (30% DMR)

Në mijë lekë

DRT	Kontrolle të kryera rasti 2				Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime të tjera	Totali
	Gjithsej	Me zbulime	Pa zbulime	Pa zbulime në %					
Berat	14	13	1	7.14%	2,545	1,772	156	1,355	5,828
Dibër	11	11	0	0.00%	3,929	2,237	354	-	6,520
Durrës	31	27	4	12.90%	19,673	19,933	12,697	3,768	56,071
Elbasan	19	18	1	5.26%	3,178	4,261	111	433	7,983
Fier	33	32	1	3.03%	17,559	11,947	20	22,288	51,814
Gjirokastrë	5	5	0	0.00%	1,112	1,678	58	424	3,272
Korçë	21	20	1	4.76%	4,688	1,955	119	150	6,912
Kukës	4	4	0	0.00%	227	399	-	50	676

Lezhe	1	1	0	0.00%	320	140	-	-	460
Sarandë	0	0	0	0.00%	-	-	-	-	-
Shkodër	21	21	0	0.00%	11,395	5,859	53	194	17,501
Vlorë	14	3	11	78.57%	9,279	1,279	219	140	10,917
Tiranë	17	15	2	11.76%	2,918	3,644	-	190	6,752
DTM	124	122	2	1.61%	61,842	117,783	34	5,611	185,270
Totali	315	292	23	7.30%	138,665	172,887	13,821	34,603	359,976

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga 315 kontrolle të kryera sipas propozimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, 292 kontrolle ose rreth 92.6 % e totalit rezultojnë me zbulime nga ana e inspektorëve të kontrollit. Zbulimi për kontroll është 1.232 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 3.261 mijë lekë, pra kemi rënie të konsiderueshme të zbulimit për kontroll ose e realizuar vetëm 38 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar;

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin datë 14.07.2023 dhe të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për vitin 2022 për të patur një efektivitet më të madh në shtimin e numrit të kontrolleve sipas rekomandimeve të KLSH-së të një viti më parë dhe nën orientimin e FMN-së, është bërë ndryshim në Manualin e Riskut në vitin 2021, për periudhën e ushtrimit të kontrolleve në tatimpagues. Nëse më parë në një tatimpagues ushtrohej kontroll për 5 vite, tani kontrolli kryhet për një periudhë 2 vjeçare, kjo gjë sjell uljen e orëve për kontroll, shtim të numrit të planifikimeve për kontroll dhe rënie të zbulueshmërisë për numër kontrolli.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas trajtimit të pretendimeve nga subjekti të paraqitura për sa më lartë, i cilëson si të paargumentuara dhe nuk ndryshon qëndrimin e tij lidhur me problematikën e konstatuar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Konstatohet një stok i lartë kontrollesh të papërfunduara nga viti 2017, ku deri në 31.12.2022, janë gjithsej 1140 kontrolle, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 81 Evidenca e fazave në të cilat ndodhen Kontrollat në proces

Kontrolle sipas viteve	Kontrolle gjithsej	Kontrolle pa filluar	Kontrolle pezulluar	Fazat në të cilën ndodhet Kontrolli					
				Projekt Raport			Dërguar raporti paraprak	Opservacion nga subjekti	Raport Përfundimtar
				Inspektori	Përgjegjësi	Drejtori kontrollit			
2017	15	7		8					
2018	18	8		6			4		
2019	22	12		6					4
2020	31	11	7	11			1		1
2021	48	18	8	17					5
2022	1006	290	33	430	6		157	4	86
Totali	1140	346	48	478	6	0	162	4	96

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga KLSH

Nga tabela evidentohet se:

-Numri i kontrolleve të pa mbyllura, nga kontrollet e planifikuara për periudhën deri në vitin 2021 është 134 kontrolle, numri i kontrolleve të pafilluara në vitin 2020 ka qenë 177, kontrolle të pafilluara për vitin 2022 janë 1006.

-Në 1140 kontrolle të pa filluara nga administrata tatimore janë përfshirë edhe kontrollet e planifikuara për muajin Dhjetor 2022, të cilat u janë nisur njoftimi për kontroll, kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit në mbështetje të tij neni 81.1/1 Njoftimi për fillimin e kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit të plotë tatimor të shkruar në njoftim, ndërsa në rastin e vizitave fiskale ky njoftim i dërgohet tatimpaguesit të paktën 10 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vizitës fiskale;

- 48 kontrolle janë të pezulluar;

-162 kontrolle janë në fazë projekt raporti;

-96 kontrolle janë në fazën e raportit përfundimtar.

-346 kontrolle janë pa filluar

Nga grupi i auditimit konstatohet se:

- Për vitin 2022 në lidhje me kontrollet e papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, stoku i kontrolleve vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84, nga të dhënat e paraqitura gjendja e stokut është rritur në krahasim me vitin 2021, ku nga 671 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces, në vitin 2022 kjo shifër është rritur në 1140 kontrolle, me një rritje të lartë të numrit të kontrolleve të pafilluara.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin datë 14.07.2023 dhe të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, në fillim të vitit 2022, gjendja e kontrolleve të pambyllura (të pezulluara, të pafilluara ose në proces) është 787 kontrolle.

Planifikimi i kontrolleve për vitin 2022 ka qenë 2579 (planifikimi në 2021 ka qenë 1903 kontrolle).

Kontrolle të mbyllura në vitin 2022 janë 2226 (kontrolle të mbyllura në 2021 kanë qenë 1856) Qëllimi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT është që në fund të periudhës raportuese të ketë stok sa më të vogël të kontrolleve të periudhave të hershme, pasi stoku i krijuar nga vetë periudha raportuese, i përket kryesisht kontrolleve të cilat për arsye të procedurave (*bazuar në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 81-85*), janë brenda afateve nga data e dërgimit të njoftimit për kontroll, kontroll paraprak, në pritje të observacioneve apo raport kontrolli përfundimtar.

Oëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas trajtimit të pretendimeve nga subjekti të paraqitura për sa më lartë, i cilëson si të paargumentuara dhe nuk ndryshon qëndrimin e tij lidhur me problematikën e konstatuar, gjithashtu nga përshkrimi i qëllimit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT për vitin 2022 i cili citon se ka qëllim të ul stokun e periudhave të hershme, ka krijuar një stok të ri për vitin koherent.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Konstatohet se drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rakordon gjendjen e kontrolleve në fund të vitit për ta përdorur si referim lidhur me planifikimet të cilat realizon për vitin pasardhës duke sjell vazhdimisht një numër të lartë të kontrolleve në proces ose të pafilluar në fund të vitit. Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet kontrollon dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfeksionimin e Drejtorive të Kontrollit në DRT.

Titulli:	Konstatohet se miratimi i kërkesës për zgjatjen e afateve të kontrollit është miratuar pasi ka përfunduar kontrolli nga Drejtoria e Kontrollit
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në një rast, është kryer kontrolli përtej afatit fillestar të miratuar, pa marrë në kohë miratimin për zgjatjen e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Kontrolli është realizuar nga data 23.05.2022 deri në 06.09.2022 në DRT Elbasan. Me memo nr. 8513/2, datë 04.08.2022 drejtuar Drejtorit të Kontrollit është kërkuar nga grupi i kontrollit zgjatja e afateve të kontrollit deri në datën 06.09.2022 lidhur nga problematikat e konstatuara deri në atë fazë, e cila është përcjellë nga drejtori i kontrollit për miratim në strukturën përkatëse. Kërkesa për shtyrje të kontrollit është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me shkresën nr. 8513/3, datë 15.09.2022. Konstatohet se miratimi i kërkesës për zgjatjen e afateve të kontrollit është miratuar pasi ka përfunduar kontrolli në DRT Elbasan.
Kriteri:	Manuali i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
Ndikimi/Efekti:	Tejkalimi i afateve dhe vijimi i procedurave pa miratim
Shkaku:	Mungesa e miratimit në kohë
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për koordinimin dhe miratimin në kohë nga niveli i duhur hierarkik të aktivitetit monitorues në DRT.

Titulli:	Ulje e performancës vjetore në kryerjen e kontrolleve me efekt në rritjen e numrit të kontrolleve të mbartura si dhe uljen e treguesve të zbulimit për vitin 2022.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se realizimi i kontrolleve të planifikuara për vitin 2022 është në masën 57.5 %, me një mosrealizim të planit të kontrolleve për vitin 2022 në masën 42.5 %. Ndikimin më të madh në mosrealizimin e planit të kontrolleve e kanë DRT Tiranë me 29.1 % kontrolle të realizuara, DRT Kukës me 31 % kontrolle të realizuara, DRT Sarandë me 57.6 % kontrolle të realizuara, DRT Fier me 57.7 % kontrolle të realizuara, DRT Elbasan me 60 % kontrolle të realizuara dhe DRT Korçë me 60.3% kontrolle të realizuara. Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2022 në lidhje me kontrollet e papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, stoku i kontrolleve vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84, ku nga të dhënat e paraqitura, gjendja e kontrolleve të pezulluara, të pafilluara ose në proces në vitin 2022 prej 1140 kontrolle është rritur në krahasim me vitin 2021 prej 671 kontrolle, me një rritje të lartë të numrit të kontrolleve të pafilluara. Konstatohet se drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rakordon gjendjen e kontrolleve në fund të vitit për ta përdorur si referim lidhur me planifikimet të cilat realizon për vitin pasardhës duke sjell vazhdimisht një numër të lartë të kontrolleve në proces ose të pafilluar në fund të vitit. Nga krahasimi i rezultateve të kontrolleve tatimore në raport me një vit më parë,

	konstatohet se zbulimi është 1.232 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 3.261 mijë lekë, pra kemi rënie të konsiderueshme të zbulimit për kontroll me 62 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
Kriteri:	Manuali I Drejtorisë së Kontrollit Tatimor. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84.
Ndikimi/Efekti:	Mbartje e kontrolleve të pafilluara/pezulluara/në proces dhe rënia e rezultateve të gjetjeve të kontrollit.
Shkaku:	Mos kryerja e rakordimeve me DRT, performancë e ulët e DRT-ve
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të implementohen procedura rakordimi me DRT me qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontrolleve sipas aktivitetit vjetor. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ngrihet grup pune për të analizuar shkaqet e performancës në rënie të zbulimeve nga kontrollet dhe të merren masa me qëllim përmirësimin e treguesve.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

- z. B.B., në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Standartizimit dhe Cilësisë.
- znj. M.R., në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit.
- z. O.C., në cilësinë e Përgjegjës të Kontrollit Tatimor (Për periudhën 01.01.2022-28.02.22).
- znj. I.D., në cilësinë e Përgjegjës të Kontrollit Tatimor (Për periudhën 28.02.22-31.12.22).
- z. B.H., në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor.
- z. C.K., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

2.6.5 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Drejtorja e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal, të kundërvajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

- Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore;
- Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:
 - a) mbledhjen e informacionit tatimor;
 - b) hetimin tatimor;
 - c) zbatimin e masave shtrënguese;
 - d) marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.

Punonjësit e hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Hetimi Tatimor është i organizuar në nivel qendror, në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si më poshtë:

- Sektori i Hetimit Tatimor;
- Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës;

a) Sektori i Hetimit Tatimor.

Sektori i Hetimit tatimor është pjesë funksionale e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, e cila është organizuar me një Drejtor të përqendruar në DPT.

Sektori i Hetimit Tatimor ushtron funksionet e tij në përputhje me dispozitat e nenit 105 “Struktura dhe funksionet e njërive të hetimit tatimor, Kreu XII “Hetimi Tatimor”, Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij. Inspektorët e hetimi janë ngarkuar gjithashtu dhe me ndjekjen dhe ezaurimin e praktikave të ardhura nga Rajonet.

Struktura e Hetimit tatimor është njësi e specializuar hetimi që ka si funksion parësor mbledhjen e informacioneve dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore lidhur me veprat penale në fushën e tatimeve. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Planet e punës dhe ngarkesa për çdo inspektor të Sektorit të Hetimit Tatimor në DPT.

Sektori Hetimit Tatimor harton planet e punës mujore, të cilat janë miratuara nga Drejtori i Hetimit Tatimore në DPT.

Tabela nr. 82 Planet e punës për vitin 2022.

Nr	Nr.Prot	Datë
1	3	10.01.2022
2	64	11.02.2022
3	140	10.03.2022
4	177	06.04.2022
5	244	06.05.2022
6	326	13.06.2022
7	369	08.07.2022
8	445	21.09.2022
9	446	21.09.2022
10	577	07.11.2022
11	651	05.12.2022

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga KLSH

Planet e punës të regjistruara në regjistrin e kartotekës janë konfidencial dhe dokumenta të klasifikuar, në dispozicion na janë vendosur vetëm protokollat e shkresave. Qarkullimi i **informacionit të klasifikuar** dhe dokumentacionit që ka lidhje me hetimin e veprave penale në fushën tatimore, bëhet duke zbatuar dispozitat e legjislationit të fushës në fuqi. Sektori Hetimit Tatimor në DPT ka **arkivin e të dhënave të klasifikuara**, me protokoll të veçantë me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor, referuar nenit 105.5.4 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Objektivat Strategjike të Drejtorisë për vitin 2022, shprehen bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën 2012-2024, në 3 shtylla kryesore për Drejtorinë e Hetimit Tatimor:

- Objektivi Nr.1 “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”.
- Objektivi Nr.2 “Zbatimi efikas i legjislationit tatimor dhe sigurimeve shoqërore dhe hetimi rasteve të mashtrimit tatimor”.
- Objektivi Nr.3 “Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore”.

Për çështjet e referuara në Prokurori, punonjësit Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të cilët gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, urdhërohen për të kryer veprime hetimore procedurale për dhe në emër të Prokurorit, në të gjitha ato raste që kryejnë referimin e veprave penale, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligj apo të vlerësuara ndryshe nga Prokurori. Nga këta inspektorë (O.P.G.J), me delegim ose urdhër të Prokurorit mund të hetohen edhe çështje të tjera, që nuk janë referuar prej tyre, por që kërkojnë kualifikim të veçantë, në fushën e tatimeve. Kryejnë një sërë veprimesh procedurale deleguar nga

Prokuroria. Në përfundim të hetimeve mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, në bazë të nenit 327/1 "Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit" të Kodit të Procedurës Penale, oficeri i policisë gjyqësore bën relacionin për përfundimin e hetimeve me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. Informacioni për veprimet dhe ngarkesën disponohet nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore. Punonjësit e Sektorit të Hetimit Tatimor gjatë vitit trajtojnë edhe kërkesa të adresuara në DHT, përcjellin propozimet për vlerësim të situatës financiare dhe kontroll tatimor, ndjekin apo kërkojnë informacion/materiale lidhur me çështjet në ndjekje etj, çështje të cilat pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

<i>Regjistri i Shkresave Hyrëse/Dalëse/Referuar/Arshivuar</i>	<i>Nr</i>
<i>Kërkesa të ndryshme</i>	<i>0</i>
<i>Propozimet për vlerësim të situatës financiare dhe kontroll tatimor</i>	<i>127</i>
<i>Referime</i>	<i>123</i>
<i>Arkivime</i>	<i>7</i>
<i>Ezaurim, Kthim Përgjigje, Dërgim Materiale, Relacione në Prokurori</i>	<i>580</i>
Total	837

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

• **Regjistri elektronik i Referimeve ne Prokurori Janar- Dhjetor 2022.**

Gjatë vitit 2022 Sektori i Hetimit Tatimor ka referuar në Prokurori vepra penale në fushën e tatimeve dhe taksave gjithsej 123 raste, në shumën totale të referuar prej 1,623,287,195 lekë, duke kërkuar fillimin e procedimit penal. Veprat penale të cilat janë referuar gjatë vitit 2022 të ndara sipas llojit dhe vlerave në dëm ekonomik për këto raste, nga Sektori i Hetimit i Drejtorisë se Hetimit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 83 Regjistri elektronik i Referimeve

<i>Nr</i>	<i>Vepra Penale</i>	<i>Neni i Kodit Penal</i>	<i>Viti 2022</i>	
			<i>Nr. Ref</i>	<i>Vlera</i>
<i>1</i>	<i>Krijimi i skemave mashtruese me Tvsh</i>	<i>144/a</i>	<i>4</i>	<i>436,248,896</i>
<i>2</i>	<i>Fshehje e të ardhurave</i>	<i>180</i>	<i>82</i>	<i>610,866,728</i>
<i>3</i>	<i>Mospagim taksash dhe tatimesh</i>	<i>181</i>	<i>32</i>	<i>433,334,880</i>
<i>4</i>	<i>Organizim i Lotarive të palejuara</i>	<i>197</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>5</i>	<i>Punësim i paligjshëm</i>	<i>170/a</i>	<i>1</i>	<i>0</i>
<i>6</i>	<i>Prishje e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare</i>	<i>182/a</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>7</i>	<i>Të tjera</i>		<i>4</i>	<i>143,426,691</i>
	Shuma		123	1,623,877,195

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- Referimi në Prokurori për veprën penale "**Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar**" parashikuar nga neni 144, gërma "a" e Kodit Penal, ku janë referuar 4 raste me vlerë të dyshuar 436,248,896 lekë.

- Referim në Prokurori për veprën penale "**Fshehja e të ardhurave**" parashikuar neni 180 i Kodit Penal, ku janë referuar 82 raste me vlerë të dyshuar 610,866,728 lekë.

- Referimi në Prokurori për veprën penale "**Mospagim taksash e tatimesh**" parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, ku janë referuar 32 raste me vlerë të dyshuar 433,334,880 lekë.

- Referimi në Prokurori për veprën penale për "**Vepra të tjera penale në fushën e tatim-taksave**" sipas parashikimeve të Kodit Penal, ku janë referuar 4 raste me vlerë të dyshuar 143,426,691 lekë

- Referim për 1 rast në Prokurori për veprën penale të "**Punësim i paligjshëm**" parashikuar nga neni 170, i Kodit Penal.

- **Informacion në lidhje me "Intervista e zhvilluara me subjektin" dhe rezultatet e nxjerra.**

Nga grupi i auditimit është kërkuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet postës elektronike informacion mbi **procedurat e zhvilluara me subjektin dhe rezultatet e nxjerra nga këto**, por nga ana e përfaqësuesve të Sektorit të Hetimit nuk na janë vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar me pretendimin se: “*Veprimet dhe dokumentacioni i administruar në kuadër të verifikimit në funksion të dokumentimit ligjor të shkeljeve tatimore dhe penale, grumbullimi dhe përpunimi sipas përcaktimeve ligjore i fakteve dhe provave që shërbejnë për fillimin e hetimeve penale, janë dokumente konfidencial apo të klasifikuara. Sektori i Hetimit Tatimor është në pamundësi objektive dhe ligjore të vendosë në dispozicion të audituesve të dhëna konkrete apo dokumentacion lidhur me çështje në hetim pasi çënohet parimi i ruajtjes të sekretit hetimor. Gjithashtu, e cituar edhe më sipër, një pjesë e konsiderueshme e veprimeve procedurale, përfshi edhe administrimin/dokumentimin e provave dhe deklaratave bëhet me kërkesës të organeve të Prokurorisë, struktura të cilat nuk janë subjekt i këtij auditimi”.*

- ***Tabelat Statistike se si është vepruar në lidhje me dosjet që kanë ardhur nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.***

Në lidhje me informacionet dhe rastet që kanë ardhur nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, rezulton se:

Tabela nr. 84 Tabela Statistike

<i>Përshkrimi/Raste</i>	<i>Viti 2022</i>
<i>Hetime Paraprake (Dosje)</i>	79
<i>Propozime për Vlerësim</i>	12
<i>Propozim për Kontroll</i>	4
<i>Kthim Përgjigje për Kompetencë</i>	38
<i>Arshivuar</i>	0
<i>Referuar</i>	41

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Për vitin 2022 korrespondenca me Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë në total 79 shkresa të cilat janë Kthim Përgjigje/Kalim shkresash për kompetencë/Kërkesa për bashkëpunim, nga ku rezulton se për 12 raste është propozuar për vlerësim tatimor, për 4 raste është propozuar për kontroll të thelluar dhe për 38 raste është kthyer përgjigje për mos kompetencë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e sektorit të hetimit tatimor, grupi i auditimit nuk ka konstatuar problematika në kryerjen e veprimtarisë së këtij sektori.

b) Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave (SPPP).

“Pastrimi i parave është procesi hetimit për fshehje ose maskimit të parave të pista të fituara nga aktivitete kriminale, të aseteve të fituara nga përdorimi i parave të pista dhe identitetit të pronarit përfitues”.

Qëllimi kryesor i punës së këtij Sektori, është parandalimi i fenomenit të pastrimit të parave në fushën e tatim taksave, duke përdorur veprimtarinë tregtare dhe marrja e masave administrative ose penale për këto raste. Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave është një Sektor në varësi të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, i cili përbëhet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Inspektorët.

Objektiv kryesor të punës Sektori, ka marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar, luftuar dhe zbuluar shkeljet administrative ose penale, që lidhen me Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Gjithashtu si synim është evidentimi i problematikave të ndryshme në lidhje me mosdeklarime të mundshme nga subjekte ose individë, të cilët kanë potencial të madh për tu përfshirë në deklarime të ndryshme sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Plani i punës dhe raportimi statistikor të Sektorit.

Planet e punës mujore dhe raportimet mbi ecurinë e tij si dhe analiza vjetore, janë miratuar nga Drejtori Drejtorisë së HT dhe Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave si pjese e Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin 2022 objektivat e punës i ka bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën 2022-2026, por ato janë dokumente të “klasifikuara” dhe si të tilla nuk bëhen të disponueshme për grupin e auditimit. Nga informacioni i kërkuar në rrugë zyrtare na janë vendosur në dispozicion statistikat në bazë mujore në lidhje me administrimin e shkresave të përpunuara nga SPPP, të cila po paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

<i>Përshkrimi</i>	<i>Total</i>
<i>Shkresa të thjeshta - Kërkesa të ndryshme</i>	<i>134</i>
<i>Propozime për vlerësim tatimor</i>	<i>13</i>
<i>Propozime për kontroll tatimor</i>	<i>23</i>
<i>Shkresa të klasifikuara</i>	<i>36</i>
<i>RAD</i>	<i>10</i>

Burimi: SPPP në DPT

1. Informacion mbi trajtimin e rasteve që kanë ardhura nga DPPP dhe urdhrat e punës për rastet e hetimit në vend.

Në lidhje me trajtimin e rasteve që kanë ardhura nga DPPP dhe urdhrat e punës për rastet e hetimit në vend, është kërkuar informacion në rrugë zyrtare dhe ka rezultuar se nuk ka pasur raste të ardhura nga DPPPP për vitin 2022, e për rrjedhojë nuk kanë dal urdhëra pune ose hetime në vend. Ndërkohë shkresa në trajtim dhe të marra nga institucione të tjera ligjzbatuese janë në total 134 praktika të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, ndërkohë rezulton se janë trajtuar/punuar 72 shkresa të klasifikuara “Sekret Shtetëror”.

2. Informacion në lidhje me praktikën e shqyrtuar dhe të përcjella në lidhje me RAD.

DHT e raporton në SPPP e cila bën ndërlidhjen (shërben si pikë kontakti) për DPPP për informacionet që vijnë në lidhje me Raportimin e Aktivitetit të Dyshimte (RAD), bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.16, datë 16.02.2009 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Terrorizmit”. Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave trajton RAD e ardhura nga Administratat Tatimore dhe pas analizimit e dërgon në DPPPP dhe nga auditimi rezulton se për vitin 2022 janë dërguar në total 10 raste RAD pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, shkresa të cilat janë të klasifikuara “Sekret Shtetëror”.

Tabela nr. 85 Subjektet referuar lidhur me raportimin RAD

Nr	Nr Prot Hyrës	Datë	Ardhur nga:	Nr prot dalës	Datë	Subjekti	Nipt
1	22788	13.01.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	94	24.02.2022	Q.N	L4.....2A
2	5815	12.04.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	138	10.03.2022	A. P.	L0.....1S
3	3643	03.03.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	138	10.03.2022	A. R. PF	L1.....2S
4	4572	18.03.2022	DRT Durrës	165	30.03.2022	E.T	K5.....2I
5	4572	18.03.2022	DRT Durrës	166	30.03.2022	V.I - 2	K4.....1U
6	6741	22.04.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	267	13.05.2022	K.A-2.	L1.....6L
7	10170	15.06.2022	DRT Fier	370	12.07.2022	E.	K5.....1Ë
8	12204/1	15.07.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	515	21.10.2022	N.	K3.....6S
9	1718/1	23.06.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	441	19.09.2022	K. A.	L8.....2O
10	2163/2	28.09.2022	Sektori i Hetimit Tatimor - DPT	515	21.10.2022	C. M.T 2	M1...3R

Burimi: Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve.

3. Informacion në lidhje me hetimin e OJF-ve ku ka dyshime të arsyeshme që kryejnë vepër penale në fushën e taksave.

Në lidhje me mbikëqyrjen e OJF-ve nga organet tatimore, bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.22, datë 19.11.2014 “Për Mbikëqyrjen e OJF-ve nga organet tatimore në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, SPPP nuk ka

hetime të nisura për OJF-ë, për të cilat ka dyshime të arsyeshme që kryejnë vepër penale në fushën e taksave.

4. Statistika mbi rastet që janë referuar në Prokurori.

Nga informacioni i marrë nga grupi i audituesve ky sektor për vitin 2022 nuk ka kaluar në sektorin e hetimit në DHT në DPT *subjekte/raste* me qëllim kallëzim penal në prokurori, për të cilët procedurat ligjore ndiqen nga struktura e kompetencës.

5. Informacion mbi rastet që janë kaluar në DRT për kontroll ose rikontroll tatimor dhe rezultatet që kanë dal nga kontrolli/rikontrolli.

Për vitin 2022 nga ana e Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave janë propozuar në total 23 raste për kontroll të thelluar, ndërkohë që raste për rikontroll nuk ka, për rastet e propozuara për kontroll të thelluar nuk ka rezultate pasi janë në proces nga DRT.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e sektorit parandalimit të pastrimit të parave (SPPP), grupi i auditimit nuk ka konstatuar problematika në kryerjen e veprimtarisë së këtij sektori.

c) Sektori i administrimit të informacionit dhe analizës

Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizes harton plane pune mujore të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i D.P.T, si në vijim:

Nr.Prot	Datë
266	12.05.2022
325	13.06.2022
368	08.07.2022
411	23.08.2022
439	13.09.2022
578	07.11.2022
652	05.12.2022

Nga auditimi rezulton se ky sektor ka administruar, ndjekur dhe kthyer përgjigje, për shkresat dhe kërkesat e ardhura në sektor, nga Institucione të ndryshme, Prokuroritë, SPAK, DPPSH, Gjykatat, Drejtoritë Vendore të Policisë, K.P.K, O.F.L, KLGJ, ILDKPKI, KJV, etj. Nga 1665 shkresa në total për vitin 2022 rezulton se:

- **613** shkresa janë të klasifikuara.
- **767** shkresa janë kërkesa për informacion, nga Prokuroritë, SPAK dhe DPPSH, DVP.
- **274** shkresa janë kërkesa për informacion, nga ILDKPKI, KPK, KLP, KLGJ, KJV dhe kthim përgjigje nga DRT-të, marrje në dijeni etj.
- **11** shkresa janë në ndjekje për verifikim dhe Analize Paraprake.

Sektori i administrimit të informacionit dhe analizës kryen gjithashtu dhe analiza paraprake për subjekte të dyshuara me shkelje të legjislacionit tatimor. Këto çështje trajtohen sipas informacioneve të ardhura nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në D.P.T dhe denoncime, ku për vitin 2022 rezultojnë të jenë trajtuar 22 raste, të detajuara si më poshtë:

- **10** nga denoncime dhe Akte Abuzive.
- **11** Memo nga informacione të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut në DPT.
- **1** rast për ndjekje nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

Nga të cilat;

- **3** çështje i janë kaluar Sektorit të Hetimit për ndjekje të metëjshme.

- 4 çështje i janë kaluar Drejtorive Rajonale Tatimore për vlerësim tatimor dhe kontroll të thelluar.
- 14 çështje janë në ndjekje dhe Analizë Paraprake.
- 1 çështje është mbyllur pas Analizës Paraprake.

Nga auditimi i evidencave për veprimtarinë të paraqitura nga ana e sektorit të hetimit tatimor, grupi i auditimit nuk ka konstatuar problematika në kryerjen e veprimtarisë së këtij sektori.

2.7. Auditim i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare.

Programimi i PBA 2022-2024 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2022

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe afatmesme 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimeve vjetore. Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore” (llog 600 & 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit. Llogaritja për shpenzime të tjera kapitale (llog 230-231) është bazuar në nevojat për investime të institucionit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2022-2024

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimi plotësues nr. 4010 prot., datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024” të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, si dhe të Aktit Normativ nr.190. datë 03.03.2021 është dërguar shkresa për PBA faza I-rë nr. 9241/1 prot., datë 27.05.2021.

Tabela nr. 86 Faza e parë e PBA-së 2022-2024

Në mijë lekë

Faza e I e PBA-së 2022-2024 për vitin 2022			
Llog	Emërtimi	Vlera sipas tavanit	Kërkesa shtesë
600	Paga	1,420,000	
601	Sigurime Shoqërore	250,000	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,277,640	318,000
605	Transferta Korrente të Huaja	2,360	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		
I	Shpenzime Korrente	2,900,000	318,000
230	Kapitale të Patrupëzuara	7,000	
231	Kapitale të Trupëzuara	276,000	532,416
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm		
230	Kapitale të Patrupëzuara		
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj		
II	Shpenzime Kapitale	283,000	532,416

I+II Totali I Shpenzimeve	3,183,000	850,416
----------------------------------	------------------	----------------

Burimi: nga të dhënat e DPT

Tabela nr.87 Totali i kërkesave sipas politikave ekzistuese për këtë fazë për DPT për projektet e investimit.

Në mijë lekë

Nr.	Produkti	2022	2023	2024
18AV801	Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike		30,000	50,000
18AV02	Paisje zyre	-	53,000	33,000
91004	Tatimpagues të asistuar	283,000	-	-
	Totali	283,000	83,000	83,000

Burimi: nga të dhënat e DPT

Totali i kërkesave sipas politikave të reja në këtë fazë e parë të PBA 2022-2024 për DPT për projektet e investimit rezultojnë si më poshtë:

Tabela nr. 88 Kërkesat buxhetore sipas politikave të reja PBA 2022-2024

Në mijë lekë

Nr.	Produkti	2022	2023	2024
18AV801	Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike		45,000	45,000
91004AA	Tatimpagues të asistuar	283,000	-	-
18AV811	Ngritja e sistemit per shkembim informacioni financiar me entet e huaja	14,930	14,930	14,930
M100446	Rikonstruksion DPT	60,000	60,000	60,000
18AV902	Rikonstruksion DRT dhe DTM	120,000	60,000	60,000
18AV906	Rikonstruksion DR Fier	132,000	66,000	66,000
18AV904	Rikonstruksion DR Diber	40,000	20,000	20,000
18AV903	Rikonstruksion DR Durres	2,446	1,223	1,223
18AV905	Rikonstruksion DR Gjirokaster	40,000	20,000	20,000
	Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektoret DPT	61,520	61,520	-
	Marrje informacioni per inventaret e tatimpaguesve	61,520	61,520	-
	Totali	815,416	380,193	257,153

Burimi: nga të dhënat e DPT

Planifikimi në fazën e II-të të PBA 2021-2023

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2022-2024, janë miratuar me VKM nr. 440 datë 22.07.2021 "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për PBA-së 2022-2024", në nivel programi. Totali i shpenzimeve për DPT për këtë fazë të PBA-së është përcaktuar në vlerën 3,183,000 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente në vlerën 2,900,000 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 283,000 mijë lekë. Në vijim, DPT ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesat buxhetore për periudhën 2022-2024 me shkresën nr. 15927, prot datë 31.08.2021.

Detajimi i buxhetit në nivel llogarie për fazën e II-të të PBA-së 2022-2024, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.89 Faza e dyte e PBA-së 2022-2024 për vitin 2022

Në mijë lekë

Faza e II e PBA-së 2022-2024 për vitin 2022			
Llog	Emërtimi	Vlera sipas tavanit	Kërkesa shtesë
600	Paga	1,480,000	
601	Sigurime Shoqërore	250,000	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,167,512	
605	Transferta Korrente të Huaja	2,104	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	384	
I	Shpenzime Korrente	2,900,000	

230	Kapitale të Patrupëzuara	7,000	
231	Kapitale të Trupëzuara	276,000	477,079
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm		
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	
II	Shpenzime Kapitale	283,000	477,079
I+II	Totali I Shpenzimeve	3,183,000	477,079

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Totali i kërkesave për projektet e investimit brenda tavanëve për këtë fazë rezultojnë si më poshtë:

Tabela nr.90 Kërkesat buxhetore për projektet e investimit

Në mijë lekë

Projekt Investimi	2022	2023	2024
	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
18AV806 - Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	44,300	-	-
18AV811 - Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja	41,340	-	-
Hapesira hardërike kapacitetin e serverave	48,400	37,682	-
Rikonstruksion Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane dhe Drejtoria e Tatimpaguesve te Medhenj	30,000	-	-
M100255 - Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020	7,000	7,000	7,000
M100024 - Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike	-	-	43,000
18AV802 - Paisje zyre	18,136	-	33,000
M100446 - Rikonstruksion DPT	20,000	-	-
Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektorët DPT	36,912	19,159	-
Marrje informacioni per inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administrates tatimore	36,912	19,159	-
Totali	283,000	83,000	83,000

Burimi: nga të dhënat e DPT

Totali i kërkesave shtesë në këtë fazë përfundimtare të PBA 2022-2024 për DPT për projektet e investimit rezultojnë në vlerën 477,079 mijë lekë i detajuar sipas si më poshtë :

- “Pajisje elektronike kompjuter” me një kërkesë shtesë prej 15,000 mijë lekë;
- “Rikonstruksion DPT” me një kërkesë shtesë prej 20,000 mijë lekë;
- “Rikonstruksion DRT Tiranë dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj” me një kërkesë shtesë prej 60,000 mijë lekë;
- “Rikonstruksion DRT Fier” me një kërkesë shtesë prej 66,000 mijë lekë;
- “Rikonstruksion DRT Dibër” me një kërkesë shtesë prej 15,000 mijë lekë;
- “Rikonstruksion DRT Shkodër” me një kërkesë shtesë prej 4,000 mijë lekë;
- “Rikonstruksion DRT Durrës” me një kërkesë shtesë prej 1,223 mijë lekë;
- “Automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët DPT”, me një kërkesë shtesë prej 69,969 mijë lekë;
- “Marrja e informacionit për inventarët e tatimpaguesve nga sistemi AT” me një kërkesë shtesë prej 69,969 mijë lekë.
- “Hapësira Harduerike kapaciteti i serverëve”, me një kërkesë shtesë prej 155,917 mijë lekë.

Me urdhrin e brendshëm nga NA, Urdhri nr. 11, datë 31.1.2022 është ngritur grupi i menaxhimit Strategjik.(GMS). Nga auditimi i dokumenteve u konstatua se gjatë vitit 2022 nuk është mbledhur asnjëherë grupi i GMS, si komponent kyç i organizimit institucional për të diskutuar mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore në lidhje me programet përkatëse, në

shkelje të Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i unifikuar si edhe në mosplotësim të përgjegjësive të NA në rolin e koordinatorit të GMS të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”. Procesi i përgatitjes së kërkesave buxhetore në lidhje me informacionin financiar dhe kostimin e produkteve si dhe plotësimin e formateve të PBA 2022-2024 është bërë nga NZ, në rolin e sekretarit të GMS në përmbushje të përgjegjësive të parashikuara në Udhëzimin nr.7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.7 “Përgjegjësitë e Nëpunësit Zbatues”. Planifikimi për programet buxhetore është përcjelle në formë elektronike ndërmjet NZ dhe grupit GMS. Kjo situatë ka impaktuar në planifikim jo të saktë të kërkesat buxhetore për shpenzimet kapitale. Nga krahasimi i listës së investimeve të programuara përgjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2022, konstatohet se projekti i investimit me kod 18AV812 “Hapësira harduerike kapacitetin e serverëve”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2022-2024 dhe vlera e likuidimit për këtë projekt është planifikuar 80,000 mijë lekë, nga 382,965 mijë lekë e planifikuar në kontratë, pra 302,965 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA. Projekti me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E-taxation” nuk është planifikuar në PBA 2022-2021, sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Pavarësisht se në përbërjen grupit të GMS është një anëtar edhe nga Drejtoria TIK nuk janë mirë planifikuar projektet e investimit për sistemet e IT-së.

Titulli i gjetjes	Mangësi në procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.
Situata:	Gjatë vitit 2022 nuk është mbledhur asnjëherë Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), strukturë kyçe e organizimit institucional për të diskutuar dhe marrë vendime mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore në lidhje me programet përkatëse, në shkelje të Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si edhe në mungesë të ushtrimit të përgjegjësive të NA në rolin e koordinatorit të GMS të përcaktuara në Udhëzimin nr.7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”. U konstatua se një projekt i programit ka ndryshuar në vlerë nga një fazë në tjetrën. Projekti i investimit me kod 18AV812 “Hapësira harduerike kapacitetin e serverëve”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2022-2024 dhe vlera e likuidimit për këtë projekt është planifikuar 80,000 mijë lekë, nga 382,965 mijë lekë e planifikuar në kontratë, pra 302,965 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA II. Gjithashtu një projekt i rëndësie të lartë me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” nuk është planifikuar në PBA 2022-2024. Sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mungesën e funksionimit të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore.
Kriteri:	Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i unifikuar si edhe në mosplotësim të përgjegjësive të NA në rolin e koordinatorit të GMS të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”.
Ndikimi:	Projekti i investimit me kod 18AV812 “Hapësira harduerike kapacitetin e serverëve”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2022-2024 dhe vlera e likuidimit për këtë projekt është planifikuar 80,000 mijë lekë, nga 382,965 mijë

	lekë e planifikuar në kontratë, pra 302,965 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA II. Gjithashtu një projekt i rëndësie të lartë Projekti me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” nuk është planifikuar në programin buxhetor të vitit 2022.
Shkaku	Grupi i menaxhimit strategjik nuk është mbledhur asnjëherë gjatë vitit 2022 për të diskutuar për përgatitjen e kërkesave buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nëpunësi Autorizues i DPT në rolin e koordinatorit të GMS të marrë masa për koordinimin, realizimin dhe monitorimin e procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet dhe objektivat e politikës së programit.

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. C.K. me detyrë Nëpunës Autorizues i DPT në rolin e koordinatorit të GMS dhe Znj. D.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxheti në rolin e sekretarit të GMS.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2022

Në zbatim të Ligjit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente për programin Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore të menaxhuar nga Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve është përcjellë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 484 prot., datë 13.01.2022; për shpenzimet kapitale me shkresën nr. 2298 prot., datë 14.2.2022 të MFE.

Ky buxhet paraqitet për vitin 2022 në vlerën 2,892,640 mijë lekë, nga të cilat:

-Shpenzime Korrente në vlerën totale **2,550,000 mijë lekë**;

Në nivel artikujsh, shpenzimet korrente janë përcaktuar si më poshtë:

Llogaria 600 “Paga dhe shtesa” në vlerën 1,420,000 mijë lekë;

Llogaria 601 “Sigurime shoqërore” në vlerën 250,000 mijë lekë;

Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në vlerën 877,512 mijë lekë;

Llogaria 605 “Transferata të jashtme” në vlerën 2,104 mijë lekë.

Llogaria 606 “Trans per Buxh. Fam. & Individ” në vlerën 384 mijë lekë.

-Shpenzime Kapitale në vlerën totale **342,640 mijë lekë**.

Në nivel projektsh, shpenzimet kapitale në vlerën 342,640 mijë lekë janë përcaktuar në çelje sipas shkresës nr. 2298, datë 14.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT trajtuar si më poshtë.

Tabela nr.91 Fondet e alokuara sipas projekteve

Në mijë lekë

Nr.	Llog. Eko	Kodi	Projekti	Vlera
1	231	18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	44,300
2	231	18AV811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja	41,340
3	231	18AV812	Hapesira hardëarike kapacitetin e serverave	80,000
4	231	18AV904	Rikonstruksion Drejtoria rajonale Diber	10,999
5	231	18AV906	Rikonstruksion(Shtese kati) Drejtoria rajonale Fier	30,000
6	231	18AV905	Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan	10,000
7	230	M100255	Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020	7,000
8	231	M100024	Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike	40,000
9	231	18AV802	Paisje zyre	15,000
10	231	M100446	Rikonstruksion DPT	20,000
11	231	18AV813	Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektorët per Drejtorinë e Përgjithshme te Tatimeve	22,000
12	231	18AV812	Marrje informacioni per inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administrates tatimore	22,000

Totali	342,640
---------------	----------------

Burimi: nga të dhënat e DPT

Detajimi i “Fondit të Veçantë” vetëm për aparatën e DPT në vlerën 384 mijë lekë, në llogarinë 606 “Transferta të buxheteve familjarë & individë” është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22922/136 prot., datë 21.01.2022, “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022”. Me shkresë nr. 300/31 08.02.2022 është shtuar vlera 3,200,000 lekë, pra vlera totale e llogarisë 606 bëhet në vlerën 3,584,000 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas tavaneve të miratuara, shpenzimet buxhetore të programit “**Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**”, faza I e PBA-së, faza II e PBA-së si dhe vlerat e miratuara në zbatim të Ligjit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” (plani fillestar), në formë tabele paraqiten si vijon:

Tabela nr.92 Fondi i miratuar sipas llogarive ekonomike

Në mijë lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Fondi i miratuar me ligjin e buxhetit “Për buxhetin e vitit 2022” (Plani fillestar)
600	Paga	1,274,770	1,420,000	1,480,000	1,420,000
601	Sigurime Shoqërore	216,540	250,000	250,000	250,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,002,796	1,277,640	1,167,512	877,512
605	Transferta Korente të Huaja	2,510	2,360	2,104	2,104
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,652		384	3,584
I	Shpenzime Korrente	2,500,268	2,900,000	2,900,000	2,550,000
230	Kapitale të Patrupëzuara		7,000	7,000	7,000
231	Kapitale të Trupëzuara	30,000	276,000	276,000	335,640
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	30,000			
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	30,000	283,000	283,000	342,640
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
I+II +III	Totali i Shpenzimeve	2,530,268	3,183,000	3,183,000	2,892,640

Burimi: të dhënat nga DPT

Nga auditimi konstatohet se shpenzimet korrente për fazën I, fazën II të PBA nuk kanë ndryshime. Pas daljes së ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, programimi i këtyre shpenzimeve ka ndryshuar nga PBA që ishte parashikuar në vlerën 2,900,000 mijë , në 2,550,000 mijë në çeljen e buxhetit pra me një zvogëlim buxheti afërsisht në masën 350,000 mijë lekë. Shpenzime kapitale të trupëzuara kanë ndryshime të konsiderueshme midis vlerës së planifikuar në fazën e parë të PBA-së 2022-2024 dhe vlerës së planifikuar për këto zëra në buxhetin vjetor me miratimin e ligjit “Për buxhetin 2022”. Në fazën e parë të PBA-së 2022-2024 këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 283,000 mijë lekë, ndërsa vlera e miratuar në buxhetin vjetor është 342,640 mijë lekë. Ndryshimi i tavaneve buxhetore nga planifikimi i PBA në çeljen e buxhetit është me një rritje fondi në vlerë 59,640 mijë lekë ose afërsisht 21% më shumë se vlera e planifikuar në PBA.

Ndryshimet e planit të buxhetit përgjatë vitit 2022

Duke u nisur nga buxheti fillestar sipas ligjit nr. Nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshimet e planit të buxhetit janë në zbatim të:

- Aktit Normativ Nr.3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Aktit Normativ Nr.12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Aktit Normativ Nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;

-Aktit Normativ Nr.19, datë 29.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”,

-VKM nr.225, datë 13.04.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë”.

-VKM nr.569 datë 25.08.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës së kompensimit për shoqëritë e transportit të linjave qytetase, rreth qytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë, faza II”.Konkretisht janë trajtuar llogarite e prekura nga ndryshimet e mësipërme:

- edhe kërkesat për rialokim fondi gjatë vitit 2022 nga strukturat përgjegjëse ne DPT.

Për shpenzimet korrente

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, është përcjellë shkresa nr. 4934/122, prot., datë 06.04.2022 e MFE, , nëpërmjet të cilës janë miratuar ndryshime në shpenzimet korrente të disa institucioneve buxhetore. Efekti për DPT ka qenë pakësim i fondeve në vlerën 143,001 mijë lekë. Konkretisht për aparatin e DPT llogaria ekonomike 602 është pakësuar në vlerën 62,251 mijë lekë dhe për disa Drejtori rajonale është pakësuar llogaria 600 në vlerën 26,500 mijë lekë si edhe llogaria 601 në vlerën 8,250 mijë lekë gjithashtu është pakësuar edhe llogaria 46,000 mijë lekë .

Tabela nr.93 Fondi i ndryshuar sipas llogarive ekonomike

Në mijë lekë

Institucioni	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
<i>Pakësohet</i>			
Aparati i DPT	602	91004AA	37,751
Aparati i DPT	602	91004AB	14,500
Aparati i DPT	602	91004AC	10,000
DRT Tiranë	601	91004AA	1250
DRT Tiranë	602	91004AA	7,000
DRT Diber	600	91004AA	2,000
DRT Diber	601	91004AA	500
DRT Diber	602	91004AA	1,000
DRT Berat	600	91004AA	3,000
DRT Durres	600	91004AA	5,000
DRT Durres	601	91004AA	2,000
DRT Durres	602	91004AA	3,000
DRT Elbasan	600	91004AA	3,000
DRT Elbasan	601	91004AA	500
DRT Fier	602	91004AA	10,000
DRT Fier	600	91004AA	1,000
DRT Fier	601	91004AA	3,000
DRT Korce	602	91004AA	1,500
DRT Kukes	600	91004AA	3,000
DRT Kukes	602	91004AA	2,000
DRT Lezhe	602	91004AA	3,000
DRT Sarande	602	91004AA	1,5000
DRT Shkoder	600	91004AA	9,500
DRT Shkoder	601	91004AA	1,000
DRT Shkoder	602	91004AA	1,500
DRT Vlore	602	91004AA	2,000
Total			143,001

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Tabela nr.94 Fondet e shpenzimeve korrente për llog. 600

Në lekë

Drejtorite	Plani Fillestar	Pakësuar	Plani i rishikuar
DR	1,132,000,000	122,207,528	1,009,792,472
DPT Aparati	288,000,000	15,775,000	272,225,000
TOTALI	1,420,000,000	137,982,500	1,282,017,500

Burim : të dhënat nga DPT

Tabela nr.95 Ndryshimet nga plani fillestar për llogarinë 601

Në lekë

Drejtorite	Plani Fillestar	Pakësuar	Plani i rishikuar
DR	188,000,000	21,638,475	167,890,000
DPT Aparati	57,000,000	11,990,000	45,010,000
TOTALI	250,000,000	37,100,000	212,900,000

Burim : të dhënat nga DPT

Tabela nr.96 Ndryshimet për llogarinë 602 nga plani fillestar

Në lekë

Drejtorite	Plani Fillestar	Shtuar	Pakësuar	Plani i rishikuar
DR.	82,900,000	4,601,000	6,001,000	81,500,000
DPT Aparati	795,012,000	522,181,300		1,317,193,300
TOTALI	877,912,000	526,782,300	6,001,000	1,398,693,300

Burim : të dhënat nga DPT

Fondet e shpenzimeve korrente llog.604:

Me anë të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 7377/5 prot., datë 27.06.2022, protokolluar me nr. 10952 prot., datë 28.06.2022, është dërguar shkresa me nr.7377/2 prot., datë 28.04.2022, së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mbi akordimin e fondeve për vitin 2022, “Mbi zbatimin e VKM nr.225, datë 13.04.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë”. Sipas kësaj VKM-je kompensimi i shoqërive të transportit jepet në masën 100 (njëqind) lekë për litër karburant për periudhën tremujore, mars, prill, maj 2022 por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë e vitit 2021. Në zbatim të VKM nr.225 me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, Urdhri nr.47, datë 27.04.2022 është ngritur grupi i punës në DPT me qëllimin koordinimin e veprimeve dhe zbatimin me korrektësi të vkm-së. Përbërja e grupit të punës :

Tabela nr.97 Anëtarët e grupit të punës

Anëtarët	Drejtoria ne DPT
I F	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
B A	Drejtoria e Manaxhitmit të Riskut
J Sh	Drejtoria Teknike dhe Ligjore
A D	Drejtoria për Proceset e Biznesit

Në këtë urdhër përcaktohet që cdo DRT do të organizojë punën për trajtimin e kërkesave të ardhura nga shoqëritë e transportit. Verifikimi i kërkesave nga DRT duhet të mbyllet brenda (pesë) ditëve pune nga data e kërkesës, më pas informacioni përcillet menjëherë në formë shkresore ose elektronike pranë grupit të punës në DPT. Grupi i punës në DPT brenda 5 (pesë) ditëve verifikon me përzgjedhje saktësinë e procedurës së ndjekur nga DRT dhe rregullsinë e trajnimit të kërkesave. Grupi i punës harton listën përmbledhëse të subjekteve përfituese dhe ja dërgon Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për çdo listë përmbledhëse përgatit një urdhër- shpenzim të ndarë për çdo bankë të nivelit të dytë ku përfituesi ka llogarinë bankare, të cilin ia paraqet Drejtorisë Rajonale të thesarit për ekzekutim. Sipas VKM nr. 225, datë 13.04.2022, pika 5 përcakton afatin e dërgimit në DR e thesarit urdhër-shpenzimet, citohet “*Administrata tatimore pas verifikimit të dokumentacionit dërgon pranë degës përkatëse të thesarit brenda 15 ditëve pune urdhër-shpenzimet duke bashkëlidhur listën përmbledhëse të subjekteve përfituese sipas bankave të nivelit të dytë*”. Grupi i punës ka dërguar tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me datë 22.09.2022 raportin përmbledhës për të gjithë procesin sipas VKM-së nr.225, datë 13.04.2022. Grupi i punës ka verifikuar me përzgjedhje 90 % të kërkesave të sjella nga DRT.

Me fondet e kaluara nga VKM nr.225, datë 13.04.2022 janë paguar 168 subjekte me vlerë totale 262,367,693 lekë, fondet e mbetura janë në vlerën 167,623,307 lekë. Nga kontrolli i dokumenteve të vëna në dispozicion rezultoi se Administrata tatimore ka dërguar dokumentacionin për këto subjekte përfitues pranë degës së thesarit për ekzekutim brënda afatit 15 ditorë. Nga auditimi u zgjodh një kampion afërsisht 10 % e total kërkesave të verifikuara nga grupi i punës. Këto praktika rezultuan pa probleme, përmbanin të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriterët e përcaktuara në VKM nr. 225 si edhe sasia e litrave të rimbursuara për tre mujorin rezultoi në përputhje me kriterin e VKM nr. 225, datë 13.04.2022. *(Sipas kësaj vkm kompensimi i shoqërive të transportit është në masën 100 (njëqind) lekë për litër karburant për periudhën tremujore, mars,prill,maj 2022 por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë e vitit 2021).*

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19973/3 prot., datë 16.12.2022, protokolluar me nr. 21205 prot., datë 19.12.2022, është dërguar shkresa me nr. 19793/2 prot., datë 25.08.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mbi akordimin e fondeve për vitin 2022, “Mbi zbatimin e VKM nr.569, datë 25.08.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë, faza II” në vlerën 120,000,000 lekë. Sipas kësaj vkm kompensimi i shoqërive të transportit është në masën 100 (njëqind) lekë për litër karburant për periudhën tremujore gusht, shtator, tetor 2022, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë e vitit 2021. Fondi në total në dispozicion për këtë fazë është 287,623,306 lekë (167,623,306 lekë fondi i mbetur nga VKM nr. 225 + 120,000,000 lekë nga VKM nr, 569). Në zbatim të vkm-së me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, Urdhri nr. 118, datë 12.09.2022 është ngritur grupi i punës me qëllimin koordinimin e veprimeve dhe zbatimin me korrektësi të VKM-së nr. 569. Në këtë urdhër thuhet që çdo DRT do të organizojë punën për trajtimin e kërkesave të ardhura nga shoqëritë e transportit dhe verifikimin e tyre brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kërkesës , më pas informacioni përcillet menjëherë tek grupi i punës në DPT në rrugë elektronike dhe shkresore. Në këtë urdhër është përcaktuar procedura që do të ndiqet nga grupi i punës i njëjtë me grupin e mësipërm.

Grupi i punës ka dërguar tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me datë 10.01.2023 raportin përmbledhës për të gjithë procesin sipas VKM-së nr.569. Grupi i punës ka verifikuar me përzgjedhje 70 % të kërkesave të sjella nga DRT. Me totalin e fondeve në dispozicion 287,623,307 lekë (120,000,000+167,623,307) janë kompensuar 232 subjekte me vlerë totale 286,733,276 lekë, mbetën pa përdorur 890,031 lekë. Gjendja e llogarisë 604 në fund të vitit 2022 rakordon me akt rakordimin vjetor në thesar. Nga auditimi i të dhënave në dispozicion i rezulton se Administrata tatimore ka dërguar dokumentacionin për këto subjekte përfitues pranë degës së thesarit për ekzekutim brënda afatit 15 ditorë. Nga auditimi u zgjodh një kampion afërsisht 15 % të total kërkesave të verifikuara nga grupi i punës. Këto praktika rezultuan pa probleme, përmbanin të gjithë dokumentacionin në përputhje me kërkesat e vkm si edhe sasia e litrave të rimbursuara për të tre muajt ishte në përputhje me kriterin e VKM nr. 569, datë 25.08.2022. *(Sipas kësaj vkm kompensimi i shoqërive të transportit është në masën 100 (njëqind) lekë për litër karburant për periudhën tremujore, gusht,shtator,tetor 2022 por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë e vitit 2021).*

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka dërguar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me anë të shkresës nr.233 prot., datë 9.1.2023 raportin mbi zbatimin e VKM nr. 569 datë 25.08.2022.

Në lekë

Kodi inst.	Institucioni	Llog ekono.	Emri produktit	VKM	Debiti	Paguar	Nr. Subjekte perfitues
1010039	DPT	6040000	Kompensim për shoqëritë e transportit	Nr. 225, 12.04.2022	430,000,000	262,376,693	168
1010039	DPT	6040000	Kompensim për shoqëritë e transportit	Nr. 569, 25.08.2022	287,623,307	286,733,276	232

				120,000,000			
	TOTALI				550,000,000	549,109,969	400

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Nga auditimi i dokumenteve dhe i të dhënave u konstatua se janë shpenzuar 3,250,300 lekë më shumë se fondi në dispozicion i planifikuar për tu shpenzuar për kompensimin e shoqërive të transportit. Janë kompensuar dy shoqëri transporti me vlerë totale 3,250,300 lekë, jo nga fondi i kaluar në llogarinë 604 me kod projekti 91004AE “Kompensim për shoqëritë e linjave të transportit “ sipas përcaktimeve të VKM nr. 225, datë 13.04.2022 dhe VKM nr. 569, datë 25.08.2022. Konstatohet se me urdhër shpenzimi nr.1421, datë 30.12.2022 nga llogaria 6027900, aprovuar nga thesari datë 26.01.2023 është kaluar fondi në vlerën 1,555,100 lekë në llogarinë e subjektit përfitues. Me urdhër shpenzimin nr. 1422, datë 30.12.2022 nga llogaria 6027900, aprovuar nga thesari datë 26.01.2023 është kaluar fondi në vlerën 1,695,200 lekë në llogarinë e subjektit përfitues. Më hollësisht trajtuar më poshtë:

Në adresën elektronike të grupit të punës në datë 23.01.2023 është dërguar kërkesa për kompensim karburanti për këto shoqëri transporti së bashku me praktiken e plotë nga DRT Tiranë me justifikimin se kërkesat janë dërguar në DRT brenda afatit, por punonjësi përgjegjës ka qenë me leje dhe nuk u dërgua në afat kërkesa për kompensim në DPT. Kërkesat për kompensim nga shoqëritë janë dërguar në DRT para datës 1 dhjetor 2022, në respektim të afatit të përcaktuar në VKM. Grupi i punës në DPT në datë 25.01.2023 ka përcjelle në formë elektronike këtë kërkesë për kompensim pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në DPT. Drejtoria DFB në DPT ka realizuar këtë kompensim për shoqëritë e transportit sipas shkresës nr.926/1 prot., datë 26.01.2023, është dërguar nga MFE në DPT transferimi i fondeve buxhetore për vitin 2022 ku Shtohet Aparati i DPT në llogarinë 602, me kod projekti 91001AE në vlerën 148,000,000 lekë dhe pakësohet Aparati i MFE me vlerën 148,000,000 lekë. Vlera prej 148,000,000 lekë rakordon edhe me llogarinë 602 të pasqyruar në akt-rakordimin me thesarin në fund të vitit 2022. Këto fonde me konfirmim elektronik paraparak nga MFE janë përdorur për të likuiduar detyrimin e prapambetur ndaj shtypshkronjave dhe për të kompensuar shoqëritë e transportit. Sipas akt-rakordimit me thesarin llogaria ekonomike 602 është pakësuar me 3,250,300 lekë paguar për kompensim shoqëritë e transportit. Konstatohet se nuk është vepruar sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 569 25.08.2022 dhe Urdhrin nr.118, datë 12.09.2022 , pasi kërkesa për rimbursim është në shkelje të afateve të përcaktuara në Urdhrin nr.118, datë 12.09.2022, pikës 3 “Verifikimi duhet të mbyllet në DRT brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kërkesës dhe të përcillet në DPT..” dhe pika 4 “Grupi i punës brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja e dokumentit harton dokumentin përmbledhës..”. Konstatohet se urdhër-shpenzimi nr. 1422, datë 30.12.2022 dhe urdhër-shpenzimin nr.1421, datë 30.12.2022 për kompensim shoqëritë e transportit nuk është bërë sipas përcaktimeve të VKM nr. 569, 25.08.2022, pika 5, si edhe në kundërshtim me ligjin nr. 115/2021 buxhetit vjetor 2022.

Titulli i gjetjes	Kryerja e shpenzimeve mbi fondin e kontigjences të akorduar për kompensimin e shoqërive të transportit.
Situata:	Nga auditimi rezulton se janë shpenzuar 3,250,300 lekë më shumë se fondi i akorduar për t’u shpenzuar për kompensimin e shoqërive të transportit me VKM nr. 225, datë 13.04.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë” dhe VKM nr. 569, datë 25.08.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë faza II”. Janë kompensuar dy shoqëri transporti me vlerë

	<p>totale 3,250,300 lekë, jo nga fondi i kaluar në llogarinë 604 me kod projekti 91004AE “Kompensim për shoqëritë e linjave të transportit” sipas përcaktimeve të VKM nr. 225, datë 13.04.2022 dhe VKM nr. 569, datë 25.08.2022. Në adresën elektronike të grupit të punës në DPT në datë 23.01.2023 është dërguar kërkesa për kompensim karburanti për këto shoqëri transporti së bashku me praktiken e plotë nga DRT Tiranë me justifikimin se kërkesat janë dërguar në DRT brenda afatit, por punonjësi përgjegjës ka qenë me leje dhe nuk u dërgua në afat kërkesa për kompensim në DPT. Grupi i punës në DPT në datë 25.01.2023 ka përcjelle në formë elektronike këtë kërkesë për kompensim pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në DPT. Konstatohet se me urdhër shpenzimi nr.1421, datë 30.12.2022 nga llogaria 6027900, aprovuar nga drejtoria rajonale e thesarit datë 26.01.2023 është kaluar fondi në vlerën 1,555,100 lekë në llogarinë e subjektit përfitues. Me urdhër shpenzimin nr. 1422, datë 30.12.2022 nga llogaria 6027900, aprovuar nga drejtoria rajonale e thesarit datë 26.01.2023 është kaluar fondi në vlerën 1,695,200 lekë në llogarinë e subjektit përfitues. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 569, datë 25.08.2022 kreu II pika 5 dhe kreu III pika 1 dhe Urdhrit nr.118, datë 12.09.2022, pika 3 ku përcaktohet “Verifikimi duhet të mbyllet në DRT brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kërkesës dhe të përcillet në DPT..” dhe pika 4 “Grupi i punës brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja e dokumentit harton dokumentin përmbledhës..”.</p>
Kriteri:	VKM nr. 569, datë 25.08.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë, faza II”, kreu II pika 5 dhe kreu III pika 1. Urdhri nr.118, datë 12.09.2022 , pika 3. Ligjin nr. 115/2021 buxhetit vjetor 2022.
Ndikimi:	Tejkalim i planit të shpenzimeve.
Shkaku	Mos kryerje në kohë e procedurës për kompensimin për shoqëritë e transportit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga DPT të merren masa për përcaktimin e përgjegjësive për mos reflektimin në kohë të kërkesave për kompensim në mënyrë që të gjithë pretendimet e subjekteve të reflektohen në kohë në drejtim të kërkesave buxhetore të rishikuara, duke marrë miratimin nga autoritetet përkatëse.

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z.C.K. me detyrë Nënpunës Autorizues dhe Znj. Sh.N. me detyrë Inspektor në DRT Tiranë, anëtarët e grupit të punës në DPT dhe Znj. D.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtarë të auditimit nga subjekti i audituar DPT është paraqitur observacioni me shkresë nr. 284/8 prot., me datë 06.09.2023 të cilat shkurtimisht po i paraqesim si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në zbatim të VKM-së nr.569, datë 25.08.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë, Faza II”, Drejtoria e Financës dhe buxhetit ka ekzekutuar me rigorozitet çdo kompensim të përcjellë në mënyrë elektronike nga adresa e Grupit të Punës, duke dërguar në degën e thesarit brenda 15 ditëve pune urdhër-shpenzimin dhe listën përmbledhëse të subjekteve përfituese. Me anë të shkresave të përcjella në vazhdimësi, përkatësisht shkresa me nr.18427 prot., datë 28.10.2022 dhe shkresa me nr.233/1 prot., datë 09.01.2023 është raportuar te Grupi

i Punës dhe me shkresën nr.233 prot., datë 09.01.2023 është raportuar të Drejtori i Përgjithshëm për fondet e përdorura si dhe fondet e mbetura nga buxheti i akorduar për këtë Paketë Antikrizë. Në pamjaftueshmëri të fondeve për kompensim me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.19973/3 prot., datë 16.12.2022, është dërguar shtesa e fondit për zbatimin e VKM-së nr.569, në vlerën 120.000.000 lekë. Përpara përfundimit të afatit të VKM-së DFB ka kërkuar në mënyrë elektronike që të gjitha kërkesat dhe praktikat të përcilleshin brenda datës 23.12.2022 për të zbatuar me rregullsi dhe përfunduar të gjitha veprimet në lidhje me procesimin e kompensimit përpara datës 31.12.2022 dhe përpara mbylljes së buxhetit për VKM-në e përcaktuar.

Me datë 23.01.2023, nga Grupi i Punës është përcjellë në mënyrë elektronike kërkesa për kompensim, e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore për tre praktika dhe në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar informacion mbi statusin e tyre. DFB ka vijuar me procesin e kompensimit për dy praktika në vlerë 3.250.300 lekë, me fondin e akorduar nga MFE sipas shkresës me nr.926/1 prot., datë 26.01.2023.

Pra Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë të gjitha masat për realizimin brenda afateve të VKM-së për Kompensimin e Transportit dhe kalimi i praktikave jashtë afatit ka ardhur si rrjedhojë e dërgimit me vonesë të informacionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar DPT mbi projekt raportin ,grupi i auditimit gjykon se :

Grupi i auditimit është i mendimit se strukturat përgjegjëse nuk kanë respektuar afatet në trajtimin e kërkesës për subjekte, kërkesa e dopozituar ne DRT është brënda afatit të përcaktuar në VKM (1 dhjetor 2022) sipas VKM nr. 569, datë 25.08.2022 kreu II pika 5 dhe kreu III pika 1. Urdhri nr.118, datë 12.09.2022 , pika 3 “Verifikimi duhet të mbyllet në DRT brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kërkesës dhe të përcillet në DPT..” dhe pika 4 “Grupi i punës brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja e dokumentit harton dokumentin përmbledhës..”, Ligjin nr. 115/2021 buxhetit vjetor 2022, si edhe pagesa e bërë është në tejkalim të fondit të kontigjencës së akorduar në llogarinë ekonomike 604 për kompesimin e shoqërive të transportit por nga llogaria ekonomike 602.

Për sa më lart argumentet e sjella në nuk qëndrojnë dhe nuk merret parasysh observacioni nga grupi i auditimit.

Për shpenzimet kapitale llog.230 – llog.231.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 9312/3 prot., datë 28.06.2022 protokolluar me nr. 11056 prot., datë 29.06.2022, është dërguar miratimi për transferimin e fondeve kapitale, programi 01140, sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me anë të shkresës nr. 5363/1 prot., datë 23.05.2022, sipas tabelës bashkëlidhur:

Në lekë

Programi	Llog. Ekon.	Kodi i thesarit	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Pakësohet	Shtohet
01140	231	3535	18AV905	Rikonstruksion Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	10,999,520	
01140	231	3535	18AV812	Hapesira harduere për kapacitetin e serverave		10,999,520

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 16048/3 prot., datë 21.09.2022 protokolluar me nr. 16003 prot., datë 22.09.2022 është dërguar miratimi për transferimin e fondeve kapitale për vitin 2022, sipas tabelës bashkëlidhur.

Tabela nr.98 Transferimi i fondeve kapitale sipas projekteve

Në lekë

Programi	Llog. Ekon.	Kodi i thesarit	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Pakesohet	Shtohet
01140	230	3535	M100255	Pagesa biletës hyrese FISCALIS 2020	4,000,000	
01140	231	3535	18AV802	Blerje pajisje zyre	8,570,040	
01140	231	3535	18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	4,157,996	
01140	231	3535	18AV815	Blerje pajisje elektronike dhe kompjuterike	2,263,000	
01140	231	3535	18AV813	Automatizimi dhe monitorimi i aktivitetit per	22,000,000	

				<i>inspektoret -DPT</i>		
01140	231	3535	18AV814	<i>Marrja e informacionit nga inventaret e tatimpaguesve nga sistemi AT</i>	22,000,000	
01140	231	3535	18AV907	<i>Brandimi i Godinave DPT + 14 DRT</i>		9,000,000
01140	231	3535	22AD801	<i>Permiresimi i sistemit E- taxation</i>		24,000,000
01140	231	3535	18AV812	<i>Hapesira hardëare per kapacitetin e serverave</i>		21,991,036
01140	231	3535	18AV816	<i>Akses kontrolli</i>		3,000,000
01140	231	3535	M100446	<i>Rikonstruksion DPT</i>		5,000,000
<i>Totali</i>					62,991,036	62,991,036

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në zbatim të Aktit Normativ Nr.12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.115/2022 “Për buxhetin e vitit 2022” i ndryshuar, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 14405/155 prot., datë 27.09.2022 protokolluar me nr. 16566 prot., datë 29.09.2022, është dërguar miratimi për limitet e shpenzimeve kapitale, programi 01140, sipas tabelës bashkëlidhur:

Në lekë

Programi	Llog. Ekon.	Kodi i thesarit	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Pakesohet	Shtohet
01140	231	3535	18AV812	<i>Hapesira hardëare për kapacitetin e serverave</i>		103,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në zbatimin të Aktit Normativ Nr.17, datë 01.12.2022, për shpenzimet kapitale, grupi 10, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 24070 prot., datë 29.12.2022, protokolluar me nr. 265 prot., datë 10.01.2023, është dërguar shkresa me nr. 22351/83 prot., datë 16.12.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, sipas tabelës bashkëlidhur:

Tabela nr.99 Ndryshimi i fondit te shpenzimeve kapitale sipas AN nr.17

Në lekë

Llog. Ekon.	Kodi i thesarit	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Pakesohet	Shtohet
231	3535	22AD801	<i>Permiresimi i sistemit E- taxation</i>	24,000,000	
231	3535	M100446	<i>Rikonstruksion DPT</i>	5,000,000	
231	3535	18AV812	<i>Hapesira hardëare per kapacitetin e serverave</i>		209,000,000
<i>Totali</i>				29,000,000	209,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në zbatimin të Aktit Normativ Nr.19, datë 29.12.2022, për shpenzimet kapitale, grupi 10, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 24043/38 prot., datë 23.01.2023 është dërguar shkresa nr. 24043/12, datë 30.12.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit protokolluar në DPT me nr. 1093 prot., datë 25.01.2023, mbi sipas tabelës bashkëlidhur:

Tabela nr. 100 Ndryshimi i fondit te shpenzimeve kapitale sipas AN nr. 19

Në lekë

Llog. Ekon.	Kodi i thesarit	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Pakesohet	Shtohet
231	3535	18AV812	<i>Hapesira hardëare per kapacitetin e serverave</i>	42,000,000	
231	3535	18AV816	<i>Akses kontrolli</i>	3,000,000	
231	3535	18AV907	<i>Brandimi I Godinave DPT + 14 DRT</i>	9,000,000	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në zbatimin të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 9261/1 prot., datë 26.01.2023 është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit protokolluar në DPT me nr. 1393 prot., datë 30.01.2023, mbi sipas tabelës bashkëlidhur:

Tabela nr.101 Rialokim fondi per projektin Tatimpagues të asistuar

Në lekë

Llog. Ekon.	Institucioni	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Pakesohet	Shtohet
602	Aparati DPT	91001AE	Tatimpagues të asistuar		148,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e investimeve sipas ndryshimit të buxhetit për vitin 2022 jepen si më poshtë:

Tabela nr.102 Ndryshimi i fondeve sipas projekteve të investimit

Në mijë lekë

Nr.	Llog. Eko	Kodi	Projekti	Plani fillestar	Pakesim fondi	Shtim Fondi	Plani me ndryshime 2022
1	231	18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	44,300	4,158	-	40,142
2	231	18AV811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja	41,340	-	-	41,340
3	231	18AV812	Hapësira hardëarike kapacitetin e serverave	80,000	42,000	344,991	382,991
4	231	18AV904	Rikonstruksion Drejtoria rajonale Diber	10,999	-	-	10,000
5	231	18AV906	Rikonstruksion(Shtese kati) Drejtoria rajonale Fier	30,000	-	-	30,000
6	231	18AV905	Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan	11,000	11,000	-	0
7	230	M100255	Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020	7,000	4,000	-	3,000
8	231	18AV815	Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike	40,000	2,263	-	37,737
9	231	18AV802	Paisje zyre	15,000	8,570	-	6,430
10	231	M100446	Rikonstruksion DPT	20,000	5,000	5,000	20,000
11	231	18AV813	Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektoret per Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve	22,000	22,000	-	-
12	231	18AV814	Marrje informacioni per inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administrates tatimore	22,000	22,000	-	-
13	231	22AD801	Permiresimi i sistemit E- taxation	-	24,000	24,000	-
			Totali	342,639	144,991	373,991	571,640

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Sic vërehet edhe nga tabela e mësipërme projekti me kod 18AV812 “Hapësira harduere për kapacitetin e serverëve” është shtuar me 302,990 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA 2022-2024 dhe në ligjin e buxhetit 2022, pothuajse 5-fish më shumë. Listës së projekteve i është shtuar një projekt i ri investimi me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E-taxation” në vlerën 24,000 mijë lekë. Konstatohet se ky projekt nuk është planifikuar në PBA 2022-2022 si edhe nuk është çelur fond në buxhetin e vitit 2022. Më hollësisht në lidhje më këto dy projekte; Me shkresën nr.1935 prot., datë 04.04.2022 me lëndën “ Rritja e kapaciteteve hardëare për sistemin e fiskalizimit” të dërguar nga AKSH, ku bën me dije DPT se në zbatim të urdhërit të brendshëm nr.1418 prot., datë 11.03.202 të drejtorit të përgjithshëm të AKSH, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të references, realizimin e studimit të tregut, përllogratijen e fondit limit si edhe hartimin e kritereve të vecanta për procedurën me objekt “Rritje e kapaciteteve hardëare për sistemin e fiskalizimit “ rezultoi fondi limit me vlerë 453,468,706 lekë me TVSH për periudhë 9 (nëntë) mujore. Konstatohet se është afërsisht 302,965 mijë lekë më shumë nga parashikimi në buxhetin e vitit 2022. AKSH ka sjellë në formë elektronike me datë 21.04.2022 me prioritet edhe kërkesën për investim për projektin “Përmirësim i sistemit e-Taxation”. Konstatohet se ky projekt nuk është parashikuar në buxhetin e vitit 2022. DPT ka dërguar një sërë kërkesash pranë MFE për shtim

fondi për të dy projektet, konkretisht; Me shkresën nr.6113 prot., datë 13.04.2022 me lëndën “Kërkesë për fonde shtesë” në vlerën 453,468 mijë lekë drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën “Kërkesë për shtim fondi” me nr.6113/1 prot., datë 28.04.2022. Me shkresën nr.6113/1 prot., datë 23.05.2022 me lëndën “kërkesë për rialokim fondi për shpenzimet kapitale ku kërkohen fonde për projektin “Rritje e kapaciteteve hardëare për sistemin e fiskalizimit “ në vlerën 453,468 mijë lekë dhe kërkohen fonde për projektin “Përmirësim i sistemit e-Taxtion” në vlerën 120,000 mijë lekë me argumentin se ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të cojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Nga auditimi i dokumenteve rezultoi se projekti “Përmirësim i sistemit e-taxation” i një rëndësie të lartë nuk u arrit të realizohej gjatë vitit 2022 pasi u shkurtuan fondet me Aktin Normativ Nr.17, datë 01.12.2022, këto fonde ju shtuan projektit 18AV812 “*Hapësira hardueare për kapacitetin e serverave*”. Sipas komunikimit me subjektin për këtë projekt, konfirmohet se as në vitin 2023 nuk ka nisur realizimi i projektit . Rezulton se ndryshimi i prioriteteve në financimin e projekteve të investimit me kërkesë të AKSHI-t për dy projekte, projekti me kod 18AV812 “*Hapësira harduere për kapacitetin e serverëve*” është shtuar me 302,990 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA 2022-2024 dhe në ligjin e buxhetit 2022, pothuajse 5-fish më shumë. Listës së projekteve i është shtuar një projekt i ri investimi me kod 22AD801 “*Përmirësimi i sistemit E- taxation*” në vlerën 24,000 mijë lekë. Për realizimin e këtyre projekteve janë shtuar fondet me Aktin Normativ Nr.17, datë 01.12.2022 dhe me Aktin Normativ Nr.12, datë 29.07.2022 dhe janë pakësuar në masën 100 % fondet e planifikuara në PBA dhe në buxhetin e vitit për projektet; “Automatizim dhe monitorim aktiviteti për inspektorët për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” (22,000 mijë lekë), “Marrje informacioni për inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administratës tatimore” (22,000 mijë lekë). Si edhe pakësim pjesor në vlerën 76,991 mijë lekë për projektet ; “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT”, “Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan”, “Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020”, “Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike” edhe projekti “ Paisje zyre”.

Realizimi i planit të buxhetit

Nga krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të DPT me të dhënat e thesarit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të njëjtën periudhë raportuese, vlerësojmë faktin se për vitin 2022 nuk ka diferenca të planit të buxhetit për të gjitha shpenzimet, po ashtu edhe të realizimit faktik për shpenzimet e personelit dhe shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, dhe me financimin e huaj.

Të ardhurat jashtë limitit: Nga të dhënat e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë dhe raportit të paraqitur nga ministria konstatojmë se për vitin 2022 për këtë ministri janë realizuar të ardhura jashtë limitit në masën 2,295,468 mijë lekë. Për sa i përket të ardhurave jashtë limitit, në vijim të kërkesës së grupit për vendosjen në dispozicion të një plani për këto shpenzime, nga ana e përfaqësuesve të institucionit u bëmë me dije se për këto të ardhura nuk ka një planifikim, pasi shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzime që i përkasin kapitull 6, rritje e autorizuar e cila ndjek këtë rrugë: DPT shpërndan produktet e saj (fatura tatimore etj.) Drejtorive Rajonale të cilat më pas kryejnë shitjen e tyre dhe i derdhen pagesat në buxhet nëpërmjet kapitullit 6. Pasi rakordohet çdo muaj mbi derdhjet që kryhen nga DRT në Degën e Thesarit, ato përcillen në rrugë zyrtare në DPT. DPT nëpërmjet shkresës zyrtare kërkon rritjen e autorizuar pranë MFE, e cila me pas realizon çeljen e fondit për ta përdorur më pas për likuidim faturash të shtypshkronjave të letrave me vlerë.

Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave

dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 8296, prot datë 18.05.2022.
- Raporti i monitorimit 8–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 15848, prot. , datë 20.09.2022.
- Raporti i monitorimit 12-muor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 2302, datë 15.02.2023.

Për sa i përket realizimi në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.103 Realizimi i programit “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”,

Në mijë lekë

Llog	Shpenzime Korente	Fakti 2021	Plani PBA	Plani Fillestar 2022	Plani i rishikuar	Realizimi	Diferenca
		1	2	3	4	5	5=3-4
600	Paga	1,264,587	1,420,000	1,420,000	1,282,018	1,282,005	100%
601	Sigurime Shoqërore	210,855	250,000	250,000	212,900	212,847	100%
602 ²	Mallra dhe Shërbime të Tjera	897,174	1,227,512	877,512	1,546,293	1,545,970	97%
604	Transferta Korente të Brendshme				550,000	549,110	100%
605	Transferta Korente të Huaja	2,227	2,104	2,104	2,104	1,721	82%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,243	384	384	28,124	19,286	65%
I	Totali i Shpenzimeve Korente	2,377,076	2,900,000	2,550,000	3,621,439	3,610,939	99%
230	Kapitale të Patrupëzuara F. B		7,000	7,000	3,000	2,796	93%
231	Kapitale të Trupëzuar F.B	542,787	276,000	335,640	568,640	528,604	93%
230-231	Kapitale me Financim të Huaj						
II	Totali i Shpenzimeve Kapitale	542,787	283,000	342,640	571,640	531,400	93%
I+II	Totali i shpenzimeve korrente dhe kapitale	2,919,862	3,183,000	2,892,640	4,193,079	4,142,339	98%
III	Shp. të ardhurat jashtë limiti	2,205,690	NA	NA	NA	2,295,468	
I+II+ III	Totali i Përgjithshëm	5,125,552	3,183,000	2,892,640	4,193,079	6,437,807	98%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Programi 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” është realizuar në masën **98%**, pra në vlerën 4,142,339 mijë lekë, kundrejt 4,193,079 mijë lekë të planit të rishikuar, ose me një mosrealizim në vlerën 50,740 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar. Krahasuar me planin fillestar programi 01140 është realizuar në masën 143 %, me një mbi realizim në vlerën 1,249,669 mijë lekë kundrejt planit fillestar (për shkak të realizimit më të lartë të zërit të investimeve dhe shtimit të fondeve në llogarinë ekonomike 602 me datë 31.12.2022 në vlerën 148,000 mijë lekë).

- Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 99 %, me një mos realizim në vlerën 10,500 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet korrente zënë peshën kryesore prej 85%.

- Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 93%, me një mos realizim në vlerën 40,240 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet kapitale zënë peshën prej 15%.

Për arritjen objektivave të DPT për vitin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Tabela nr.104 Realizimi i projekteve të investimit

Në mijë lekë

Nr.	Llog. Eko	Kodi	Projekti	Plani fillestar 2022	Plani me ndryshime 2022	Realizimi
1	231	18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center),	44,300	40,142	40,142

² Shënim : në llogarinë 602 është llogaritur edhe fondi i shtuar nga MFE me shkresën nr. 9261/1 prot., datë 26.01.2023 në vlerën 148,000 mijë lekë.

			sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT			
2	231	18AV811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja	41,340	41,340	41,340
3	231	18AV812	Hapësira hardëarike kapacitetin e serverave	80,000	382,991	382,965
4	231	18AV904	Rikonstruksion Drejtoria rajonale Diber	10,999	10,000	0
5	231	18AV906	Rikonstruksion(Shtese kati) Drejtoria rajonale Fier	30,000	30,000	0
6	231	18AV905	Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan	11,000	0	0
7	230	M100255	Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020	7,000	3,000	2,796
8	231	18AV815	Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike	40,000	37,737	37,737
9	231	18AV802	Paisje zyre	15,000	6,430	6,429
10	231	M100446	Rikonstruksion DPT	20,000	20,000	19,989
11	231	18AV813	Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektorët per Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve	22,000	-	0
12	231	18AV814	Marrje informacioni per inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administrates tatimore	22,000	-	0
13	231	22AD801	Permiresimi i sistemit E- taxation	-	24,000	0
			Totali	342,639	595,640	531,400

Burim : të dhënat nga DPT

Projekti i investimit me kod 18AV812 “Hapësira harduerike kapacitetin e serverëve” është prokuruar nga Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit (AKSHI) lidhur kontrata nr.30 prot., datë 20.10.2022 dhe me vlerë 425,353,716 lekë me afat lëvrimi 9 (nëntë) muaj. Sipas auditimit të dokumenteve data e marrjes së kontratës në DPT është nr. 1184 prot., datë 3.11.2022 dhe është obliguar në sistem me 11.11.2022.

Tabela nr.105 Fondet e alokuara për projektin “Hapësira harduerike kapacitetin e serverëve”
Në mijë lekë

Shkresat	Data e kalimit te fondit	Fondi kod 18AV812
Ligj buxheti 2022	01.01.2022	80,000
Rialokim fondi	21.09.2022	21,991
Rialokim fondi	28.06.2022	10,999
AN. Nr.12, datë 29.07.2022	29.07.2022	103,000
Data e lidhjes se Kontrates 20.10.2022	fonde gjithësej	215,990
AN. Nr 17, date 01.12.2022	29.12.2022	209,000
AN. Nr. 19, datë 30.12.2022	31.12.2022	(42,000)
Totali		424,990

Burim : të dhënat nga DPT

Për projektin 18AV812 “Hapësira harduerike kapacitetin e serverave “ janë lëshuar faturat si më poshtë;

Tabela nr.106 Statusi i faturat për projektin e investimit 18AV812

Në lekë

Date fature	Vlera	Statusi
11/21/2022	3,525,187	likujduar
12/14/2022	10,705,754	likujduar
12/20/2022	13,813,656	likujduar
12/27/2022	354,920,583	likujduar
Totali	382,965,180	likujduar

Burim : të dhënat nga DPT

Nga sa më sipër rezulton se nga vlera totale e kontratës 425,353 mijë lekë me afat lëvrimi 9 (nëntë) muaj, janë paguar 382,965 mijë lekë për dy muaj, afërsisht 90% e vlerës së kontratës është likuiduar brenda dy muajve. Krahasuar me vlerën planifikuar në PBA për vitin 2022 ishte 80,000 mijë lekë të, është pothuajse 5 fish më shumë. Konstatohet se deri me 20.10.2022 kur është lidhur kontrata nga AKSHI fonde të disponueshëm për këtë projekt janë në vlerën 215,990 mijë lekë pra afërsisht 167,000 mijë lekë më pak se vlera e kontratës. Rezulton se është ndërmarrë angazhim buxhetor nga AKSHI përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndarë për këtë projekt sipas buxhetit të vitit 2022. Ky veprim është në kundërshtim me

Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", kreu "Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike", pika 153-154.

Nga auditimi konstatohet se për 4 (katër) raste procedura e prokurimit fillon me vonesë megjithëse janë pjesë e PBA-së duke sjellë nënshkrimin e kontratave në mbyllje të vitit buxhetorë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për Procedurat Standard të Zbatimit të Buxhetit", pika 79-83, me pasojë mospërdorimin e fondeve buxhetore të investimeve të miratuara për vitin 2022. Më hollësisht trajtuar si më poshtë :

1. Kontrata me vlerë nr. 17086/7, datë 07.12.2022 "Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Tatimeve Dibër" lidhur midis DPT me shoqërinë "2" shpk me NIPT L.....L me vlerë totale 12,104,625 lekë, për vitin 2022 vlera është 8,070,153 dhe për vitin 2023 vlera 4,034,471 lekë. Sipas të dhënave të dërguara në PBA 2022-2024 ky projekt është parashikuar të realizohet brenda vitit 2022 dhe fondi i planifikuar dhe i çelur sipas ligjit të buxhetit 2022 është 10,000 mijë lekë. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është lidhur pas datës 15 tetor të vitit buxhetor si edhe kontrata e lidhur është deri në vitin 2023, jashtë afatit të përcaktuar në PBA 2022-2024. Për vitin 2022 konstatohet se realizimi i projektit është 0 lekë.

Këto parregullsi të konstatuara për këtë projekt 18AV904 janë në reference të Udhëzimi nr. 9 date 20.03.2018 "Për Procedurat Standard të Zbatimit të Buxhetit" pika 79-83 ;

79. E drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës. Për fondet e njësisve vendore, nga transferta e pakushtëzuar apo të ardhurat vendore, e drejta për të kryer shpenzime është në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës për vetëqeverisjen vendore.

80. Për të siguruar kontrollin që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavaneve trevjeçare, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit ndiqet kjo procedurë:

a. Regjistrimi dhe mbartja e kontratave, vjetore apo shumëvjeçare, bëhet nga dega e thesarit përkatës, sipas vlerave të përcaktuara për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar;

b. Nëse kohëzgjatja e kontratës shumëvjeçare shkon përtej periudhës trevjeçare të ligjit të miratuar të buxhetit, pjesa e mbetur e vlerës së kontratës, pas regjistrimit të vlerave për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar, regjistrohet në vitin buxhetor pasardhës që vjen menjëherë pas vitit të fundit të ligjit të miratuar të buxhetit trevjeçar.

81. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime.

82. Përcaktimi i limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik.

83. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndër marrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor.

2. Kontrata "Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve" lidhur me shoqërinë "O" SHPK me NIPT K.....A me datë 10.11.2022 me vlerë 19,989,511 lekë me kohë zbatimi dy muaj , ky angazhim buxhetor është në tejkalim të afatit 15 tetor të vitit buxhetor.

3. Kontrata me vlerë nr. 30 prot., datë 20.10.2022 "Hapësira harduerike për kapacitetin e serverëve " në vlerën vlerë 425,353,716 lekë me afat lëvrimi 9 (nëntë) muaj. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është marrë jashtë afatit të përcaktuar në pikën 83 të cituar më lart.

4. Rikonstruksion Fier lidhur kontrata me datë 23.12.2022 në vlerën 54,995,410 lekë me afat 9 muaj, me grafik pagesë për vitin 2022 është 25,000 mijë lekë dhe për vitin 2023 me vlerë 29,995 mije lekë. Bazuar në PBA 2022-2024 ky projekt 18AV906 është planifikuar të përfundojë brenda vitit 2022. Konstatohet se ky angazhim buxhetor i parashikuar në PBA, kontrata është lidhur me afat përfundimi në vitin 2023 jo në respektim të afatit e parashikuar në PBA 2022-2024 si edhe në tejkalim të afatit 15 tetor të vitit buxhetor. Këto parregullsi të

konstatuara për këtë projekt 18AV904 janë në referencë të Udhëzimi nr. 9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 79-83 të cituar më lart.

Titulli i gjetjes	Në detajimin e planeve të miratuara të investimeve nuk janë zbatuar nga DPT kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve si pasojë e kostove të shtuara përkundrejt përllogaritjeve fillestare nga AKSHI.
Situata:	Nga auditimi u konstatua ndryshim i prioriteteve dhe i vlerës në financimin e projekteve të investimit me kërkesë të AKSHI-t shkresa nr.1935 prot., datë 04.04.2022 për dy projekte, projekti me kod 18AV812 “ <i>Hapësira harduere për kapacitetin e serverave</i> ” është shtuar me 302,990 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA 2022-2024 dhe në ligjin e buxhetit 2022 që ishte planifikuar në vlerën 80,000 mijë lekë, pothuajse 5-fish më shumë. Listës së projekteve i është shtuar një projekt i ri investimi me kod 22AD801 “ <i>Përmiresimi i sistemit E- taxation</i> ” në vlerën 24,000 mijë lekë, nuk është planifikuar në programin afatmesëm buxhetor për vitin 2022 si edhe në buxhetin e vitit 2022. Për realizimin e këtyre projekteve janë shtuar fondet me Aktit Normativ Nr.17, datë 01.12.2022 dhe me Aktit Normativ Nr.12, datë 29.07.2022 dhe janë pakësuar në masën 100 % fondet e planifikuara në PBA dhe në buxhetin e vitit 2022 për projektet; “Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektorët për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” (22,000 mijë lekë), “Marrje informacioni për inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administratës tatimore” (22,000 mijë lekë). Si edhe pakësim pjesor në vlerën 76,991 mijë lekë për projektet ; “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT”, “Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan”, “Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020”, “Blerje paisje zyre elektronike,komjuterike” edhe projekti “ Paisje zyre”. Konstatohet se nga rishikimi i vlerave të projekteve institucioni i DPT ekspozohet në marrjen e angazhimeve buxhetore përtej fondeve të miratuara konstatuar në projektin me kod 18AV812 “ <i>Hapësira harduere per kapacitetin e serverave</i> ”. Rezulton se deri me 20.10.2022 kur është lidhur kontrata nga AKSHI fonde të disponueshëm janë në vlerën 215,990 mijë lekë pra afërsisht 167,000 mijë lekë më pak se vlera e kontratës, pra përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndarë për këtë projekt në buxhetin e miratuar për vitin 2022.
Kriteri:	Udhëzimi nr.1, datë 10.01.2022 “ <i>Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022</i> ”, pika 25. Udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 “ <i>Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit</i> ”, Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, pika 153-154. Ligji i buxhetit 115/2021 “ <i>Për buxhetin e vitit 2022</i> ”.
Ndikimi:	Për të realizuar dy projektet kod 22AD801, kodi 18AV812 janë pakësuar në masën 100 % fondet e planifikuara në PBA dhe në buxhetin e vitit 2022 për projektet “ <i>Automatizim dhe monitorim aktiviteti per inspektorët për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve</i> ” (22,000 mijë lekë), “ <i>Marrje informacioni për inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administratës tatimore</i> ” (22,000 mijë lekë). Ndërmarrja e nagaxhimeve buxhetore përtej fondeve të miratuara .
Shkaku	Ndryshim i prioriteteve dhe vlerës së projekteve nga AKSHI.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e DPT të mos pranohen projektet e rishikuara në vlerë nga AKSHI si pasojë e studimit të tregut përtej fondeve buxhetore të miratuara për projektet respektive.

	Në të njëjtën kohë DPT të mos paraqesë projekte në fushën e teknologjisë së informacionit në kushtet emergjence, por të përmirësojë procedurën e planifikimit buxhetor afatmesëm nëpërmjet strukturave të GMS në bashkëpunim me përfaqësuesin e AKSHI.
--	--

Titulli i gjetjes	Ndërmarrja e angazhimeve të reja buxhetore në tejkalim të afatit 15 tetor të vitit buxhetor.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatuan angazhime të reja buxhetore jashtë afatit 15 tetor të vitit buxhetor. 1. Kontrata me vlerë nr. 17086/7, datë 07.12.2022 “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Tatimeve Dibër” lidhur midis DPT me shoqërinë “2” SHPK me NIPT L.....L me vlerë totale 12,104,625 lekë, për vitin 2022 vlera është 8,070,153 dhe për vitin 2023 vlera 4,034,471 lekë. Sipas të dhënave të dërguara në PBA 2022-2024 ky projekt është parashikuar të realizohet në vitin 2022 dhe fondi i planifikuar dhe i celur sipas ligjit të buxhetit 2022 është 10,000 mijë lekë. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është lidhur pas datës 15 tetor vitit buxhetor për vitin 2022 si edhe kontrata e lidhur është afërsisht 2,104 mijë lekë mbi fondin buxhetor të parashikuar në ligjin e buxhetit për vitin 2022. Gjithashtu kontrata e lidhur është deri në vitin 2023, jashtë afatit të përcaktuar në PBA 2022-2024. Për vitin 2022 konstatohet se realizimi i projektit është 0 lekë.</p> <p>2. Kontrata datë 10.11.2022 “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” lidhur me shoqërinë “O” SHPK me NIPT K.....A me vlerë 19,989,511 lekë me kohë zbatimi dy muaj brenda afateve kohore të parashikuar në PBA 2022-2024 si edhe brenda tavanit të miratuar për këtë projekt.</p> <p>3. Kontrata nr. 30 prot., datë 20.10.2022 “Hapësira harduerike për kapacitetin e serverëve “ në vlerën vlerë 425,353,716 lekë me afat lëvrimi 9 (nëntë) muaj. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është marrë jashtë afatit të përcaktuar 15 tetor të vitit buxhetor.</p> <p>4. Rikonstruksion Fier lidhur kontrata me datë 23.12.2022 në vlerën 54,995,410 lekë me afat 9 muaj, me grafik pagesë për vitin 2022 është 25,000 mijë lekë dhe për vitin 2023 me vlerë 29,995 mije lekë. Bazuar në PBA 2022-2024 ky projekt 18AV906 është planifikuar të përfundojë brenda vitit 2022 si edhe fondet në dispozicion për këtë projekt sipas buxhetit të vitit 2022 janë 30,000 mijë lekë. Konstatohet se kontrata është lidhur 24,995 mijë lekë më shumë se fondi në dispozicion si edhe me afat përfundimi në vitin 2023 jo në respektim të afatit e parashikuar në PBA 2022-2024. Këto parregullsi të konstatuara për këtë projekt 18AV904 janë në referencë të Udhëzimit nr. 9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 79-83.</p>
Kriteri:	Udhëzimi nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standard të Zbatimit të Buxhetit” pika 79-83. Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 51 “Menaxhimi i Angazhimeve “. Ligji i buxhetit 115/2021 “Buxheti i vitit 2022”.
Ndikimi:	Mos përdorim i fondeve buxhetore brenda vitit buxhetor.
Shkaku	Fillimi i procedurave me vonesë dhe lidhjet e kontratave në fund të vitit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e DPT të përcaktohen përgjegjësitë për ndërmarrjen e angazhimeve të reja përtej afatit të përcaktuar në kuadrin rregullator dhe të merren masa për iniciimin e procedurave të prokurimit me detajimin e fondeve .

Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve me bankën u konstatuan 27 urdhër-shpenzime nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës janë kryer likuidimet në tejkalim të afatit 30 ditore nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” dhe në Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve. Sipas komunikimit me subjektin këto fatura ndiqen nëpërmjet sistemit “Sistemi i menaxhimit të kontratave” (SMK), sistem i ngritur nga AKSHI për të ndjekur kontrata e krijuara nga ky institucion në rastin konkret me përfitues shërbimi apo malli të kontratës DPT. Ky sistem (SMK) është një sistem i ri i vendosur në përdorim përgjatë vitit 2022, bazuar me shkresën me nr. 7789 prot., datë 10.11.2021 të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, protokolluar në DPT me nr. 20569 prot., datë 15.11.2021, dhe mënyra e funksionimit të tij ka shkaktuar vonesa në pranimin e faturave për likuidim nga DFB.

Tabela nr.107 Urdhër shpenzimet e paguara jashtë afatit

Në lekë

Furnitori	Shuma	Data furnitorit	Data urdher shpenzimit	Diferenca
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	3/10/2022	6/2/2022	84
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	7/6/2022	11/7/2022	124
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	7/12/2022	9/20/2022	70
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	10/6/2022	11/18/2022	43
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	8/11/2022	11/24/2022	105
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	9/6/2022	11/18/2022	73
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	6/6/2022	11/18/2022	165
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	6/13/2022	9/20/2022	99
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	10/11/2022	11/24/2022	44
IKUBINFO	9,566,112	3/15/2022	5/17/2022	63
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	1/6/2022	6/22/2022	167
IKUBINFO	9,566,112	2/14/2022	5/17/2022	92
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	5/10/2022	7/13/2022	64
IKUBINFO	9,566,112	11/14/2022	12/21/2022	37
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	4/6/2022	6/2/2022	57
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	2/7/2022	6/2/2022	115
IKUBINFO	9,566,112	5/12/2022	7/13/2022	62
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	4/11/2022	5/20/2022	39
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	2/10/2022	5/20/2022	99
IMAGE&COMMUNICATIONSDEVELOPEMENT	580,000	9/12/2022	12/21/2022	100
IKUBINFO	9,566,112	4/12/2022	5/17/2022	35
IKUBINFO	9,566,112	9/12/2022	11/7/2022	56
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	8/8/2022	11/18/2022	102
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	11/7/2022	12/21/2022	44
IKUBINFO	9,566,112	7/12/2022	8/29/2022	48
INFOSOFT SYSTEMS	3,219,528	3/7/2022	6/2/2022	87
IKUBINFO	9,566,112	1/12/2022	5/18/2022	126

Burim : të dhënat nga DPT

Titulli i gjetjes	Mbi likuidimin me vonesë të faturave
Situata:	Nga auditimi rezultoi se për 27 urdhër-shpenzimi nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës janë kryer likuidimet në tejkalim të afatit kohor 30 ditore nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik në kundërshtim me ligjin

	nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve “. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.
Kriteri:	Udhëzimin nr.9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve “.
Ndikimi:	Likuidimet e kryera në tejkalim të afatit kohor 30 ditorë rrisin riskun potencial për rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore.
Shkaku	Faturat me bazë kontrate nga AKSHI me përfitues DPT ndiqen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të faturave (SMK) dhe procedura që ndiqet nga aprovimi deri në likuidimin e faturës merr shumë kohë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i DPT të marrë masa për përcaktimin e një rregulloreje të brendshme për disiplinimin e procesit të ekzekutimit të fondeve buxhetore në kohë dhe për konstatimet e faturave në fushën e teknologjisë së informacionit të reflektojë problematikën në marrëveshjet dhe procedurat në bashkëpunim me AKSHI .

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. C.K me detyrë Nënpunës Autorizues dhe strukturat përgjegjëse dhe përfaqësuese nga AKSHI dhe Znj. D.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar DPT me shkresën nr. 284/8 prot., date 06.09.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim si më poshtë:

“1. Kontrata me nr.17086/7, datë 07.12.2022 Rikonstruksioni i Godinës së Drejtorisë së Tatimeve Dibër” lidhur midis DPT me shoqërinë “2”shpk... dhe “Këto parregullsi të konstatuara për këtë projekt 18AV904 janë në referencë të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 79-83;

“3.Kontrata me nr.30 prot., datë 20.10.2022 “Hapësira harduerike për kapacitetin e serverave” në vlerë 425.353.716 lekë me afat lëvrimi 9 (nëntë) muaj. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është marrë jashtë afatit të përcaktuar në piken 83”; dhe

“4. Rikonstruksion DRT Fier lidhur kontrata me datë 23.12.2022 në vlerën 54.995.410 lekë me afat 9 (nëntë) muaj...“Konstatohet se kontrata është lidhur 24.955 mijë lekë më shumë se fondi në dispozicion si dhe me afat përfundimi në vitin 2023 jo në respektim të afatit të parashikuar në PBA 2022-2024.”. Ju bëjmë me dije se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit funksionon në aspekt zbatimi buxhetor dhe çdo muaj kryen raportimet përkatëse mbi statusin e realizimit të investimeve dhe të çdo kontrate në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka përgjegjësi dhe nuk përfshihet në procedurën e lidhjes së kontratave dhe të kushteve që duhen plotësuar për lidhjen e tyre si dhe në asnjë moment nuk ka lidhje me kalimin e afateve të procedurave

të cilat realizohen nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve. Pra kjo gjetje nuk mund të pranohet, pasi Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk realizon dhe nuk ndjek procedurën e prokurimeve.

Në lidhje me konstatimin “Nga auditimi me përzgjedhje të veprimeve me bankën u konstatuan 27 raste që nuk janë kryer likuidimet në afatet kohore sipas përcaktimit në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndyshuar, neni 52, Kryerja e shpenzimeve dhe në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184...”

Sikurse paraqitet dhe në Akt Konstatim likuidimi me vonesë i detyrimeve ka ndodhur vetëm për faturat e lëshuara në bazë të kontratave, për të cilat përdoret Sistemi i Menaxhimit të Kontratave (SMK). Kjo ka ardhur si pasojë pasi sistemi i Kontratave (SMK) është një sistem i ri i vendosur në përdorim përgjatë vitit 2022, faktuar me shkresën me nr.7789 prot., datë 10.11.2021 të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, protokolluar me tonën me nr.20569 prot., datë 15.11.2021, dhe mënyra e funksionimit të tij ka shkaktuar vonesa në pranimin e faturave për likuidim nga DFB. Përkatësisht ekziston procedura ku për çdo kontratë faturat respektive duhet të firmosen nga çdo individ ndjekës i kontratës përkatëse dhe për arsye të mosfunksionimit të duhur të sistemit DFB pas çdo konstatimi të mungesës së firmave ka vënë në dijeni dhe ka kryer komunikime elektronike për plotësimin e tyre në mënyrë që të procedohej me likuidimin e faturave, gjë që ka rezultuar me vonesa në pagesën e tyre. Gjithashtu një arsye tjetër ka qenë dhe sulmi kibernetik i ndodhur në korrik të vitit të kaluar, për shkak të të cilit për një periudhë dy mujore Administrata Tatimore ka patur probleme në përdorimin e sistemeve dhe aksesimin e email-eve.

Pra kjo gjetje nuk mund të pranohet pasi vonesat në realizimin e likuidimeve me bankë nuk kanë ardhur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit por, nga problematikat e funksionimit të sistemit të ri të implementuar SMK (Sistemi i Menaxhimit të Kontratave).

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Grupi i Auditimit pasi shqyrtoi observacionin Tuaj sqaron se:

Angazhimet buxhetore të krijuara janë ndërmarrë jashtë afatit të përcaktuar në ligjin 9936, datë 26.06.2007 “ Për menaxhimin i sistemit buxhetor në RSH”, neni 51 qe thotë “ Nëpunësi autorizues i njësisë mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor” , Udhëzimi nr.9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standard të Zbatimit të Buxhetit” pika 79-83. Ndërmarrja e angazhimeve jashtë afatit ndikon në shlyerjen e detyrimit si edhe në mospërdorim e fondeve të alokuara për këto projekte për vitin buxhetor 2022, pasi bazuar programin buxhetor afatmesëm PBA 2022-2024 këto projekte janë planifikuar të realizohen brenda vitit 2022 dhe nga auditimi rezulton se vetëm 2 prej tyre janë realizuar në afat, të tjerët kanë realizimin zero në fund të vitit 2022. Në lidhje me likuidimin e detyrimeve jashtë afatit 30-ditorë , gjykojmë se nga auditimi i të dhënave rezulton se likuidimet për 27 fatura janë kryer jashtë afatit, në observacionin tuaj keni paraqitur justifikimin qe ka ndikuar ose ka shkaktuar vonesat për tejkalimin e afatit në lidhje me sistemin e përdorur , kjo është reflektuar në rekomandim.

Për sa më lart argumentet e sjella nga subjekti, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura.

Sipas shkresës nr. 2619 prot., datë 21.02.2023 për konfirmimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, ku këto detyrime paraqiten në vlerën 433,700 mijë lekë, përbëhet nga vendimet gjyqësore (gjyqëfitues ish punonjës dhe subjektet). Kjo vlerë është konfirmuar edhe nga vlera neto e llogarisë 486 “ shpenzime te periudhave te ardhshme” në pasqyrat financiare të DPT. Krahasuar me vitin paraardhës detyrimet e prapambetura ishin në vlerën 950 milion lekë, rezulton se në fund të vitit 2022 detyrimet e prapambetura janë pakësuar me afërsisht 517 milion lekë. Për sa i përket raportimit të stokut të rimbursimit të TVSH-së për ato pagesa të cilat nuk kanë mundur të procesohen në fund të vitit 2022, por kanë kaluar procedurat respektive të kontrollit dhe verifikimit nga ana e DPT-së, këto shuma nuk raportohen në totalin e detyrimeve të prapambetura, por në situacionin e muajit Dhjetor të dorëzuar në

Degën e Thesarit ato janë raportuar në vlerën 22,469,292 mijë lekë në kolonën me emërtimin “rimbursime”.

Tabela nr. 108 Detyrimet e prapambetura në vitin 2022

Në lekë

Emertimi	Detyrimi i prapambetur 31.12.2021	Detyrime të lindura gjatë vitit 2022	Paguar gjatë vitit 2022	Detyrimi i prapambetur 31.12.2022
F SHPK	581,859,444	-	361,050,000	220,809,444
B SHPK	66,393,943	-	11,050,000	55,343,943
P SHPK	12,918,313	-	12,918,313	-
I. (sistemi i investimit)	41,340,000	-	41,340,000	-
V (investim)	40,142,484	-	40,142,484	-
A SHPK	-	68,708,227	68,708,227	-
G S	-	20,278,603	-	20,278,603
Gjyqëfitues (Ish punonjës)	116,255,623	98,680,172	77,667,121	137,268,674
Bileta transporti dhe shtypshkrime	91,954,304	-	91,954,304	-
Totali	950,864,111	187,667,002	704,830,449	433,700,664

Burimi; nga të dhënat e DPT

Në zbatim të Udhëzimit nr. 37, date 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, kreu III pika 2 ku citohet se “*struktura përgjegjëse për thesarin.. çdo muaj, deri në afatin e miratuar për publikimin e të dhënave përfundimtare të treguesve fiskal të konsoliduar, struktura përgjegjëse për Thesarin në degë kryen rakordimin mujor me njësitë shpenzuese, të konfirmuar zyrtarisht nga nëpunësi autorizues*”, dhe Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, me shkresën nr. 3116, prot datë 18.2.2021 është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë një kërkesë për bashkëpunim nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT, ku është kërkuar bashkëpunim për mos raportimin mujor por 6 mujor të detyrimeve edhe gjatë vitit 2022 është vepruar në zbatim të kësaj shkrese.

Mbi hartimin e pasqyrave financiare

- Hartimi i pasqyrave financiare vjetore. Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, veçanërisht në:

-zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, paraqitja e shtesave apo përmirësimeve të kryera gjatë vitit në aktivin e duhur.

-zërin "Të drejta të arkëtueshme" analizuar sipas llojit të tatimit. Testimi i të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyrave financiare.

-zërin “Detyrime ndaj të tretëve” sipas llojit (përfshirë detyrimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe TVSH). Kontabilizimi dhe raportimi i tyre në kuadër të raportimit periodik të detyrimeve të prapambetura në MFE, sipas llojit dhe kohës së krijimit të tyre.

Kontrolli periodik i aktiveve

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiency të tyre.

1-Procesi i inventarizimit të aktiveve në administratën e DPT

Për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve, nga Drejtori i Përgjithshëm ka dalë urdhri i brendshëm, Urdhri nr. 8408 prot., datë 19.05.2022 me lëndë “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj” për inventarizimin e vlerave fizike materiale në magazinat dhe zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve deri me datë 31.03.2022. Komisioni i inventarizimit përbëhet nga pesë anëtarë: znj.K.H. (Kryetar), Znj. G.A. (Anëtar), z. A.Q.

(Anëtar), z.H.K. (Anëtar), z.J.S (Anëtar). Komisioni i inventarizimit ka nisur nga puna në datë 15.06.2022.

Komisioni ka kryer verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit dhe magazinave të njësisë publike dhe ka pasqyruar të dhënat në procesverbal.

Në raportin përmbledhës komisioni i inventarizimit ka hartuar edhe shumatat e vlerave të aktiveve sipas llogarive ekonomike sipas tabelës në vijim:

Tabela nr.109 Inventari sipas llogarive ekonomike

Në lekë

Nr. Llogarisë	Sipas procesit të inventarizimit		
	Vlera bruto kontabël	Vlera bruto fizike	Diferenca
212	144,572,341	144,572,341	-
213	1,404,010,783	1,404,010,783	-
214	217,581,668	217,581,668	-
215	100,035,825	100,035,825	-
218	158,379,752	158,074,400	305,352
312	45,207,792	45,207,792	-
327	69,673	67,873	1,800
350	4,196,376	4,196,376	-
532	85,393	85,393	-
TOTALI	2,074,139,605	2,073,832,453	307,152

Burimi: Raporti i komisionit mbi inventarizimin e DPT-së dhe të dhënat e pasqyrave financiare

Diferencat e mësipërme midis shumave të vlerave të llogarive të aktiveve të raportuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerave të këtyre aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare është shkaktuar nga mos dorëzimi i materialeve në ngarkim të punonjësve të larguar.

Komisioni i inventarizimit ka konstatuar disa materiale në ngarkim të punonjësve të transferuar brenda strukturës si edhe ish-punonjës të cilët janë larguar rezultojnë ende me materiale në ngarkim.

Tabela nr. 110 Materialet në ngarkim të punonjësve të larguar

Në lekë

Magazina	Emër Mbiemër	Vlera Materiale në ngarkim	Gjendja
M161	K. F.	4,758	Larguar nga puna
M161	K.F	70,615	Larguar nga puna
M222	P.K	70,615	Larguar nga puna
M224	R.S	48,000	Larguar nga puna
M266	D.B	900	Larguar nga puna
M335	T.K	13,500	Larguar nga puna
M335	T.K	22,000	Larguar nga puna
M334	E.G	48,000	Larguar nga puna
M334	E.G	4,680	Larguar nga puna
M334	E.G	900	Larguar nga puna
M367	K.A	23,184	Larguar nga puna
			Larguar nga puna
	Total	307,152	

Burim : të dhënat nga DPT

Komisioni realizoi verifikimin e inventarit fizik të përgjigjesit material K.P. (ish punonjës) në magazinën M03 me vlerë 229,719,684. Ky verifikim fizik u krye pranë drejtorisë TIK në DPT në prani të z. K.P pavarësisht faktit që nuk ishte më punonjës i DPT. Inventari përmban orendi, mobilie, pajisje zyre etj..dhe sisteme, pajisje dhe programe IT. Për këto materiale nuk ishte kryer procedura e dorëzimit kur është larguar nga puna punonjësi. Nga auditimi i dokumenteve bazuar në fletë hyrjen në magazine dhe sistemin e kartelës së përgjegjesit, u konstatua se orendi, mobilie, pajisje zyre et., janë kaluar në kartelën e drejtorit të TIK në DPT. Ndërsa sistemet, pajisjet, programet do të kalohen nga “Komisioni i Kalimit Kapital” ndërmjet DPT-AKSHI-it, rezulton se nuk është finalizuar ky kalim inventari gjatë vitit 2022. Kjo problematikë e konstatuar edhe nga komisioni i inventarizimit lidhet edhe me mos finalizimin e procedurës së inventarizimit midis AKSH-DPT në kundërshtim të urdhrat të

përbashkët të kalimit kapital me nr. 8778, datë 02.05.2019, sipas të cilit afati i transferimit duhet të ishte përfunduar 09.05.2019.

Përsa i përket magazinave, janë kontrolluar fizikisht nga ana e komisionit, por shuma totale e magazinave nuk janë ndarë sipas llogarive ekonomike por sipas përgjegjësit material :

Tabela nr.111 Diferenca në inventar midis vleres kontabël dhe vlerës fizike

Në lekë

Emërtimi i Magazinës	Vlera Kontabel	Vlera Fizike	Diferenca
Materiale Magazina H.K	24,937,099	24,937,099	-
Mjete Magazina H.K	97,297,872	97,297,872	
Materiale Magazina S.H	14,294,273	14,294,273	
Mjete Magazina S.H	290,857,837	290,857,837	
Shtypshkrime magazina S.H	5,978,220	5,655,660	322,560
Bileta Transporti H.K	3,890,532	3,890,532	
Pulla Takse Magazina H.K	391,237	391,237	
Totali	437,647,073	437,647,073	322,560

Burim : të dhënat nga DPT

Diferenca ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës fizike rezulton nga vlera e materialeve të pa dorëzuar nga ish punonjësit. Për këto raste struktura përgjegjëse ka marrë masat duke dërguar shkresë zyrtare nr/21398 prot., datë 20.12.2022 pranë drejtorisë Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Shërbimit Mbështetës për të mundësuar kontaktet me ish punonjësit që nuk kanë dorëzuar materialet.

Me shkresën nr. 11324 prot., datë 01.07.2022, me lëndë “Dërgohet raporti përfundimtar mbi inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave, sipas inventarit kontabël datë 31.03.2022”, komisioni i inventarizimit ka njohur Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtorin e Financës dhe Buxhetit, Drejtorin e Shërbimeve Mbështetëse, me rezultatet e inventarizimit si edhe me procesverbalin e të gjithë punonjësve që zotërojnë asetet dhe procesverbalin e magazinës. Në këtë raport janë paraqitur edhe problematikat e dala nga procesi i inventarizimit për tu trajtuar nga komisioni i vlerësimit më tej.

2-Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2022, në administratën e DPT

Me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, Urdhri nr.13801 prot., datë 11.08.2022 është ngritur komisioni “Komisioni i Vlerësimit të vlerave në magazinën e DPT”. Ky komision ka bërë vlerësimin e aktiveve në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi si edhe ka trajtuar dhe adresuar problematikat e paraqitura nga komisioni i inventarizimit. Pas përfundimit të vlerësimit komisioni ka hartuar procesverbalin e vlerësimit për listën e materialeve të verifikuara duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre. Komisioni i vlerësimit ka përpiluar relacionin e vlerësimit nr.13801/2, datë 02.09.2022, bashkëngjitur është edhe lista e materialeve të saktësuara për jashtë përdorimit. Në relacion, komisioni i vlerësimit ka gjykuar të ngrihen disa komisione ;

- Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve ,
- Ngritja e Komisionit të ri të kalimit Kapital të përbashkët me AKSH për konkludimin e plotë dhe të menjëhershëm të mallrave sipas VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017.
- Ngritja e Komisionit për nxjerrjen në rezervat e shtetit të automjeteve.
- Sistemimi i mallrave ndërmjet punonjësve nga magazina dhe ndryshimi i të dhënave të plotësuara për vlerësim.
- Pjesë e komisionit duhet të jetë edhe një punonjës SHLVL.

Me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, Urdhri nr.116 prot., datë 08.09.2022 është ngritur komisioni “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të automjeteve për nxjerrje jashtë përdorimi në inventar të DPT”. Në këtë urdhër citohet se raporti përfundimtar duhet të dërgohet brenda datës 18.09.2022. Në zbatim të këtij urdhri është mbajtur

procesverbali nr.1 datë 16.09.2022 ku është përshkruar procedura e ndjekur për çdo aktiv lidhur me nxjerrjen jashtë përdorimit. Procesverbali mban vlerësimin teknik për çdo automjet i shoqëruar edhe me foto. Në datë 20.09.2022 është dërguar raporti i vlerësimi të automjeteve në zbatim të urdhrin nr.116, datë 08.09.2022. Në raport është kërkuar të vazhdohet procedura për transferim pranë rezervave të shtetit për automjetet që do të nxirren jashtë përdorimit:
Tabela nr.112 Automjetet që janë nxjerrë jashtë përdorimit

Në lekë

Kodi Artikullit	EMERTIMI	Njesia	Nr.llog .inventariale	Sasia	Cmimi
AQ0351	Autoveture opel Frontera 3084300	cope	2151120	1.00	3,084,300
AQ0352	Autoveture Foristrade 3385235	cope	2151120	2.00	3,385,235
AQ0380	Autoveture `Bora` 2500000	cope	2151120	1.00	2,500,000
AQ0551	Autovetore NISAN Terrane viti 1999 ndin CAFAO 2145012	cope	2151120	1.00	2,490,878

Burim : të dhënat nga DPT

Me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, Urdhri nr.1380/5 prot., datë 20.09.2022 është ngritur komisioni “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve në inventar të DPT“. Me shkresën nr.13801/9, datë 18.10.2022 është dërguar raporti përfundimtarë mbi procedurën e ndjekur nga komisioni. Komisioni ka bërë ndarjen e aktiveve që jashtë përdorimit por që janë të riciklueshme dhe do të ndiqet procedura e shitjes në ankand. Me anë të shkresës nr. 13801/7 prot., datë 14.10.2022 ka përcjelle pranë drejtorisë së mbështetjes listën e aktiveve që do të zbatohet procedura me ankand. Sipas komunikimit me subjektin, po vijohet me procedurën e ankandit. Procedura e ndjekur nga dy komisionet është në përputhje me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisioni ka identifikuar aktivet të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit si jashtë funksionit për të cilat për shkak të natyrës nuk mund të përdoren më dhe janë për asgjësim si proces verbal, akcize etj. Më datë 10.10.2022 në ambientet e shtypshkronjës se Letrës me vlerë u realizua procedura e asgjësimit. Për këtë procedurë është mbajtur procesverbali datë 10.10.2022. Aktivet e tjera të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit si jashtë funksionit për të cilat për shkak të natyrës nuk mund të përdoren më duhet të asgjësohen. E gjithë procedura e asgjësimit është dokumentuar nga ana e komisionit nëpërmjet procesverbalit të mbajtur 30.09.2022 për këtë qëllim .

Me Urdhrin e Brendshëm nr.125, datë 29.09.2022, është ngritur grupi i punës ku AKSHI ka marr në ngarkim Aktivet për infrastrukturën harduere dhe sistemeve IT, në zbatim të Urdhrin të Përbashkët nr.1, datë 19.10.2022, për AKSHI Nr. 6541 Prot., datë 19.10.2022 dhe DPT Nr. 13801/10 Prot., datë 19.10.2022 është finalizuar procesi i kalimit të pajisjeve dhe softuere të sistemeve:

1. E-TAX
2. M-TAX
3. Fiskalizimi - “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”
4. AEOI - “Sistemi i shkëmbimit të informacionit”

Kalimi i asetëve konfirmohet me shkresën e AKSHI-t Nr.7535/1, datë 07.12.2022 për marrjen në dorëzim të aktiveve. Konstatohet se procesi inventarit nuk është finalizuar i plotë pasi nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të softuere-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim gjatë vitit 2022.

Mbi procedurën e inventarizimit të Drejtorive Rajonale Tatimore kanë dalë urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit. Ky proces ka përfunduar brenda afateve të përcaktuara në urdhër dhe përpara hartimit të pasqyrave financiare, sipas të dhënave si vijon: DRT Fier, përfunduar procesi i inventarizimit më datë 29.12.2022; DRT Durrës, përfunduar procesi i inventarizimit më datë 30.12.2022 ; DRT Vlorë, përfunduar procesi i inventarizimit

më datë 04.01.2023; DRT Shkodër ka përfunduar procesi i inventarizimit me datë 30.12.2022; DRT Kukës, përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2022; DRT Elbasan përfunduar procesi i inventarizimit më 31.12.2022; DRT Korë përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2022; DRT Dibër, përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2022; DRT Berat, përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2022; DRT Sarandë përfunduar procesi i inventarizimit më 15.12.2022; DTM, përfunduar procesi i inventarizimit më 15.02.2023; DRT Tiranë, përfunduar procesi i inventarizimit më 28.02.2023, DRT Gjirokastrë përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2022, DRT Lezhë përfunduar procesi i inventarizimit më 31.12.2022.

Nga sa më lart rezulton se :

- Anëtari i komisionit z.H K është njëkohësisht edhe përgjegjës material për Magazina Bileta transporti dhe Magazina Pulla, Taksa, Tarifa. Nga auditimi konstatohet se përbërja e komisionit të inventarizimit është në shkelje më Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë publike”, pika 82 ku citohet *”Anetarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin.”*

- Komisioni i inventarizimit nuk ka vepruar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë publike”, pika 83 ku citohet se *“Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material “.*

- Nuk është kryer procedura e dorëzimit të detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13 dhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30.

- Nga auditimi konstatohet se edhe përgjatë vitit 2022 në zbatim të VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” , i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës së kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të softëare-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim. Kjo situatë ka bërë që i gjithë procesi i kalimit kapital të mos konkludohet ndër vite.

Titulli i gjetjes	Mangësi në procesin e inventarizimit.
Situata:	Anëtari i komisionit të inventarit, ngritur me Urdhrin nr. 8408 prot., datë 19.05.2022 <i>“Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj”</i> është njëkohësisht edhe përgjegjës material për Magazinën “Bileta transporti dhe Magazina Pulla, Taksa, Tarifa”, në shkelje më Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë publike”</i> , pika 82.“ Komisioni i inventarizimit nuk ka vepruar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë publike”</i> , pika 83 se nuk është fiksuar numri i fletëve para kontrollit, para fillimit të inventarit. Rezulton se puna nuk është kryer procedura e dorëzimit të detyrës për 12 raste punonjës të larguar nga puna , në mënyrë korrekte dhe në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e</i>

	<p><i>sektorit publik</i>”, pika 13 dhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 “<i>Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30.</i></p> <p>Përgjatë vitit 2022 nuk është finalizuar procesi i kalimit të inventarit në zbatim të VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për “<i>Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit</i>” , i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës së kalimit të asetëve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të softuerë-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim. Kjo situatë ka bërë që i gjithë procesi i kalimit kapital të mos konkludohet brenda vitit 2022.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë publike</i>”, kreu IV ”Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 82, Kreu I, pika 13; VKM nr. 124, datë 17.2.2016 “<i>Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri tek pika 30.</i></p> <p>VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për “<i>Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit</i>” , i ndryshuar, neni IV pika 18.</p>
Ndikimi:	Mangësitë në procesin e inventarizimit të aktiveve ndikojnë në informacionin mbi saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar.
Shkaku	Mos njohje e legjislacionit dhe mos kryerje e procesit të inventarizimit sipas procedurave të miratuara.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Strukturat përgjegjëse në DPT të marrin masa që të kryhet një proces i kujdesshëm i inventarit, si edhe të merren masa për sistemimin e situatës për materialet e pa dorëzuara nga ish punonjësit, me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike.</p> <p>Strukturat përgjegjëse në DPT dhe struktura përgjegjëse në AKSHI-t të marrin masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për kalimin e asetëve nga DPT tek AKSHI, me qëllim finalizimin sa më të shpejtë të këtij procesi.</p>

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z.C.K. me detyrë Nënpunës Autorizues dhe strukturat përgjegjëse dhe përfajqësuesë nga AKSHI dhe Znj. D.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar DPT me anë të shresës nr. 284/8 prot.,date 06.09.2023 ka sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim si më poshtë:

Në lidhje me konstatimin “Nga auditimi konstatohet se edhe përgjatë vitit 2022 në zbatim të VKM nr.673, datë 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës së kalimit të asetëve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit në burim të softëare-ve, si dhe dhomës së serverave tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim.”

Kalimi Kapital i përbashkët tek AKSHI ka qenë një nga kërkesat 5-vjeçare ku Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është drejtuar AKSHI-t për konkludim dhe një pjesë e mirë e tyre u realizua në dhjetor të vitit 2022. Moskalimi kapital si rezultat i kodit në burim nuk është përgjegjësi e titullarit të institucionit e mbi të gjitha atij aktual pasi pasja e sistemeve të vjetra shumëvjeçare në DPT dhe VKM nr.673, datë 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”,

nuk e parashikon një situatë të tillë. Për këtë arsye komisioni i vlerësimit ka parashtruar këtë kërkesë AKSH-it, si dhe në relacionet e kalimit kapital është vendosur klauzola ku AKSHI të bëjë një saktësim sesi do procedohet për këto asete, pasi ky është një problem institucional dhe jo vetëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Pra kjo gjetje nuk mund të pranohet pasi konkludimi i kalimit kapital nuk varet vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe rasti i kalimit të sistemeve të vjetra nuk është i parashikuar në VKM-në nr.673.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar DPT, grupi i auditimit gjykon se :
Nga auditimi rezulton se edhe përgjatë vitit 2022 nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës së kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit në burim të software-ve, si dhe dhomës së serverave tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim në zbatim të VKM nr.673, datë 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar neni IV pika 18, sic e keni shkruar edhe ju në observacion “...një pjesë e mirë e tyre u realizua në dhjetor të vitit 2022..”. Procesi i kalimit kapital nuk rezulton i përfunduar kjo e faktuar nga shkresa, Kalimi i aseteve konfirmohet me shkresën e AKSHI-t Nr.7535/1, datë 07.12.2022 për marrjen në dorëzim të aktiveve.

Për sa më lart argumentet e sjella nga subjekti, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

Mbi hartimin e pasqyrave financiare

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare të DPT dhe të Konsoliduarat të vitit 2022,
- Ditari i Bankës,
- Libri i Madh,
- Aktrakordimet me Degën e Thesarit,
- Inventarët etj.,

I. Pasqyrat Financiare të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 5208 prot., datë 20.03.2023 në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshme”.i ndryshuar me Udhëzimin n.5, date 21.02.2022. Të gjitha pasqyrat financiare janë të firmosura nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi autorizues, përkatësisht znj. D C dhe z. C K.

Pasqyrat financiare të aparatit të DPT, si dhe pasqyrat e konsoliduar përmbajnë përmbajnë të gjitha pasqyrat që përcaktohen në pikën 25 dhe 26 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, i ndryshuar :

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese;
- Formati 6 - Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Formati 8 - Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Bashkangjitur pasqyrave të mësipërme të aparatit të DPT, janë kartelat e llogarive.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar u përqëndrua në vlerësimin e saktësisë së veprimeve dhe përputhshmërisë ligjore nga struktura përgjegjëse mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare

dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe të ardhurave të rakorduar me degën e Thesarit.

Në zbatim të ligjit të buxhetit, evidentimi i veprimtarisë financiare, mbajtja e kontabilitetit dhe konsolidimi i llogarive vjetore, realizohet në 15 njësitë e sistemit tatimor, 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku administrimi i llogarive të shpenzimeve administrative të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është detyrë funksionale e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Gjendja e llogarive të aktiveve të Aparatit të DPT-së, për vitin 2022, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.113 Aktivitet e Aparatit të DPT-së

Në lekë

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi Paraardhës 2021	Diferenca 2022-2021
A	A K T I V E T	1,318,369,144	2,324,208,417	-1,005,839,273
	I.Aktivitet Afat shkurtra	521,186,880	1,183,524,101	-662,337,221
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	9,565,872	8,566,397	999,475
520	Disponibilitete ne Thesar	9,565,872	8,566,397	999,475
	2.Gjendje Inventari qarkullues	26,581,070	51,401,026	-24,819,956
31	Materiale	25,562,583	47,050,318	-21,487,735
32	Inventar I imët	62,473	68,938	-6,465
35	Mallra	956,014	4,281,770	-3,325,756
	3.Llogari te Arketushme	51,339,274	172,692,568	-121,353,294
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoha	769,485	769,485	0
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	50,569,789	171,923,083	-121,353,294
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	433,700,664	950,864,110	-517,163,446
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	433,700,664	950,864,110	-517,163,446
	II.Aktivitet Afat gjata	797,182,264	1,140,684,316	-343,502,052
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	24,291,460	26,101,460	-1,810,000
202	Studime dhe kërkime	24,291,460	26,101,460	-1,810,000
21	2.Aktive Afatgjata materiale	772,890,804	1,114,582,856	-341,692,052
212	Ndërtesa e Konstruksione	121,945,813	107,322,423	14,623,390
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	154,685,768	883,180,930	-728,495,162
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	439,771,575	86,301,756	353,469,819
215	Mjete Transporti	28,959,515	13,927,316	15,032,199
218	Inventar ekonomik	27,528,133	23,850,432	3,677,701
	4.Investime	0	0	0
231	Per Aktive Afatgjata materiale	0	0	0

Burim : të dhënat nga DPT

Totali i Aktivit për vitin 2022 është 1,318,369,144 lekë, ku krahasuar me vitin paraardhës rezulton me pakësim në vlerën 1,005,839,273 lekë. Aktivitet Afatshkurtra paraqiten në shumën 521,186,880 lekë, duke zënë rreth 40 % të totalit të aktiveve, me një pakësim prej 662,337,221 lekë krahasuar me vitin 2020. Aktivitet Afatgjata paraqiten në shumën 797,182,264 lekë, duke zënë rreth 60 % të totalit të Aktivit, me një pakësim prej 341,692,052 lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Tabela nr.114 Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(vlera neto)gjatë vitit 2022

Në lekë

E m e r t i m i	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
I. Aagj/ jo materiale	30,707,600	4,606,140	26,101,460	2,796,140	4,606,140	0	0	33,503,740	9,212,280	24,291,460
Studime dhe kërkime	30,707,600	4,606,140	26,101,460	2,796,140	4,606,140			33,503,740	9,212,280	24,291,460
II. Aagj/ materiale	2,024,512,252	909,929,395	1,114,582,857	473,376,210	76,468,500	1,260,488,982	521,889,219	1,237,399,480	464,508,676	772,890,804
Ndërtime e Konstruksione	144,572,338	37,249,915	107,322,423	19,989,511	5,366,121			164,561,849	42,616,036	121,945,813
Rruge,rrjete,vepra ujore	1,404,010,786	520,829,856	883,180,930	0	49,594,811	1,091,392,544	412,492,193	312,618,242	157,932,474	154,685,768

Instalime teknike,makineri, paisje, vegla pune	217,511,094	131,209,338	86,301,756	383,035,753	13,276,050	110,090,985	93,801,101	490,455,862	50,684,287	439,771,575
Mjete transporti	100,035,825	86,108,509	13,927,316	24,922,847	2,865,171	21,871,125	14,845,648	103,087,547	74,128,032	28,959,515
Inventar ekonomik	158,382,209	134,531,777	23,850,432	45,428,099	5,366,347	37,134,328	750,277	166,675,980	139,147,847	27,528,133
Totali (i+ii)	2,055,219,852	914,535,535	1,140,684,317	476,172,350	81,074,640	1,260,488,982	521,889,219	1,270,903,220	473,720,956	797,182,264

Burim : të dhënat nga DPT

Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik për aktivet afatgjata jo materiale dhe materiale në përputhje me normat e amortizimit në pikën 36 të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve është llogaritur sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”.

Aktivet Afatshkurtra paraqiten në shumën 521,186,880 lekë dhe përbëhen nga:

-Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre përfaqësojnë vlerën neto të llogarisë 520 “Disponibilitete ne Thesar” e cila rezulton të jetë në shumën 9,565,872 lekë, me një rritje prej 999,475 lekë krahasuar me një vit më parë, e cila rakordon në pasiv me llog 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

-Gjendje Inventari qarkullues përfaqëson vlerën totale të llogarive 31 “Materiale” (25,562,583 lekë), 32 “Inventar i imët”(62,473 lekë) dhe 35 “Mallra”(956,014 lekë) në vlerën totale prej 26,581,070 lekë ose 24,819,956 lekë më pak se një vit më parë, ku pjesën më të madhe të këtij zëri e zë llog. 31 “Materiale” e cila përbëhet nga materialet kancelarie dhe të përdorimit të zyrës për punën e përditshme (Lapsa, Stilolapsa, Tonera, Letër A4 etj, Shtypshkrime (Proces-Verbale, Akt-Konstatime, Fatura Tatimore, Fatura të Thjeshta, Fletë Shoqërimi etj), Karburant, Vula të ndryshme.

Aktivet Afatgjata paraqiten në shumën 797,182,264 lekë dhe përbëhen nga:

-Aktive Afatgjata jo materiale përfaqësojnë vlerën neto të aktiveve afatgjata jo materiale të cilat rezultojnë të jenë në shumën 24,291,460 lekë, me një pakësim prej 343,502,052 lekë krahasuar me një vit më parë për shkak të amortizimit. Kjo llogari përfaqëson kontributin vjetor Fiscalis 2020 apo shpenzime për trajnime në zbatim të ligjit nr. 1/2015, datë 29.01.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen në programin e unionit “Fiscalis 2020”.

- Aktivet Afatgjata Materiale përfaqësojnë vlerën neto të aktiveve afatgjata materiale në shumën 772,890,804 lekë, e cila vjen si rezultat i zbritjes së amortizimit të këtyre aktiveve në shumën prej 464,508,676 lekë nga kosto historike e tyre prej 1,237,399,480 lekë. Të detajuara sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në vlerën 121,945,813 lekë përfaqëson vlerën e ndërtesës së Aparatit të DPT dhe rezulton me rritje krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 14,623,391 lekë, si rezultat i amortizimit ku norma e amortizimit të aplikuar është 5% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018. Kjo vlerë rakordohet me vlerën e inventarizimit të aktiveve .

Tabela nr.115 Amortizimi i llogaritur per llogarinë “Ndërtime dhe konstruksione”

Në lekë

EMERTIMI	Vlera	Amortizimi akumuluar	Vlera mbetur 31/12/2021
Ndertesa 123260639	89,368,285.00	30,474,589	61,993,363.95
Rikonstrukcion ndertese 15/12/2016 3637947	3,637,947.00	852,604	2,931,939.72
Rikonstrukcion DPT tarrace,fasade 31.12.2018 14,549,091	14,549,091.00	2,698,765	12,474,026.90
Rikonstrukcion DPT vendosje sitemi i kondicionimit 31.12.2018 23,790,788	23,790,788.00	4,413,042	20,397,626.86
Muri Rretues 2007 12925030	13,226,230.00	4,177,039	9,525,464.71
Rikonstrukcion godine	19,989,511		19,989,511
Shuma 212	144,572,341.00	42,616,040	107,322,422.15

Burimi: nga të dhënat DPT

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 154,685,758 lekë përfaqëson vlerën e programe, softje, licenca informatike së Aparatit të DPT-së e cila rakordon me vlerën neto të pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto), Formati 7/b. Krahasuar me vitin e mëparshëm rezulton me ulje në shumën 728,495,162 lekë. Si rezultat i përlllogaritjes së amortizimit në vlerën 412,492,193 lekë dhe janë bërë dalje 1,091,392,544 leke. Për aktivet e llogarisë 213 është aplikuar norma e amortizimit 25%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 439,771,575 lekë përfaqëson vlerën e motogeneratorë, server, HP storage, hardware, kondicionerë, etj informatike të Aparatit të DPT dhe rezulton me rritje krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 353,469,819 lekë. Gjithashtu rritja ka ardhur dhe si rezultat i përlllogaritjes së amortizimit për vitin 2022 në vlerën 13,276,050 lekë. Janë bërë hyrje 383,035,753 lekë ,përmirësuar Oracle storage,blerë oracle database, oracle real etj. Për aktivet e llogarisë 214 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 28,959,515 lekë e cila rezulton me rritje krahasuar me vitin 2021 prej 15,032,199 lekë si rezultat i hyrjes së dy automjeteve në shumën 24,922,847 lekë dhe aplikimit të amortizimit në vlerën 2,865,171 lekë dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të 5 automjeteve. Për aktivet e llogarisë 215 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018, pika nr.36.

Tabela nr.116 Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”

Në lekë

	Gjendje	Amortizimi vitit 2022	Vlera mbetur 31/12/2022
Autovetura tip Volksäagen Touareg Tr 0213 N 4400000 Viti 2007	4,400,000	-	-
Autovetura Mitsubishi,V80 (PAJERO)3200 cc 4284000	21,420,000	171,360	685,440
Autovetore NISAN Terrane viti 1999 ndin CAFAO 2145012	-	99,635	-
Autoveture Santa Fe 2868000 v.11/09	2,868,000	22,944	91,776
Automjet AA693LA Volsvagen nr sh ËV1ZZZ7HZFH089726 2015	3,187,094	-	-
Autovetute Peugeot 308AA368LK Nr Sh VF3LB9HPAFS037494 (2015) 1923208	1,923,208	-	-
Autoveture Peugeot 308 AA 827LH Nr Sh VF3LB9HPAFS039559 (2015) 19223208	1,923,208	165,742	662,967
Automjet Toyota Rav 4 viti 2016 5102269	51,022,690	1,972,965	18,096,397
Automjet scoda 4804099	4,804,099	240,205	960,820
Autoveture peugeot 308 aa196li nr sh vf3lb9hpafs032716 (2015) 1923208	1,923,208	96,160	384,642
Autoveture peugeot 308 aa142lk nr sh vf3lb9hpafs037494 (2015) 1923208	9,616,040	96,160	8,077,474
Shuma 215	103,087,547	2,865,171	28,959,515

Burim : të dhënat nga DPT

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 27,528,133 lekë rezulton me rritje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 3,677,701 lekë, si rezultat i aplikimit të amortizimit në vlerën 4,616,070 lekë dhe daljeve në shumën 37,134,328 lekë dhe hyrje në vlerën 45,428,099 lekë.

Për aktivitet e llogarisë 218 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

-Investimet përbëhen nga “Aktive Afatgjata materiale”, për këtë vit nuk është bërë asnjë investim.

Gjendja e llogarisë të pasivit të Aparatit të DPT-së, për vitin 2022, krahasuar me vitin paraardhës dhe fondi i konsoliduar paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.117 Pasivet e aparatit të DPT

Në lekë

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi Paraardhës 2021	Diferenca 2022-2021
B	PASIVET(DETYRIMET)	494,605,811	1,132,123,077	-637,517,266
	I.Pasivet Afat shkurtra	494,605,811	1,132,123,077	-637,517,266
	1. Llogari te Pagueshme	494,605,811	1,132,123,077	-637,517,266
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	13,807,314	79,107,632	-65,300,318
42	Detyrime ndaj personelit	18,667,091	16,890,594	1,776,497
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	2,880,811	2,653,531	227,280
435	Sigurime Shoqërore	5,705,101	5,140,649	564,452
436	Sigurime Shëndetësore	791,269	713,291	77,978
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	9,565,873	8,566,398	999,475
467	Kreditore te ndryshëm	442,418,867	1,018,281,497	-575,862,630
4341	Operacione me shtetin(detyrime)	769,485	769,485	0

Burim : të dhënat nga DPT

Llogari të Arketushme

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” e aktivitet e cila paraqitet në shumën 769,485 lekë dhe rakordon në pasiv me llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” e cila përbëhet nga: llog 423: Debitorë të vjetër në vlera monetare/materiale O. S., S.J., M. S.); llog 429: Debitorë të vjetër sipas urdhër zhdëmtimeve për mjetet në ngarkim “J. Sh.” etj.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në shumën 50,569,789 lekë, përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të Dhjetorit 2021, e cila së bashku me llog 486 në shumën 433,700,664 lekë, kuadrojnë me llog:

- Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 13,807,314 lekë;
- Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 18,667,091 lekë,
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 2,880,811 lekë,
- Llogaria 435 “Detyrime për sigurime shoqërore” në vlerën 5,705,101 lekë,
- Llogaria 436 “Detyrime për sigurime shëndetësore” në vlerën 791,269 lekë dhe llog 467 në vlerën 442,418,867 lekë.

Sipas Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë: a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

- Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;
- Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

- Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;
- Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Në lekë

Llogaria	Vlera
Llog 486	433,700,664
Llog 4342	50,569,789
Total	484,270,453

Llog 401	13,807,314
Llog 421	18,667,091
Llog 431	2,880,811
Llog 435	5,705,101
Llog 436	791,269
Llog 438	-
Llog 467	442,418,867
Total	484,270,453

Burimi:Përpunuar sipas të dhënave të DPT

- Të tjera aktive afatshkurtra përfaqëson vlerën neto të llogarisë 486 “ shpenzime te periudhave te ardhshme” e cila paraqitet në shumën prej 433,700,664 lekë me përbërjen si vijon:

Tabela nr.118 Gjendja e llogarisë “Shpenzimet te periudhave të ardhshme”

Në lekë

Detyrimi	Vlera e detyrimit
F	220,809,444
B	55,343,943
G	20,278,603
Gjyqfituesit (ish punonjës)	137,268,674
Totali	433,700,664

Burimi:Përpunuar sipas të dhënave të DPT

Në pikën 42 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, përcaktohet se të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore zërin e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, për të cilat do të përdoret llogaria 486 “*Shpenzime për periudhat e ardhshme*”, në varësi të natyrës së tyre. Vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 rezulton me rënie krahasuar me vitin paraardhës, ku këto detyrime paraqiteshin në shumën rreth 950 milion lekë, afërsisht 517 milion lekë më pakë. Konstatohet se kjo llogari nuk rakordon me vlerën e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, e cila rezulton ne vlerën 442,418,867 lekë, me diference 8,718,203 lekë më pak. Kjo pasi përveç shumës prej 433,700,664 të llog 467 janë përfshirë edhe detyrimet të lindura në muajin dhjetor 2022 që do të paguhet në muajin janar 2023.

Nga auditmi u konstatua se në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provigjone, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr.6, “Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara”, pika nr. 47, si dhe “Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 ku thuhet:

“Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t’u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë nëse:

- Njësia ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur;
- Është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të jetë e nevojshme për të përmbushur detyrimin; si dhe - Mund të bëhet një parashikim i besueshëm mbi vlerën e detyrimit”.

Nevoja e parashikimit të provizionit në DPT lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna dhe me vendime të tjera lidhur me tatimpaguesit.

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore paraqitet në vlerën -24,819,956 lekë e detajuar sipas tabelës.

Tabela nr.119 Rezultati i veprimtarisë ushtrimore

Në lekë

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi Paraardhës 2021	Diferenca 2022-2021
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	823,763,333	1,192,085,340	-368,322,007
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	823,763,333	1,192,085,340	-368,322,007
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	848,583,289	1,198,526,945	-349,943,656
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	(24,819,956)	-6,441,605	-18,378,351
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,318,369,144	2,324,208,417	-1,005,839,273

Burim : të dhënat nga DPT

Titulli i gjetjes	Mos llogaritje e provizioneve dhe krijim i detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore.
Situata:	Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provizione për shpenzimet që mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t'u paguar nga ana e njësisë. Nevoja e parashikimit të provizionit në DPT lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, me vendime gjyqësore të tjera lidhur me tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se DPT për vitin 2022 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 433 milion leke nga të cilat janë për çështje tatimore në vlerën 296,432 mijë lekë dhe në vlerën 137,268 mijë lekë janë detyrimet e prapambetura të krijuara nga vendimet gjyqësore për ish punonjës. Krijimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet se vjen edhe nga mosllogaritja e detyrimit të mundshëm në formën e provizioneve për planifikimin e fondeve në kohë. Nga kërkesa për informacion mbi databasën e të dhënave të vendimeve gjyqësore drejtuar DPT u vendos në dispozicion vetëm lista e pasqyruar në llogarinë 486, c'ka e bën të pamundur vlerësimin e efektit të detyrimeve të mundshme nga vendimet gjyqësore për DPT nga ana e grupit të auditimit. Për këto arsye konstatohet mos koordinim ndërmjet strukturave të ngarkuara me ndjekjen e vendimeve gjyqësore dhe atyre të ngarkuara me shlyerjen e vendimeve gjyqësore për përlllogaritjen e efekteve në shpenzimet e vendimeve gjyqësore në kohë me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura.
Kriteri:	Standardin Kombëtar të kontabilitetit nr.6, "Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara", pika nr. 47. Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 34.
Ndikimi:	Mos llogaritja e provizioneve në pasqyrat financiare të DPT për shpenzimet që mund të ndodhin në të ardhmen rrit riskun potencial për mos likuidimin në kohë të detyrimit e lindura.
Shkaku	Vështirësitë e shfaqura për ta plotësuar këtë kriter në sektorin publik.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e titullarit të DPT-së të përcaktohen procedura konfirmuese mbi vendimet gjyqësore dhe efektin e pritshëm të tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore me qëllim shmangien e efekteve negative për buxhetin e shteti. DPT t'i bëjë të ditur MFE që të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ku konkretisht Sektori i Kontabilitetit të kësaj drejtorie të marrë masat për shqyrtimin e situatës, në mënyrë që të përcaktohen edhe procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike në zbatim të kuadrit ligjor.

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z.C.K. me detyrë Nënpunës Autorizues dhe strukturat përgjegjëse dhe përfaqësues nga AKSHI dhe Znj. D.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me anë të shkresës nr. 284/8 prot., datë 06.09.2023 ka sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim si më poshtë :

Në lidhje me konstatimin “ Mos llogaritje e provizioneve..” , Në njohje të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3 “Procedura për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 referon: “Provizionet si edhe në SKK , përkatësisht SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” Fusha e zbatimit, pika 6 : Termi “provision” përdoret shpesh në kontekstin e zërave të tillë si amortizimi, zhvlerësimi i aktiveve dhe llogari të arkëtueshme të pambledhshme. Citimi i elementëve të mësipërm tregon qartazi disa veprime për të cilat nuk mund të marrim angazhim mbi njohjen e provigjoneve pasi: Në zbatim të Udhëzimit nuk plotësohen kriteret e njohjes së provigjionit; Në bazë të Udhëzimit në Pasqyrat Financiare të miratuara nuk ka zë “Provigjione”; Nuk ka aktive/asete të cilat plotësojnë kriterin e njohjes së provigjionit ; “ Provigjioni “ do të ngarkojë në mënyrë fiktive , jo reale detyrimin e institucionit; Njohja pas shkallës së dytë të procesit të apelimit - aktualisht sot janë detyrime të prapambetura, sepse në DFB çdo proces që është mbyllur në shkallë apelimi lind detyrim i prapambetur jo provigjon. Proceset gjyqësore zgjasin 10-vite, si do të mbahen në provigjon apo detyrim? Gjykojmë se kjo gjetje nuk është ende e mundur të zbatohet si në njohje të Udhëzimit, por edhe të SKK-ve por është e pamundur edhe në aspektin praktik të saj. DFB nuk e pranon si gjetje, si mënyrë të përsëritur mbi këtë qasje, por nëse është e mundur nga ana e KLSH-së një orientim mbi zbatueshmërinë e saj.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar DPT, grupi i auditimit gjykon se :
*Bazuar në Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 34 referon: “Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që të do të ketë një detyrim për t’u paguar nga ana e njësisë”. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat të kenë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto provizione duhet të njihen dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet bëhen si mëposhtë: Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime: Debitohet llog. 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit”; dhe Kreditohet llog.150 “Shuma të parashikuara për rreziqet e shpenzime”. Në rastin konkret për DPT janë vendimet gjyqësore me tatim pagesit si edhe vendimet gjyqësore me punonjësit e larguar nga puna, apo investimet. Pra institucioni juaj ka ngjarje të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tu paguar nga njësia jua, ndaj edhe duhet të alokohen fonde për këto rast në mënyrë që të shmangim efektin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Shkresa bashkëngjitur observacionit, Shkresa nr.13377 prot., datë 09.08. 2023 drejtuar MFE mbi rregjistrimin e provizioneve nga DPT, nuk do të konsiderohet në raportin përfundimtarë, pasi është marrë jashtë periudhës së objekt auditimit.
 Për sa më lart argumentet e sjella nga subjekti, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.*

Tabela nr.120 Pasqyra e performancës financiare viti 2022

Në lekë

Llog	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi Paraardhës 2021	Diferenca 2022-2021
A	TE ARDHURAT	3,076,704,202	2,554,143,052	522,561,150
72	V.GRANTE KORENTE	3,076,704,202	2,554,143,052	522,561,150
720	1.Grant korrent i Brendshëm	3,076,704,202	2,554,143,052	522,561,150
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	2,064,889,498	1,587,592,169	477,297,329
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	961,244,915	794,627,800	166,617,115
7206	Financim I pritshëm nga buxheti	50,569,789	171,923,083	-121,353,294

B	SHPENZIMET	3,101,524,158	2,560,584,657	540,939,501
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	273,297,663	259,323,349	13,974,314
6001	Paga, personel i përhershëm	273,297,663	259,323,349	13,974,314
6002	Paga personel i Përkohshëm			0
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	45,645,029	42,886,664	2,758,365
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	45,645,029	42,886,664	2,758,365
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	1,290,644,116	1,002,504,812	288,139,304
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0	
	V.TRANSFERIME KORENTE	1,467,117,394	1,255,869,832	211,247,562
604	1.Transferime korente të brendshme	1,449,109,969	794,375,798	654,734,171
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	1,449,109,969	794,375,798	654,734,171
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0		
605	2.Transferime korente me jashtë	1,720,625	2,226,722	-506,097
6051	Transferime Per Organizatat Ndërkombëtare	0	2,226,722	-2,226,722
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individë	16,286,800	459,267,312	-442,980,512
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	16,286,800	459,267,312	-442,980,512
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	24,819,956	6,441,605	
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES	-24,819,956	-6,441,605	
	(Rezultati I Veprimtarisë së vitit Ushtrimor)			0

Burim : të dhënat nga DPT

Llogaria 7200 “Grante korrente nga Buxheti Qendror” është pasqyruar në vlerën 2,064,889,498 lekë, afërsisht 477,297 mijë lekë më shumë se viti paraardhës.

Llogaria 7206 “Financimi i pritshëm nga buxheti” është paraqitur si kundërpadi e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 50,569,789 lekë si një detyrim që shteti ka kundrejt institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Llogaria 7205 “Financim shtese për të ardhurat e krijuara brenda sistemit”, përbëhet nga shuma e përdorur nga të ardhurat për shpenzime, shuma 961,244,915 leke , afërsisht 166,617 mijë lekë më shumë se viti paraardhës.

Llogaria 600 “Paga dhe Përfitimet e punonjësve “ është pasqyruar në vlerën 273,297,663 lekë, afërsisht 13,974 mijë lekë më shumë se viti 2021.

Llogaria 602 “Blerje Mallrash “ është pasqyruar në vlerë 1,290,644,116 lekë, afërsisht 288,139 mijë lekë më shumë se viti i kaluar.

Transfertat korente janë pasqyruar 1,467,117,394, afërsisht 211,247 mijë lekë më shumë se vitit i kaluar.

Krahasuar me vitin paraardhës, në total llogaria e të ardhurave është rritur me 522,561 mijë lekë më shumë dhe llogaria e shpenzime në total është rritur me 540,939 mijë lekë .

Tabela nr.121 Pasqyra e Flukseve Monetare(Cash Flow)

Në lekë

EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi Paraardhës 2021
VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	42,063,312	125,961,760
Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	2,211,624,996	1,695,475,980
Arkëtime e të hyra(Cash), gjatë vitit ushtrimor	963,195,494	949,537,678
Te hyra nga ardhurat jo tatimore (+)	900,951,104	815,335,679
Te tjera, arkëtuar(+)	61,244,915	134,201,999.00
Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	-3,132,757,178	-2,519,051,898
Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-2,171,512,263	-1,587,592,169
Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-2,629,930	-2,629,930
Te tjera te paguara (-)	-961,244,915	-928,829,799
VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	40,239,726	11,071,145
Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	571,640,000	553,858,088
Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-531,400,274	-542,786,943
TRANSFERTA E TE TJERA	-81,303,563	-139,662,835
Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-951,104	-20,707,879
Transferime ne buxhet te Fondeve të pa përdorura(-)	-80,352,459	-118,954,956
Lëvizje e brendshme e transfertat te tjera(+/-)		

Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare	999,475	-2,629,930
Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	8,566,397	11,196,327
Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	9,565,872	8,566,397

Burim : të dhënat nga DPT

Në këtë pasqyrë janë pasqyruar fonde buxhetore të akorduara për shpenzime korrente të vitit 2022, shpenzimet e vitit ushtrimor, fondet buxhetore të akorduara për investime dhe shpenzimet e investimeve. Teprica e likuiditetit në fund të vitit ushtrimor është 999,475 lekë dhe rakordon me vlerën e fondeve disponibilitet në thesar.

II. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr.7540, datë 28.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT (NA) dhe miratuar nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ), në përputhje me pikën 120 të Udhëzimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshme”, i cili përcakton se këto pasqyra duhet të përfundojë brenda muajit Prill të vitit pasardhës. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të firmosura në çdo faqe nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi autorizues, në zbatim të UMFE nr.8, datë 09.03.2018.

Këto pasqyra hartohen nga DPT duke përmbledhur informacionin respektiv të pasqyrave financiare të hartuara nga DPT, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës pranë DPT dhe DRT Berat, Durrës, Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Vip. Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës pranë DPT bazuar në raportet e fund vitit në sistemin C@TS ka hartuar pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara të cilat janë dërguar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës me shkresën nr. 3793/3 prot., datë 20.04.2023, dhe është marrë në dorëzim nga DBF datë 24.04.2023.

Nga auditimi u konstatua se DRT Vlorë, DRT Gjirokastrë, DRT Elbasan, DRT Tirane kanë dërguar PF në DPT jashtë afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, pika 117 “Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit.” Nga auditimi i dokumenteve në dispozicion konstatua se DRT Kukës, DRT Durrës, DRT Lezhe, DRT Fier, DRT Gjirokastrë mungon akt rakordimi me thesarin sipas përcaktimeve të Udhëzimit 8, pika 29.

Tabela nr.122 Pasqyra e Pozicionit financiar, e konsoliduar për vitin 2022.

Në lekë

Emertimi	Viti ushtrimor 2022	Viti paraardhës	Diferenca
A.A K T I V E T	436,544,423,174	383,373,521,491	53,170,901,683
I.Aktivt Afat shkurtra	435,232,745,298	381,617,724,613	53,615,020,685
1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	177,120,315,671	142,668,723,845	34,451,591,826
Disponibilitete ne Thesar	177,120,315,671	142,668,723,845	34,451,591,826
2.Gjendje Inventari qarkullues	90,788,586	124,818,291	(34,029,705)
Materiale	52,605,220	78,088,729	(25,483,509)
Inventar I imet	4,850,875	5,482,504	(631,629)
Mallra	33,332,491	41,247,058	(7,914,567)
3.Llogari te Arketushme	257,587,848,377	237,873,318,367	19,714,530,010
Personeli, parardhenie, deficite, gjoba	805,141	805,141	-
Debitore te ndryshem	149,520,810,842	139,091,469,226	10,429,341,616
Operacione me shtetin(Te drejta)	108,066,232,394	98,781,044,000	9,285,188,394
4.Te tjera aktive afatshkurtra	433,792,664	950,864,110	(517,071,446)
Shpenzime te periudhave te ardhshme	433,792,664	950,864,110	(517,071,446)
II.Aktivt Afat gjata	1,311,677,876	1,755,796,878	(444,119,002)
1.Aktive Afatgjata jo materiale	24,291,460	26,101,460	(1,810,000)
Studime dhe kerkime	24,291,460	26,101,460	(1,810,000)

2.Aktive Afatgjata materiale	1,287,386,415	1,729,695,418	(442,309,003)
Toka, Troje, Terene	16,194,396	16,194,396	-
Ndertesa e Konstruksione	478,777,962	554,618,393	(75,840,431)
Ruge, rrjete, vepra ujore	154,722,366	883,228,516	(728,506,150)
l'instalime teknike, makineri e paisje	465,405,534	114,709,319	350,696,215
Mjete Transporti	58,711,845	55,217,648	3,494,197
Inventar ekonomik	113,107,258	104,964,679	8,142,579
Aktive afatgjata te demtuara	467,054	762,467	(295,413)
3.Aktive Afatgjata Financiare	-	-	-
4.Investime	-	-	-
B.PASIVET(DETYRIMET)	435,141,896,910	381,489,856,521	53,652,040,389
I.Pasivet Afat shkurtra	435,141,896,910	381,489,856,521	53,652,040,389
1. Llogari te Pagushme	435,141,896,910	381,489,856,521	53,652,040,389
Furnitore e llogari te lidhura me to	19,398,541	82,838,037	(63,439,496)
Detyrime ndaj personelit	88,929,984	87,036,012	1,893,972
Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	9,239,765	9,618,066	(378,301)
Sigurime Shoqerore	25,634,590	24,885,635	748,955
Sigurime Shendetsore	3,582,429	3,437,423	145,006
Institucione te tjera publike	7,142,043	5,267,471	1,874,572
Kreditore per mjete ne ruajtje	177,113,113,826	142,663,396,572	34,449,717,254
Kreditore te ndryshem	108,353,239,749	99,524,092,938	8,829,146,811
Operacione me shtetin(detyrime	149,521,615,983	139,089,284,367	10,432,331,616
2.Te tjera pasive afatshkurtra	-	-	-
II.Pasivet Afat Gjata	-	-	-
C.AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,402,526,264	1,883,664,970	(481,138,706)
D.FONDI I KONSOLIDUAR :	1,402,526,264	1,883,664,970	(481,138,706)
Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,436,555,969	1,879,595,896	(443,039,927)
Rezultatet e mbartura			-
Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	(34,029,705)	4,069,074	(38,098,779)
Te Tjera	-	-	-
TOTALI I PASIVEVE(B+C)	436,544,423,174	383,373,521,491	53,170,901,683

Burim : të dhënat nga DPT

Aktivitet paraqiten në pasqyrat e konsoliduara me vlerën 436,544,423,174 leke. Krahasuar me vitin paraardhës janë me rritje afërsisht 53,170,901,683 lekë më shumë.

Aktivitet Afat shkurtra të pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT për vitin 2022 paraqiten në vlerën 435,232,745,298 lekë, ku krahasuar me vitin paraardhës rezultojnë me rritje në vlerën 53,615,020,685 lekë. Nga detajimi i këtij zëri rezulton se rritja më e lartë vjen nga Mjetet monetare dhe ekuivalent të tyre e cila përbëhet vetëm nga llog **520 "Disponibilitet në Thesar"** e cila paraqitet në vlerën 177,120,315,671 lekë, me një rritje prej 31,451,591,826 lekë krahasuar me vitin paraardhës. Kjo llogari përbëhet nga:

Tabela nr.123 Gjendja e disponibilitet në thesar

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për llog 520 "Disponibilitet në Thesar"	PF
59,803	DRT Fier
177,110,689,996	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës
9,565,872	DPT
177,120,315,671	Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Rubrika Inventari qarkullues në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar të DPT për vitin 2022 paraqiten në vlerën 90,788,586, ku krahasuar me vitin paraardhës rezultojnë me ulje në vlerën 34,029,705 lekë, përbërë nga:

- Llog 31 "Materiale" në vlerën 52,605,220 lekë;
- Llog 32 "Inventar i imët" në vlerën 4,850,875 lekë;
- Llog 35 "Mallra" në vlerën 33,332,491 lekë.

Rubrika “Llogaritë e Arkëtueshme” e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT, paraqiten në shumën **257,587,848,377** lekë e cila zë 59 % në totalin e Aktiveve Afat shkurtra. Krahasuar me vitin 2021, llogaritë e arkëtueshme janë rritur me vlerën 19,714,530,010 lekë dhe përbëhen nga:

a-Llogaria 423, 429 “Detyrime të personelit për paradhënie e gjoba” në shumën 805,141 lekë (e mbartur nga vitit 2021), e cila zë një peshë shumë të vogël në totalin e Aktiveve Afatshkurta. Në bilancin e aparatit të DPT kjo vlerë është 769,485 lekë.

b-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 149,520,810,842 lekë ose 34% e totalit të Aktiveve Afatshkurtra. Kjo llogari pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera, brenda dhe jashtë sistemit C@TS.

c- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në shumën 108,066,232,394 lekë ose 25% e totalit të Aktiveve Afatshkurta. Kjo llogari 4342 sëbashku me llogarinë 486, rakordon me llogaritë kundër parti të pasivit sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, e detajuar si më poshtë:

Tabela nr.124 Gjendja e llogarise 4342

Në lekë

Llogaria	Vlera
Llog 486	433,792,664
Llog 4342	108,066,232,394
Total	108,500,025,058
Llog 401	19,398,541
Llog 421	88,929,984
Llog 431	9,239,765
Llog 435	25,634,590
Llog 436	3,582,429
Llog 438	
Llog 467	108,353,239,749
Total	108,500,025,058

Burim : të dhënat nga DPT

Në këtë llogari janë pasqyruar detyrimet afatshkurtra te muajit dhjetor 2022 për tu likuiduar në vitit 2023.

Rubrika “Të tjera aktive afatshkurtra” e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT, ka vlerën 433,792,664 lekë dhe përbëhet vetëm nga **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, e cila pasqyron shpenzimet që do të kryhen në periudhat pasardhëse, përbëhet nga shpenzimet për vendime gjyqësore. Kjo llogari (486) përbëhet nga vlera 433,700,664 lekë e pasqyruara në llogarinë 486 të pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-s dhe vlera 92,000 nga DRT. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 486 është ulur për vlerën 517,071,446 lekë.

Analiza e llogarisë 468 “Debitorë te ndryshëm”

Në pasqyrat financiare të Aparatit të DPT llogaria 468 “Debitorë te ndryshëm” ka vlerën 0 (zero) lekë. Në pasqyrat financiare të konsoliduara Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 149,520,810,842 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga:

Tabela nr. Gjendja e llogarise 468 “Debitor të ndryshëm”

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për 468 “Debitorë të ndryshëm”	PF
18,567,238	DRT Shkodër
149,502,243,603	Pasqyrat financiare të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës
149,520,810,842	Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, ka vlerën 149,520,810,842 lekë, në të cilën përfshihet vlera e pasqyrave të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës (DKS) prej 149,502,243,603 lekë, si dhe llogaria e DRT Shkodër në vlerën 18,567,238 lekë. Vlera e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,

përbënë 34% e totalit të aktiveve afatshkurtra. Sipas të dhënave të bilancit vlera e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në 31.12.2022 ka një rritje prej 10,429,341,616 lekë më shumë se në vitin 2021.

Nga auditimi konstatohet se llogaria 468 “*Debitore te ndryshëm*” 149,520,810,842 lekë, “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” (805,141 lekë) kuadron me llog 4341 “*Operacione me shtetin -Detyrime*” (149,521,615,983 lekë).

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera brenda dhe jashtë sistemit C@TS, ka vlerën 149,502,243,603 lekë nga të cilat detyrimet e pasqyruara në sistemin C@TS janë në vlerën 147,148,518,789 lekë ndërsa detyrimet e kontabilizuara por të mbajtura jashtë sistemit C@TS janë në vlerën 2,353,724,814 lekë. Sqarojmë se në bilancin konsoliduar të DKS nuk është e përfshirë vlera debitorë 18,567,238 lekë për DRT Shkodër, e paraqitur në llogarinë 468 të bilancit të DRT Shkodër.

Situata debitor gjendje me 31.12.2022 në vlerën 149,502,243,603 lekë është e kuadruar me analizën e llogarisë 468 sipas tatimit (tabela në vijim).

Peshën me të madhe të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e zë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 52,682,237,131 lekë ose 34 % të totalit, tatimi mbi fitimin në vlerën 40,686,516,357 lekë ose 27 % e totalit. Përbërja e llogarisë 468 sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr.125 Detyrimet gjendje ne sistem me 31.12.2022

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrime gjendje në Sistem me 31.12.2022
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	2,149,186,164
7001	- Tatim mbi fitimin	40,686,516,357
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	3,283,373,832
7009	- Tjera tatime	5,846,654,743
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	52,682,237,131
7031	- Akciza	2,106,993,328
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	3,530,360,079
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	410,194,271
7050	- Taksa e rrugës	11,296,396,072
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	21,249,550
7115	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	7,268,064,864
75	Sigurime shoqërore e shëndetësore	20,219,941,150
	Sigurime shoqërore	17,928,369,230
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	8,734,121,496
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	9,194,247,734
	Sigurime shëndetësore	2,291,571,920
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	1,071,784,623
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	1,219,787,297
	1 % Grante	1,076,062
	Totali	149,502,243,603

Burim : të dhënat nga DPT

Tabela në vijim paraqet gjendjen e detyrimeve me 31.12. 2022, jashtë sistemit C@TS :

Tabela nr.126 Gjendjen e detyrimeve me 31.12. 2022, jashtë sistemit C@TS

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrime te pasqyruara ne kontabilitetin e DPT ne C@TS dhe Jashtë Sistemit ne DRT per Tatime, Sigurime e Financa shpenzime 31.12.2022
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	4,542,205
7001	- Tatim mbi fitimin	1,945,256
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	1,017,655
7009	- Tjera tatime	12,754,490
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	6,194,564
7031	- Akciza	2,106,993,328
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	-
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	-
7050	- Taksa e rrugës	165,000
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	-
7115	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	10,113,513
75	Sigurime shoqërore e shëndetësore	208,922,741

	Sigurime shoqërore	171,565,365
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	77,419,400
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	94,145,965
	Sigurime shëndetësore	37,357,376
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	29,601,812
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	7,755,564
	1 % Grante	1,076,062
	Totali	2,353,724,814

Burim : të dhënat nga DPT

Tabela e mëposhtme paraqet totalin e detyrimeve sipas llojit, të paraqitura në sistemin C@TS dhe detyrimet që mbahen jashtë sistemit.

Tabela nr.127 Detyrimet tatimore sipas llojit, të paraqitura në sistemin C@TS dhe detyrimet që mbahen jashtë sistemit.

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrimet tatimore gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2019	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2020	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2021	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2022	Diferenca 2022-2021
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	58,993,901	58,993,901.00	56,844,018	4,542,205	(52,301,813)
7001	Tatim mbi fitimin	2,883,175	2,772,290.00	2,772,290	1,945,256	(827,034)
7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogël	63,750	63,750.00	63,750	1,017,655	953,905
7009	Tjera tatime	17,556,858	17,556,858.00	18,655,210	12,754,490	(5,900,720)
7030	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	10,609,113	10,609,113.00	10,609,113	6,194,564	(4,414,549)
7031	Akciza	2,107,792,556	2,107,792,556.00	2,107,792,556	2,106,993,328	(799,228)
7032	Takse mbi shërbimet specifike (Lojëra fati)	0	-	-	0	-
7033	Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	0	-	-	0	-
7050	Taksa e rrugës	331,675	165,000.00	165,000	165,000	-
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	0	-	-	0	-
7115	Gjoha dhe kamatvonesa,sekustrime e zhdëmtime	10,113,513	10,113,513.00	10,113,513	10,113,513	-
75	Sigurime shoqërore e shëndetësore	217,302,943	217,302,943.00	213,798,546	208,922,741	(4,875,805)
	Sigurime shoqërore	178,924,414	178,924,414.00	175,781,514	171,565,365	(4,216,149)
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	142,287,358	148,345,324.00	105,016,303	77,419,400	(27,596,903)
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	36,136,855	30,579,090.00	70,765,211	94,145,965	23,380,754
	Sigurime shëndetësore	38,378,529	38,378,529.00	38,017,032	37,357,376	(659,656)
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	34,283,457	34,031,663.00	35,524,103	29,601,812	(5,922,291)
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	4,095,072	4,346,866.00	2,492,929	7,755,564	5,262,635
	Të tjera	60,562,530	60,562,530.00	3,468,220		(3,468,220)
	Shtypshkrime	1,125,267	1,144,724.00	861,694		(861,694)
	1 % Grante	795,254	1,273,976.00	1,593,423	1,076,062	(517,361)
	Pulla (me çmim blerje)	307,582,788	321,467,297.00	288,222,896		
	Totali	2,795,713,322	2,809,818,452	2,714,960,228	2,353,724,814	(361,235,414)

Burim : të dhënat nga DPT

Pra, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,353,724,814 lekë, i cili paraqiten me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 361,235,414 lekë. Sipas informacionit, situata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo të gjitha deklaratat tatimore ishin të informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin në ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore. Pjesën me të madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,106,993,328 lekë i përket vetëm 1 tatimpaguesi, “A.” sha me Nipt J.....D sipas informacionit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikave nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem. Diferenca tjetër përfaqëson detyrim të ndryshime të papaguara të akumuluar ndër vite për disa subjekte të ndryshëm që nuk kanë qenë të regjistruar në sistem tatimor.

Aktivet Afat gjata në fund të vitit 2022 janë 1,311,677,876, kundrejt vlerës 1,755,796,878 lekë në vitin 2021 dhe përbëhen nga aktivet afatgjata jo materiale në vlerën 24,291,460 lekë dhe nga aktivet afatgjata materiale në vlerën 1,287,386,415 lekë. Krahasuar me vitin 2021, aktivet afatgjata janë zvogëluar në vlerën 444,119,002 lekë.

Pesha specifike e aktiveve afatgjata materiale të aparatit të DPT-së zë rreth 61 % të aktiveve të qëndrueshme të pasqyrave të konsoliduar. Tabela në vijim paraqet aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale të aparatit të DPT-së, si dhe peshën specifike që zë secili zë i aktiveve të aparatit te aktivet e konsoliduar të DPT.

Tabela nr.128 Aktivet e DPT

Në lekë

Nr. Llog.	EMERTIMI	I Konsoliduar 2022	Aparati	Pesha
	I. Aktive Afatgjata jo Materiale	24,291,460	24,291,460	100
202	Studime dhe kërkime	24,291,460	24,291,460	100
	II. Aktive Afatgjata Materiale	1,287,386,415	772,890,804	60
210	Toka, troje, terrene	16,194,396		
212	Ndërtime e Konstruksione	478,777,962	121,945,813	25
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	154,722,366	154,685,768	100
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	465,405,531	439,771,575	94
49215	Mjete transporti	58,711,845	28,959,515	49
21248	Inventar ekonomik	113,107,258	27,528,133	24
24	Aktive te Qend.te trupëzuara te demtuara			
TOTALI (I + II)		1,311,677,876	797,182,264	61

Burim : të dhënat nga DPT

Për aktivet është llogaritur amortizimi në përputhje me normat e përcaktuara në pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Vlera e llogarisë 20 e Pasqyrës 7/b kuadron me vlerën e llogarisë 20 të pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu totali i llogarive 20-28 i pasqyruar në pasqyrën 7/b kuadron me vlerën totalë të llogarive 20-28 të pasqyrës së pozicionit financiar.

Pasivet në bilancin e konsoliduar të DPT janë në vlerën 435,141,896,910 lekë. Këto përbëhen vetëm nga pasivet afatshkurtra ku sipas rubrikës 1. **“Llogari të pagueshme”** paraqiten në vlerën 435,141,896,910 lekë në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022 dhe përbëhet nga:

-Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, në pasqyrat e konsoliduara të DPT ka vlerën 19,398,541 lekë, nga e cila vetëm vlera e aparatit të DPT është 13,807,314 lekë.

Në 31.12.2021 llogaria 401-408 ka vlerën 82,838,037 lekë, pra gjatë vitit 2022 kjo llogari është ulur me vlerën 63,439,496 lekë.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 88,929,984 lekë. Kjo llogari përfaqëson detyrimet që institucioni ka ndaj personelit për pagën neto muaji dhjetor 2022.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 9,239,765 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit për TAP për muaji dhjetor 2022.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 25,634,590 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit për muajin dhjetor 2022.

Vlera e kësaj llogarie për aparatit e DPT është 5,705,101 lekë.

-Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 3,582,429 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit për muajin dhjetor 2022.

- Llogaria 44 “Institucione të tjera publike” në bilancin e konsoliduar të DPT ka vlerën 7,141,043 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 177,113,113,826 lekë përbëhet nga :

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për 466 “Kreditorë per mjete ne ruajtje”	PF
9,565,873	DPT
177,103,547,953	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës
177,113,113,826	Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar

Burim : të dhënat nga DPT

Situata e llogarisë 466 sipas të dhënave të DKS për vlerat e pasqyruara në sistemin C@TS, për vitin 2022, progresive dhe ato që i përkasin vitit 2022 paraqiten në vijim:

Tabela nr. 129 Llogaria 466 progresive

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	PROGRESIVE (31.12.2022)	VITI 2021 (31.12.2022)
4665	Depozitime te tjera (per tu sistemuar ne te Ardhmen)	142,639,786,687.00	34,473,704,161.00
4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje , Te vitit ushtrimor	-	
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	646,951,420.00	81,086,444.00
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	134,463,319,691.00	34,041,881,792.00
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	3,124,668,035.00	184,223,821.00
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	1,892,592,510.00	713,214.00
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	18,688,940.00	492,367.00
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojërave të fatit	5,491,353.00	115,562.00
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	50,285,605.00	1,296,201.00
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjokat	38,750,765.00	3,821,599.00
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sigurime shoqërore, shëndetësore dhe TAP)	1,523,579,880.00	155,707,330.00
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimit e Thjeshtuar	875,458,488.00	4,365,831.00
4665599	Te ardhura ne llogarinë pezull per tatime dhe sigurime	-	
Total		142,639,786,687.00	34,473,704,161.00

Burim : të dhënat nga DPT

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT ka vlerën 108,353,239 lekë, përbëhet nga :

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për 467 “Kreditorë te ndryshëm”	PF
5,123,482	DRT Shkoder
5,507,541	DRT Lezhe
80,024	DRT Kukes
107,900,109,835	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës
442,418,867	DPT
108,353,239,749	Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar

Burim : të dhënat nga DPT

Përbërja e llogarisë 467 sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës në vlerën 107,900,108,836 lekë (Detyrime te pasqyruara ne kontabilitetin e DPT ne C@TS dhe Jashtë Sistemit ne DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime) paraqitet në tabelën e mëposhtme, krahasuar me situatën në vitin paraardhës:

Tabela nr. 129 Përbërja e llogarisë 467 sipas të dhënave nga DKS

Në lekë

Nr llogarisë	Emërtimi	Detyrime Kreditorë Gjendje me 31.12.2021	Detyrime Kreditorë Gjendje me 31.12.2022
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	570,058,600.00	580,524,750
7001	- Tatim mbi fitimin	13,534,872,951.00	15,279,903,091
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	1,225,812,941.00	1,214,284,114
7009	- Tjera tatime	1,847,871,648.50	1,869,289,104
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	75,342,375,088.00	83,058,863,041
7031	- Akciza	73,115,289.00	78,563,454
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	69,538,007.00	68,806,685
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	12,433,887.00	8,091,395
7050	- Taksa e rrugës	6,778,058.00	6,820,032

7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	6,681,328.00	6,255,584
7115	- Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrim e zhdëmtime	82,048,907.00	74,907,256
75	Sigurime shoqërore e shëndetësore	5,551,831,823.21	5,653,782,738
	ARKA RREGJISTRUSE	190,145.00	
	SHTYPSHKRIME	216,282.00	
	PULLA (ME ÇMIM BLERJEJE)	173,334,535.15	
	Grante(e lidhur me TFTH ,transferuar NJV)		18,592
Total		98,497,159,489.86	107,900,109,836

Burim : të dhënat nga DPT

Detyrimet Kreditore te pasqyruara ne kontabilitetin e DPT jashtë sistemit ne DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime dhe ato në C@TS të ndara paraqiten si më poshtë:
Tabela nr.130 Detyrimet kreditore jashtë sistemit c@ts

Në lekë

Nr llogarisë	Emërtimi	Jashtë Sistemit ne DRT per Tatime, Sigurime	Detyrime Kreditore te pasqyruara ne C@TS	Detyrime ne C@TS dhe Jashtë Sistemit ne DRT per Tatime, Sigurime
		1	2	3+1+2
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	45,534,581	534,990,169	580,524,750
7001	- Tatim mbi fitimin	34,343,591	15,245,559,500	15,279,903,091
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	1,192,087	1,213,092,027	1,214,284,114
7009	- Tjera tatime	12,544,852	1,856,744,252	1,869,289,104
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	43,970,075	83,014,892,966	83,058,863,041
	Nga kjo Stoku i Rimbursimit të TVSH	-	-	-
7031	- Akciza	78,563,454		78,563,454
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	1,000,000	67,806,685	68,806,685
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	555,723	7,535,672	8,091,395
7050	- Taksa e rrugës		6,820,032	6,820,032
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore		6,255,584	6,255,584
7115	- Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrim e zhdëmtime	2,175,125	72,732,131	74,907,256
75	Sigurime shoqërore e shëndetësore	109,280,964	5,544,501,774	5,653,782,738
	Sigurime shoqërore	108,782,524	5,488,906,550	5,597,689,074
	Sigurime shëndetësore	498,440	55,595,224	56,093,664
	Grante(e lidhur me TFTH ,transferuar NJV)	18,592	-	18,592
Total		329,179,044	107,570,930,792	107,900,109,836

Burimi:Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në llogarinë 467 pozicionohen te gjitha kreditë e deklaruar nga tatimpaguesit (TVSh-ja), mbi pagesat e rezultuara për çdo rast kur detyrimi ne deklarate është me i vogël se pagesa e kryer gjate vitit (për tatim fitimin), çdo rivlerësim ne ulje i një akti administrativ detyrimet e te cilit janë paguar me pare se të fillojë procesi i ankimimit te aktit administrative nga ana e tatimpaguesit.

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në shumën 34,029,705 lekë kuadron me Pasqyrën Formati 2 “Performanca Financiare”.

Tabela nr.131 Rezultati i veprimtarisë ushtrimore

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Viti 2022	Viti 2021
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,402,526,264	1,883,664,970
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,402,526,264	1,883,664,970
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,436,555,969	1,879,595,896
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	34,029,705	4,069,074
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	436,544,423,174	383,373,521,491

Burim : të dhënat nga DPT

Nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës është realizuar hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022 për 14 DRT dhe Aparatin. Nga auditimi rezultoi se hartimi i pasqyrave financiare është realizuar sipas dispozitave ligjore të cituara më lartë. Gjithashtu nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të konsoliduara të vitit 2022 rezultoi se të dhënat e pasqyruara në pasqyrat financiare (si në aktiv dhe pasiv) janë të kuadruara me të dhënat e dërguara nga DRT (bilancet) dhe nuk rezultuan diferenca sipas llogarive përkatëse.

2.8. Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion.

Për auditimin e kësaj çështjeje u morën në shqyrtim:

- *Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;*
- *Rregullore për funksionimin dhe organizimin e ATQ;*
- *Rregullore për marrëdhëniet e punës së personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore;*
- *Procedurat për vakancat, rekrutimet, emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve;*
- *Trajnimet e punonjësve;*
- *Dosjet personale dhe vlerësimet e tyre;*
- *Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;*
- *Administrimi i marrëdhënieve të pagave.*

Organizimi i përgjithshëm i Administratës Tatimore Qendrore (ATQ).

Administrata Tatimore Qendrore është institucion qendror, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE). Organigrama e ATQ miratohet nga Ministri i MFE, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ajo përbëhet nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me vendndodhje në Tiranë, si dhe
- 14 Drejtori Rajonale Tatimore.

2.8/a Struktura organizative e ATQ.

Struktura e ATQ është përcaktuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, i ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 152, datë 19.11.2020, e cila përmban 1450 punonjës në total. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, është përcaktuar struktura organizative e DPT, me 308 punonjës në total. Në lidhjet e tjera bashkëlidhur urdhrin, janë përcaktuar strukturat organizative të Drejtorive Rajonale Tatimore (DRT).

Me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”, është miratuar nga Ministri i MFE, rregullorja e funksionimit të ATQ. Në rregullore janë përcaktuar dispozitat e përgjithshme, funksionimi i strukturës për çdo drejtori e sektor, si dhe janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme për çdo pozicion, konform dispozitave ligjore. Me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar rregullorja e brendshme “Për marrëdhënien e punës të personelit jo nëpunës civilë, në ATQ”. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen ndaj të gjithë kandidatëve për punësim në administratën tatimore, si dhe ndaj punonjësve të administratës tatimore që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Respektimi i strukturës organizative të miratuar të ATQ, si dhe krahasimi me faktin për periudhën objekt auditimi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, për muajt e zgjedhur, rezultoi se nuk janë plotësuar dhe as tejkaluara numri i punonjësve në DPT, edhe për njësitë përbërëse të saj, (drejtori apo sektor), e paraqitur më e detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 132 Krahasimi plan/fakt i numrit të punonjësve në DPT, periudha Janar – Dhjetor 2022

Nr.	Muajt	Janar	Mars	Qershor	Gusht	Tetor	Dhjetor
Nr. Punonjës plan		308	308	308	308	308	308
Nr. Punonjës fakt		254	257	260	261	259	259
Realizimi në %		82.5%	83.4%	84.4%	84.7%	84.1%	84.1%

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të mësipërme, u konstatua se struktura është realizuar nga planifikimi, mesatarisht me 83.9 %. Mungesa e vazhdueshme e punonjësve në strukturën e administratës tatimore, tregon problematikat që ka institucioni në menaxhimin e burimeve njerëzore, risk për mosrealizimin e objektivave, si dhe funksionimin e institucionit.

2.8/b Administrimi i marrëdhënieve të punës në respektimin e dispozitave ligjore për planifikimet, vakancat, rekrutimet, emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve, në vitin 2022.

Marrëdhëniet e punës në ATQ, për nëpunësit e shërbimit civil rregullohen me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; për punonjësit jashtë shërbimit civil rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore. Sipas strukturës së miratuar, në DPT rezultojnë 196 punonjës pjesë të shërbimit civil dhe 112 punonjës me kod pune, për vitin 2022.

Planifikimi i punonjësve pjesë të shërbimit civil.

Në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të pikës nr. 4, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, DPT ka dorëzuar në DAP planifikimin vjetor të vendeve vakante, me email-in e datës 28.12.2021, e jo me shkresë zyrtare. Sipas dokumentit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në të gjithë ATQ rezultojnë 135 pozicione vakante.

Në zbatim të pikës nr.3/a, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka përcjellë në DAP, edhe listën e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, gjatë vitit 2022. Në rubrikën Aneks, është paraqitur Tabela nr. 2 “Plani vjetor i punonjësve të ATQ, për vitin 2022”.

Pozicionet vakante dhe procedura e rekrutimit të punonjësve pjesë e shërbimit civil nëpërmjet DAP-it.


Pozicionet vakante në ATQ, DAP ka filluar t’i shpallë në muajin qershor të vitit 2022. Në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, dorëzuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DAP, planifikimi për vitin 2022, ka qenë 135 pozicione vakante në të gjithë ATQ. Ndërkohë DAP ka realizuar 45 shpallje për 48 pozicione vakante përgjatë vitit, pra rreth 35.5% të nevojave, për rekrutim. Nga 135 pozicione vakante janë plotësuar 41 prej tyre, ose 30.4%.

Struktura e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore përbëhet nga 23 punonjës. Kjo drejtori në fund të vitit 2022, ka funksionuar me 65.2% të kapacitetit të saj. Si rezultat i vakancave të punonjësve me status të nëpunësit civil, DPT nuk ka funksionuar me maksimumin e kapaciteteve të saj, por vetëm me 81.6%.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2022, DBNJ në DPT e ka ushtruar veprimtarinë e saj pa drejtues të nivelit të lartë, pasi me shkresën nr. 2299/1 prot, datë 15.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë transferimi i përkohshëm, i Drejtorit të DBNJ, në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT Tiranë. Gjithashtu edhe pozicioni i zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve, i cili ka në varësi DBNJ, ka qenë vakant.

DAP ka nxjerrë 45 shpallje për 48 pozicione vakante, janë shpallur fitues 41 kandidatë ose 85%, nga 48 pozicione vakante të shpallura.

Në rubrikën Aneks, është paraqitur Tabela nr. 3 “Pozicionet vakante në DPT, të punonjësve pjesë e shërbimit civil”.



Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Emërimi i punonjësve pjesë e shërbimit civil në ATO.

Nga auditimi me zgjedhje i punonjësve emëruar rishtaz brenda shërbimit civil u konstatua se, procedurat e ndjekura për emërimin e tyre nga DAP janë në përputhje me përcaktimet e nenit 23 dhe 24, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në dosjet e punonjësve ishin të arkivuara diplomatat përkatëse për pozicionet e kërkuara, vlerësimet vjetore të periudhës së provës nga eprorët direkt, shkresa e emërimit nëpunës civil në periudhë prove nga DAP, si dhe emërimi nga titullari i institucionit për fillimin e marrëdhënieve financiare.

Nga auditimi i procedurave të testimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, të cilat realizohen në DAP, nga Komiteti i Pranimin për Ngritjen në Detyrë (KPND), me 5 anëtarë, u konstatua se për kandidatët fitues, z. Gj.S. dhe znj. H.N., këto dokumente ishin mungesë në dosjet personale. Nga DBNJ na u komunikua se, “procedurat e konkurimit të pozicioneve të mesme drejtuese depozitohen vetëm nga DAP dhe nuk përcillen te Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT”.

Sa më sipër, VKM nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të cilat përcaktojnë të gjitha hapat që ndiqen gjatë procedurës për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët e të mesme drejtuese, nuk shprehin asgjë, në lidhje me këtë përgjegjësi të DAP-it.

Në dosjen personale të z. S., nuk rezultuan të arkivuara: certifikata familjare, vërtetim nga gjykata apo prokuroria e rrethit për dëshmi penaliteti, si dhe procesverbali i dorëzimit të detyrës së mëparshme, veprime këto në kundërshtim me kreun II, “Dosja e Personelit”, e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe Aneksi I dhe II të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit”.

Pozicionet vakante të punonjësve me kod pune në ATO.

Në strukturën organizative të DPT, rezultojnë 112 punonjës që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe me Rregulloren “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore”, e miratuar me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në tabelën më poshtë janë detajuar pozicionet vakante të punonjësve me kod pune, në drejtoritë përkatëse të DPT.

Tabela nr. 133 Pozicionet vakante në DPT, Janar dhe Dhjetor 2022

Nr.	Drejtoria në DPT	Sektori	Pozicioni Vakant	Nr. i pozicioneve Janar 2022	Nr. i pozicioneve Dhjetor 2022
1	Drejtoria e Hetimit Tatimor	Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave	Përgjegjës Sektori	1	1
		Sektori i Hetimit Tatimor	Inspektor	6	6
2	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren	Sektori i Koordinimit	Përgjegjës Sektori	1	
		Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit Task Forcë	Përgjegjës Sektori	1	
		Sektori i Trajtimit të Ankesave	Inspektor	2	1
3	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	Sektori i Shërbimeve të Brendshme	Shofer	1	2
4	Kabineti		Sekretar		1
	Total DPT			13	11

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e të dhënave të mësipërme u konstatua se, DPT në Janar 2022, ka pasur 13 pozicione vakante dhe 11 pozicione vakante në Dhjetor 2022. Nga grupi i auditimit të Klsh, u konstatua mosplotësimi i 6 pozicioneve vakante, në Sektorin e Hetimit Tatimor, të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në fund të vitit 2022. Në të gjithë ATQ nga auditimi rezultuan 22 pozicione vakante në Janar dhe 20 në Dhjetor 2022, të punonjësve me kod pune.

Procedura e rekrutimit dhe e emërimit të punonjësve me kod pune në ATQ.

Emërimet sipas pozicioneve të punës për vitin 2022, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela Emërimet me Kod Pune në ATQ, për vitin 2022

DPT	Me Kod Pune	31 emërimë 6 emërimë, këshilltarë në kabinet 2 emërimë, përgjegjës sektori 13 emërimë, inspektor hetimi 4 emërimë, protokollist 1 emërim, protokollist/arkivist 1 emërim, punonjës informacioni 3 emërimë, shofer 1 emërim, korrier	Burimi: Drejtor ia e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit
DRT	Me Kod Pune	26 emërimë 5 emërimë, llogaritar/arkëtar 13 emërimë, inspektor 2 emërimë, protokollist/arkivist 2 emërimë, sekretare 1 emërim, magazinier 1 emërim, shofer 1 emërim, korrier 1 emërim, sanitare	

Procedurat për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve me kod pune në ATQ, janë përcaktuar në Rregulloren “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore”, e miratuar me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se janë kryer 31 emërimë në DPT dhe 26 emërimë në DRT, me procedurën e përcaktuar në nenin 15 “Pranimi në punë pa konkurrin”, të kësaj rregulloreje.

Gjatë vitit 2022, nuk është kryer asnjë emërim i punonjësve me kod pune, sipas përcaktimeve të nenit 9 “Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve”, pika nr. 1, ku citohet se: “Përzgjedhja e kandidatëve për punësim në ATQ kryhet si rregull nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në plotësimin e kërkesave nga kandidatët për punësim”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 9, pika nr. 5 dhe 6/a citon: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: 6 a) mundësinë për punësim... duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit”.

Nga auditimi i procedurës së emërimit të z. M L, u konstatua se me Vendimin nr. 9, datë 28.01.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë emërimi i tij në pozicionin Këshilltar

Kabineti në DPT, kategoria e pagës III-a/1, në zbatim të nenit 15, pika d, të Rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në ATQ”. Në dosjen personale të z. L. ish-in të arkivuara diploma e integruar të nivelit të dytë (DIND), si dhe të gjitha dokumentet e nevojshme sipas përcaktimeve të nenit 2, të kontratës së punës në ATQ dhe kërkesave të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”. Vendimit të emërimit nga Titullari i Institucionit, i ishte bashkëngjitur kërkesa e z. L. për punësim në administratën tatimore, e cila mban të njëjtën datë me atë të emërimit, 28.01.2022, e protokolluar në DPT.

Planifikimi i punonjësve me kontratë të përkohshme.

Me shkresën nr. 22633 prot, datë 20.12.2021, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka përcjellë në MFE, kërkesën për miratim të punonjësve me kontratë të përkohshme. Me VKM nr. 35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”, për ATQ janë miratuar 300 punonjës me kontratë të përkohshme, për një periudhë 6 mujore me 8 orë/ditë, si dhe 43 punonjës për një periudhë 1 vjeçare, me 6 orë/ditë, për vitin 2022.

Në zbatim të këtij Vendimi, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr. 8, datë 28.01.2022 “Për detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022, pjesë e administratës tatimore”, si dhe urdhrin nr. 8/1, datë 1.02.2022, “Për përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022, pjesë e administratës tatimore”, ku janë përcaktuar kriteret e arsimit.

Emërimi i punonjësve me kontratë të përkohshme në ATQ.

Nga auditimi u konstatua se, nga 300 kontrata të përkohshme, për një periudhë 6 mujore me 8 orë/ditë, për të gjithë ATQ janë nënshkruar 268 të tilla. Ndërsa nga 43 kontrata për një periudhë 1 vjeçare me 6 orë/ditë, janë nënshkruar 37. Në fund të vitit 2022, planifikimi vjetor për punonjësit me kontratë të përkohshme, në të gjithë ATQ është realizuar me 88.9%. Detajimi i punonjësve me kontratë të përkohshme për DPT, si dhe sa punonjës kanë qenë pjesë e strukturës deri në fund të vitit 2022, është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 134 Detajimi i punonjësve me kontratë të përkohshme në DPT, plan/fakt për vitin 2022

Emërtimi i Drejtorisë	Plan / Punonjës Shërbimi Kontratë 6 mujore me 8 orë/ditë	Plan / Punonjës Shërbimi Kontratë 12 mujore me 6 orë/ditë	Fakt / Punonjës Shërbimi Kontratë 6 mujore me 8 orë/ditë	Fakt / Punonjës Shërbimi Kontratë 12 mujore me 6 orë/ditë	
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	35	8	Protokoll/arkiv 3	4	Protokoll/arkiv 2
			Sanitarë 3		Sanitarë 2
			Mirëmbajtje 2		Mirëmbajtje 1
Total 43			Total 37		

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i 3 dosjeve të emërimeve me kontratë të përkohshme në DTM, DRT Vlorë e Berat, u konstatua se, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT, janë arkivuar nga Sektorët e Shërbimeve Mbështetëse të drejtorive përkatëse, dosjet e të punësuarve. Nga verifikimi i tyre u konstatua se, të 3 kandidatët i plotësonin kushtet e arsimit në zbatim të urdhrin nr. 8/1, datë 1.02.2022, “Për përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022, pjesë e administratës tatimore” të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Mbi transferimet e përkohshme dhe të përhershme të punonjësve.

Gjatë vitit 2022, në ATQ janë kryer gjithsej 33 transferime të punonjësve të shërbimit civil. Në DPT janë kryer 6 transferime të përkohshme dhe 1 transferim i përhershme. Në DRT Rajonale janë kryer 18 transferime të përkohshme dhe 8 transferime të përhershme.

- Nga auditimi mbi procedurat e transferimeve të përkohshme, u konstatua se, me shkresën nr. 2299/1 prot, datë 15.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, pas Vendimit nr. 950/1 prot, datë 14.02.2022, të DAP-it, znj. V.T. nga pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, transferohet për një periudhë kohe deri në 6 muaj, “për interesa të institucionit”, në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Qendror), në DRT Tiranë. Me shkresën nr. 950/5 prot, datë 18.05.2022, DAP njofton përfundimin e transferimit të përkohshëm të znj. T., pas kërkesës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, me shkresën 2299/4 prot, datë 12.05.2022, për ndërprerje të periudhës së transferimit, për shkak të marrjes së lejes së barrë lindjes nga data 12.05.2022.

Transferimi i përkohshëm i znj. T., si dhe vakanca e pozicionit të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Progameve, përgjatë gjithë vitit 2022, deri në emërimin e znj. D.Ç. më datë 27.02.2023, pozicion që ka në varësi direkte, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT, ka sjellë që Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të qëndrojë pa drejtues të nivelit të lartë për 1 vit kalendarik.

- Nga auditimi u konstatua se, me Vendimin nr. 205, datë 13.06.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm, znj. M V është liruar nga pozicioni Protokollist, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në DPT dhe emërohet në pozicionin Protokollist/Arkivist, në Zyrën e Burimeve Njerëzore në DTM. Me Vendimin nr. 343, datë 03.10.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë lirimi i znj. V., nga pozicioni Protokollist/Arkivist, në Zyrën e Burimeve Njerëzore në DTM, si dhe rikthehet me emërim në pozicionin Protokollist, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në DPT.

Lirimi i znj. V. nga detyra në DPT, emërimi në DTM dhe rikthimi i saj po në DPT, për një periudhë 4 mujore, është bërë i paargumentuar. Në dosjen personale të punonjësës nuk ishte arkivuar asnjë dokument ku të vërtetonte arsyet që kanë sjellë këto transferime të shpeshta.

- Nga auditimi u konstatua se, sipas pikës nr. 4, neni 72 të “Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore”, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore “përgatit dhe zbaton strategjinë menaxhuese dhe planet operationale për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim, sipas vendeve të lira të krijuara, në bashkëpunim me zv. Drejtorin e Përgjithshëm”, një akt i tillë nuk është hartuar për punonjësit, marrëdhënia e të cilëve rregullohet me Kodin e Punës.

Në rubrikën Aneks, është paraqitur Tabela nr. 8 “Përmbledhje e transferimeve në DPT për vitin 2022”, si dhe Tabela nr. 9 “Përmbledhje e transferimeve në DRT Rajonale për vitin 2022”.

Mbi largimet e punonjësve nga puna.

Në vitin 2022, nga administrata tatimore kanë shkëputur marrëdhëniet e punës 106 punonjës gjithsej, 57 punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe 49 punonjës, të punësuar me kod pune. Në tabelën e mëposhtme janë detajuar numri i punonjësve të DPT dhe DRT-ve, sipas arsyeve të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Tabela nr.135 Ndërprerja e marrëdhënieve të punës së punonjësve të ATQ, viti 2022

Arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës	DPT		DRT		Shuma sipas arsyes së largimit
	Nëpunës Civil	Kod Pune	Nëpunës Civil	Kod Pune	
Lirim nga detyra me kërkesën e saj / e tij.	5	13	13	17	48
Lirim nga detyra/ dalë në pension.	4	1			

			25	10	40
Masë disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".	3	1	4		8
Zgjidhje e kontratës së punës për shkaqe të justifikuara.		1		4	5
Zgjidhje e kontratës së punës për shkaqe të pajustificuara.		1			1
Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës.		1			1
Emërim në një institucion tjetër.	1		1		2
Ndarë nga jeta.			1		1
Total	13	18	44	31	106
Grand Total	31			75	106

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Në analizë të dhënave të mësipërme, u konstatua se numri më i lartë i ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës, është me arsyen “Lirim nga detyra me kërkesë të saj/ tij” me 48 raste, ndjekur më pas me “Dalje në pension” me 40 raste.

Nga DPT janë larguar 31 punonjës gjithsej dhe nga DRT-të janë larguar 75 punonjës, në vitin 2022. Me numrin më të lartë të largimeve nga puna, pas DPT, rezultoi DRT Tiranë me 25 punonjës (10 nëpunës civil dhe 15 me kod pune).

Mbi largimet e punonjësve me Kod Pune nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT.

Në strukturën e DPT bën pjesë Drejtoria e Hetimit Tatimor, e cila ka në organigramën e saj, 60 pozicione pune. Sipas shkresave për zgjidhjen e kontratave të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, gjatë vitit 2022 u konstatua se, ka pasur 7 largime nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, 1 nga pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë, largim me kërkesë të tij, si dhe 6 largime, Inspektorë nga Sektori i Hetimit Tatimor në këtë drejtori. Nga këta: 4 largime me kërkesë të vetë punonjësve, 1 largim me vendimin nr. 139, “Masë disiplinore” Inspektorin A.B., si dhe 1 largim me vendimin nr. 385, “Zgjidhje e kontratës së punës për shkaqe të justifikuara” për inspektorin A.V.

Mbi largimet e punonjësve me Kod Pune nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DRT Tiranë (në Rajonin Qendror)

Struktura e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren të DRT Tiranë, ka në organigramën e saj, 65 pozicione pune. Sipas shkresave për zgjidhjen e kontratave të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, gjatë vitit 2022 u konstatua se, ka pasur 10 largime në total. Nga këto: 1 largim “Dalje në pension” në pozicionin Inspektor në Sektorin e Koordinimit, si dhe 9 largime nga të cilat: 1 largim “Dalje në pension” në pozicionin Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, 7 largime me kërkesë të vetë punonjësve në pozicion Inspektor, si dhe 1 largim me vendimin nr. 96, “Zgjidhje e menjëhershme të justifikuar e kontratës së punës” për Inspektorin O.U.

Mbi largimet e punonjësve me Kod Pune nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DRT Fier (në Rajonin Jugor)

Struktura e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren të DRT Fier, ka në organigramën e saj, 23 pozicione pune. Sipas shkresave për zgjidhjen e kontratave të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, gjatë vitit 2022 u konstatua se, ka pasur 3 largime në total. Nga këto: 2 largime me kërkesë të vetë punonjësve në pozicion Inspektor, në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren dhe Sektorin e Koordinimit, si dhe 1 largim me vendimin nr. 60, “Zgjidhje e kontratës së punës për shkaqe të justifikuara” për Inspektorin R.B. në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren.

Mbi largimet e punonjësve me Kod Pune nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DRT Shkodër (në Rajonin Verior)

Struktura e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren të DRT Shkodër, ka në organigramën e saj, 24 pozicione pune. Sipas shkresave për zgjidhjen e kontratave të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, gjatë vitit 2022 u konstatua se, ka pasur 1 largim me kërkesë të vetë Inspektorit në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren.

Mbi largimet e punonjësve nga puna, të trajtuara nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) DIBA, si dhe nga Komisioni i Disiplinës.

Drejtorja e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) DIBA, është strukturë e specializuar për parandalimin, zbulimin dhe hetimin administrativ e penal në administratën tatimore qendrore, në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Gjatë vitit 2022, nga kjo drejtori janë shqyrtuar 13 raste me shkelje. Nga këto, 11 raste kanë qenë për punonjës të shërbimit civil dhe 2 raste punonjës, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet me Kodin e Punës. Sipas vendimit të marrë pas trajtimit të rasteve, ato grupohen në:

Ndërprerje e ecurisë disiplinore – 5 raste;

Vërejtje me shkrim – 1 rast;

Pezullim ngritje në detyrë 6 muaj – 1 rast;

Pezullim ngritje në detyrë 2 vjet – 3 raste;

Largim nga shërbimi civil – 3 raste.

Nga auditimi i 5 praktikave me shkelje disiplinore, të cilat janë ndjekur nga DIBA, për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil: I. Ç, N.P., A.Q., E. S., M.V. u konstatua se Vendimet për rastet e shkeljeve janë marrë në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Si dhe nga auditimi i 2 praktikave për punonjësit me Kod pune: V.D., dhe F.I., Vendimet janë marrë në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Kreu VIII “Përgjegjësia, masat dhe procedurat disiplinore”, e rregullores së punonjësve me Kod Pune. Bashkëlidhur Vendimeve të marra nga Komisioni, u konstatuan: konstatimi i shkeljes, dokumente që faktojnë shkeljen, njoftimi fillim ecurie disiplinore, vendimi i Komisionerit për mbikëqyrjen e shërbimit civil (në rastin e A. Q).

Në rubrikën Aneks, është paraqitur Tabela nr. 11 “Raste me shkelje disiplinore të punonjësve të ATQ, trajtuar nga DIBA, për vitin 2022”.

Përveç Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) DIBA, që ndjekin rastet me shkelje nga ana e punonjësve, propozues për marrjen e masave disiplinore me qëllim inicimin e procedurës, janë edhe eprorët direkt, të drejtorive ku punonjësit janë pjesë e strukturës.

Komisioni Disiplinor në DPT, ka shqyrtuar 90 raste të shkeljeve disiplinore gjatë vitit 2022, të propozuara nga: eprori direkt, nga drejtoritë rajonale përkatëse, nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, si dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Në këto 90 raste shkeljesh: janë 75 punonjës nëpunës civil dhe 15 punonjës me kod pune.

Vendimet e marra nga komisioni disiplinor për nëpunësit civil:

Për masën “vërejtje” janë marrë 10 vendime: në 4 punonjës inspektor i dytë, kontrolli, në 3 inspektorë kontabiliteti, në 1 specialist sektori i shërbimeve, në 1 inspektor borxhi dhe në 1 inspektor sektori i proceseve ligjore;

Për masën “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë” janë marrë 7 vendime: në 1 inspektor i dytë kontrolli, në 1 përgjegjës sektori të kontrollit tatimor, në 3 drejtor drejtorie, në 2 drejtor rajonal;

Për masën “largim nga shërbimi civil” janë marrë 3 vendime: për I N- inspektor i dytë, në DRT Fier; për S.N.- inspektor i dytë, në DRT Fier, si dhe për Sh.K(H)- drejtor drejtorie në DPT.

Për 39 raste të shqyrtuara të nëpunësve civilë, komisioni ka vendosur “ndërprerjen e ecurisë disiplinore” dhe për 21 raste, ka vendosur “vendim të ndërmjetëm pezullim procedure”.

Vendimet e marra nga komisioni disiplinor për punonjës me kod pune:

Për masën “vërejtje me shkrim” janë marrë 7 vendime: në 5 inspektorë verifikimi, në 1 specialist protokollit dhe 1 shofer;

Për masën “vërejtje me paralajmërim, për largim nga puna” janë marrë 2 vendime, për inspektor verifikimi;

Për masën “Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës” janë marrë 2 vendime: për M.P.-shofer në DRT Lezhë dhe për A.B.- inspektor hetimi në DPT. Për 4 raste të shqyrtuara, komisioni ka vendosur “ndërprerjen e ecurisë disiplinore”.

Nga auditimi u konstatua se, bashkëlidhur Vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ishte depozituar propozimi nga eprori për fillim ecurie disiplinore. Nga auditimi i procedurës dhe afatet që duhet të ndiqen për zgjidhjen e kontratës nga punëdhënësi, në shqyrtimin e praktikave të punonjësve M.P., O.U., A.B., R.B., u konstatua se Vendimet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, janë marrë sipas pikës nr. 3, “brenda një afati 48 orë deri në një javë pas takimit”, neni 144, i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes:	Menaxhimi jo me efektivitet i burimeve njerëzore në ATQ.
Situata 1:	-Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka filluar t’i shpallë pozicionet vakante për punonjësit me status nëpunësi civil në ATQ, në muajin qershor të vitit 2022. Nga 135 pozicione vakante janë plotësuar vetëm 41 prej tyre, ose 30.4%. Si rezultat i vakancave të punonjësve me status të nëpunësit civil, DPT ka funksionuar me 81.6% të kapaciteteve të saj gjatë vitit 2022.
Situata 2:	-Përgjatë vitit 2022, DBNJ ka ushtruar veprimtarinë e saj pa drejtues të nivelit të lartë, pasi me shkresën nr. 2299/1 prot, datë 15.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë transferimi i përkohshëm, i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT Tiranë. Gjithashtu edhe pozicioni i zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve, i cili ka në varësi DBNJ, ka qenë vakant. Kjo drejtori ka qëndruar pa drejtues të nivelit të lartë për 1 vit.
Situata 3:	-Gjatë vitit 2022, nuk është kryer asnjë emërim i punonjësve me Kod Pune, nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 9 “Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve”, pika nr. 1, 5 dhe 6/a të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
Situata 4:	- Nga auditimi u konstatua se, në një rast ka pasur lëvizje të shpeshta brenda vitit të punonjësit në pozicionin e protokollistit nga një drejtori në tjetrën, në dosjen personale të së cilës nuk ishte arkivuar asnjë dokument ku të vërtetonte arsyet që kanë sjellë këto transferime të shpeshta.
Situata 5:	- Nga auditimi u konstatua se, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk ka përgatitur dhe për pasojë as zbatuar strategjinë menaxhuese dhe planet operationale për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim për punonjësit, marrëdhënia e të cilëve rregullohet me Kodin e Punës, sipas vendeve të lira të krijuara, në bashkëpunim me zv. Drejtorin e Përgjithshëm, në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 4, neni 72 të “Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore”.
Kriteri:	Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, “Për miratimin e

	strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, i ndryshuar. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9, pika nr. 5 dhe 6/a. Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhri nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të MFE, neni 72, pika 4.
Ndikimi/Efekti:	Ulje të efektivitetit dhe efikasitetit në punë, nga mosplotësimi i vendeve vakante, mos bërja transparente me anë të njoftimeve të pozicioneve vakante, si dhe lëvizjet e shpeshta brenda administratës tatimore, kanë çënuar mbarëvajtjen dhe efektivitetin në punë gjatë vitit 2022.
Shkaku:	Mosplotësimi i pozicioneve vakante, pranimi pa konkurrim i punonjësve me kod pune, transferimet e shpeshta, gjatë vitit 2022.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil, në zbatim të urdhrit nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit; rekrutimet e emërimet në ATQ, të kryhen nëpërmjet konkurrimit të hapur, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Përshkrimet e punës.

Në zbatim të pikës nr. 13/a, të kreut IV, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, i cili përcakton: “Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit respektiv të punës. Ai shërben për: a) të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë”; si dhe në mbështetje të udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil” të DAP-it, në vlerësim me përputhshmërinë e zbatimit të tyre, nga auditimi u konstatua se, përshkrimet e punës për nëpunësit civil të ATQ, janë miratuar dhe firmosur sipas hierarkisë së institucionit, si dhe administrohen në dosje nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT.

Për çdo punonjës, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, detyrat funksionale dhe teknike pasqyrohen në përshkrimin e punës, të bazuara te Rregullorja e brendshme e funksionimit të administratës tatimore nr. 193, datë 12.08.2020, e miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi me zgjedhje i kërkesave të posaçme të pozicionit Inspektor, Sektori i Koordinimit në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DRT Shkodër (Rajoni Verior), si dhe të Inspektorit në Sektorin e Koordinimit në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DRT Fier (Rajoni Jugor), u konstatua se kërkesat e posaçme në arsim, përvojë në profesion e të tjera njohuri, janë të njëjta.

Titulli i Gjetjes:	Mbi rregullshmërinë e përshkrimeve të punës së punonjësve me Kod Pune.
Situata:	Nga auditimi i kërkesave të posaçme në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, u konstatua se, për të njëjtin pozicion, kërkesat e arsimit dhe përvojës në punë ishin të ndryshme. Një Inspektor ka si kriter pasjen e diplomës të nivelit “Master Shkencor”, si dhe me përvojë jo më pak se 2

	<p>vite në profesion, ndërsa një Inspektor tjetër, ka si kriter pasjen e diplomës “Master Profesional” dhe pa përvojë pune në profesion.</p> <p>Gjithashtu, nga auditimi u konstatua diferencim të kërkesave të posaçme, për arsim dhe përvojë pune, në pozicionin Inspektor, me kategori page të njëjtë, III-b, në DPT. Për pozicionin Inspektor, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kërkohet diplomë “Master Shkencor” në shkenca Ekonomi/Juridik dhe përvojë jo më pak se 2 vite punë në profesion, ndërsa në Sektorin e Koordinimit po në këtë drejtori, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kërkohet diplomë “Bachelor” në shkenca Ekonomi/Juridik dhe pa përvojë pune në profesion.</p> <p>Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, në Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës me strukturë (1+11), u konstatuan, me pozicionin Inspektor i Parë, kategori page III-b, 6 prej tyre kanë si kriter arsimor pasjen e diplomës “Master Shkencor” dhe 5 me diplomë “Master Profesional”. Këto trajtime të punonjësve nuk janë në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 9, pika nr. 5 dhe 6/a citon: “5) Në kuptim të këtij neni, ndalohet diskriminimi në lidhje me: 6 a) mundësinë për punësim vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale”.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 9, pika nr. 5 dhe 6/a.
Ndikimi/Efekti:	Përshkrimet e paunifikuara të punës mund të sjellin procedura të pabarabarta konkurrimi.
Shkaku:	Mungesa e unifikimit të kriterëve të posaçme për punonjësit jashtë shërbimit civil, në përshkrimet e punës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kriterëve të posaçme për pozicionin e inspektorit në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kur detyrat funksionale janë të njëjta, me qëllim rritjen e performancës individuale dhe institucionale në këtë fushë.

Vlerësimet e performancës në punë.

Për sa i përket vlerësimeve mbi performancën në punë të punonjësve të DPT, nga auditimi i 30 praktikave, rezultoi se ishin kryer vlerësimet për nëpunësit civil, në të dy periudhat e vitit 2022, sipas formatit të bazuar në Lidhjen 2, të Vendimit nr. 252, datë 30.3.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si dhe ishin të nënshkuara nga eprorët e nga punonjësi i vlerësuar. Për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune, u konstatua se vlerësimet ishin kryer vjetore, në zbatim të kreut IX, “Vlerësimi i rezultateve dhe arritjeve gjatë ushtrimit të detyrave”, neni 37 dhe 38, të rregullores për “Marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në ATQ”.

Dosjet e personelit.

Për të audituar përputhshmërinë e administrimit të dokumentacionit në dosjet e personelit, në raport me kërkesat e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrat Qendror të Personelit”, grupi i auditimit përzgjodhi 25 dosje. Nga auditimi u konstatua se në dosjet personale mungonin: librezat e punës, përshkrimet e punës dhe vlerësimet e performancës së punonjësve për vitin 2022. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, grupit të auditimit ju vendosën në dispozicion dokumentet e mësipërme të arkivuara në dosje të veçanta, arkivimi i

tyre në këtë mënyrë bëhej me arsyetimin se, administrata tatimore ka një numër të madh punonjësish dhe arkivimi i tyre për çdo dosje është e pamundur.

Një rast i përsëritur i cili konstatohet në auditimet e KLSH kryer në DPT, është mosdorëzimi i librezës së punës, nga punonjësit e rekrutuar rishtazi në administratën tatimore.

Me shkresën nr. 146/1 prot, datë 13.01.2022, Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të DPT, i ka përcjellë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (DFB), informacionin e kërkuar nga kjo Drejtori, në lidhje me vjetërsinë e punonjësve të DPT, bazuar në librezat e tyre të punës. Nga informacioni i dhënë konstatohet se deri në këtë datë, nuk kanë dorëzuar librezën e punës, 30 punonjës të DPT.

Me email të datës 30.11.2022, dërguar nga specialisti i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, z. A.H., për plotësim dokumentacioni, drejtuar z. S.Sh., Drejtor në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DRT Tiranë, si dhe znj. E B, Përgjegjëse Sektori të Burimeve Njerëzore në DRT Tiranë, rezulton se dosjet e M.K., E.K., E.S., E.L. të emëruar në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në DRT Tiranë, kanë mungesë në: vërtetim gjykatë, kopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuar, cv, kopje të kartës së identitetit, raport mjeko-ligjor, librezë pune, si dhe autorizim për parandalimin e konfliktit të interesit.

Gjatë vitit 2022, nga Drejtoria e Burime Njerëzore janë kërkuar përmes email-eve të shumtë, drejtuar drejtorive ku janë rekrutuar punonjës të rinj, mbi dokumentacionet që nevojiten për plotësimin e dosjeve personale. Duke qenë se çështjet nuk ka gjetur zgjidhje përmes email-ve, Drejtoria e Burime Njerëzore në DPT, ka përcjellë në të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore shkresën nr. 3099 prot, datë 13.02.2023 *“Për zbatimin dhe ndjekjen e procedurës për administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit”*, të nënshkruar nga Titullari i institucionit, lidhur me problematikat dhe dokumentacionin personal të çdo punonjësi i cili rekrutohet në ATQ, duke cituar detyrimet ligjore që kanë Sektorët dhe Drejtoritë e Shërbimeve Mbështetëse, si njësi përgjegjëse direkte në këto drejtori rajonale, si dhe përgjegjësitë e vetë punonjësit të rekrutuar. *“Në rast moszbatimi të këtyre kërkesave, -citetohet në shkresë,- do të procedohet me masa disiplinore sipas parashikimeve ligjore në fuqi”*.

Titulli i Gjetjes:	Mbi administrimin e dosjeve të personelit të ATQ.
Situata:	<p>--Për rregullshmërinë e administrimit të dokumentave të nevojshme në dosjet e personelit të ATQ, u audituan 25 dosje të punonjësve që janë emëruar rishtaz si dhe të atyre që janë rikthyer në ATQ. Në 7 dosje u konstatuan mungesa në vërtetim gjykatë, kopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuar, cv, kopje të kartës së identitetit, raport mjeko-ligjor, si dhe autorizim për parandalimin e konfliktit të interesit të punonjësve.</p> <p>-Nga auditimi u konstatua se, në një rast DBNJ administron më shumë se një dosje personale të punonjësve të ATQ, megjithëse dokumentet e nevojshme që përmbajnë informacionet personale të punonjësve, duhet të arkivohen në një dosje të vetme, pavarësisht pozicioneve të mbajtura nga ta. Vepime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 <i>“Për arkivat”</i> dhe pikën nr. 4 dhe 5, kapitulli nr. II, <i>“Dosja e personelit”</i> e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 <i>“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”</i>.</p>
Kriteri:	<p>-Pika nr. 4 dhe 5, kapitulli nr. II, <i>“Dosja e personelit”</i> e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 <i>“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”</i>;</p> <p>-Aneksi I dhe II i VKM nr. 355, datë 07.07.2000 <i>“Për organizimin e dosjes së regjistrin të personelit”</i>.</p> <p>-Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 <i>“Për arkivat”</i>.</p>
Ndikimi/Efekti:	Parregullsi në administrimin e dosjeve të personelit në ATQ, që sjell mungesë të informacionit në kohë.

Shkaku:	Mospërgjegjësi nga strukturat përkatëse të ATQ.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj strukturave përgjegjëse për mosplotësim të dosjeve të personelit, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT dhe Sektorët e Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Rajonale, të marrin masa për plotësimin dhe përditësimin e të gjitha dosjeve të punonjësve, me dokumentacionin e nevojshëm.

Trajnimi i punonjësve të ATO.

Me vendimin nr. 1, datë 28.01.2022, të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore e Doganore (QTATD), është miratuar programi i trajnimeve për administratën tatimore, për vitin 2022. Nga auditimi u konstatua se në bazë të programit të trajnimeve nga QTATD, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka përgatitur kalendarin e trajnimeve që duhet të ndiqen nga punonjësit e ATQ, si dhe kalendarin për trajnimin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, ku janë planifikuar:

28 tema trajnimi në 44 ditë, për punonjësit e nivelit vazhdues;

18 tema trajnimi në 25 ditë, për punonjësit e rinj;

10 tema trajnimi në 10 ditë, për punonjësit e nivelit drejtues.

Temat e trajnimeve të parashikuara në kalendar janë: fiskalizimi, sistemi C@ts, procedurat tatimore, ndryshimet në legjislacion, kontrolli tatimor, shërbimi tatimpagues, tatime indirekte tvsh etj. Nga auditimi i listëprezencave të mbajtura nga QTATD, u konstatua se në vitin 2022, janë zhvilluar të gjitha temat dhe ditët e planifikuara, si dhe kanë qenë pjesëmarrës të gjithë punonjësit e caktuar.

Mbi administrimin e shpenzimeve të pagave në institucion.

Marrëdhëniet e pagave të punonjësve së ATQ përcaktohen në VKM nr. 187, datë 08.03.2017, *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”*, në lidhjet 1, 2 dhe 6/8 i ndryshuar. Si dhe në VKM nr. 717, datë 23.06.2009, *“Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore”*, i ndryshuar.

-Nga auditimi i përputhshmërisë së listëpagesave me listëprezencat, u konstatua se, listëprezencat e plotësuar për muajin mars, nga përgjegjësi i Sektorit të Hetimit Tatimor, z. A.C., nuk përputhen datat e raporteve me datat e vendosura në të. z. I.N. në muajin mars, është paguar për 19 ditë pune të plota dhe 3 ditë raport, në listëprezencën e këtij muaji rezultuan 3 ditë mungesë me raport të vërtetuar, dhe 1 ditë mungesë në punë. z. E.L., është paguar për 13 ditë pune të plota dhe 9 ditë raport, në listëprezencën e këtij muaji rezultuan 9 ditë mungesë me raport të vërtetuar, dhe 1 ditë mungesë në punë.

-Në zbatim të përputhshmërisë së llogaritjes së pagës të punonjësve të DPT, për vitin 2022, sipas klasave, niveleve dhe shtesave për vështirësi, që përcakton VKM nr. 717, datë 23.06.2009 *“Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”*, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 234, datë 20.04.2022 *“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike buxhetore”*, i ndryshuar me VKM nr. 627, datë 28.09.2022, u audituan listëpagesat e punonjësve të DPT të muajve janar, mars, qershor, shtator dhe dhjetor 2022, nga ku rezultoi se:

Konstatim: z. A.A. është emëruar me Vendimin nr. 1828, datë 05.12.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, në pozicionin Korrier në Sektorin e Administratës në DPT, paga e të cilit i përket klasës II, Lidhja nr. I/1, sipas VKM nr.717/2009, e ndryshuar, me vlerë 31,600 lekë.

Me Vendimin nr. 188, datë 06.04.2020 “Për transferimin e përhershëm në kuadër të ristrukturimit të institucionit”, z. A. është transferuar Korrier në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në DPT, sipas klasës I, Lidhja nr. I/1, në vlerën 30,000 lekë. Përcaktimi i klasës I, në Vendimin nr. 188, datë 06.04.2022, është në kundërshtim me VKM nr. 717/2009, i ndryshuar, për këtë pozicion pune. Në listëpagesat e muajve janar dhe mars 2022, paga i është llogaritur në vlerën 30,000 lekë.

z. P. T. i emëruar me Vendimin nr. 19, datë 27.01.2021, në pozicionin Punëtor/Mirëmbajtje, paga e të cilit i përket klasës IV, Lidhja I/1, sipas VKM nr. 717/2009, e ndryshuar, me vlerë 33,400 lekë. Në listëpagesat e muajve janar dhe mars 2022, u konstatua se, paga i është llogaritur sipas klasës I, Lidhja nr. I/1, në vlerën 30,000 lekë.

Në auditimin e listëpagesave për pagat e kabinetit në vitin 2022, kategoria e pagës për këtë strukturë, rezultoi të ishte sipas urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të ATQ” dhe lidhjes nr. 6/8 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve”, të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar.

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masa në rilllogaritjen e pagës së punonjësve, duke kontrolluar edhe periudhat e mëparshme.

Në tabelën më poshtë është paraqitur fondi i pagave për DPT, realizimi nga planifikimi, për muajt Janar e Dhjetor 2022.

Tabela nr. 136 Të dhënat për pagat e DPT, viti 2022

Në lekë

Nr.	EMËRTIMI	Janar 2022			Dhjetor 2022		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Shpenzimet për pagat	24,000,000	20,813,000	86.7	24,000,000	21,278,903	88.7
2	Sig. Shëndetësore & Shoqërore	4,750,000	3,496,271	73.6	4,750,000	3,884,558	81.8
3	TAP		1,756,876			1,950,654	
	Total	28,750,000	26,066,147		28,750,000	27,114,115	

Burimi: Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e tabelës së mësipërme rezulton se, fondi i pagave në janar 2022, është realizuar në masën 86.7% dhe në dhjetor të vitit 2022, në masën 88.7%.

Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërm ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të numrit të punonjësve, pasi në janar 2022, në krahasim me organikën institucioni ka punuar me 59 punonjës më pak dhe në dhjetor 2022, me 49 punonjës më pak nga plani. Sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 73.6%, në janar dhe në masën 81.8% në dhjetor 2022.

Fondi i veçantë, është përdorur në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, duke u përdorur për rastet e veçanta, në vlerën totale 516,800 lekë, e ndarë në: për dalje në pension në 3 raste, me vlerën 290,400 lekë, për fatkeqësi në familje gjithsej 4 raste, me vlerë 120,000 lekë, ndihmë për sëmundje në 2 raste me vlerë 100,000 lekë, si dhe me vlerën 6,400 lekë është kryer pagesë shërbimi telefonik, Titullarit të Institucionit, në zbatim të pikës nr. 5, të udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”. Fondi i veçantë nuk është përdorur për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve në fund të vitit ushtrimor, sipas përcaktimeve të pikës nr. 9, të VKM nr. 929/2010 i ndryshuar.

Dieta dhe udhëtime.

Nga auditimi i mbylljes së veprimeve me bankë, për dieta e udhëtime brenda vendit, të punonjësve të administratës tatimore, gjatë vitit 2022 u konstatua se, llogaritjet e dietave ditore ishin kryer në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 997, datë 12.10.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Në zbatim të përcaktimit të pikës nr. 196 “Shpenzimet në Valutë”, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, mbi planifikimin e pagesave në valutë për vitin 2022, nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve në DPT, ka përcjellë në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, parashikimin e shpenzimeve të aktiviteteve për vitin 2022, në shumën 46,780 euro.

Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë.

Nga auditimi u konstatuan, 146 çështje gjyqësore me vendim të formës së prerë, ku palë e paditur është ATQ. Nga këto çështje, 133 janë padi të ngritura nga ish-nëpunës me status të nëpunësit civil, ku bëjnë pjesë 57 çështje të reja, të ardhura në vitin 2022, si dhe 13 çështje, nga ish punonjës, marrëdhënia e punësimit së të cilëve ka qenë e rregulluar me kod pune. Në tabelën më poshtë, është paraqitur një përmbledhje e çështjeve gjyqësore për ish-punonjës të shërbimit civil të vitit 2022, së bashku me ato të mbartura nga vitet e tjera.

Tabela Çështjet gjyqësore për ish-punonjësit me status

Nr. i çështjeve	Statusi i procesit ligjor
Shkalla e I	Çështje në proces -25
Shkalla e II, në Apel	Çështje në proces -86
Formë e prerë	Çështje - 10

Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPT, është dhënë informacioni mbi detyrimet dhe likuidimet e kryera gjatë vitit 2022, për vendimet gjyqësore të formës së prerë për Administratën Tatimore.

Tabela nr.137 Detyrimet dhe likuidimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë për ATQ

Në lekë

Statusi punonjësit	Numri	Detyrimi i prapambetur 31.12.2021	Detyrime të lindura gjatë 2022	Paguar gjatë 2022	Detyrime ndaj përmbauesve gjatë 2022	Paguar përmbaues gjatë 2022	Detyrim i prapambetur 31.12.2022
1	2	3	4	5	6	6	7
Ish nëpunës me status	133	116,255,623	85,395,376	76,688,641	6,960,722	7,208,415*	124,962,358
Ish punonjës me kod pune	13	0	13,284,796	978,480	995,087	0	12,306,316
Listë Pritje	-	-	-	-	-	-	-
Dëmshpërblim	-	-	-	-	-	-	-
Total	146	116,255,623	98,680,172	77,667,121	7,955,809	7,208,415	137,268,674
Total Detyrime 3+4			214,935,795				

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, konstatohet se në fillim të vitit 2022, administrata tatimore ka pasur detyrime të mbartura nga viti 2021, për vendimet gjyqësore të formës së prerë, vetëm për ish punonjës të shërbimit civil, në vlerën **116,255,623 lekë**. Gjatë vitit, kanë lindur detyrime të reja në vlerën totale **98,680,172 lekë**, ku konstatohet se, vlera **13,284,796 lekë**, janë detyrime të cilat kanë lindur për 13 ish punonjës, të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me kod pune. Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPT, ka paguar për shpenzime gjyqësore, të ish punonjësve, gjithsej vlerën **77,667,121 lekë**. Kjo vlerë cilësohet si efekt negativ për buxhetin e shtetit, pasi për të njëjtin pozicion pune, paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i emëruar rishtaz në administratën tatimore.

Drejtoria Teknike dhe Ligjore, i vendosi në dispozicion grupit të auditimit, listën e kërkesave të përmbauesve, të protokolluara në DPT gjatë vitit 2022, për zbatim vendimi të formës së prerë për 18 gjyqfitues, ish punonjës të administratës tatimore.

Nga auditimi konstatohet se, për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore nga ana e institucionit, janë paguar kosto shtesë për zyrat përmbauese, në vlerën **7,208,415 lekë**, (detyrime të prapambetura së bashku me ato, të vitit 2022*). Nga auditimi u konstatua

se, institucioni ka ndjekur vullnetarisht 32 procedura gjyqësore, si dhe 114 procedura me përmbarues gjyqësor gjatë vitit 2022.

Titulli i Gjetjes:	Mbi shpenzimet gjyqësore me efekt për buxhetin e shtetit.
Situata:	<p>Gjatë vitit 2022, nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish-punonjës të larguar nga puna në mënyrë të padrejtë, në vlerën 77,667,121 lekë. Kjo vlerë cilësohet si efekt negativ për buxhetin e shtetit, pasi për të njëjtin pozicion pune, paguhen 2 persona, ish-punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i emëruar rishtaz në administratën tatimore. Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja ndaj përmbaruesve, në vlerën 7,955,809 lekë, nga të cilat janë paguar 7,208,415 lekë, kjo vlerë është kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Në fund të vitit 2022, vlera e detyrimeve të prapambetura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjësit e administratës tatimore është 137,268,674 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.</p> <p>Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Institucionit dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime.</p> <p>Veprime në kundërshtim me pikën nr. 60, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".</p>
Kriteri:	Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika nr. 60.
Ndikimi/Efekti:	Mosveprimi dhe mosmarrja e masave të duhura nga Titullari i Institucionit, si dhe Strukturave Përgjegjëse, në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore, ka shkaktuar kosto financiare shtesë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Ndërprerja e padrejtë e marrëdhënieve të punës së punonjësve të ATQ.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore.

Radha e likuidimit të shpenzimeve gjyqësore - FIFO

Në zbatim të përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPT, në lidhje me radhën e likuidimeve të shpenzimeve gjyqësore për ish punonjës të ATQ, në bazë të përcaktimeve të udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", nga auditimi u konstatua se, DFB dispononte databazën e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe përllogaritjen e detyrimit për çdo gjyqfitues, në zbatim të pikës nr. 4, e cila përcakton se: "Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumatat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës". Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në DPT. Kjo databazë i është vënë në

dispozicion grupit të auditimit në formatin Excel, e cila gjendet në rubrikën Aneks, Tabela nr. 14 “Detyrimet e vendimeve gjyqësore 2022”.

Mbi veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm.

Në zbatim të përputhshmërisë së procedurave të ndjekura për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjës të ATQ, në lidhje me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka krijuar bazën e të dhënave gjyqësore me informacionin e duhur, sipas përcaktimeve të pikës nr. 2, të Kreut II “Krijimi i bazës së të dhënave gjyqësore”, të këtij urdhri. Numri total i vendimeve të formës së prerë për vitin 2022, të regjistruara në këtë data bazë, për ish nëpunës civil të ATQ është 57. Në këtë numër, janë përfshirë edhe 13 ish punonjës të cilët kanë mbushur moshën e pensionit.

Me urdhrin nr. 31, datë 10.03.2022, “Për një ndryshim të urdhrin nr. 85, datë 04.11.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata tatimore”, të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë ndryshimi i një anëtarit të Komisionit, sipas përcaktimeve të paragrafit 6, të pikës nr. 1, kreu IV, të urdhrin nr. 5151/2015.

Komisioni i Posaçëm përbëhet nga:

z. C.K në cilësinë e Kryetarit;

z. I.K, anëtar;

Znj. I.K, anëtare;

Znj. D.C, anëtare.

Sipas pikës nr. 3, të kreut IV, të urdhrin nr. 5151/2015, Komisioni i Posaçëm ngarkohet me këto detyra:

- a) Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqfitues;
- b) Shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitore, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- c) Shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqfituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda institucionit nga ku është larguar, apo në një institucion të varësisë së tij.

Në zbatim të tyre, nga auditimi u konstatua se, Komisioni pas shqyrtimit të dokumentave, ka ekzekutuar 10 praktika vendimesh të formës së prerë në vitin 2022, nga këto:

2 praktika- punonjës të rikthyer në punë, në administratën tatimore;

2 praktika- ekzekutim vendimi pasi, punonjësit kanë rezultuar të punësuar në institucione të tjera;

6 praktika- për punonjës me përfundim të marrëdhënies nga shërbimi civil, pasi punonjësi ka mbushur moshën për pension.

Me procesverbalin nr. 9390/1, datë 07.06.2022, Komisioni i Posaçëm ka dokumentuar detyrat që duhet të zbatohen 3 drejtoritë e DPT, konkretisht: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Teknike dhe Ligjore në lidhje me praktikën e gjyqfituesve. Gjatë vitit 2022, në DPT kanë ardhur praktika të reja. Sektori i Rekrutimit dhe i Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ka përcjellë te Komisioni i Posaçëm informacione për 3 praktika që kanë ardhur për ekzekutim vendimi.

Titulli i Gjetjes:	Mbi veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm.
Situata 1:	-Nga veprimtari e Komisioni i Posaçëm në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, u konstatua se, në 2 raste të

<p>Situata 2:</p>	<p>trajtuara gjatë vitit 2022, nuk është mbledhur nga kryetari, brenda 2 ditë pune nga depozitimi i kërkesës me shkrim të kreditorit, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kërkesa për ekzekutim vendimi të z. A.P., është protokolluar në DPT, në datë 12.01.2022, si dhe e z. M.D. më datë 14.01.2022, ndërsa Komisioni është mbledhur më datë 25.01.2022, i dokumentuar me procesverbalin me nr. protokolli 1116.</p> <p>-Me shkresën nr. 5236 prot, datë 05.04.2022, Sektori i Rekrutimit dhe i Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore i ka dhënë informacion Komisionit, në lidhje me praktikën e znj. M.K., e diplomuar në degën Financë, niveli DIND, ish nëpunës në pozicionin Drejtor Drejtorie e Kontrollit Tatimor në DRT Korçë. Vendimi nr. 89, datë 04.03.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit ka detyruar palën debitore DPT, për rikthimin e znj. K. në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të ngjashëm me të. Nga verifikimi i kryer nga DBNJ, pozicioni Drejtor Drejtorie në Kontrollit Tatimor, në DRT Korçë është vakant, si dhe znj. K. nuk është e punësuar në subjekt tjetër. Nga auditimi u konstatua se, Komisioni i Posaçëm nuk ka marrë asnjë vendim për rikthimin e znj. K. në pozicionin e mëparshëm, sipas vendimit të Gjykatës, duke qenë se ai pozicion rezulton vakant.</p> <p>Mosveprimi për rikthimin në punë të punonjësve shkakton një kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit duke qenë se për të njëjtin pozicion pune paguhen dy individë ose më shumë punonjës.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Pika nr. 2 dhe 3, kreu IV, i Urdhrit nr. 5151/2015. “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”;</p> <p>Vendimi nr. 89, datë 04.03.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit.</p>
<p>Ndikimi/Efekti:</p>	<p>Mosveprimi dhe mosmarrja e masave të duhura nga Titullari i Institucionit, si dhe strukturave përgjegjëse, në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore.</p>
<p>Shkaku:</p>	<p>Moszbatimi i përgjegjësive të Komisionit të Posaçëm, që i ngarkon urdhri nr. 5151/2015.</p>
<p>Rëndësia:</p>	<p>E lartë</p>
<p>Rekomandimi:</p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm, edhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm, të marrë masa me sistemin e gjyqfituesve në kushtet e vakancave në strukturë, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhetin e shtetit.</p>

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. C.K., Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve; znj. D.C., Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit në DPT; z. I.K., Përgjegjës i Sektorit të Trajnimeve dhe Vlerësimit, si dhe për periudhën 15 shkurt – 31 dhjetor 2022, edhe në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT; znj. I.K., Drejtor i Drejtorisë Teknike e Ligjore, në DPT.

Për sa trajtuar më sipër, është mbajtur Projekt Raporti nr. 284/7 prot, datë 02.08.2023, protokolluar në DPT me nr. 13072 prot, datë 03.08.2023. Subjekti i audituar, mbi këtë Projekt Raport ka paraqitur observacionin e protokolluar në KLSH me nr. 284/8 prot, datë 06.09.2023, ku sqarojmë sa më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:

-Lidhur me pikën 8/2ç Konstatim: Ku shpreheni se nuk pranohet, ju sqarojmë se: “Nga grupi i auditimit, u kërkuan procedurat e testimi dhe të vlerësimit të kandidatëve z. S. dhe znj. N. (mungesë në dosje), të cilat realizohen nga Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND), me 5 anëtarë. Nga DBNJ na u komunikua se, “procedurat e konkurimit të pozicioneve të mesme drejtuese depozitohen vetëm nga DAP dhe nuk përcillen te Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT”. Në lidhje me plotësimin e dosjes personale të z. Gj.S (...) sqarojmë se dokumentacioni i munguar në dosjen personale të z. Gj.S, është arshivuar gabimisht në dosjen e vjetër të personelit të z. Gj.S, pasi dhe më herët ka qenë punonjës i ATQ në bazë të vendimit nr. 12964 datë 05.07.2019 i emëruar si Drejtor Rajonal në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj deri më datë 28.07.2020, ku është larguar me kërkesën e tij në bazë të vendimit nr. 551, datë 28.07.2020. Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion kopje të dokumentacionit personal të Z. S. (Çertifikatë personale datë 09.11.2021, Çertifikatë familjare datë 14.12.2021, Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore datë 13.12.2021), të marra nga administrimi i dokumentacionit gabimisht në dosjen e vjetër të regjistrit të personelit të Z. S”.

- “VKM nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të cilat përcaktojnë të gjitha hapat që ndiqen gjatë procedurës për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët e të mesme drejtuese, nuk shprehin asgjë, në lidhje me këtë përgjegjësi të DAP-it”.

-Për sa më lart, “është e përcaktuar qartazi se Institucioni përgjigjes për ndjekjen e këtyre procedurave është Departamenti i Administratës Publike”.

- Referuar asaj që ju citoni në faqen 7 dhe 8 “lidhur me pozicionet vakante pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në fund të çdo viti kalendarik përcjell vakancën e pozicioneve të punës marrëdhëniet e të cilëve rregullohen sipas dispozitave ligjore të Ligjit 152/2013, i ndryshuar “Për nëpunësin civil”, në DAP dhe pozicionet e sipërcituara vakante të cilat janë krijuar gjatë vitit kalendarik, një pjesë e tyre janë plotësuar, këto pozicione vakante të krijuara gjatë vitit 2022, janë përcjellë edhe në fund të vitit 2022, me shkresën nr. 21953 prot., datë 30.12.2022, drejtuar DAP, por është kompetencë e këtij të fundit grupimi dhe shpallja e pozicioneve të punës. Ju sjellim në vëmendje se për shpalljen e vakancave dhe realizimin e procesit për vitin 2022, kanë ndikuar edhe sulmet kibernetike të ndodhur pasi për një periudhë 3 mujore, janë shtyrë procedurat nga DAP, (pezulluar)...”.

-Lidhur me Konkluzionin në faqen 12: “Me procedurën e rekrutimit “Pranimi në punë pa konkurim” në ATQ, konstatohet një diferencim, pamundësi e çdo individit për të qenë punonjës i administratës tatimore(...) ku përmendet emërimi i z. M.L., ju sqaroj:

Referuar Urdhrit 10, datë 31.01.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për miratimin e Rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore” gërma d, pika 1, neni 15, Këshilltarët e Kabinetit kanë varësi të drejtëpërdrejtë nga titullari duke qënë pozicion politik dhe këshillues për Titullarin dhe emërimi i tyre bëhet nga Titullari i Institucionit, duke marrë në konsideratë edhe rëndësinë e pozicionit ishte e nevojshme plotësimi i tij.

Emërimi i Zj. M. V. në momentin e emërimit pranë DTM, është bërë duke marr parasysh se është një Drejtori me një numër të lartë subjektësh, për shkak të vakancës dhe ngarkesës në punë, është bërë emërimi i saj pranë kësaj drejtorie deri në plotësimin e pozicionit, në momentin e plotësimit të pozicionit të punës zj. V. është kthyer në pozicionin e saj të punës”.

-Konstatimi, në faqen 15: “Referuar shkresës nr. 2113 prot., datë 10.02.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është drejtuar DAP duke sqaruar dhe arsyet e këtij transferimi duke qënë se nëpunësi plotësonte kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme për këtë pozicion.

Gjatë periudhës së transferimit të zj. T. pozicioni ka qënë vakant por për shkak të rëndësisë së pozicionit të Drejtorit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara i cili ka të

drejtën e nënshkrimit, për nxjerrjen e Autorizimeve për njoftim të pagesave, Bllokim/Zhbllokim të llogarive bankare, Njoftimit të Barrës Siguruese, Barrës Hipotekore, Pezullimit të aktivitetit në Dogana është bërë ky transferim, me qëllim dhe përmbushjen e misionit të krijimit të Drejtorisë, duke qenë e klasifikuar si Drejtori në funksionet e përmbajtjes”.

-Konkluzion: “Duke marr parasysh që pozicionet e punës me Kod pune në gjithë ATQ janë gjithsej 322 pozicione pune Plan, nga të cilat 20 prej tyre janë vakant e përkthyer në përqindje është një numër shumë i ulët vetëm 6.2 % janë vakant, por në vazhdim do të mbahet në konsideratë shpallja e pozicioneve të lira të punës në faqen zyrtare të Institucionit duke i grupuar sipas pozicioneve të lira”.

-Në faqen 21:Referuar pikës 8.2/k “Sqarojmë se librezat e punës nuk janë pjesë e dosjes personale por vetëm kopje e saj për punonjësit/nëpunësit e Drejtorive Rajonale Tatimore. Çdo punonjës dorëzon librezën origjinale pranë njësisë së burimeve njerëzore dhe arshivohen në një kasafortë të caktuar, gjithashtu dhe vlerësimet e punës dhe përshkrimet e punës arkivohen në dosje të veçanta për shkak të numrit të madh të punonjësve të ATQ”.

-Faqe nr. 25, pika 8.3/b, mbi Komisionin e Posaçëm ju sqarojmë: “Në lidhje me z. A. P. dhe z. M. D., ku shpreheni se u konstatua që Komisioni i Posaçëm në 2 rastet e trajtuara gjatë vitit 2022, nuk është mbledhur nga kryetari, brenda 2 ditë punë nga depozitimi i kërkesës me shkrim të kreditorit për ekzekutim të vendimit gjyqësor ju sqarojmë si më poshtë vijon”..

-Për znj. M.K.ju bëjmë me dije se nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 5236 prot, datë 05.04.2022 i është vënë në dispozicion informacioni Komisionit të Posaçëm në lidhje me praktikën e znj. K., bashkëlidhur shkresa. Praktikë e cila do të merret në konsideratë në këtë fazë ristrukturimi së bashku me praktikat e tjera gjyqësore me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Për pikën 8/2ç Konstatim: Në lidhje me pretendimin e subjektit, për dokumentacionin e munguar (certifikate personale, certifikate familjare, si dhe vërtetim i Gjendjes Gjyqësore), në dosjen personale të z. Gj. S., është paraqitur dokumentacion vërtetues bashkëlidhur me observacionet, për këtë arsye pretendimi pranohet pjesërisht, pasi informacionet personale të punonjësve, duhet të arkivohen në një dosje të vetme, pavarësisht pozicioneve të mbajtura nga ta. Grupi i auditimit, kreu reflektimet përkatëse, në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

- Për sa më lart, është e përcaktuar qartazi: Për këtë konstatim, ashtu si dhe në sqarimin tonë të bërë në Projekt Raport, ju sqarojmë se, grupi i auditimit kërkoi t’i viheshin në dispozicion procedurat e testimit dhe vlerësimit në konkurrencë, të kandidatëve z. S. e znj. N., të cilat mungonin në dosjet e tyre personale, e jo të përcaktonte se kush Institucion ka përgjegjësinë për ndjekjen e procedurave të kandidatëve për pozicionet vakante të krijuara. Në Projekt Raport, nga ana jonë është cituar: “Nga DBNJ na u komunikua se, “procedurat e konkurimit të pozicioneve të mesme drejtuese **depozitohen** vetëm nga DAP dhe nuk përcillen te Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT”. VKM nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2015, të cilat përcaktojnë të gjitha **hapat që ndiqen gjatë procedurës** për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët e të mesme drejtuese, nuk shprehin asgjë, me përgjegjësinë e DAP-it, në lidhje me depozitimin e përgjigjeve të testimit dhe vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e mesme drejtuese. Për këtë arsye, pretendimi juaj nuk pranohet.

-Referuar asaj që ju citoni në faqen 7 dhe 8: Pretendimi i subjektit konfirmon, konstatimin e bërë nga grupi i auditimit, në pikën “Pozicionet vakante dhe procedura e rekrutimit të punonjësve pjesë e shërbimit civil nëpërmjet DAP-it”. Auditimi është kryer me dokumentacionin e vënë në dispozicion, njëkohësisht është trajtuar edhe periudha e shpalljes së vakancave nga ana e DAP-it. Për sa më sipër, pretendimi juaj nuk pranohet.

-Lidhur me Konkluzionin në faqen 12: Për emërimin me procedurën “Pranim pa konkurrencë” në ATQ, të punonjësve që rregullojnë marrëdhëniet me kod pune, nga grupi i auditimit u konstatua se, kjo procedurë është ndjekur në të gjitha rastet për vitin 2022. Për procedurën e emërimit të z. L., nuk është konstatuar se është në shkelje me Urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020,

por kërkesa për punësim me aktin e emërimit janë në të njëjtën ditë. Në dosjen e znj. V., nuk rezultonin të argumentuara akt lirimet dhe akt emërimit e saj, në një periudhë aq të shkurtër. Për këtë arsye, pretendimi juaj nuk pranohet.

-Konstatimi, në faqen 15: Siç është trajtuar edhe në Projekt Raport, transferimi i znj. T., duke plotësuar një vakancë, por duke lënë vakant një drejtori tjetër të rëndësishme, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT, në periudhën kur ishte vakant edhe pozicioni i zv. Drejtorit, i cili ka në varësi këtë drejtori, është i paargumentuar mirë. Për sa më sipër, pretendimi juaj nuk pranohet.

-Konkluzion: Në vazhdim do të mbahet në konsideratë shpallja e pozicioneve të lira të punës në faqen zyrtare të Institucionit duke i grupuar sipas pozicioneve të lira. Ky konstatim është pranuar nga subjekti.

-Në faqen 21:Referuar pikës 8.2/k Pretendimi i subjektit konfirmon, konstatimin e bërë nga grupi i auditimit, në pikën 8.2/k “Dosjet e personelit”.

-Faqe nr. 25, pika 8.3/b, mbi Komisionin e Posaçëm ju sqarojmë: Në lidhje me 2 rastet e trajtuara gjatë vitit 2022, për z. A. P. dhe z. M. D. nga Komisioni i Posaçëm, në pretendimin tuaj keni detajuar trajtimin e këtyre dy çështjeve dhe shumë të tjera nga Komisioni, gjatë vitit 2022. Por, në konstatimin e grupit të auditimit, është vënë theksi në mos përmbushjen e afatit që duhet të ketë parasysh Komisioni i Posaçëm, brenda 2 ditë punë nga depozitimi i kërkesës me shkrim të kreditorit për ekzekutim të vendimit gjyqësor, detyrim që e përcakton urdhri nr. 5151/2015, datë 28.10.2015 i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, pra pretendimi juaj nuk merret parasysh.

-Për znj. M.K.: Pretendimi i subjektit konfirmon, konstatimin e bërë nga grupi i auditimit.

2.9. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallrave dhe shërbime.

Parashikimi fillestar për vitin 2022, referuar shkresës nr. 3410 prot., është kryer në datë 01.02.2023. Regjistri i prokurimeve publike, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme gjatë vitit 2022. Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për 12/mujorin e vitit 2022 është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borsit Publik me shkresë nr. 2344/76 prot., në datë 07.02.2023 dhe Degës së Thesarit me shkresë nr. 2344/77 prot., në datë 07.02.2023.

Për vitin 2022, Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në datë 10.05.2022, me shkresë nr. 7592 prot., ka krijuar komisionin e prokurimit me vlerë të vogël. Urdhri në shkresën nr.7592/2 prot., datë 20.05.2022 ka caktuar personat përgjegjës për prokurim, i është nxjerrë jashtë afateve të përcaktuara në pikën 1, neni 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit është konstatuar se informacioni është përcjellë në organet qendrore jashtë afateve të përcaktuara në VKM nr. 285, neni 4, pika 2, informacioni i 4/mujorit 2022 është dërguar në 26.05.2022, i 8/mujorit është dërguar në 13.09.2022, ndërsa i 12/mujorit të vitit 2022 është dërguar informacion në 07.02.2023. Dokumenti i vendosur në dispozicion, rezulton se është përcjell nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, jashtë afateve të parashikuara dhe si rrjedhojë informacioni i përcjell në organet qendrore është dërguar jashtë afatit.

Sipas regjistrit të prokurimeve të Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2022 janë parashikuar të kryhen prokurime për DPT-në, AKSH-in dhe ASHPP-në të evidentuara në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.138 Procedura e prokurimeve për DPT, AKSH, ASHPP

Në Lekë

Organi që ka zhvilluar procedurën e prokurimit	Parashikuar			Realizuar		Niveli i realizimit	
	Numër	Vlerë	Ndryshimi gjatë vitit	Numër	Vlerë	Numër %	Vlerë %
DPT	21	94,239,520.00	79,665,516	12	24,449,395	57.14	30.69
AKSHI	5	168,679,566.00	462,727,556	2	420,702,180	40	90.92
ASHPP	7	72,862,071.60	42,042,032	6	40,553,748	85.71	96.46

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në referencë të tabelës më sipër, DPT ka parashikuar të realizojë 21 procedura në vlerën 79,665,516 lekë dhe janë realizuar 12 procedura në vlerën 24,449,395 ose 30.69% të vlerës së parashikuar për vitin 2022. Referuar të dhënave të Regjistrimit të parashikimit dhe realizimit, DPT ka realizuar procedurat e prokurimit në vitin 2022 sipas llojit të procedurave si më poshtë:

Tabela nr.139 Procedura e prokurimit sipas llojit të procedurave

Në Lekë

Lloji i procedurave	Parashikuar			Realizuar	
	Numër	Vlerë	Ndryshimi gjatë vitit	Numër	Vlerë
Procedura mbi 1,000,000	6	73,332,934	57,500,000	1	16,657,927
Procedura nga 100,000-1,000,000	11	7,333,333	5,804,597	8	2,768,943
Sistemi dinamik, blerje bileta		100,000	1,000,000	7	752,060
Blerje deri në 100,000	5	400,871	400,871	5	365,133

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Procedura e prokurimit, “Pagesë ambienti me qira DRT Tiranë, DTM, parashikim ambient i ri”, e zgjedhur për t’u shqyrtuar nga grupi i auditimit, në bazë të shkresës nr.6472 datë 05.05.2023 është objekt nën hetim dhe si rrjedhojë është përjashtuar nga përzgjedhja, në këtë mënyrë, janë përzgjedhur në mënyrë rastësore të auditohen procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:

Nr	Procedura sipas realizimit te regjistrimit	Fondi limit pa tvsh	Vlera e kontrates pa tvsh	Diferenca	OE Pjesëmarrës	OE i Kontraktuar
1	Shpenzime per mirembajtje per objekte ndertimore	800,000.00	565,000	235,000	OE Pjesëmarrës -8 OE të Kualifikuar -5 OE të Skualifikur 3	A. shpk
2	Blerje Uniforma	993,200	945,000	48,200	OE Pjesëmarrës -24 OE të kualifikuar -24 OE të Skualifikuar-0	P.I.
3	Shpenzime për mirëmbajtje aparate, pajisje teknike dhe vend pune					
3.1	Riparim printera	99,688	99,583	105	OE Pjesëmarrës -3 OE të kualifikuar -1 OE të Skualifikur 2	B.E.
3.2	Blerje Çertifikat SSL	153,875	78,000	75,875	OE Pjesëmarrës -6 OE të kualifikuar -3 OE të Skualifikur 3	I.T.
4	Rikonstruksion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	20,817,793	16,657,926	4,159,867	OE Pjesëmarrës -5 OE të Kualifikuar -2 OE të Skualifikur 3	BOE O. & E
5	Rikonstruksion Drejtoria Rajonale Dibër	12,499,194	10,146,086	2,353,108	OE Pjesëmarrës -4 OE Kualifikuar -2 OE të Skualifikur 2	2

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

1. Shpenzime për mirëmbajtje për objekte ndërtimore

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit:		
Urdhër Prokurimi Nr 4391/1, datë 28.06.2022	Urdhër Nr. 7592 prot., datë 10.05.2022 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël znj. B.H., kryetare znj. A.S., anëtarë z. A.K., anëtar	OE i Kontraktuar A. sh.p.k
Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Blerje me Vlerë Vogël”		
Fondi Limit (pa TVSH) 800,000.00 Lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 565,000.00 Lekë	Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 235,000 lekë

Data e hapjes së tenderit: 05.07.2022	Vlera kontratës për vitin 2022 678,000 Lekë me TVSH	Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender: 8 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 5 OE
---	---	--

Fillimi i procedurave për tenderin e mirëmbajtjes së godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është kërkuar në datën 17.03.2022 nga Sektori i Brendshëm, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me shkresën nr. 4391 prot., drejtuar Sektorit të Prokurimit.

Argumentimi i fondit limit. Nga shqyrtimi i dosjeve të procedurës konkurruese u konstatua se në procesverbalin e mbajtur në datë 24.05.2022 mbi llogaritjen e fondit limit të blerjes së vogël me objekt “Mirëmbajtja e godinës së DPT-së”, përlllogaritja e fondit limit është bazuar në studimin e tregut, ku janë administruar oferta nga 3 operatorë ekonomikë dhe mesatarja e çmimeve të marra nga ky studim është 892,333.5 lekë. Nga ofertat e sjella nga 2 operatorët ekonomikë, vlera mesatare e fondit e tejkalon vlerën e planifikuar. Në planifikimin buxhetor të vitit 2022 nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në regjistrin e prokurimeve ky zë është planifikuar me vlerën 800,000 lekë pa tvsh. Procedura është zhvilluar me fond limit, 800,000 lekë pa tvsh, në 22.09.2022 është ndryshuar në regjistrin e realizimit në 566,667 lekë pa tvsh.

Urdhri i prokurimit. Në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 4391/1 prot., datë 28.06.2022 të nxjerrë nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së godinës së DPT-së për vitin 2022”, është përdorur procedura e prokurimit me vlerë të vogël.

Ftesa për ofertë. Në shkresën nr. 4391/2 prot., datë 28.06.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën me vlerë të vogël me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së godinës së DPT-së për vitin 2022”. Ftesa për ofertë ju është dërguar 5 operatorëve ekonomikë. Në ftesën për ofertë në dosje dhe të ngarkuar në sistemin e APP është e paplotësuar data dhe ora e zhvillimit të procedurës. Mos përfshirja e vendit, datës dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 21, pika 2.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë, janë kualifikuar 5 OE dhe janë skualifikuar 3 operator. Renditja e operatorëve ekonomik të kualifikuar është si me poshtë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Oferta Ekonomike
1	A SHPK	565,000.00
2	B.B	773,400.00
3	O.	788,000.00
4	A	789,000.00
5	J	792,000.00

Operatori ekonomik fitues për procedurën me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së DPT-së për vitin 2022 është A. SHPK, në 05.07.2022.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Rezulton se dokumentacioni i sjellë nga operatori ekonomik i shpallur fitues është në përputhje me dokumentet e përcaktuara në ftesën për ofertë. Formulari i ofertës ekonomike, e dorëzuar nga A.shpk në datë 05.07.2022, përmban përshkrimin e shërbimit, ku shuma pa tvsh është 565,000 Lekë, me tvsh (20%) 113,000, shuma në total, 678,000 Lekë.

Zbatimi i kontratës. Kontrata shërbimi, nr. 4391/3 datë 18.07.2022 e lidhur midis palëve kontraktuese, ofertuesi i shërbimit Shoqërisë “A.” dhe porositësi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vlerën totale 678,000.00 lekë me tvsh, me afat deri më datë 31.12.2022. Nga momenti i lidhjes së kontratës deri në 19.12.2022 janë dërguar tre fatura për likuidim drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Me shkresën nr. 4391/8 datë 31.08.2022 është dërguar për likuidim fatura e shërbimi për periudhën 18.07.2022-31.08.2022. Me shkresën 17548 datë 13.10.2022 është dërguar për likuidim fatura e shërbimit për periudhën 01.09.2022-12.10.2022. Me shkresën nr. 20659 datë 07.12.2022 është dërguar për likuidim fatura e shërbimit për periudhën 12.10.2022-06.12.2022. Totali i vlerës për faturat e shërbimit të

mirëmbajtjes nga data 18.07.2022 deri në 06.12.2022 është 633,988 leke me tvsh. Nga kontrata nr. 4391/3 datë 18.07.2022 ka ngelur pa ezauruar shuma 44,012 leke me tvsh.

2. Blerje Uniforma

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit:		
Urdhër Prokurimi Nr 9009/2, datë 30.05.2022	Urdhër Nr. 7592 prot., datë 10.05.2022 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël znj. B.H., kryetare znj. A.S., anëtarë z. A.K., anëtar	Operatorët Ekonomike P
Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Blerje me Vlerë Vogël”		
Fondi Limit (pa TVSH) 993,200.00 Lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 945,000 Lekë	Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 48,200 lekë
Data e hapjes së tenderit: 01.06.2022	Vlera kontratës për vitin 2022 1,134,000 Lekë me TVSH	Operatorët Ekonomike Pjesëmarrës në tender: 24 OE b) Skualifikuar: 24 OE c) Kualifikuar: 0 OE

Në shkresën nr. 8507/2 prot., më datë 24.05.2022, nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i është paraqitur kërkesa për pajisjen me uniforma të punonjësve të Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren pranë Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

Shkresa nr. 8507 prot., datë 20.05.2022 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për planifikimin e fondeve në lidhje me kërkesën për pajisje me uniforma.

Argumentimi i fondit limit. Titullari i Autoritetit Kontraktor, në datë 27.05.2022, me shkresë nr. 9009 prot., ka nxjerrë Urdhrin për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit me objekt “*Blerje uniforma për sektorin e verifikimit dhe monitorimit në terren*”. Në procesverbalin e mbajtur në datë 30.05.2022, mbështetur në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76 “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, anëtarët e njësisë së prokurimit, hartuan fondin limit duke u bazuar në studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, 993,200.00 lekë pa tvsh. Procedura është zhvilluar me fond limit, 993,200 lekë pa tvsh, në 15.12.2022 është ndryshuar në regjistrin e realizimit në 945,000 lekë pa tvsh.

Urdhri i prokurimit. Urdhri i Prokurimit nr. 9009/2 prot., në datë 30.05.2022 nxjerrë nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, për prokurimin me vlerë të vogël me objekt “Blerje Uniforma”, mbështetur në nenin 41, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 56, pikat 4 dhe 10, Kreu VI të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, blerje uniforma, xhupa me mëngë 150 copë dhe xhupa pa mëngë 150 copë.

Ftesa për ofertë. Bazuar në të dhënat e sistemit elektronik të APP, ftesa për ofertë ju është dërguar 5 operatorëve ekonomikë. Janë paraqitur 24 OE pjesëmarrës, 24 operatorë ekonomikë janë kualifikuar dhe 0 OE janë skualifikuar. Në ftesën për ofertë në dosje dhe të ngarkuar në sistemin e APP është e paplotësuar data dhe ora e zhvillimit të procedurës. Mos përfshirja e vendit, datës dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 21 pika 2.

Vlerësimi i ofertave. Nga auditimi rezulton se janë tërhequr nga procedura 9 operatorë ekonomikë dhe operatori ekonomik fitues është shpallur **P.I.**, me vlerë 945,000.00 Lekë. Bazuar në ofertat e ardhura, klasifikimi përfundimtar është si më poshtë vijon:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera e ofruar	Data e Njoftim Fituesi	Data e Njoftim Skualifikimi	Arsye e tërheqjes nga procedura
1	Xh.	675,500.00	02.06.2022	02.06.2022	Arsye shëndetësore
2	B.	682,000.00	02.06.2022	03.06.2022	Arsye shëndetësore
3	Y.	705,000.00	03.06.2022	06.06.2022	Nuk u paraqit
4	G.	724,000.00	06.06.2022	06.06.2022	Arsye shëndetësore

5	A.	757,000.00	06.06.2022	07.06.2022	Angazhime të tjera, të pamundur realizimin brenda afateve
6	E.	825,000.00	07.06.2022	08.06.2022	Arsye shëndetësore
7	E.	870,000.00	08.06.2022	08.06.2022	Arsye objektive
8	S.	900,000.00	08.06.2022	08.06.2022	Arsye objektive
9	L.	920,000.00	08.06.2022	08.06.2022	Angazhime të tjera
10	P.	945,000.00	08.06.2022		Fitues

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Në ftesën për ofertë është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizimi, për tatimpaguesit që përdorin platformën qendrore të faturave, kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme e kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softuerike të cilat rezultojnë të jenë dorëzuar nga operatori ekonomik fitues.

Zbatimi i kontratës. Në datë 03.06.2022, shkresa nr.9009/4 prot., përmban Urdhrin për ngritje e grupit të punës për marrjen në dorëzim të shërbimit të prokuruar me objekt “Blerje Uniforma”, në përputhje me Ligjin nr. 162 dt 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Në datë 14.06.2022, është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të uniformave, nga komisioni i marrjes në dorëzim të objektit: “Blerje uniforma”, Komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 9009/4 prot., datë 03.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve pasi verifikoi në sasi dhe cilësi se uniformat e sjella ishin sipas kërkesave të DPT-së kreu marrjen e tyre në dorëzim. Malli u shoqërua me faturën nr. 68 datë 14.06.2022 të subjektit P.I., në vlerën 440,100.00 lekë pa tvsh (528,120.00 me tvsh). Sasia e uniformave të furnizuara me anë të kësaj fature i referohet vetëm xhupave pa mëngë, në sasinë 150 copë sipas përmasave të caktuara.

Në datë 20.06.2022 u mbajt procesverbali për marrjen në dorëzim të uniformave nga komisioni i marrjes në dorëzim të objektit: “Blerje uniforma”, pasi verifikoi në sasi dhe cilësi se uniformat e sjella ishin sipas kërkesave të DPT-së kreu marrjen e tyre në dorëzim. Malli u furnizua me faturën nr. 69 datë 20.06.2022 të subjektit Power Industries, në vlerën 504,900.00 lekë pa tvsh (605,880.00 me tvsh). Sasia e uniformave të furnizuara me anë të kësaj fature i referohet vetëm xhupave me mëngë, në sasinë 150 copë sipas përmasave të caktuara. Totali i vlerës së realizuar është 945,000.00 lekë pa tvsh ose 1,134,000 lekë me tvsh.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit:		
Urdhër Prokurimi	Urdhër	OE i Kontraktuar
Nr 18747, datë 03.11.2022	Nr. 7592 prot., datë 10.05.2022	

3. Shpenzime për mirëmbajtje aparate, pajisje teknike dhe vend pune, 3.1 Riparim printera

Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Blerje me Vlerë Vogël”	Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël znj. B.H., kryetare znj. A.S., anëtarë z. A.K., anëtar	B , sh.p.k
Fondi Limit (pa TVSH) 99,687.77 Lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 99,583.33 Lekë	Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 104.44 lekë
Data e hapjes së tenderit: 11.11.2022	Vlera kontratës për vitin 2022 119,500 Lekë me TVSH	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: -1 OE c) Kualifikuar: 2 OE

Në shkresën nr. 18483 prot., më 31.10.2022 është kërkuar fillimi i procedurave për shërbimin e riparimit printer/fotokopje drejtuar Sektorit të Shërbimeve bazuar mbi kërkesën e bërë nga Drejtoria Juridike si dhe gjendjes teknike të fotokopjes.

Argumentimi i fondit limit. Anëtarët e njësisë së prokurimit, hartuan fondin limit duke u bazuar në “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”. Në procesverbalin e datës 03.11.2022 është kryer llogaritja e fondit limit të blerjes së vogël me objekt, “Riparimi i printerave dhe fotokopjeve”, mbështetur në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, “Mënyrat për llogaritjen e vlerës së prokurimit”. Mesatarja e marrë nga ky studim për riparimin e printerave dhe të fotokopjeve është 99,687.77 lekë pa tvsh.

Urdhri i prokurimit. Shkresa nr. 18747 prot., në datë 3.11.2022, përmban Urdhër Prokurimi, procedura e prokurimit me vlerë të vogël për riparimin e printerave (2 copë) dhe riparimi i fotokopjeve (2 copë).

Në procesverbalin për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera, të mbajtur në datë 11.11.2022 për konfirmimin e punimeve të bëra për riparimin e fotokopjeve dhe printerave sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 8747 prot., datë 03.11.2022, janë specifikuar riparimet e kryera për fotokopjet dhe printerat.

Ftesa për ofertë. Për procedurën e prokurimit me objekt “Riparim printera” rezultojnë 3 operatorë ekonomikë që kanë paraqitur ofertat si më poshtë vijon:

Në lekë

Ofertuesi	B	N	B
Nipti	J.....7D	J.....E	K.....V
Vlerat e ofertës pa tvsh	99,583.33	99,780.00	99,700.00

Fitues rezulton ofertuesi me vlerën më të ulët B E me vlerë 99,583.33 lekë pa tvsh.

Vlerësimi i ofertave. Komisioni i blerjeve të vogla, i caktuar me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 7592 prot., në datë 10.05.2022 ka shpallur ofertën fituese të B bazuar në vlerën më të ulët të ofruar.

Në datë 11.11.2022 është mbajtur procesverbal për konfirmimin e punimeve të kryera për riparimin e fotokopjeve dhe printerave sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 18747 prot., datë 03.11.2022 në të cilën janë konfirmuar shërbimet e kryera. Fatura tatimore nr. 7944/2022 e lëshuar në datë 11.11.2022 në emër të B ka vlerën 99,583.33 Lekë pa tvsh (119,500.00 Lekë me tvsh)

3.2 Blerje Certificate SSL

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit:		
Urdhër Prokurimi Nr 15540, datë 15.09.2022	Urdhër Nr. 7592 prot., datë 10.05.2022 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël	OE i Kontraktuar I
Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Blerje me Vlerë Vogël”	znj. B.H., kryetare znj. A.S., anëtarë z. A.K., anëtar	

Fondi Limit (pa TVSH) 153,875 Lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 78,000 Lekë	Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 75,875 lekë
Data e hapjes së tenderit: 10.10.2022, 11:30	Vlera kontratës për vitin 2022 93,600 Lekë me TVSH	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës : 6 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 3 OE

Kërkesa për fillimin e procedurave ka filluar nëpërmjet email në datë 13.09.2022 të nisur nga drejtori në Drejtorinë e TIK të Tatimeve. Në datë 15.09.2022 është mbajtur procesverbal mbi llogaritjen e fondit limit të blerjes së vogël me objekt, “Blerje certifikate SSL për DPT-në, bazuar në çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo autoritete të tjera kontraktore.

Argumentimi i fondit limit. Në procesverbalin e mbajtur në datë 15.09.2022, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, anëtarët e njësisë së prokurimit kanë hartuar fondit limit bazuar në çmimin e kontratës së mëparshme, të realizuar nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore dhe për të llogaritur fondin limit është bazuar në faturën nr.6, datë 21.10.2022 nga subjekti E.N. me NIPT L.....L për Certifikatë SSL për periudhë 2 vjeçare në vlerën 94,500 lekë, fondi limit përllogaritet në vlerën 47,500 lekë pa tvsh.

Urdhri i prokurimit. Shkresa nr. 15540 prot., datë 15.09.2022, përmban Urdhrin e Prokurimit që të përdoret procedura e prokurimit me vlerë të vogël për “Blerje Certifikatë SSL për nevoja të aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit (CTS).

Ftesa për ofertë. Shkresa nr. 15540/1 prot., datë 15.09.2022 që përmban ftesën për ofertë me specifikimet teknike të certifikatës SSL për CTS.

Vlerësimi i ofertave. Shkresa në datë 04.10.2022, përmban Njoftim Anulimi për blerje me vlerë të vogël me objekt “Blerje certifikate SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit (CST) për shkak se nuk u paraqit asnjë ofertë e përshtatshme në këtë procedurë. Janë refuzuar ofertat e mëposhtme:

1	I	80,000.00
2	R	120,000.00
3	O	150,000
4	I	285,000.00
5	X	588,000.00

Janë refuzuar ofertat si më poshtë vijon për shkak se nuk u paraqit asnjë ofertë e përshtatshme:

1	I	85,000.00
2	R	130,000.00
3	O	150,000.00
4	I	250,500.00

Në procesverbalin e mbajtur në datë 06.10.2022, është llogaritur fondi limit bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga studimi i tregut, në datë 05.10.2022 në vlerën 153,875.00 lekë pa tvsh. Pas anulimit të procedurës dy herë në SPE për arsye se të gjitha ofertat ishin më të larta se fondi i llogaritur nga ne (i cili u llogarit duke u bazuar në kontratat e mëparshme) u vendos rillogaritja e fondit. Fondit limit përllogaritet duke u bazuar në mesataren e ofertave të paraqitura në datë 05.10.2022 në vlerën 153, 875 pa tvsh.

Anëtarët e Komisionit të blerjeve të vogla kanë deklaruar se nuk janë kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit e mëposhtëm:

1	I	65,000.00
2	I	175,000.00
3	O	500,000.00
4	X	588,000.00

Shkresa në datë 07.10.2022, përmban Njoftim Anulimi, anulimin e procedurës blerje e vogël me objekt “Blerje Certifikatë SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit (CTS) për shkak se nuk u paraqit asnjë ofertë e përshtatshme në këtë procedurë.

Ofertat e pranuar	Ofertat e refuzuara
I: 78,000	I: 59,000

R: 130,000	X:580,000
A: 145,932	M: 732,500

Në shkresën nr. 15540/2 prot., datë 12.10.2022, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 124, pika 1 në VKM nr 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107, pika 3, 6 për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve përmban Urdhër për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të shërbimit të prokuruar me objekt, “Blerje certifikatë SSL për nevoja të aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit (CTS)

Zbatimi i kontratës. Në procesverbalin e mbajtur në datë 27.12.2022 në prani të përfaqësuesve të grupit të punës të ngritur në bazë të urdhrin nr.15540/2 prot., datë 12.10.2022 me objekt “Blerje Certificate SSL për nevoja të aksesimit të sistemit të përbashkët të Transmetimit (CTS)” për shërbimin e furnizuar me faturën nr. 29/2022 nga subjekti Inside System Touch. Grupi i punës mori në dorëzim certifikatën e dorëzuar pasi verifikoi se është në përputhje me specifikimet teknike. Në datë 27.12.2022 është lëshuar fatura tatimore nr. 29/2022 operatorit ekonomik I nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në vlerën 78,000.00 lekë pa tvsh dhe 93,600.00 me tvsh.

4. Rikonstruksion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit:		
Urdhër Prokurimi Nr 16157, datë 23.09.2022	Urdhër nr. 16157/1, datë 30.09.2022 Komisioni i vlerësimit të ofertave I.K., Kryetare H.K., anëtar J.M., anëtar E.Ç., anëtar A.L., anëtar	Urdhër Prokurimi Nr 16157, datë 23.09.2022 Njësia e prokurimit B.H. A. K. A.S
Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e Hapur		
Fondi Limit (pa TVSH) 20,817,793 Lekë	Oferta ekonomike (pa TVSH) 16,657,926 Lekë	Operatorët Ekonomike OE Pjesëmarrës -5 OE të Kualifikuar -2 OE të Skualifikur 3
Lidhja e Kontrates Nr. 16157/8 prot., datë 10.11.2022	Vlera kontratës për vitin 2022 19,989,511 me TVSH	OE i Kontraktuar BOE O.

Hartimi i fondit limit

Shkresa nr. 11752 prot., 07.07.2022, përmban Urdhër për emërim specialisti për hartimin e detyrës së projektit, për tenderin me objekt, “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”. Sektori i prokurimeve ka kërkuar informacion nëse ka fonde të planifikuara për hartimin e projektit për rikonstruksionin e godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në shkresën nr. 11752/4 prot., datë 25.07.2022, nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është bërë me dije se nga buxheti është e pamundur mbulimi me fonde buxhetore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është drejtuar operatorëve ekonomikë, të listuar në tabelën e mëposhtme me kërkesë për hartim projekti pa pagesë pasi për shkaqe financiare dhe afati nuk mund të realizojë projekte nëpërmjet procedurës së prokurimit, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjithashtu nuk ka kapacitetet e nevojshme për hartimin e projekteve nëpërmjet stafit të saj.

Me shkresë nr. 13667/1 prot., në datë 15.08.2022, operatori ekonomik “A. M.” sh.p.k ka njoftuar se është e gatshme për realizimin e projektit me objekt, “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme dhe mureve rrethues të godinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”. Ndërmjet palëve shoqëria A.M. sh.p.k dhe përfituesit të dhurimit, DPT është lidhur kontratë dhurimi, me shkresën nr. 13667/2 prot., datë 19.08.2022. Urdhër nr. 13667/3 prot., datë 19.08.2022 nxjerrë nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur komisionin për marrjen në dorëzim të projektit.

Bazuar në kontratën e dhurimit nr.13667/2 datë 19.08.2022, firma A.M. shpk ka dorëzuar “Projektin e zbatimit dhe preventivat përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të godinës së DPT në datë 08.09.2022 me protokoll nr. 13667/5 e cila është marrë në dorëzim

nga komisioni në datën 09.09.2022. Dokumentet e dorëzuara rezultojnë në përputhje me kërkesat teknike të projektit për rikonstruksionin e ndërtesës së DPT-së.

Në shkresën nr. 13667/6, në datë 15.09.2022, është kërkuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, konfirmim nëse fondi për projektin e zbatimit dhe preventivat përfundimtar të rikonstruksionit të godinës të DPT është i parashikuar për vitin 2022 nga DPT-ja. Në datë 20.09.2022, shkresa me nr. 13667/7, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse sqaron se, DPT disponon fondin buxhetor për shpenzimin kapital për projektin “Rikonstruksion i DPT në vlerën 25,000,000 lekë me tvsh. Nëpërmjet shkresës nr. 16048/2 në 19.09.2022 është miratuar transferimi i fondeve.

Zhvillimi i procedurës

Urdhër prokurimi nr. 16157 prot., datë 23.09.2022 i nxjerr nga titullari i institucionit ka kërkuar të kryhet prokurimi i fondit prej 20,817,793 Lekë pa tvsh vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për tenderin me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, procedurë e hapur. Kjo procedurë është përzgjedhur mbështetur në nenin 42, pika 1 të ligjit 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik, jep mundësi të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar dhe në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 47, “Procedura e Hapur”, kjo është procedura e prokurimit me një fazë që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra me një vlerë mbi kufirin e ulët monetar.

Në datë 26.09.2022, bazuar në udhëzimin nr. 2 dt. 09.06.2021 është kërkuar asistencë nga Agjencia e Prokurimit Publik për të shqyrtuar dokumentacionin e përgatitur nga DPT. Referuar rekomandimeve të dërguara në rrugë elektronike nga Agjencia e Prokurimit Publik për disa nga pikat e kritereve teknike të hartuara nga komisioni bashkëlidhur është dërguar hartimi dhe argumentimi i rishikuar nga anëtarët e komisionit.

Në shkresën nr. 16157/1 prot., në 30.09.2022, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, për tenderin me procedurë, “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstruksion i Godinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Në datë 30.09.2022, shkresa nr. 16157/2 përmban njoftimin e shkurtuar të kontratës, ku kohëzgjatja e kontratës është 2 muaj me fond limit 20,817,793.00 pa tvsh dhe në të njëjtën datë është mbajtur procesverbali standard i argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Është urdhëruar emërtimi i inxhinierit për llogarinë e vlerës së mbikëqyrësit dhe kolaudatorit për projektin. Procesverbali i hapjes së ofertave për tenderin është mbajtur me datë 19.10.2022 lidhur me hapjen e procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Rikonstruksioni i Godinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me fond limit 20,817,793.00 Lekë. Pasi u hap procedura nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm rezultoi se janë paraqitur 5 operatorë ekonomik me oferta si më poshtë vijon:

1. “2” sh.p.k me ofertë ekonomike, 15,825,818 lekë pa tvsh
2. “A” sh.p.k me ofertë ekonomike, 19,642,144.29 lekë pa tvsh
3. “I” Sh.p.k me ofertë ekonomike, 17,951,890 lekë pa tvsh
4. “L” Sh.p.k me ofertë ekonomike 18,306,520 lekë pa tvsh
5. “O.” sh.p.k me ofertë ekonomike 16,657,926 pa tvsh

Më datë 19.10.2022, nga ana e KVO, të Autoritetit Kontraktor pasi janë shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat për tenderin me objekt dhe vlerë të sipërcituar, është analizuar dokumentacioni i paraqitur, është verifikuar plotësimi i kërkesave ligjore, teknike dhe financiar, janë verifikuar ligjshmëria e ofertave të paraqitura dhe është konkluduar me vlerësimin se operatori ekonomik, BOE “O.” sh.p. është konstatuar se plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike të kërkuara nga ana e Autoritetit kontraktor.

Në datë 27.10.2022 autoriteti kontraktor ka mbyllur procedurën në SPE dhe është njoftuar operatori ekonomik BOE "O." shpk nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, për të paraqitur dokumentacionin sipas parashikimeve ligjore, pranë DPT-së.

Zbatimi i kontratës me nr. 16157/8, datë 10.11.2022

Në datë 10.11.2022 është lidhur kontratë pune nr. 16157/8 prot., objekti "Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve", midis Drejtorisë e Përgjithshme të Tatimeve dhe BOE "O." ShPK. Vlera e kontratës është 19,989,511 me tvsh.

Punimet janë një fazë dhe fillojnë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe duhet të përfundojnë në 31.12.2022. Shkresa nr. 16157/12, në datë 11.11.2022, përmban Urdhër për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin dhe ndjekjen e kontratës.

D., mbikëqyrësi i punimeve, ka dërguar shkresën nr. 16157/13 prot., datë 11.11.2022, ku njoftohet se kontraktori B.O.E "O. Sh.p.k ka marrë në dorëzim ambientet për fillimin e punimeve. Data e fillimi të punimeve do të jetë data 11.11.2022. Në shkresën nr. 16157/19 datë 30.12.2022 dërgues D, në datë 30.12.2022, ka njoftuar për përfundim e punimeve për objektin "Rikonstruksioni i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve." Në zbatim të kontratës nr. 16157/8 Prot., datë 10.11.2012 ndërmjet Autoritetit Kontraktor "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve" dhe kontraktuesit të punimeve B.O.E "O."shpk si edhe kontratës së lidhur me Mbikëqyrësin e punimeve, shoqërinë "D."Shpk për realizimin e kontratës me objekt:"Rikonstruksioni i Godinës së DPT" është vënë në dijeni se nga verifikimit në objekt nga ana e D. dhe bazuar në shkresën e datës 30.12.2022 të Kontraktuesit, punimet e këtij objekti kanë përfunduar me datë 30.12.2022 dhe është dërguar dosja përfundimtare për objektin "Rikonstruksion i përgjithshme të tatimeve" një kopje i është dhënë dhe Kolaudatorit të objektit me datë 30.12.2022.

5. Rikonstruksion Drejtoria Rajonale Diber

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit:		
Urdhër Prokurimi Nr. 17086, datë 06.10.2022	Urdhër nr. 17086/2, datë 17.10.2022 Komisioni i vlerësimit të ofertave A.Ç., Kryetar, I.P, anëtar, J.Sh., anëtar, G.G., anëtar, A.I, anëtar	Urdhër Prokurimi Nr 17086, datë 06.10.2022 Njësia e prokurimit B.H. A.K. A.S.
Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur		
Fondi Limit (pa TVSH) 12,499,194 Lekë	Oferta ekonomike (pa TVSH) 10,146,086 Lekë	Operatorët Ekonomikë OE Pjesëmarrës -4 OE Kualifikuar -2 OE të Skualifikur - 2
Lidhja e Kontrates Nr.17086/7, datë 07.12.2022	Vlera kontratës 12,104,625 me TVSH	OE i Kontraktuar 2 N. sh.p.k

Hartimi i fondit limit

Shkresa nr. 1772 prot., datë 27.05.2022, përmban Urdhër nr.3 për krijimin e komisionit të pranimit të dokumentacionit për dorëzimin e projektit të rikonstruksionit DRT Diber, ku bazuar në kërkesat e procedurës për tender për verifikimin paraprak dhe dokumentin e dokumentacionit të kërkuar për zhvillimin e tenderit të rikonstruksionit të ndërtesës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Diber.

Shkresa nr. 2134 prot., më 02.08.2022 përmban kërkesën për hartim projekti, rikonstruksion të zyrave të DRT Diber, ku i është dërguar, E, A, Joint Venture P, në të cilën Drejtoria Rajonale Tatimore Diber do të kryejë rikonstruksionin e ambienteve të brendshme të godinës së saj. Nga buxheti i shtetit garantohet financimi për rikonstruksionin e godinës të Drejtorisë Rajonale Tatime Diber por për shkaqe financiare dhe mungesë të afatit nuk mund të realizojë projekte duke ndjekur procedurat përkatëse për hartimin e projekteve që nevojiten nëpërmjet stafit të saj.

Shkresa, në datë 05.08.2022, përmban njoftim për realizimin e projektit me objekt, “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme të godinës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër”, ku në bazë të njoftimit nr.2134, prot. datë 02.08.2022 për hartim projekti E, NIPT K.....K, njofton se është e gatshme të realizojë hartimin e projektit për këtë objekt brenda afateve kohore të përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

Shkresa me nr. 2134/1 prot., datë 05.08.2022, përmban Kontratë Dhurimi për projektin dhe është lidhur kontratë ndërmjet palëve, Shoqëria E. ShPK dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër. Shkresa e protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve në datë 03.08.2022, ka numër protokolli nr. 2134/1 prot., është mbajtur procesverbal 02.08.2022 ku në zbatim të Urdhrit të brendshëm të Drejtorit Rajonal të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër nr. 1772 prot., datë 27.05.2022 komisioni i verifikimit të dokumentacionit pas shqyrtimit ka konfirmuar dokumentet e sjella rezultojnë të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit për rikonstruksionin e ndërtesës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër.

Shkresa nr. 13359/1 prot., më 19.08.2022, përmban Urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të “Projektit të zbatimit dhe preventivat përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër dhe hartimi i kriterëve teknike.

Procesverbal për komisionin për marrjen në dorëzim të Projektit të zbatimit dhe preventivat përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, me shkresë nr. 13357 prot., datë 03.08.2022 dhe nr. 13359 prot., datë 03.08.2022 të DRT Dibër, është marrë në dorëzim në datë 18.08.2022, praktika e sjellë .

Shkresa me nr. 13359/3 prot., datë 29.08.2022, komisioni ka marrë në dorëzim projektin për rikonstruksionin e DRT Dibër në datë 23.08.2022.

Zhvillimi i procedurës

Shkresa nr. 17086 prot., datë 06.10.2022 përmban Urdhër prokurimi ku mbështetur në Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik, në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021, ku është përcaktuar kryerja e prokurimit me fond të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për tenderin me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Tatimeve Dibër”. Në datë 17.10.2022, shkresa nr. 17086/2 prot., përmban Urdhër për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave mbështetur.

Në datë 04.11.2022 është bërë hapja e ofertave, ku rezultoi se për tenderin me objektin e sipërcituar kanë paraqitur ofertën 4 operatorë si më poshtë:

1. “2” sh.p.k, me ofertë ekonomike, 10,146,089 lekë pa tvsh
2. “L.” sh.p.k me ofertë ekonomike, 10,450,036 lekë pa tvsh
3. “E” sh.p.k me ofertë ekonomike, 11,436,240 lekë pa tvsh
4. “M” me ofertë ekonomike, 12,416,897 lekë pa tvsh

Janë shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat e mësipërme, në datë 17.11.2022 nga Komisioni i vlerësimit të ofertave të Autoritetit Kontraktor bazuar në dokumentacionin e paraqitur ku është verifikuar plotësimi i kërkesave financiare, teknike dhe ligjore dhe është konkluduar se operatori ekonomik “2” sh.p.k i plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe ligjore të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në datën 17.11.2022 autoriteti kontraktor ka mbyllur procedurën e SPE dhe është njoftuar operatori ekonomik “2” sh.p.k nëpërmjet sistemit të prokurimeve publike elektronike, për të paraqitur dokumentacionin pranë DPT. Në datë 01.12.2022 operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar i cili është i plotë dhe sipas kërkesave të DPT. Ofertuesi “2” shpk me ofertën ekonomike 10,146,089 lekë pa tvsh është fitues.

Procesverbali i mbajtur në datë 15.12.2022 nga anëtarët e njësisë së prokurimit në lidhje me procedurën e hapur “Rikonstruksion i godinës së Tatimeve Dibër”, në datën 22.11.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka hedhur njoftimin e fituesit e cila është miratuar nga APP-ja në datën 23.11.2022 dhe dalë në buletin nr. 164 në 30.11.2022. Nuk ka pasur asnjë ankimues dhe është vazhduar me lidhjen e kontratës.

Zbatimi i kontratës me nr. 17086, datë 07.12.2022

Në datë 07.12.2022, është lidhur kontrata nr. 17086/7 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe shoqërisë “2.N” shpk, nënshkruar nga sipërmarrësi i “2” shpk dhe Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vlera e kontratës është 12,104,625.00 lekë me tvsh. Për vitin 2022 vlera është 8,070,153.48 lekë me tvsh dhe 4,034,471.52 lekë me tvsh.

Titullari i Autoritetit kontraktor nëpërmjet Urdhër nr. 17086/11 prot., datë 7.12.2022 ka caktuar personat përgjegjës për zbatimin dhe ndjekjen e kontratës. Në datë 07.12.2022, nr.17086 prot., është bërë njoftimi mbi fillimin e punimeve, ku mbikëqyrës i punimeve është “G.” sh.p.k, i cili në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës nr. 18149/2 prot., datë 7.12.2022, ka njoftuar se kontratori “2” sh.p.k ka marrë në dorëzim sheshin në ndërtimi për kryerjen e punimeve në objektin “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Tatimeve Dibër”.

Titulli i gjetjes:	Nuk janë respektuar afatet dhe rregullat për zbatimin e procedurës së prokurimit.
Situata :	Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë jashtë afateve të përcaktuara Urdhrin për caktimin e personave përgjegjës për prokurim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, “Personi përgjegjës për prokurim dhe njësia e prokurimit”, pika 1 “Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/at përgjegjës për prokurim...” Urdhri nr. 7592/2 prot., për caktimin e personave përgjegjës për prokurim është nxjerrë datë 20.05.2022.
Situata 2:	Referuar VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4 “Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit”, pika 2, “Autoriteti, çdo 4 muaj por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator, 10 janar të çdo viti dorëzon në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara”, ky informacioni është dërguar jashtë afateve të përcaktuara, respektivisht informacioni është dërguar në datë 26.05.2022 për 4 mujorin, në datë 13.09.2022 për 8 mujorin, dhe në datë 07.02.2023 për 12 mujorin e vitit 2022.
Situata 3:	Data dhe ora e zhvillimit të procedurës nuk është përcaktuar në Ftesën për Ofertë, në procedurën “Shpenzime për mirëmbajtje për objekte ndërtimore” në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 21, pika 2, “Ftesa për ofertë përfshin të paktën informacion...vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre”.
Kriteri:	Ligj nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4, pika 2; neni 21, pika 2; neni 74, pika 1 .
Ndikimi:	Nuk është i mbështetur në bazën ligjore zbatimi i procedurës së prokurimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) pasi nuk ka respektuar afatet dhe rregullat e përcaktuara në bazën ligjore.
Shkaku	Mos zbatimi i bazës ligjore në procedurave të prokurimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për kryerjen e procedurave të kërkuara nga aktet ligjore në fushën e prokurimit publik me fillimin e vitit buxhetor duke caktuar njësinë e prokurimit në kohë, me qëllim fillimin dhe përfundimin e procedurave të prokurimit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator përkatës.

Për sa më sipër, është mbajtur Projektraporti i Auditimit, i protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023. Subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacione mbi këtë projektraport.

2.10. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm

2.10.1 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Në zbatim të pikës nr. 10 të programit të auditimit “*Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm*”, për vlerësimin e auditimit të brendshëm u shqyrtua dokumentacioni si poshtë:

- Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e auditimit publik;
- Rregulloren e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore;
- Strukturën e njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe aktivitetin e saj;
- Plani Vjetor i Auditimit 2022 dhe Plani Strategjik 2022-2024;
- Raporti Vjetor i DAB për vitin 2022;
- Karta e Auditimit të Brendshëm;
- Dosje auditimi.

Neni 5 i Kreut II të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” citon se misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, veprimtaria e Auditimit të Brendshëm duhet të kryhet në përputhje me:

- Standardet Ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të njohura dhe të zbatuara në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara nga Ministri i Financave;
- Këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës, Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i Financave, si dhe akte të tjera për kryerjen e shërbimit të auditimit, pra zbatimin i standardeve është detyrim ligjor.

Referuar nenit 6 të Kreut II të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, DAB duhet t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, duke përgatitur plane strategjike dhe vjetore auditimi bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar, si dhe duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
- përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
- ruajtjen e aseteve;
- kryerjen e veprimtarisë së njësisë me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
- duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;
- duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna, etj.

Nga auditimi i realizuar për vitin 2022, për aktivitetin e ushtruar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DPT, është konstatuar se qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara në dokumentet themeluese të njësisë, siç janë Karta e Auditimit dhe Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të ATQ, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 193, datë 12.08.2020, “*Për miratimin e*

rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”. Me urdhrin nr. 72, datë 24.09.2020, “Për miratimin e Kartës së Auditit të Brendshëm, së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, është kryer miratimi nga Titullari i Institucionit, si dhe me shkresën nr. 20411 prot., datë 20.10.2020, është dërguar në DHAB, në MFE.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është ngritur dhe funksionon në nivel Drejtorie, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe përcaktimet e standardit 1100 “Pavarësia dhe objektiviteti”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm. DAB në DPT, e realizon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në:

- 14 Drejtori në DPT;
- 14 Drejtori Rajonale Tatimore;
- 6 Drejtori sipas Rajoneve.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm (DAB) në aspektin organizativ dhe funksional përgjigjet përpara titullarit të institucionit. Për vitin 2022, veprimtaria e DAB është kryer në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, “Planifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëm”, Kapitulli IV, “Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit”, Kodit të Etikës, Standardeve Ndërkombëtare dhe praktikave profesionale të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik të pranuar për zbatim në RSH, dhe Rregullores për funksionimin e ATQ-së.

Struktura organizative e DAB është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

DAB ka në përbërjen e saj dy sektorë:

1. Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit (strukturë me 1 përgjegjës sektori + 2 inspektorë).
2. Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave (strukturë me 1 përgjegjës sektori + 4 inspektorë);

Përmes organigramës së vënë në dispozicion nga DBNJ, në muajin Janar 2022, kjo Drejtori ka patur një vend vakant në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, vakancë e cila nuk është plotësuar përgjatë gjithë vitit 2022.

Tabela nr. 140 Organigrama e DAB, Dhjetor 2022

Pozicioni	Vende Sipas strukturës	Vende Faktike
DAB	9	9
Drejtor Drejtorie	1	1
Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave	5	5
Përgjegjës Sektori	1	1
Inspektor i Parë	1	1
Inspektor i Parë	1	1
Inspektor i Parë	1	1
Inspektor i Parë	1	1
Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit	3	3
Përgjegjës Sektori	1	Vakant
Inspektor i Parë	1	1
Inspektor i Parë	1	1

Burimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore, DPT

Mosplotësimi përgjatë gjithë vitit i vendit vakant të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, ka bërë që DAB të funksionojë

me 90% të kapacitetit të strukturës së saj. Duke patur parasysh rëndësinë e kësaj Drejtorie, e cila konsiderohet si një filtër i domosdoshëm për t'i dhënë titullarit të njësisë publike, nivelin e sigurisë mbi saktësinë e aktivitetit ekonomik-financiar të njësisë shpenzuese të varësisë, si dhe bazuar në faktin që auditimi i brendshëm në njësitë publike është një nga tre shtyllat e kontrollit të brendshëm financiar publik (sipas standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm Kuadri COSO dhe sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit), mungesa dhe mosplotësimi i vendeve vakante në këtë Drejtori për një periudhë të gjatë kohore mund të sjellë mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit të saj. Në Raportin Vjetor 2022 të DAB-së, mungesa e burimeve njerëzore përmendet si një nga arsyet që ka ndikuar në ecurinë e auditimeve të planifikuara dhe realizuara përgjatë vitit 2022.

Certifikimi i DAB

Përsa i përket certifikimit të punonjësve të DAB-së, grupi i auditimit pas shqyrtimit të dosjeve të personelit, konstatoi se i gjithë personeli i kësaj Drejtorie është i certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Nga auditimi u konstatua se punonjësit i përshtaten kërkesave të veçanta për pozicionin e punës, ku 7 prej tyre rezultojnë me arsim bazë ekonomist dhe 1 jurist. Përsa i përket eksperiencës dhe vjetërsisë në strukturat e auditimit ndarja rezulton si më poshtë:

- Vjetërsi pune deri në 5 vite: 3 punonjës
- Vjetërsi pune mbi 5 vite: 5 punonjës

Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2022

Përmes shkresës nr.18920 prot., datë 19.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së ka miratuar Planin Vjetor të Auditimeve për vitin 2022, ku zgjedhja për auditim është bazuar kryesisht në bazë të vlerësimit të riskut. Në Planin Vjetor të Auditimit 2022 janë planifikuar 11 auditime:

- 5 auditime përputhshmërie;
- 5 auditime të kombinuara;
- 1 auditim mbi zbatimin e rekomandimeve.

Tabela nr. 141: Plani Vjetor i Auditimeve për vitin 2022

Planifikuar			Statusi në fund të vitit
Nr.	Subjekti	Lloji i Auditimit	
1	Drejtoria Menaxhimit të Riskut në DPT	Auditim përputhshmërie	Anulluar
2	Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT	Auditim përputhshmërie	Anulluar
3	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT	Auditim përputhshmërie	Anulluar
4	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Jugor	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
5	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Verior	Auditim përputhshmërie	Anulluar
6	DRT Durrës	Auditim i kombinuar	Anulluar
7	DTM	Auditim i kombinuar	Përfunduar
8	DRT Tiranë	Auditim i kombinuar	Anulluar
9	DRT Vlorë	Auditim i kombinuar	Anulluar
10	DRT Shkodër	Auditim i kombinuar	Anulluar
11	Zbatimi i rekomandimeve	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
Total		11	

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPT, përpunuar nga KLSH.

Me shkresën nr.18920 prot., datë 19.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është miratuar hartimi i Planit Vjetor 2022 dhe Plani Strategjik i Auditimit 2022-2024.

Nëpërmjet shkresës nr.2183 prot., datë 14.02.2023, është dërguar në MFE, Raporti i Veprimtarisë së DAB-së për vitin 2022, së bashku me pyetësonin e vetëvlerësimit, në të cilin nga 40 pyetje në total, 8 kanë vlerësim “përputhshmëri e pjesshme” dhe 32 të tjerat “përputhshmëri e plotë”, pra përputhshmëria e pjesshme rezulton 20% dhe ajo e plotë 80%.

DAB gjatë vitit 2022 ka pasur ndryshim në planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2022, duke u bazuar në Nenin 12, shkronja “ç” të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin III “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm”, në pikën 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetorë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, datë 25.10.2016.

Ndryshimi sipas shpjegimit nga titullari i DAB-së bëhet me arsyetimin e shmangies së auditimit paralel duke qenë se në periudhën në fjalë këto drejtori kanë qenë në proces auditimi nga KLSH, në këtë ndryshim është kryer anulimi i auditimeve për drejtoritë, si më poshtë:

- Drejtoria Menaxhimit të Riskut në DPT;
- Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT;
- Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT;
- Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Verior;
- DRT Durrës;
- DRT Tiranë;
- DRT Vlorë;
- DRT Shkodër;

Veprimet e sipërcituara kanë ardhur si pasojë e moskordinimit të punës së titullarit të AB, kjo në kundërshtim me nenin 25 “Marrëdhënia me Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin III “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm”, pika 1 “Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditin e brendshëm dhe njësit e auditit të brendshëm bashkëpunojnë me Kontrollin e Lartë të Shtetit bazuar në parimet e komunikimit të vazhdueshëm, angazhimit, mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë”, pika 2, gërma a “fusha kryesore e bashkëpunimit është shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit më synim shmangien e mbivendosjeve”.

Tabela nr 142: Ndryshimet në Planin Vjetor të Auditimeve për vitin 2022

Audituar pas ndryshimeve			Statusi në fund të vitit
Nr.	Subjekti	Lloji i Auditimit	
1	DTM	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
2	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Qëndror	Auditim përputhshmërie	Në proces
3	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Jugor	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
4	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni në DPT	Auditim përputhshmërie	Në proces
5	Zbatimi i rekomandimeve	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
Total		5	

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPT, përpunuar nga KLSH.

Plani i ri Vjetor për vitin 2022 ka konsistuar në 5 auditime përputhshmërie. Nga auditimi rezulton se ndryshimi i Planit Vjetor të Auditimit nuk ka ndodhur sipas përcaktimeve të nenit 12 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe përcaktimeve të kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, ku përcaktohet se: “Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit”, por është miratuar nga vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

E njëjta situatë ka ndodhur në rastin e dërgimit të Planit Vjetor të Auditimit 2022 dhe Planit Strategjik 2022-2024 pranë DHAB në MFE përmes shkresës nr. 18920 prot., datë 19.10.2021. Duke qenë se Komiteti i Auditimit nuk ka qenë funksional në këtë periudhë, përmes shkresës 18920/1, është miratuar Plani Vjetor dhe Plani Strategjik i Auditimit nga vetë Titullari i DPT.

Mungesa e mendimit nga Komiteti i Auditimit ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të këtij komiteti pranë MFE. DAB ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit, komunikimin elektronik me Drejtorinë e Auditimit në MFE, ku sqarohet se Komitetit të Auditimit të Brendshëm i ka përfunduar mandati i përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 211, datë 07.06.2019.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin, datë 14.07.2023 dhe të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023 protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 mbi ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Drejtuesi i auditimit harton plan strategjik dhe vjetor për njësinë që drejton ndërsa plani i konsoliduar i auditimit të brendshëm i cili është për të gjitha njësitë e auditimit në rang vendi nuk koordinohet dhe shkëmbehet nga drejtuesi i një njësie auditimi. Kjo është përgjegjësi e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pasi referuar Kapitullit III pika 3.3 “Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor” në manualin e auditimit të brendshëm të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016 i ndryshuar.

Oëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas trajtimit të pretendimeve nga subjekti të paraqitura për sa më lartë, i cilëson si të paargumentuara dhe nuk ndryshon qëndrimin e tij lidhur me problematikën e konstatuar. *Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.*

Analiza e Planit Vjetor për vitin 2022

Plani Vjetor i Auditimeve i ndryshuar, ka në përbërjen e tij 5 auditime të planifikuara për vitin 2022, ndërkohë që nga viti 2021 ka patur 3 auditime të mbartura për DRT Dibër, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Jugor dhe Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Qendror. Përgjatë vitit, janë përfunduar 6 auditime, 8 auditime janë anuluar dhe 2 janë në proces. Evidentohet se DAB nuk e ka arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor të ndryshuar.

Gjithashtu nga analiza e ngarkesës së punës audituese të audituesve të DAB përgjatë vitit, konstatohet se DAB ka planifikuar me rezervë angazhimin e burimeve njerëzore, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesës shumë të ulët të disa audituesve të tjerë. Grupi i auditimit konstaton planifikim joeficient të burimeve njerëzore nga ana e DAB, kjo ka sjell si pasojë një numër të ulët të auditimeve të realizuara për vitin 2022 të cilat kanë cënuar mbarëvajtjen e punës në këtë drejtori me pasojë mos realizimin të planit të auditimeve për këtë periudhë.

Tabela nr. 143 Ditët e punës për çdo punonjës.

Nr	Punonjësi	Ditë pune në auditim	Ditë pune përgatitje materiali	Ditë punë për vitin 2022	Ditë pune jo efektive
1	E.S.	60	58	230	112
2	N.T.	64	58	230	108
3	Bl.L.	76	58	230	96
4	K.K.	76	58	230	96
5	I.Gj.	76	58	230	96

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni, dërguar me email në datën 27.07.2023 “Observacion për Akt Konstatimin, datë 14.07.2023 dhe të njëjtat në vijim mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 13072/2 datë 31.08.2023

protokolluar në KLSH me nr. 284/8 datë 06.09.2023 mbi ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me shfrytëzimin e burimeve njerëzore dhe shpërndarjen efektive të kohës së punës në auditime, janë marrë në konsideratë krahas të tjerave; madhësia e subjektit që do të auditohet , fushat dhe sistemet që do të auditohen, përvoja e gjithsecilit auditues etj, të cilat e bëjnë të vështirë ndarjen e barabartë të ngarkesës individuale për secilin inspektor.

Dëshirojmë t'ju sqarojmë se faktorët që ka ndikuar në mosrealizimin e numrit të auditimeve të planifikuara sipas planit vjetor 2022 (objektivi i drejtorisë) janë :

Auditimeve të kryera me kërkesë të titullarit.(2 Auditime të raporturura në proces të evaduar në vitin 2023).

Mungesë e përhershme e stafit (vende vakante) si dhe mungesa të përkohshme për shkak të paafhtësisë së përkohshme në punë.

Një pjesë të kohës efektive të punës e kanë zënë raportimi i auditimeve që kanë qenë në proces nga viti 2021 gjithsej 3 auditime.

Zgjatje të afatit të auditimit në terren për shkak të volumit të madh të dokumentacionit të audituar.

Gjatë vitit 2022 kemi patur lëvizje me zyra disa herë, e cila ka ndikuar në efektivitetin në punë (shfrytëzimin maksimal të kohës efektive të punës)

Oëndrimi i grupit auditues: Kundërshtimet e paraqitura në observacion nuk i referohen konstatimit të grupit të auditimit pasi në rezultatet e tabelës më lartë janë marrë në konsideratë ndryshimet auditimet e kryera me kërkesë të titullarit, zgjatja e afateve të auditimit si dhe ndryshimet e tjera të ndodhura gjatë vitit, pretendimet nga subjekti të paraqitura për sa më lartë, nuk e ndryshon qëndrimin e grupit të auditimit lidhur me problematikat e konstatuar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Mënyra e zgjedhjes për auditim është bazuar kryesisht në bazë të vlerësimit të riskut. Për auditimet e planifikuara, vlerësimi i riskut paraqitet si vijon:

- 10 subjekte janë vlerësuar me risk të lartë;

Për vitin 2022, vlerësimi i fushave me risk jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 144 Vlerësimi i fushave me risk për vitin 2022

Identifikimi i risqeve	Risku
Sistemi i kontrollit tatimor	I lartë
Sistemi i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara	I lartë
Sistemi i verifikimit dhe koordinimit në teren	I lartë

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DPT

Bazuar në metodologjitë e përdorura për vlerësimin e riskut, janë programuar dhe audituar ato që kanë rezultuar me një nivel të lartë të riskut. Përmbledhja e punës së DAB përgjatë vitit 2022 paraqitet si në vijim:

- **Auditime të përfunduara, të mbartura nga viti 2021:**
 - ✓ Auditim i kombinuar në DRT Dibër;
 - ✓ Auditim i kombinuar në Drejtorin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Jugor;
 - ✓ Auditim i kombinuar në Drejtorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Qendror.
- **Auditime të përfunduara për vitin 2022:**
 - ✓ Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve;
 - ✓ Auditim i kombinuar në Drejtorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Jugor;
 - ✓ Auditim përputhshmërie në DTM.
- **Auditime në proces për vitin 2022:**

- ✓ Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara – Rajoni Qendror (*përfunduar puna në terren*);
- ✓ Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni në DPT.

Nga parashikimi vjetor, DAB nuk ka arritur të përfundojë sipas planit auditimet në subjektet:

1. Drejtoria Menaxhimit të Riskut në DPT;
2. Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT;
3. Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT;
4. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Verior;
5. DRT Durrës;
6. DRT Tiranë;
7. DRT Vlorë;
8. DRT Shkodër;

Për subjektet e sipërpërmendura, për të cilat nuk ka filluar auditimi Drejtoria e Auditit nuk ka një qëndrim me procedurën që do të ndiqet në vijim.

Konstatohet se DAB nuk ka arritur të përmbushë objektivat e saj vjetor.

Gjetjet kryesore në auditimet e realizuara nga DAB për vitin 2022

Gjetjet që kanë ardhur si rezultat i auditimeve nga DAB për vitin 2022, vijnë kryesisht nga zbatimi i gabuar apo i pjesshëm i legjislacionit tatimor. Gjetjet në vlerë kanë rezultuar në sistemin e kontrollit tatimor, sistemin e shërbimit ndaj tatimpaguesit, funksionimin e kontrollit të brendshëm, etj. **Gjetjet e auditimit në vlerë** janë gjetje me efekte tatimore në shumën **7,600,000 lekë**, e cila i përket DTM.

Konstatohet një vlerë e ulët e gjetjeve krahasuar kjo me vitin 2021, ku rezulton se për vitin 2022 gjetjet janë sa 6.5% e vitit paraardhës ose 93.5 % më pak.

Gjetjet sipas fushës ose sistemeve rezultojnë 26 në total, të gjitha në sistemet e tatimeve, taksave, doganave.

Konstatohet një numër i vogël i gjetjeve krahasuar kjo me vitin paraardhës ku rezulton se për vitin 2021 gjetjet në numër janë 137.

Tabela nr. 145 Gjetjet sipas %

Gjetjet	Viti 2022	Viti 2021	2022/2021 në %
Gjetje në vlerë	7,600,000	118,500,000	6.50%
Gjetje në numër	26	137	19%

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DPT

✓ **Gjetjet kryesore janë:**

- Detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies me më shumë se 10% dhe nuk janë penalizuar.;
- Raste të mos mbajtjes së gjobave për mosrespektimin e afateve të pagesës së kësteve të tatimfitimit për periudhën 2020-2021.
- Mungesë e analizës së plotë të tatimpaguesve me humbje;
- Raste të mospërputhjes import/experte lidhur me TVSH-së së paguar në doganë me atë të deklaruar në tatime;
- Problematika me cilësinë e kontrollit ku nuk janë analizuar blerjet dhe TVSH e zbritshme, shitjet dhe TVSH e llogaritur, nuk është bërë analizë e tepricës kreditore të TVSH, etj;
- Lënia e vendeve vakante për një kohë relativisht të gjatë;
- Mangësi në procesin e ndarjes së punës;

Nga auditimet e kryera në vitin 2022, rezulton që asnjë çështje nuk është dërguar për investigim, pra sipas DAB asnjë gjetje nuk ka rezultuar të përbëjë vepër penale.

Rekomandimet e dhëna nga DAB për vitin 2022

Në bazë të gjetjeve nga DAB për auditimet e kryera në vitin 2022 janë dhënë rekomandimet përkatëse për sistemimin dhe përmirësimin e punës në të ardhmen. Rekomandimet e dhëna lidhen me:

- Marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale;
- Mbikqyrjen e administrimit të riskut dhe kontrolleve;
- Sigurimin e administrimit efektiv të punës organizative dhe përgjegjësisë;
- Komunikimin e informacionit mbi riskun dhe kontrollin, në sistemet e duhura të njësisë publike.
- Rikontroll për 3 subjekte të DTM.
 - 1- N.P. me nipt L.....N
 - 2- J. me nipt K.....M
 - 3- C. me nipt K.....M

Rekomandimet janë pranuar nga subjektet e audituara në masën 100%.

Inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve

DAB pas përfundimit të çdo auditimi, ka kryer procesin e inventarizimit të dosjeve, për çdo subjekt të audituar. Inventarizimi është bazuar në kërkesat e përcaktuara në Manualin e Auditimit. Në zbatim të kërkesave të parashikuara në *“Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën Shqipërisë”*, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për arkivat”*, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), DAB i ka dorëzuar pranë sekretarisë së DPT.

Nga dosjet e marra në shqyrtim nga grupi i auditimit, rezulton se janë të inventarizuara dhe firmosur nga audituesit, drejtuesi i DAB dhe marrësi në dorëzim. Këto dosje përmbajnë dokumentet përkatës të nevojshëm në një dosje auditimi si: Autorizimi, Deklarata e Konflikti të Interesit të Audituesve të Brendshëm, Njoftimi për Fillimin e Angazhimit të Auditimit, Programin e Angazhimit të Auditimit, ndarja e detyrave, Projekt-Raporti, Observacionet e Njësisë së Audituar, Raporti Përfundimtar i Auditimit, Rishikimi i Cilësisë nga Përgjegjësi i Grupit dhe nga Drejtuesi i Njësisë, Memo për Titullarin, Lidhur me auditim e ushtruar në DTM gjenden në dosje shkresat me nr.4092/9, nr.4092/10, 4092/11, datë 30.11.2022 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me emrat e subjekteve të cilët janë propozuar për rikontroll nga grupi i auditimit.

Konstatohet se nuk është vazhduar procedura për propozimin për rikontroll drejtuar DTM, procedura e cila është kryer në kundërshtim me nenin 85, të ligjit 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar” pika 2.Rikontrolli tatimor miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kërkesës me shkrim për fillimin e një rikontrolli tatimor, të bërë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale apo Drejtuesi i Njësisë së ngjashme me të, si dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit apo Auditit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.*

3. Vendimi i miratimit të rikontrollit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në të cilin janë shprehur qartë arsyet e rikontrollit, i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin e kontrollit tatimor.

Titulli:	Performancë e ulët e drejtorisë së auditimit të brendshëm si pasojë e planifikimit joeficient të burimeve njerëzore dhe ndryshim i planit të auditimit pa marrë miratimin nga MFE.
Situata:	Nga auditimi mbi aktivitetin e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm konstatohen mungesa në strukturën e kësaj drejtorie. Mungesa dhe mosplotësimi i vendeve vakante në këtë Drejtori për një periudhë të gjatë kohore ka sjellë mungesë të eficientë dhe efektivitetit të saj. DAB gjatë vitit 2022 ka ndryshuar planin vjetor të auditimit të

brendshëm, duke u bazuar në Nenin 12, shkronja “ç” të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin III “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm”, në pikën 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetorë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Ndryshimi është bërë me arsyetimin e shmangies së auditimit paralel duke qenë se në periudhën në fjalë këto drejtori kanë qenë në proces auditimi nga KLSH, ku është kryer anulimi i auditimeve për drejtoritë e Menaxhimit të Riskut në DPT, drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT; Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT; Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Verior; DRT Durrës; DRT Tiranë; DRT Vlorë; dhe DRT Shkodër. Konstatohet se veprimet e sipërcituara kanë ardhur si pasojë e moskoordinimit të punës së titullarit të AB, kjo në kundërshtim me nenin 25 “Marrëdhënia me Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin III.

Nga auditimi rezulton se ndryshimi i Planit Vjetor të Auditimit nuk ka ndodhur sipas përcaktimeve të nenit 12 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe përcaktimeve të kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, ku përcaktohet se: “Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit”, por është miratuar vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pa miratimin e MFE.

Gjithashtu, konstatohet se DAB edhe pas ndryshimeve të pa miratuara nga MFE, nuk e ka arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor të ndryshuar. Nga auditimi mbi analizën e ngarkesës së punës të audituesve të DAB përgjatë vitit, konstatohet se DAB ka planifikuar shpërndarje jo të drejtë të angazhimit të burimeve njerëzore si rezultat i planifikimit jo eficient, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesë të ulët të disa audituesve të tjerë. Kjo ka sjell si pasojë një numër të ulët të auditimeve të realizuara për vitin 2022 të cilat kanë çenuar mbarvajtjen e punës në këtë drejtori me pasojë mos realizimin të planit të auditimeve për këtë periudhë.

Përsa i përket efektivitetit të punës audituese, konstatohet një rënie e gjetjeve si në numër edhe në vlerë ku nga krahasimi me vitin paraardhës nga 137 gjetje në vlerën 118.500.000 lekë, në vitin 2022 kanë rezultuar 26 gjetje në vlerën 7.600.000 lekë.

Nga auditimi mbi auditimet e ushtruara nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm konstatohet se megjithëse nga grupi i auditimit është paraqitur raporti i auditimit të brendshëm shoqëruar me memo dhe shkresat për propozim për rikontroll, nuk janë marrë masa nga strukturat përgjegjëse për vazhdimin e procedurës për kryerjen e rikontrolleve. Nga verifikimi i dosjes së auditimit të brendshëm të zhvilluar në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj është konstatuar se nuk është vazhduar procedura për propozimin për rikontroll për 3 tatimpagues, procedurë e cila është kryer në kundërshtim me nenin 85, të ligjit 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar” pika 2. Rikontrolli tatimor miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kërkesës me shkrim për

	<i>fillimin e një rikontrrolli tatimor, të bërë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale apo Drejtuesi i Njësisë së ngjashme me të, si dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit apo Auditit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. 3. Vendimi i miratimit të rikontrrollit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në të cilin janë shprehur qartë arsyet e rikontrrollit, i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin e kontrollit tatimor.</i>
Kriteri:	Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
Ndikimi/Efekti:	Performancë e ulët e aktivitetit të auditimit të brendshëm, mos kryerje e rikontrrolleve tatimore.
Shkaku:	Ndryshim i pa miratuar i planit të të auditimit nga MFE dhe planifikim jo eficient i burimeve njerëzore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të merren masa për rakordimin e aktivitetit auditues që në fillim të vitit me qëllim shmangien e auditimeve paralele të njëkohshme si dhe për çdo ndryshim plani të merret miratimi nga strukturat përkatëse nga MFE. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për shpërndarje të drejtë të punës audituese, sipas audituesve të brendshëm në dispozicion gjatë hartimit të planit vjetor të auditimit dhe programeve individuale të auditimit për çdo subjekt të audituar. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të merren masa për vazhdimin e procedurës të propozimit dhe miratimit për rikontrroll për tatimpaguesit e evidentuar me problematika nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Për problematikat e mësipërme mbajnë përgjegjësi z. Sh. P., në cilësinë e Drejtorit të Auditit të Brendshëm dhe Z. C.K. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

2.10.2. Mbi auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

Për auditimin e kësaj çështjeje u morën në shqyrtim:

- Struktura organizative dhe organigrama e institucionit për periudhën në auditim;
- Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj DPT, Rregullorja e funksionimit dhe organizimit të DPT, Manuali i Proceseve të Punës, Rregullore e Parandalimit të Konfliktit të Interesit, Kodi i Etikës së Institucionit;
- Urdhrat / Emërimet për NA & NZ, shkresat e miratuara nga ta, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Shkresat për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP);
- Regjistri i Riskut për vitin 2022, Udhëzimi i miratuar për gjurmën e auditimit;
- Plani vjetor i trajnimeve të stafit si dhe realizimi i tyre;
- Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e Cilësisë, Pyetëtori i Vetëvlerësimit, si dhe të tjera të dala gjatë auditimit.

Nga auditimi u konstatua se:

DPT e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, të cilat rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimeve të organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të

Financave dhe Ekonomisë nr. 193, datë 12.08.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”. Në rregullore janë përcaktuar dispozitat e përgjithshme, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e çdo strukture të ATQ.

* Për periudhën objekt auditimi, institucioni në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022 - 2024. Me shkresën nr. 15927 prot, datë 31.08.2021, është dërguar në MFE, një kopje e projektbuxhetit.

* ME shkresën nr. 2712 prot, datë 21.02.2023, nëpunësi autorizues (NA) i institucionit ka dërguar te nëpunësi i parë autorizues (NPA), në MFE, jo më vonë se fundi i muajit shkurt 2023, Deklaratën për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022 dhe Raportin për funksionimin e kontrollit të brendshëm në DPT, i cili është përmbledhje e raportit vjetor të aktivitetit dhe performancës së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, veprim në përputhje me pikën nr. 1, neni 18, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

* Me shkresën nr. 2713 prot, datë 21.02.2023, është dërguar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MFE, Pyetëtori i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2022. Me shkresën nr. 2715, datë 21.02.2023, është dërguar Regjistri i riskut dhe plani operacional për DPT.

* Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe të udhëzimit nr. 9 datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” të MFE, NPA ka miratuar me urdhrin nr. 135, datë 27.04.2022, ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programeve Buxhetore (EMP) edhe të DPT.

* Në zbatim të pikës nr. 8/b, të nenit 8, të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe të Manualit të MFK, titullari i institucionit me urdhrin nr. 11, datë 31.01.2022, ka miratuar krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe në cilësinë e anëtarëve, janë caktuar zv. Drejtorët e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive në DPT.

Në kreun III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, citohet: “*Titullarët e njësive publike zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i Kontrollit.

Menaxhimi ka rolin kryesor në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë: integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

1.1 Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë, të këtij institucioni.

* Në lidhje me respektimin e normave etike e profesionale, nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar. Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe i stafit të DPT duhet të përcaktohen nga titullari i institucionit, në një Kod të Brendshëm Etike ose në një

Kod Sjelljeje. Nga auditimi u konstatua se, në zbatim të pikës nr. 2/a, neni 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe të kreut III, paragrafi “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, të Manualit të MFK, DPT disponon një Kod Etik të Brendshëm për Administratën Tatimore, të miratuar me vendimin nr. 22, datë 17.12.2020, në mbledhjen e Komitetit të Reformave.

* Me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar Rregullorja “Për marrëdhënien e punës të personelit jo nëpunës civilë, në ATQ”.

* Institucioni disponon rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në DPT”, miratuar me urdhrin nr. 4, datë 21.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i punës.

Punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve bëhet në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore për nëpunësit e shërbimit civil, si dhe ata jashtë shërbimit civil në ATQ. Kjo procedurë rregullohet nga strukturat e ATQ:

* Sektori i Rekrutimit dhe i Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të menaxhimit sipas pikës nr. 1, neni 10, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kreu II, i VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;

* Komiteti i Pranimit në zbatim të përcaktimeve të kreut III, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar;

* Titullari i institucionit në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka hartuar “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, për vitin 2022 dhe e ka përcjellë në Departamentin e Administratës Publike me email-in e datës 28.12.2021, e jo me shkresë zyrtare.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi u konstatua se DPT funksionon me strukturën që bazohet në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Struktura e DPT është miratuar me urdhrin nr. 152, datë 19.11.2020, të Kryeministrit, e cila përmban organikën e institucionit me numrin total të punonjësve. Institucioni ka një program buxhetor me qëllim përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve njerëzore dhe financiare. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme të strukturave përkatëse, janë të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të institucionit. Nëpërmjet përshkrimit të punës për çdo pozicion pune, është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit, të cilat nga auditimi u konstatuan se administrohen në dosje të veçanta, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT.

Gjatë vitit janë plotësuar disa pozicione të lira/vakante, por nga auditimi rezultoi se në muajin dhjetor 2022, në DPT ka pasur 49 pozicione të lira/vakante.

-Në lidhje me përcaktimin e NA dhe NZ në institucion. Me vendimin nr. 625, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, është bërë emërimi i z. C.K. Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve. Në bazë të pikës nr. 23, neni 4, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm është edhe nëpunës autorizues (NA) i institucionit, si dhe në bazë të pikës nr. 1, neni 10, i po këtij ligji, z. K. është Koordinator i riskut.

Në vitin 2022, detyrën e nëpunësit zbatues (NZ), e ka kryer znj. D.C., e emëruar në këtë pozicion me vendimin nr. 208, datë 06.02.2017. Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në

përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

-Në lidhje me delegimin e detyrave të NA dhe NZ. Në kryerjen e detyrave të tyre brenda fushës së zbatimit të MFK-së, NA ka të drejtë të delegojë disa detyra/kompetenca te vartësit e tij, me përjashtim të NZ, duke specifikuar kërkesat për raportimin mbi përmbushjen e detyrave. NZ ka të drejtën të delegojë detyrat e tij te vartësit e tij funksionalë, duke specifikuar kërkesat për raportimin mbi realizimin e detyrave. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk duhet të çenojë të drejtat e menaxherit që delegon, ose ta shkarkojë atë nga përgjegjshmëria për realizimin e detyrave përkatëse, apo për përzgjedhjen e vartësit, të cilit i ka deleguar të drejtat dhe detyrat.

Nga auditimi u konstatua se, me urdhrin nr. 8/2, datë 25.02.2022, NA ka urdhëruar nënshkrimin e kontratave të punës së punonjësve të shërbimit me kontratë të përkohshme, nga Drejtorët e Drejtorive Rajonale, si dhe me urdhrin nr. 37, datë 17.03.2022, është urdhëruar zv. Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve, për nënshkrimin e kontratave të punës së punonjësve të shërbimit me kontratë të përkohshme në DPT, delegime që janë kryer në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe në Manualin për MFK i ndryshuar. Ndërsa NZ, gjatë vitit 2022, nuk ka deleguar asnjë nga funksionet e tij.

1.4 Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, janë të rregulluara me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet në zbatim të tij. Si dhe me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë. Përgjegjësia e menaxhimit fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen edhe për caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune, verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës, emërimet dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta, procedurat e largimeve të stafit, niveli i pagës së tyre.

Në rregulloren për funksionimin e institucionit, janë të përcaktuara rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të institucionit. Në Kodin e Etikës janë të përcaktuara: orari dhe koha e punës, etika në komunikim, shkeljet disiplinore, etj.

1.5 Aftësitë profesionale të punonjësve.

Me vendimin nr. 1, datë 28.01.2022, të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore e Doganore (QTATD), është miratuar programi i trajnimeve për administratën tatimore, për vitin 2022. Nga auditimi u konstatua se në bazë të programit të trajnimeve nga QTATD, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka përgatitur kalendarin e trajnimeve që duhet të ndiqen nga punonjësit e ATQ, si dhe kalendarin për trajnimin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave e kapaciteteve profesionale të punonjësve gjatë vitit 2022, ku janë planifikuar:

28 tema trajnimi në 44 ditë, për punonjësit e nivelit vazhdues;

18 tema trajnimi në 25 ditë, për punonjësit e rinj;

10 tema trajnimi në 10 ditë, për punonjësit e nivelit drejtues.

Temat e trajnimeve të parashikuara në kalendar janë: fiskalizimi, sistemi C@ts, procedurat tatimore, ndryshimet në legjislacion, kontrolli tatimor, shërbimi tatimpagues, tatime indirekte tvsh etj. Nga auditimi u konstatua se në vitin 2022, janë zhvilluar të gjitha temat dhe ditët e planifikuara.

2. Menaxhimi i Riskut

-Regjistri i riskut jep një pasqyrim të identifikimit të risqeve të çdo njësie, të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të vënë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Me shkresën nr. 2715 prot, datë 21.02.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, DPT ka miratuar dhe dërguar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit

Financiar në MFE, Regjistrin e Riskut, në përputhje me nenin 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, nenin 10 “Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut” të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, si dhe pikës nr. 3.2, “Menaxhimi i Riskut” në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Risqet kryesore me mundësi dhe ndikim më të lartë që janë evidentuar nga drejtoritë e DPT, cilësohen:

- Ndryshimet e shpeshta të akteve ligjore dhe nënligjore tatimore, si dhe mos njohja e tyre nga punonjësit e administratës;
- Risku i mos akordimit të fondeve të kërkuara në zbatim të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 8537/1999 “Për barrët siguroese”, i ndryshuar;
- Largimi i punonjësve të kualifikuar nga administrata tatimore;
- Mospërputhja e të dhënave të gjeneruara nga sistemi C@ts ditore, mujore dhe progresive krahasuar me publikimet e MFE, etj.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT ka miratuar disa plane gjatë vitit 2022. Bazuar në vendimin nr. 28, datë 03.03.2022, të Komitetit të Përmbushjes është vendosur:

1. Miratimi i Plani të Përmbushjes së DPT-së 2022;
2. Miratimi i ndryshimeve në Manualin e Menaxhimit të Riskut;
3. Miratimi i Regjistrit të Riskut.

3. Veprimtaritë e Kontrollit.

* Aktivitetet e kontrollit janë rregulla, procedura dhe veprime që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Nga auditimi u konstatua se, përgjegjësitë kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e funksionit të institucionit, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Praktikat që hartohen nga specialistët përkatës në institucion, pranohen nga përgjegjësit e sektorëve, konfirmohen nga drejtorët e drejtorive, si dhe më pas paraqiten te NA për miratim, duke respektuar hierarkinë. Në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare, kryerja e pagesave është autorizuar pas firmosjes së NZ dhe NA.

Protokollimi, arkivimi dhe ruajtja e informacionit, kryhet në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

* Për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të DPT, për vitin 2022, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, Titullari i Institucionit ka urdhëruar krijimin e komisioneve në përputhje me kreun IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, në paragrafët nr. 74, 81, dhe 96 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

* Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në DPT ekzistojnë risqet që kërcënojnë objektivat pasi, struktura e DPT ka mbartur vende vakante përgjatë periudhës objekt auditimi, ndaj në këto kushte riskohet mos zbatimi i objektivave.

4. Informimi dhe Komunikimi.

* Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për t’i ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave.

Titullari i Institucionit informohet nga zv.drejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive, mbi aktivitetin e strukturave që ata drejojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike. NZ, informon me anë të informacioneve periodike, me atë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, si dhe me anë të raporteve të monitorimit çdo 3-muaj. Komunikimi i brendshëm në institucion kryhet me

shkrim dhe email, ndërsa jashtë institucionit komunikohet në formë shkresore zyrtare, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

* Sektori i Trajtimin të Ankesave në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren të DPT, administron dhe shpërndan për trajtim ankesat lidhur me shkelje të legjislacionit tatimor dhe ankesave të ndryshme për veprime korruptive. Mekanizmat e dedikuar për ankesat për korrupsion, janë numri jeshil: 08001414, adresë email-i: denoncime@tatime.gov.al, stop informaliteti etj. Të gjitha ankesat për korrupsion dërgohen për verifikime në Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm.

* Sistemi i IT-së është i pajisur me një sistem rezervë (backup) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ri përfitimin e tyre, në rast aksidenti për shërbimet financiare.

5. Monitorimi.

* Në kryerjen e monitorimit, NA, NZ dhe drejtuesit e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së MFK-së dhe objektivave të arritura. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Rolet në procesin e monitorimit sipas përgjegjësisë menaxheriale të tyre në kuadër të procesit të monitorimit të MFK-së janë:

-Stafi i punonjësve duhet të kryejë monitorimin e punës së tyre, për t'u siguruar se e kanë kryer atë në mënyrën e duhur;

-Përgjegjësit e sektorëve duhet të monitorojnë të gjitha aktivitetet dhe transaksionet në sektorët e tyre;

-Drejtorët e drejtorive duhet të vlerësojnë sa mirë funksionojnë kontrollet në të gjithë drejtoritë që mbulojnë;

-Titullari i institucionit duhet të ketë në fokus të aktiviteteve të tij monitoruese, drejtoritë kryesore të institucionit. Për shkak të këtij fokusi më të gjerë, monitorimi duhet të përqendrohet veçanërisht në arritjen e qëllimeve të institucionit. Nisur nga sa më sipër, nga auditimi u konstatua se në DPT, nivelet më të ulta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë te niveli më i lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. C.K., Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues; znj. D.C., Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit në DPT, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues; z. I.K., Përgjegjës i Sektorit të Trajnimeve dhe Vlerësimit, si dhe për periudhën 15 shkurt – 31 dhjetor 2022, edhe në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT; z. E.C., Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në DPT.

Për sa trajtuar më sipër, është mbajtur Projekt Raporti nr. 284/7 prot, datë 02.08.2023, protokolluar në DPT me nr. 13072 prot, datë 03.08.2023. Subjekti i audituar, mbi këtë Projekt Raport ka paraqitur observacionin e protokolluar në KLSH me nr. 284/8 prot, datë 06.09.2023, ku sqarojmë sa më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:

Titulli i gjetjes: “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon një regjistër të aktiveve” Ju bëjmë me dije se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit mban regjistër të aktiveve në mënyrë elektronike dhe kartelat e aktiveve aktualisht mbahen në programin Alpha web. Në kontabilitet aktivet paraqiten me kosto historike dhe në pasqyrat e bilancit paraqiten me shkallën e amortizimit të akumuluar. Pra kjo pikë është realizuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe prandaj nuk qëndron.
--

Titulli i gjetjes: “Plotësimi i disa rubrikave të Pyetësorit të Vlerësimit, nuk është kryer për vitin 2022, por për periudhën 2019-2021”.
--

Rubrikat e paplotësuara nuk lidhen me institucionin tonë pasi pjesa e paplotësuar ju përket institucioneve që kanë bord. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është një institucion që nuk

funksionon me bord. Ky pyetësor është për çdo institucion buxhetor ndaj jo çdo pikë është e dedikuar për DPT-në. Gjithashtu ju vëmë në dukje se në vlerësimet e OECD dhe SIGMA, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është një ndër institucionet me pikët më të larta buxhetore (përkatësisht në vendin e dytë me vlerësimin prej 54.5 pikë nga 72 pikë gjithsej) për aspektin e zbatimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin dhe këto vlerësime janë për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit, regjistrin e riskut, deklarata e cilësisë e sistemit të kontrollit të brendshëm etj. Pra kjo gjetje nuk mund të pranohet pasi rubrikat e paplotësuara nuk janë kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si institucion.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Konstatimi për mosadministrimin e Regjistrit të Aktiveve nga DPT qëndron, pasi grupit të auditimit të KLSH nuk ju vendos në dispozicion, në periudhën e auditimit në terren. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk merret parasysh.

-Në lidhje me konstatimin nga grupi i auditimit të KLSH, mbi plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit. Grupi i auditimit konstatoi në fazën e terrenit dhe i'a bëri të qartë personave përgjegjës në takimet ballafaqese, mosplotësimin korrekt të pyetësorit. Pyetësoi është plotësuar në rubrika të caktura për vitet 2019-2021, e jo për vitin 2022. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk merret parasysh.

Titulli i Gjetjes:	Mbi mosfunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Situata:	<p>-Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, rezultoi se GMS nuk është mbledhur në asnjë takim gjatë vitit 2022, pasi ajo ka përgjegjësinë të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet e grupit të GMS duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive, në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Këto vendime duhet të pasqyrohen në dokumenta dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të Institucionit. Nga auditimi u konstatua se, kërkesa për miratimin e:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrin të riskut, 2. Prioritetet buxhetore me kërkesat shitesë, si dhe 3. Pyetësoi i vetëvlerësimit, i janë përcjellë në rrugë elektronike më datë 18.02.2022, nga NZ i Institucionit në email-et e Kryetarit dhe anëtarëve të GMS. <p>- Nga auditimi u konstatua se, Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të miratuara nga MFE, si dhe nuk rezulton arkivimi i tyre. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces.</p> <p>- Institucioni nuk disponon Manualin e Proceseve të Punës. Qëllimi i manualit të proceseve të punës është që të përcaktojë në detaje rolin dhe detyrat brenda njësisë publike. Ai përshkruan të gjitha proceset e punës në institucion duke lejuar identifikimin e dobësive, si mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon një regjistër të aktiveve në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se, disa rubrika të plotësimit të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, për vitin 2022, përgjigjet janë dhënë për periudhën 2019-2021.</p> <p>- Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet periodike 4 dhe 8 mujore të monitorimit buxhetor, si dhe raporti 12 mujor, por nuk janë publikuar në</p>

	faqen e Web-it të Institucionit ose të MFE-së, veprim në kundërshtim me pikën nr. 271, Kreu VI, “Raportet e monitorimit”, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të MFE.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i ndryshuar, miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, të ministrit të MFE; Udhëzimi nr. 30, datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 të MFE “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, pika 271, kreu VI.
Ndikimi/Efekti:	Mungesë performace institucionale dhe cënimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Shkaku:	Moskryerja e detyrimeve që lindin nga kuadri rregullator i menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Titullari i Institucionit të marrë masa për kryerjen e mbledhjeve të GMS me pjesëmarrjen e nivelit drejtues të njësisë, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm është konstatuar se DPT, ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr.121/51 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH me nr.20/19 prot., datë 17.07.2023 jashtë afatit 6-mujor, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm konstatohet se nga 36 rekomandime të lëna, subjekti ka pranuar 31 rekomandime, ose 86% e tyre dhe nuk ka pranuar 5 rekomandime. Janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 9 rekomandime, janë në proces 3 rekomandime dhe nuk janë realizuar 16 rekomandime ose 45.1 % e tyre, si më poshtë:

- Nga 34 “Masa Organizative”, janë pranuar 31 masa, nga të cilat 5 janë zbatuar plotësisht, 8 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces, 14 masa janë pa zbatuar dhe 5 masa janë pa pranuar.

- Është rekomanduar 1 “Masë për eliminimin e paligjshmërisë në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike”, ku nga verifikimi rezulton se është pranuar masa dhe është zbatuar pjesërisht.

- Është rekomanduar “Masë Disiplinore” në kompetencë të Titullarit e cila është pranuar nga ana e subjektit dhe është në proces zbatimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e afatit ligjor në informacionin mbi ecurinë e zbatimit të masave të rekomanduara, si dhe për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe rikërkojmë të merren masa nga DPT për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, pjesërisht të zbatuara si dhe të pa zbatuara të

dërguara me shkresën Nr. 20/17 Prot., të Kryetarit të KLSH datë 19.09.2022, konkretisht për masat organizative, rekomandimet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 18, 19, 20, 23, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe për masën për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, rekomandimin nr. 1.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2022, bazuar në ligjin nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të TVSH-së, me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022", protokolluar në DPT me nr. 3185 prot., datë 25.02.2022. Për vitin 2022 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për 18,500,000 mijë lekë, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën 22,469,292 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim në shumën 3,969,292 mijë lekë, ose 21.46% më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

Ka rezultuar se plani i rimbursimit mujor është tejkaluar ndjeshëm në 7 muajt të vitit 2022, konkretisht në muajt: Janar +2%, Maj +4%, Qershor +9%, Korrik +14%, Gusht +35%, Shtator + 38% dhe Dhjetor +334%, ndërsa ka pasur mosrealizim të planit të rimbursimit në muajt e tjerë: Shkurt -35%, Mars -29%, Prill -35%, Tetor -38% dhe Nëntor -48%.

Gjithashtu, konstatohet se në 8 Drejtori Rajonale Tatimore është tejkaluar ndjeshëm plani i rimbursimit, konkretisht në DTM, DRT Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Lezhë dhe Dibër, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale për 4,388,280 mijë lekë ose kanë tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim të TVSH-së, ndërsa 6 DRT, konkretisht DRT Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Sarandë nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për 418,987 mijë lekë. Referuar të dhënave del se peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) në vlerën për 13,894,827 mijë lekë, ose 61.84 %, të totalit të realizimit faktik të rimbursimit të TVSH-së në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën +126.89% e ndjekur më pas nga DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 3,136,837 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 133.20%, tejkalim në shumën 781,837 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 14; ligjin nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", i ndryshuar dhe shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2022", protokolluar në DPT me nr. 3185 prot., datë 25.02.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 81-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për planifikim real të vlerës së rimbursimeve të TVSH-së, si dhe të marrë masat e nevojshme për monitorimin e këtij procesi, me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve.

Menjëherë e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, nëpërmjet emaili-t të datës 07.02.2023, ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit në shumën 0 lekë në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2022, në zbatim të Udhëzimit nr. 8, të MFE "Për përgatitjen e pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendrore". Nga auditimi është konstatuar se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, rezultojnë 32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për 1,843,722 mijë lekë, të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit të TVSH-së në DPT më 31.12.2022, sipas vlerësimit të grupit të auditimit është më së paku në vlerën 1,843,722 mijë lekë. Këto

veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1, dhe VKM nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 81-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së, nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore, dhe raportimin e saktë në MFE lidhur me këtë çështje.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Plani fillestar i të ardhurave tatimore për buxhetin e vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 1533 prot, DPT datë 01.02.2022 për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shumën totale 157,548 milion lekë neto, megjithëse ligji për buxhetin është miratuar më 25.11.2021.

Me Vendim nr. 23 datë 23.03.2022 nga Komiteti Operacional është miratuar plani i të ardhurave për DRT për vitin 2022 në vijim të Urdhrit të Drejtorit të DPT nr. 2968 datë 23.02.2022 “Për detajimin e planit të të ardhurave për vitin 2022”. Ky plan i përcaktuar në nivel DRT-je në muaj dhe sipas llojit të tatimit është dërguar në DRT përkatëse me shkresën nr. 2968 datë 24.03.2022 ku është cituar “bashkëlidhur po ju dërgojmë planin vjetor të të ardhurave të periudhës Janar – Prill 2022”.

Nga auditimi konstatohet se megjithëse i referohet planit vjetor, në drejtoritë rajonale tatimore është dërguar plani i të ardhurave tatimore vetëm për periudhën Janar-Prill 2022, duke mos përfshirë të gjithë periudhën vjetore. Procesi fillestar i detajimit të planit të të ardhurave tatimore për drejtoritë rajonale tatimore përkatëse nga ana e DPT konstatohet se ka zgjatur për një periudhë 3-mujore nga fillimi i vitit buxhetor dhe 2-mujore nga data e dërgimit të planit të të ardhurave tatimore në përgjegjësi të DPT nga MFE, megjithëse gjatë kësaj periudhe është miratuar Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2022, i cili ka ndryshuar një pjesë të të ardhurave tatimore. Efektet e këtij plani të ndryshuar të të ardhurave tatimore nuk janë reflektuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kohë. Mos reflektimi në kohë i efektit të të ardhurave të ndryshuara sipas këtij akti normativ, në planin e drejtorive rajonale tatimore është kushtëzuar edhe nga dërgimi me vonesë nga MFE i të ardhurave tatimore në përgjegjësi mbledhjeje të administratës tatimore sipas shkresës nr. 7088 prot. DPT datë 26.04.2022. Nga auditimi konstatohet se edhe pas kësaj shkrese të MFE nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk është reflektuar ndryshimi në të ardhura tatimore, deri në efektet e ndryshimeve me Aktin Normativ nr. 12 datë 11.08.2022, sipas shkresës nr. 13863/3 prot., datë 09.12.2022 drejtuar DRT-ve, duke e detajuar planin sipas DRT-ve përkatëse rreth 4 muaj pas daljes së aktit normativ. Nga auditimi konstatohet se edhe në këtë rast, megjithëse nga legjislativi ishte miratuar Akti Normativ nr. 17 datë 01.12.2022 me efekte në ndryshimin e të ardhurave tatimore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është shpërndarë pas daljes së këtij akti në drejtoritë rajonale tatimore, efekti në planin e të ardhurave i Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022.

Me shkresën nr. 21811 prot., DPT datë 29.12.2022 është dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit normativ nr. 17 datë 01.12.2022. Pra plani i të ardhurave është dërguar me rreth një muaj vonesë nga akti normativ për ndryshimin e të ardhurave dhe vetëm dy ditë përpara mbylljes së vitit buxhetor, duke bërë të pamundur reflektimin e veprimeve operacionale për zbatimin e tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga ana e DPT me shkresën nr. 21811/1 datë 04.01.2023 i është kërkuar MFE-së detajimi i planit të të ardhurave të ndryshuar për vitin 2022 për zërin Taksa Nacionale e të tjera, plan i

cili rezulton i pa detajuar edhe në vijim të kërkesës nr. 13863/1 datë 18.08.2022 nga DPT pas ndryshimit të të ardhurave sipas Aktit Normativ nr. 12 datë 11.08.2022. Konstatohet se në muajin Janar të vitit 2023, kohë në të cilën mundësitë për realizimin e të ardhurave tatimore janë ezauruar plotësisht, nuk janë qartësuar ende çështje që lidhen me planin e të ardhurave tatimore për vitin e mbyllur buxhetor 2022. Nga DPT, me shkresën nr. 21811/4 prot., datë 16.01.2023 është dërguar në drejtoritë rajonale tatimore për vitin 2022 plani i të ardhurave të ndryshuara sipas Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, i cili përfaqëson planin përfundimtar të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të miratohet rregullore/udhëzues në lidhje me afatet dhe procedurat për detajimin e planit të dërguar nga MFE drejt Drejtorive Rajonale Tatimore në mënyrë që të ndërmerren veprimet operacionale në kohë për mbledhjen e tyre, duke rritur kështu performancën institucionale dhe evidentimin e përgjegjësive të zyrtarëve publikë.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2022, të ardhurat tatimore janë programuar 193.0 miliard lekë dhe janë realizuar 189.6 miliard lekë, me një mosrealizim prej 3.4 miliard lekë ose 1.8% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën të ardhurat u realizuan 168.7 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 20.9 miliard lekë ose 12.4 % më shumë. Nga auditimi konstatohet se të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në shumën 183,9 miliard lekë dhe diferenca me raportimin e DPT qëndron në faktin se janë përfshirë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në të ardhura tatimore. Efekti i këtyre të ardhurave të përkohshme me normë të reduktuar tatimore nga rivlerësimi sipas akt rakordimeve të degëve të thesarit në rrethe me DRT dhe drejtoritë vendore të ASHK si dhe përmbledhëses së vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar raportohet në shumën 5.6 miliard lekë ose rreth 2% e të ardhurave. Në krahasim me planin përfundimtar prej 193 miliard lekë, efekti i mos realizimit paraqitet në shumën 9 miliard lekë, megjithëse në raport me një vit më parë të ardhurat janë realizuar 15.2 miliard lekë më tepër. Në terma neto, të ardhurat janë realizuar në shumën 161.5 miliard lekë, përkundëjt planit prej 174.5 miliard lekë, me një mos realizim në shumën 13 miliard lekë e ndikuar nga tejkalimi i rimbursimeve të kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar më tepër se plani për rreth 4 miliard lekë. Të analizuara sipas llojit të tatimeve, me përjashtim të tatimit mbi fitimin, problematika paraqiten në drejtim të mos realizimit me ndikim më të madh nga taksat nacionale dhe taksa e qarkullimit rrugor.

- Nga auditimi mbi performancën e arkëtimit të taksave dhe tarifave kombëtare konstatohet se mosrealizimi prej 5.2 miliard lekë ka ardhur në pjesën më të madhe si pasojë e mos realizimit të taksës nacionale të karbonit (për benzinën, benzolin dhe gazoilin) si dhe taksës nacionale për ambalazhet plastike, me efekt në total prej rreth 3 miliard lekë. Efekt tjetër negativ në mos realizim paraqesin edhe taksa mbi primet e shkruara për policat e sigurimit, taksa e rentës minerare, si dhe taksa për automjetet e përdorura të transportit rrugor, me efekt në total prej 1.5 miliard lekë.

- Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 23.4 miliard lekë, janë arkëtuar 18.2 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 5.2 miliard lekë ose 22.0% më pak.

Në konkluzion, mos realizimi më i madh në grupin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave kombëtare të raportuara në tabelën e treguesve fiskalë si një komponent i taksave nacionale dhe të tjera është shkaktuar nga mos realizimi i taksës së qarkullimit rrugor dhe taksës së karbonit, të cilat janë taksa të indeksuara me sasinë e konsumuar të produkteve dhe nënprodukteve të naftës. Sipas statistikave fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgjatë vitit 2022, importi i karburanteve të cilat janë subjekt i këtyre taksave në sasi ka rënë

në raport me një vit më parë. Ulja e konsumit të këtyre mallrave me peshë në të ardhurat buxhetore vlerësohet në 54,622 ton ose 9 % në raport me vitin 2021, të cilat në kuadër të taksave fikse të indeksuara mbi sasinë e aplikueshme, kanë sjellë një performancë jo të mirë me efekt në mos realizimin e të ardhurave të përgjithshme tatimore në përgjegjësi mbledhjeje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet riklasifikimi përkundrejt planit i të ardhurave dytësore në raportin e performancës, me qëllim ruajtjen e trendit historik të raportimeve, si dhe nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore të drejtojnë burimet e kontrollit në sektorët që janë objekt i taksave kombëtare të konstatuara me mosrealizim për shkak të rënies së konsiderueshme të të dhënave për sasinë e indeksuara me taksat kombëtare.

Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave tatimore, konstatohet se raportohen si të ardhura të realizuara për efekt të planit, gjopa të sistemit tatimor në shumën 706,686,752 lekë, me përjashtim të gjobave të tjera të cilat janë raportuar në dënimet administrative në shumën 122,837,286 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Llogaria 70 “Tatime dhe taksat”.

Përveç shumave të raportuara si më sipër, konstatohet se raportohen si e ardhur edhe gjobat e vendosura nga kontrollat e realizuara në tatimpagues, pasi elementët përbërës të tatimit të munguar si pasojë e rivlerësimeve tatimore përfshijnë detyrimin për tatimin dhe gjobën përkatëse. Një konkluzion i tillë arrihet pasi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin nuk janë raportuar në asnjë llogari analitike të të ardhurave gjopa, çka sjell raportim të gabuar të të ardhurave referuar kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018.

- Gjithashtu konstatohet se, në realizimin e të ardhurave tatimore janë raportuar për efekt realizimi parapagimet e bëra nga tatimpaguesit për tatime të ndryshme përgjatë vitit 2022, në total në shumën 34,473,704,161 lekë. Efekti më i madh i këtyre parapagimeve vlerësohet në deklaratimet për deklaratën e tatimit mbi fitimin në shumën 34,041,881,792 lekë. Konstatohet se përdorimi i kësaj llogarie për tatimet e tjera përveç tatimit mbi fitimin, për realizim të të ardhurave tatimore nuk është në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pasi nuk plotësohen kushtet për klasifikimin si të ardhur duke qenë se nuk lidhen me një pagesë pa kthim.

Për sa i përket parapagimeve për tatimin mbi fitimin, konstatohet se përdorimi i llogarisë 466 në momentin e arkëtimit sjell si pasojë nevojën për kryerjen e veprimeve rregulluese në periudhën paraardhëse me qëllim anulimin e efektit të përkohshëm të mbajtjes në ruajtje të mjeteve monetare për pagesa të kryera nga tatimpaguesit. Referuar pasqyrave financiare të konsoliduara dhe komponentit të drejtorisë së kontabilitetit konstatohet se teprica e llogarisë së parapagimeve rezulton për vitin 2022 në rreth 177 miliard lekë, me një rritje prej 34.4 miliard lekë nga viti 2021, ku teprica e llogarisë ishte në shumën 142.7 miliard lekë. Konstatohet se përdorimi i llogarisë 466 krijon detyrime për mjete në ruajtje në konsolidim sipas pasqyrave financiare të konsoliduara. Me raportimin e pagesës së kësteve të tatim fitimit në llogarinë e parapagimeve si veprimi i parë për njohjen në formën e të ardhurës si dhe me dorëzimin e deklaratave në mbyllje të vitit financiar (kontabilizimin e tyre në llogarinë 7001 “Tatimi mbi fitimin”) rezulton se nuk kryhet veprimi i anulimit të parapagimeve të cilat kalojnë në të ardhura dhe netimi i llogarive të kreditorëve të mjeteve në ruajtje.

Konstatohet se procesimi i transaksioneve financiare për pagesat të cilat kryhen për tatimin mbi fitimin, nuk kontabilizohen në llogarinë e të ardhurave sipas klasës 7 dhe në të njëjtën kohë praktika aktuale nuk bën netimin e llogarisë së parapagimeve me dorëzimin e deklaratës finale të tatimit mbi fitimin nga ana e tatimpaguesit.

Kjo procedurë kontabilizimi dhe mos kryerja e veprimeve rregulluese në lidhje me parapagimet për tatim fitimin sjellin raportim jo të saktë të të ardhurës së periudhës në lidhje me tatimin mbi fitimin dhe parapagimeve të lidhura me këtë tatim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet ripublikimi i treguesve të të ardhurave në raportin e performancës, duke hequr komponentin e gjobave nga realizimi dhe në të njëjtën kohë të bëhet në raportim ndarja e të ardhurave nga detyrimi kryesor dhe gjoba shoqërues e detyrimet për rivlerësimet tatimore të deklaratave në përfundim të kontrollit tatimor.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhen veprimet rregulluese në lidhje me depozitimet e përkohshme për deklaratën e tatim fitimin në momentin e dorëzimit të deklaratës së tatim fitimit nga ana e tatimpaguesve me qëllim shmangien e akumulimit të tepricës së pa stornuar të kësaj llogarie.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) rezultoi se gjatë vitit 2022 nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore. Sipas komunikimit me subjektin arsyeja që nuk është arritur kryerja e inspektimeve në DRT është se nuk ka pasur staf të mjaftueshëm. Konstatohet se mungesa e kryerjes së inspektimeve është në kundërshtim me Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Kreu 2.1.1 "Inspektimi", Nuk janë kontrolluar apo monitoruar rajonet nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale, nëse kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhornuar të debitorëve, nëse kanë ndjekur procedurat e përcaktuara për masat shtrënguese. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Nga titullari i DPT të analizohet situata e kësaj Drejtorie duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të merren masa për plotësimin e vendeve vakantë të drejtorisë DMDTP sipas strukturës së miratuar Urdhrit e Kryeministrit Nr. 33 datë 12.02.2020 "Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", së bashku me hartimin e miratimin e programeve të inspektimit në mënyrë që DMDTP të realizojë inspektime në të gjithë rajonet.

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,353,724,814 lekë, i cili paraqitet me ulje krahasuar me vitin paraardhës për vlerën 361,235,414 lekë. Situata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo të gjitha deklaratat tatimore ishin të informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin në ndjekje dhe administrim nga Administrata Tatimore si agjentë tatimorë.

Pjesën më të madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtorja e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,106,993,328 lekë i përket vetëm 1 tatimpaguesi, vlerë e cila sipas informacionit nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem. Diferenca tjetër përfaqëson detyrime të ndryshme të papaguara të akumuluar ndërsa vite për disa subjekte që nuk kanë qenë të regjistruar në sistem tatimor. Në zbatim të Urdhrit Nr.146, datë 14.10.2022, pranë DPT është ngritur grupi i punës për trajtimin

e problematikës së detyrimeve jashtë sistemit C@TS, i cili ka trajtuar problematikën në bashkëpunim me DRT.

Lista e debitorëve që nuk kanë gjeneralitetet e nevojshme (pa NIPT) për t'u hedhur në sistem përbëhet nga 762 subjekte me vlerë gjithsej 58,740,342 lekë. Këto subjekte janë të penalizuar nga inspektorët e verifikimit në terren nga viti 2005-2011 për mos regjistrim aktiviteti, për të cilët janë kontabilizuar jashtë sistemit dhe sigurime shoqërore gjë që ka sjellë mangësi në raportimin e të dhënave lidhur me debitorët për sa kohë një pjesë e tyre mbahen në sistem, dhe një pjesë jashtë sistemit. Gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes së mbledhjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: DPT të marrë masa për trajtimin e rasteve sipas problemeve të identifikuar nga grupi i punës në mënyrë që këto detyrimet tatimore të papaguara të trajtohen me procedurën e mbledhjes së borxhit tatimorë që të rritet mundësia e vjeljes së detyrimit jashtë sistemit C@TS.

Menjëherë e në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e detyrimeve tatimore gjithsej të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën rreth 134,934 milion lekë, që i përket një numri prej 192,701 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej rreth 182,379 subjektsh debitorë. Pra rezulton një rritje prej rreth 11.8 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me një ulje prej 10,322 debitorëve në fund të vitit. Subjektet me status Aktiv janë në numër 64,543 subjekte ose 37 % e total numrit të subjekteve debitorë, me vlerë detyrimi të papaguar afërsisht 40.7 miliard lekë ose 28 % e total detyrimit të papaguar. Subjektet me status Pasiv janë numër 110,948 subjekte ose 63 % mbi numrin gjithsej të subjekteve debitor, me vlerë detyrimi të papaguar 105.9 miliard lekë ose 72 % mbi total detyrimin e papaguar. Krahasuar me vitin e kaluar rezulton një rritje e subjekteve pasive në numër janë rritur afërsisht me 6 % dhe në vlerë janë rritur afërsisht 7 % e masës së detyrimit total të papaguar. Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2022 rezulton se peshën më të madhe të stokut të detyrimit e zënë detyrimet me moshë borxhi nga 2-5 vite me peshë 28 % të total detyrimit të papaguar dhe detyrimet me moshë borxhi mbi 5 vite zënë rreth 49% të total detyrimit të papaguar. Krahasuar me vitin paraardhës rezulton se borxhi me moshë 1-2 vjet është rritur me afërsisht 5 miliard lekë ose 4 % më shume mbi totalin e detyrimit dhe borxhi më moshë mbi 5 vite me 18 miliard lekë ose 10 % më shume mbi totalin e detyrimit, fashat e tjera të moshës së borxhit kanë një rritje me të vogël.

Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2022 janë 37 miliard lekë ose afërsisht 4 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2021, ku detyrimet e shtuara ishin 33 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 24 miliard lekë, krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 18 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 5 miliard lekë më shumë. Për sa i përket subjekteve në proces gjyqësor rezultojnë 1,391 subjekte me detyrim total 13 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2021 janë rreth 200 subjekte më pak me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuara në gjykatë prej rreth 1 miliard lekë më pak. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuara prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,135 subjekte, ndjekur nga DTM me rreth 2 miliard lekë për 90 subjekte. Për sa i përket stokut të detyrimeve tatimore të papaguara sipas rajoneve rezulton se rajoni Qendror ka peshën më të madhe të rritjes së detyrimeve të papaguara, afërsisht me 70 % të total detyrimit tatimorë të papaguar ose 8,272 milion lekë rritje. Rezulton se në rajonin Qendror afërsisht 30% të total detyrimit tatimorë të papaguar e zënë 6 subjekte me status pasiv me vlerë detyrimi 30.5 miliard lekë. Rritja e stokut të detyrimeve tatimore të papaguara e bën më të vështirë menaxhimin e detyrimit tatimor të papaguar në drejtim të reagimit sa më të shpejtë që

të jetë e mundur ndaj borxheve të reja, pasi ndërhyrja e hershme rrit gjasat për mbledhjen e borxhit tatimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masa të menjëhershme për uljen e borxhit tatimor si dhe të luajnë një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit. Të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar për uljen e borxhit tatimor si edhe duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Menjëherë e në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2022 nuk është mbledhur asnjëherë Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), strukturë kyçe e organizimit institucional për të diskutuar dhe marrë vendime mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore në lidhje me programet përkatëse, në shkelje të ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si edhe në mungesë të ushtrimit të përgjegjësive të NA në rolin e koordinatorit të GMS të përcaktuara në Udhëzimin nr.7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”. U konstatua se një projekt i programit ka ndryshuar në vlerë nga një fazë në tjetrën. Projekti i investimit me kod 18AV812 “Hapësira harduerikë kapacitetin e serverave”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2022-2024 dhe vlera e likuidimit për këtë projekt është planifikuar 80,000 mijë lekë, nga 382,965 mijë lekë e planifikuar në kontratë, pra 302,965 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA II. Gjithashtu një projekt me rëndësi të lartë me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” nuk është planifikuar në PBA 2022-2024. Sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mungesën e funksionimit të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues i DPT në cilësinë e koordinatorit të GMS të marrë masa për koordinimin, realizimin dhe monitorimin e procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet dhe objektivat e politikës së programit.

Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se janë shpenzuar 3,250,300 lekë më shumë se fondi i akorduar për t’u shpenzuar për kompensimin e shoqërive të transportit me VKM nr. 225, datë 13.04.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë” dhe VKM nr. 569, datë 25.08.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë faza II”. Janë kompensuar dy shoqëri transporti me vlerë totale 3,250,300 lekë, jo nga fondi i kaluar në llogarinë 604 me kod projekti 91004AE “Kompensim për shoqëritë e linjave të transportit” sipas përcaktimeve të VKM nr. 225, datë 13.04.2022 dhe VKM nr. 569, datë 25.08.2022. Në adresën elektronike të grupit të punës në DPT në datë 23.01.2023 është dërguar kërkesa për kompensim karburanti për këto shoqëri transporti së bashku me praktikën e plotë nga DRT Tiranë me justifikimin se kërkesat janë dërguar në DRT brenda afatit, por punonjësi përgjegjës ka qenë me leje dhe nuk u dërgua në afat kërkesa për kompensim në DPT. Grupi i punës në DPT në datë 25.01.2023 ka përcjellë në formë elektronike këtë kërkesë për kompensim pranë

Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në DPT. Konstatohet se me urdhër shpenzimi nr.1421, datë 30.12.2022 nga llogaria 6027900, aprovuar nga drejtoria rajonale e thesarit datë 26.01.2023 është kaluar fondi në vlerën 1,555,100 lekë në llogarinë e subjektit përfitues. Me urdhër shpenzimin nr. 1422, datë 30.12.2022 nga llogaria 6027900, aprovuar nga drejtoria rajonale e thesarit datë 26.01.2023 është kaluar fondi në vlerën 1,695,200 lekë në llogarinë e subjektit përfitues. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 569, datë 25.08.2022 kreu II pika 5 dhe kreu III pika 1 dhe Urdhrin nr.118, datë 12.09.2022 të Drejtorit të DPT, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi: Nga DPT të merren masa për përcaktimin e përgjegjësive për mungesën e reflektimit në kohë të kërkesave për kompensim në mënyrë që të gjithë pretendimet e subjekteve të referohen në kohë në drejtim të kërkesave buxhetore të rishikuara, duke marrë miratimin nga autoritetet përkatëse.

Menjëherë e në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2022 ka pasur ndryshim të prioriteteve dhe i vlerës në financimin e projekteve të investimit me kërkesë të AKSHI-t shkresa nr.1935 prot., datë 04.04.2022 për dy projekte, projekti me kod 18AV812 “*Hapësira harduer për kapacitetin e serverave*” është shtuar me 302,990 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA 2022-2024 dhe në ligjin e buxhetit 2022 që ishte planifikuar në vlerën 80,000 mijë lekë, pothuajse 5-fish më shumë. Listës së projekteve i është shtuar një projekt i ri investimi me kod 22AD801 “*Përmirësimi i sistemit E- taxation*” në vlerën 24,000 mijë lekë, i cili nuk ka qenë i planifikuar në programin afatmesëm buxhetor për vitin 2022 si edhe në buxhetin e vitit 2022. Për realizimin e këtyre projekteve janë shtuar fondet me Aktit Normativ Nr.17, datë 01.12.2022 dhe me Aktit Normativ Nr.12, datë 29.07.2022 dhe janë pakësuar në masën 100 % fondet e planifikuara në PBA dhe në buxhetin e vitit 2022 për projektet; “Automatizim dhe monitorim aktiviteti për inspektorët për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” (22,000 mijë lekë), “Marrje informacioni për inventarin e tatimpaguesve nga sistemi i administratës tatimore” (22,000 mijë lekë). Gjithashtu, ka pasur pakësim pjesor në vlerën 76,991 mijë lekë për projektet ; “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT”, “Rikonstruksion Drejtoria Rajonale tatimore Elbasan”, “Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020”, “Blerje pajisje zyre elektronike, kompjuterike” edhe projekti “Pajisje zyre”. Konstatohet se nga rishikimi i vlerave të projekteve, institucioni i DPT ekspozohet në marrjen e angazhimeve buxhetore përtej fondeve të miratuara konstatuar në projektin me kod 18AV812 “*Hapësira harduer për kapacitetin e serverave*”. Rezulton se deri më 20.10.2022 kur është lidhur kontrata nga AKSHI fonde të disponueshëm janë në vlerën 215,990 mijë lekë, afërsisht 167,000 mijë lekë më pak se vlera e kontratës, pra përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndarë për këtë projekt në buxhetin e miratuar për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi: Nga ana e DPT të mos pranohen projektet e rishikuara në vlerë nga AKSHI si pasojë e studimit të tregut përtej fondeve buxhetore të miratuara për projektet respektive.

Në të njëjtën kohë DPT të mos paraqesë projekte në fushën e teknologjisë së informacionit në kushtet e emergjencës, por të përmirësojë procedurën e planifikimit buxhetor afatmesëm nëpërmjet strukturave të GMS në bashkëpunim me përfaqësuesin e AKSHI-t.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Kanë rezultuar angazhime të reja buxhetore jashtë afatit 15 tetor të vitit buxhetor.

1. Kontrata nr.17086/7, datë 07.12.2022 “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Tatimeve Dibër” lidhur midis DPT me shoqërinë “2” SHPK me NIPT L.....L me vlerë totale 12,104,625 lekë, për vitin 2022 vlera është 8,070,153 dhe për vitin 2023 vlera 4,034,471 lekë.

Sipas të dhënave të dërguara në PBA 2022-2024 ky projekt është parashikuar të realizohet në vitin 2022 dhe fondi i planifikuar dhe i çelur sipas ligjit të buxhetit 2022 është 10,000 mijë lekë. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është lidhur pas datës 15 tetor vitit buxhetor për vitin 2022, si edhe kontrata e lidhur është afërsisht 2,104 mijë lekë mbi fondin buxhetor të parashikuar në ligjin e buxhetit për vitin 2022. Gjithashtu kontrata e lidhur është deri në vitin 2023, jashtë afatit të përcaktuar në PBA 2022-2024. Për vitin 2022 konstatohet se realizimi i projektit është 0 lekë.

2. Kontrata datë 10.11.2022 “Rikonstruksion i Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” lidhur me shoqërinë “O.” SHPK me NIPT K.....A me vlerë 19,989,511 lekë me kohë zbatimi dy muaj brenda afateve kohore të parashikuar në PBA 2022-2024 si edhe brenda tavanit të miratuar për këtë projekt.

3. Kontrata nr.30 prot., datë 20.10.2022 “Hapësira harduerik për kapacitetin e serverave“ në vlerën vlerë 425,353,716 lekë me afat lëvrimi 9 (nëntë) muaj. Konstatohet se ky angazhim buxhetor është marrë jashtë afatit të përcaktuar 15 tetor të vitit buxhetor.

4. Rikonstruksion Fier lidhur kontrata me datë 23.12.2022 në vlerën 54,995,410 lekë me afat 9 muaj, me grafik pagesë për vitin 2022 është 25,000 mijë lekë dhe për vitin 2023 me vlerë 29,995 mije lekë. Bazuar në PBA 2022-2024 ky projekt 18AV906 është planifikuar të përfundojë brenda vitit 2022 si edhe fondet në dispozicion për këtë projekt sipas buxhetit të vitit 2022 janë 30,000 mijë lekë. Konstatohet se kontrata është lidhur 24,995 mijë lekë më shumë se fondi në dispozicion si edhe me afat përfundimi në vitin 2023 jo në respektim të afatit të parashikuar në PBA 2022-2024.

Këto parregullsi të konstatuara për këtë projekt 18AV904 janë në referencë të Udhëzimi nr.9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 79-83 të cituar më lart. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Nga ana e DPT të përcaktohen përgjegjësitë për ndërmarrjen e angazhimeve të reja përtej afatit të përcaktuar në kuadrin rregullator dhe të merren masa për iniciimin e procedurave të prokurimit me detajimin e fondeve .

Menjëherë e në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Për 27 urdhër-shpenzimi nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës janë kryer likuidimet në tejkalim të afatit kohor 30 ditorë nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve “. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë, pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masa për përcaktimin e një rregulloreje të brendshme për disiplinimin e procesit të ekzekutimit të fondeve buxhetore në kohë dhe për konstatimet e faturave në fushën e teknologjisë së informacionit të reflektojë problematikën në marrëveshjet dhe procedurat në bashkëpunim me AKSHI.

Menjëherë e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Anëtar i komisionit të inventarit, ngritur me Urdhrin nr. 8408 prot., datë 19.05.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj” është njëkohësisht edhe përgjegjës material për Magazinën “Bileta transporti dhe Magazina Pulla, Taksa, Tarifa”, në shkëlqje më Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë publike”, pika 82.“

Komisioni i inventarizimit nuk ka vepruar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe nga titullari i njësisë

publike”, pika 83 se nuk është fiksuar numri i fletëve para kontrollit, para fillimit të inventarit.

- Nga auditimi u konstatua se për 12 raste punonjës të larguar nga puna nuk është kryer procedura e dorëzimit të detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13 dhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30.

Përgjatë vitit 2022 nuk është finalizuar procesi i kalimit të inventarit në zbatim të VKM nr. 673, date 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës së kalimit të asetëve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të softuerë-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim. Kjo situatë ka bërë që i gjithë procesi i kalimit kapital të mos konkludohet brenda vitit 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në DPT të marrin masa që të kryhet një proces i kujdesshëm i inventarit si edhe të merren masa për sistemimin e situatës për materialet e pa dorëzuara nga ish punonjësit, me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike.

Strukturat përgjegjëse në DPT dhe struktura përgjegjëse në AKSHI-t të marrin masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për kalimin e asetëve nga DPT tek AKSHI, me qëllim finalizimin sa më të shpejtë të këtij procesi.

Menjëherë e në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provizione për shpenzimet që mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t’u paguar nga ana e njësisë. Nevoja e parashikimit të provizionit në DPT lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, me vendime gjyqësore të tjera lidhur me tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se DPT për vitin 2022 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 433 milion leke nga të cilat janë për çështje tatimore në vlerën 296,432 mijë lekë dhe në vlerën 137,268 mijë lekë janë detyrimet e prapambetura të krijuara nga vendimet gjyqësore për ish punonjës. Krijimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet se vjen edhe nga mos llogaritja e detyrimit të mundshëm në formën e provizioneve për planifikimin e fondeve në kohë. Nga kërkesa për informacion mbi databasën e të dhënave të vendimeve gjyqësore drejtuar DPT u vendos në dispozicion vetëm lista e pasqyruar në llogarinë 486, çka e bën të pamundur vlerësimin e efektit të detyrimeve të mundshme nga vendimet gjyqësore për DPT nga ana e grupit të auditimit. Për këto arsye konstatohet mungesë koordinimi ndërmjet strukturave të ngarkuara me ndjekjen e vendimeve gjyqësore dhe atyre të ngarkuara me shlyerjen e vendimeve gjyqësore për përlllogaritjen e efekteve në shpenzimet e vendimeve gjyqësore në kohë me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Nga ana e titullarit të DPT-së të përcaktohen procedura konfirmuese mbi vendimet gjyqësore dhe efektin e prishëm të tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore me qëllim shmangien e efekteve negative për buxhetin e shtetit.

DPT t’i bëjë të ditur MFE që të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ku konkretisht Sektori i Kontabilitetit të kësaj drejtorie të marrë masat për shqyrtimin e situatës, në mënyrë që të përcaktohen edhe procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike në zbatim të kuadrit ligjor.

Menjëherë e në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 346 kontrolle nga 2579 kontrolle të planifikuara ose rreth 13% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut (DMR) nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës.

Megjithëse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale.

Konstatohet se për vitin 2022 DPT ka nxjerr vetëm planin operacional për turizmin, ndërkohë që duke ju referuar renditjes të aktiviteteve të cilët sipas rregullave të thyera të riskut të gjeneruar nga DMR zënë peshën më të madhe në përqindje, mungojnë plane operationale të tjera për këto veprimtari për gjatë vitit 2022, për disa nga aktivitetet me më shumë rregullatë riskut të thyera. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 90-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa që në aktivitetet e planifikimit për kontroll të reflektohet stoku i kontrolleve të mbartura nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me DRT të shkëmbejë në kohë informacion për problematikat e kontrolleve tatimore.

Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM me qëllim arritjen e objektivave të institucionit.

Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të hartojë strategji dhe plane operationale të dedikuara për secilin nga sektorët të evidentuar me risk të lartë si pasojë e rregullave të thyera të evidentuara nga moduli i menaxhimit të riskut.

Menjëherë e në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se jo në të gjitha rastet megjithëse në planin e punës është parashikuar kryerje e inventarit fizik, kjo nuk është reflektuar në urdhrat e punës të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT), si dhe aktiviteti operacional i drejtorisë nuk është kryer nëpërmjet programit e-inspektor. Nga auditimi konstatohet se programi “E-Inspektor” i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës, monitorimin e inspektorëve së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren dhe kryerjen e kontrollit, identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatueshme, është jashtë funksionit që prej datës 17.09.2021, datë në të cilën ka përfunduar kontrata. Referuar qëllimeve të implementimit të këtij programi që përfshijnë rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit në procesin e kryerjes së inspektimeve nga administrata tatimore, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit, konstatohet se nuk është vepruar në drejtim të rritjes së performancës së institucionit.

Konstatohet se për planin e punës me nr.20019 prot., datë 25.11.2022 janë përcaktuar drejtimet në të cilat do të operojnë grupet e kontrollit në terren, ku një nga pikat do të jetë edhe inventari me përzgjedhje gjatë kontrollit. Nga verifikimi i urdhrave të punës të dalë për këtë plan pune konstatohet se kjo pikë verifikimi jo në të gjitha rastet është përcaktuar në urdhër pune gjatë periudhës objekt auditimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 90-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për vendosjen në funksionim të Programit “E-Inspektor” i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren me qëllim rritjen e

transparencës dhe monitorimit në kryerjen e kontrolleve tatimore si dhe të reflektohen në urdhrat e punës, parashikimet e bëra për kontrolle të inventarit fizik sipas planeve të miratuara.

Menjëherë e në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer hartimi i planeve operacionale vjetore të punës në bazë 6-mujore dhe planeve strategjike afatgjatë për aktivitetin e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm, kjo në kundërshtim me Manualin e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) pika 2.3. “Funksionet kryesore të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm janë: Hartimi i planeve operacionale vjetore të punës në bazë 6-mujore dhe planeve strategjike afatgjatë për punën e investigimit të brendshëm; Përgatitja e raporteve përmbledhëse për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve mbi punën e bërë në baza gjashtëmujore dhe vjetore;”. Gjithashtu konstatohet se nuk është kryer raportimi vjetor me rezultatet e detajuara të punës për vitin paraardhës, kjo në kundërshtim me Manualin e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) pika 6.3.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 90-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion të hartohen dhe raportohen sipas frekuencës së kërkuar në manualin e punës, planet vjetore dhe strategjike si dhe të kryhet raportimi në kohë mbi rezultatet e punës.

Menjëherë e në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në një rast, është kryer kontrolli përtej afatit fillestar të miratuar, pa marrë në kohë miratimin për zgjatjen e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Kontrolli është realizuar nga data 23.05.2022 deri në 06.09.2022 në DRT Elbasan. Me memo-n nr. 8513/2, datë 04.08.2022 drejtuar Drejtorit të Kontrollit është kërkuar nga grupi i kontrollit zgjatja e afateve të kontrollit deri në datën 06.09.2022 lidhur nga problematikat e konstatuara deri në atë fazë, e cila është përcjellë nga drejtori i kontrollit për miratim në strukturën përkatëse. Kërkesa për shtyrje të kontrollit është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me shkresën nr. 8513/3, datë 15.09.2022. Konstatohet se miratimi i kërkesës për zgjatjen e afateve të kontrollit është miratuar pasi ka përfunduar kontrolli në DRT Elbasan. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 90-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për koordinimin dhe miratimin në kohë nga niveli i duhur hierarkik të aktivitetit monitorues në DRT.

Menjëherë e në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i kontrolleve të planifikuara për vitin 2022 është në masën 57.5 %, me një mosrealizim në masën 42.5 %. Ndikimin më të madh në mosrealizimin e planit të kontrolleve e kanë DRT Tiranë me 29.1 % kontrolle të realizuara, DRT Kukës me 31 % kontrolle të realizuara, DRT Sarandë me 57.6 % kontrolle të realizuara, DRT Fier me 57.7 % kontrolle të realizuara, DRT Elbasan me 60 % kontrolle të realizuara dhe DRT Korçë me 60.3% kontrolle të realizuara. Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2022 në lidhje me kontrollet e papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, stoku i kontrolleve vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84. Sipas të dhënave të paraqitura, gjendja e kontrolleve të pezulluara, të pafilluara ose në proces në vitin 2022 prej 1140 kontrolle është rritur në krahasim me vitin 2021 për 671 kontrolle, me një rritje të lartë të numrit të kontrolleve të pafilluara. Konstatohet se drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rakordon gjendjen e kontrolleve në fund të vitit për ta përdorur si referim lidhur me

planifikimet të cilat realizon për vitin pasardhës duke sjell vazhdimisht një numër të lartë të kontrolleve në proces ose të pafilluar në fund të vitit.

Nga krahasimi i rezultateve të kontrolleve tatimore në raport me një vit më parë, konstatohet se zbulimi është 1.232 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 3.261 mijë lekë, pra kemi rënie të konsiderueshme të zbulimit për kontroll me 62 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 90-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të implementohen procedura rakordimi me DRT me qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontrolleve sipas aktivitetit vjetor.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ngrihet grup pune për të analizuar shkaqet e performancës në rënie të zbulimeve nga kontrollet dhe të merren masa me qëllim përmirësimin e treguesve.

Menjëherë e në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar një vend vakant në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm (DAB), për një periudhë të gjatë kohore, me pasoja mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit të saj.

DAB gjatë vitit 2022 ka ndryshuar planin vjetor të auditimit të brendshëm, duke u bazuar në Nenin 12, shkronja “ç” të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin III “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm”, në pikën 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetorë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Ndryshimi është bërë me arsyetimin e shmangies së auditimit paralel duke qenë se në periudhën në fjalë këto drejtori kanë qenë në proces auditimi nga KLSH, ku është kryer anulimi i auditimeve për drejtoritë e Menaxhimit të Riskut në DPT, drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT; Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT; Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Verior; DRT Durrës; DRT Tiranë; DRT Vlorë; dhe DRT Shkodër.

Konstatohet se veprimet e sipërcituara kanë ardhur si pasojë e moskoordinimit të punës së titullarit të DAB, i cili ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, neni 25 “Marrëdhënia me Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Gjithashtu, rezulton se ndryshimi i Planit Vjetor të Auditimit nuk ka ndodhur sipas përcaktimeve të nenit 12 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe përcaktimeve të kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, por është miratuar vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, pa miratimin e strukturës përkatëse në MFE.

DAB nuk e ka arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor të ndryshuar. Nga auditimi mbi analizën e ngarkesës së punës të audituesve të DAB përgjatë vitit, konstatohet se nuk është planifikuar shpërndarje e drejtë të angazhimit të burimeve njerëzore si rezultat i planifikimit jo eficient, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesë të ulët të disa audituesve të tjerë. Kjo ka sjell si pasojë një numër të ulët të auditimeve të realizuara për vitin 2022 të cilat kanë çenuar mbarëvajtjen e punës në këtë drejtori me pasojë mos realizimin të planit të auditimeve për këtë periudhë.

Përsa i përket efektivitetit të punës audituese, konstatohet një rënie e gjetjeve si në numër edhe në vlerë ku nga krahasimi me vitin paraardhës nga 137 gjetje në vlerën 118,500mijë lekë, në vitin 2022 kanë rezultuar 26 gjetje në vlerën 7,600 mijë lekë.

Megjithëse në auditimet e ushtruara nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka pasur propozim për rikontroll, nuk janë marrë masa nga strukturat përgjegjëse për vazhdimin e procedurës për kryerjen e tyre në Drejtorinë Rajonale Tatimpaguesve të Mëdhenj, në kundërshtim me nenin 85, të ligjit 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë i ndryshuar” pika 2 dhe 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 201-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të merren masa për rakordimin e aktivitetit auditues që në fillim të vitit me qëllim shmangien e auditimeve paralele, për çdo ndryshim plani të merret miratimi nga strukturat përkatëse nga MFE, si dhe të vijohet me rikontrolle për tatimpaguesit e evidentuar me problematika nga auditimi në DTM. DAB të marrë masa për shpërndarje të drejtë të veprimtarisë audituese, sipas audituesve të brendshëm në dispozicion gjatë hartimit të planit vjetor të auditimit dhe programeve individuale të auditimit për çdo subjekt të audituar.

Menjëherë e në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik konstatohet se:

- Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë jashtë afateve të përcaktuara Urdhrin për caktimin e personave përgjegjës për prokurim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, “Personi përgjegjës për prokurim dhe njësia e prokurimit”, pika 1 “Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/at përgjegjës për prokurim...”, pasi urdhri nr. 7592/2 prot., për caktimin e personave përgjegjës për prokurim është nxjerrë datë 20.05.2022.

- Referuar VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4 “Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit”, pika 2, “Autoriteti, çdo 4 muaj por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator, 10 janar të çdo viti dorëzon në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara”, ky informacioni është dërguar jashtë afateve të përcaktuara, respektivisht informacioni është dërguar në datë 26.05.2022 për 4 mujorin, në datë 13.09.2022 për 8 mujorin, dhe në datë 07.02.2023 për 12 mujorin e vitit 2022.

-Në një rast, data dhe ora e zhvillimit të procedurës nuk është përcaktuar në Ftesën për Ofertë në procedurën e mirëmbajtjes ndërtimore për DPT, në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 21, pika 2, “Ftesa për ofertë përfshin të paktën informacion...vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 190-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandime: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për kryerjen e procedurave të kërkuara nga aktet ligjore në fushën e prokurimit publik me fillimin e vitit buxhetor duke caktuar njësinë e prokurimit në kohë, me qëllim fillimin dhe përfundimin e procedurave të prokurimit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator përkatës.

Menjëherë e në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga ana e DPT janë dërguar elektronikisht 1,416,276 listë-pagesa në ISSH për vitin 2022, me një diferencë prej 43,998 listë-pagesa nga totali. Për sa më sipër, konstatohet se mungesa e transferimit të listë-pagesave në ISSH është bërë në kundërshtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 1422, datë 19.05.2017 dhe nr. 4473/1, datë 23.05.2017, me efekt mospasqyrimi në kohë, të kontributeve të deklaruara e të paguara. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, si dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1422, datë 19.05.2017 dhe nr. 4473/1, datë 23.05.2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 73-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: DPT të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës të marrë masa për dërgimin në ISSH, së të gjithë listë-pagesave të kontributeve të deklaruara e të paguara.

Menjëherë e në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: -Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka filluar t'i shpallë pozicionet vakante për punonjësit me status nëpunësi civil në ATQ, në muajin qershor të vitit 2022. Nga 135 pozicione vakante janë plotësuar vetëm 41 prej tyre, ose 30.4%. Si rezultat i vakancave të punonjësve me status të nëpunësit civil, DPT ka funksionuar me 81.6% të kapaciteteve të saj gjatë vitit 2022.

-Përgjatë vitit 2022, DBNJ ka ushtruar veprimtarinë e saj pa drejtues të nivelit të lartë, pasi me shkresën nr. 2299/1 prot, datë 15.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë transferimi i përkohshëm, i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT Tiranë. Gjithashtu edhe pozicioni i zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve, i cili ka në varësi DBNJ, ka qenë vakant. Kjo drejtori ka qëndruar pa drejtues të nivelit të lartë për 1 vit.

-Gjatë vitit 2022, nuk është kryer asnjë emërim i punonjësve me Kod Pune, nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 9 "Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve", pika nr. 1, 5 dhe 6/a, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

- Nga auditimi u konstatua se, në një rast ka pasur lëvizje të shpeshta brenda vitit të punonjësit në pozicionin e protokollistit nga një drejtori në tjetrën, në dosjen personale të së cilës nuk ishte arkivuar asnjë dokument ku të vërtetonte arsyet që kanë sjellë këto transferime të shpeshta.

- Nga auditimi u konstatua se, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk ka përgatitur dhe për pasojë as zbatuar strategjinë menaxhuese dhe planet operationale për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim për punonjësit, marrëdhënia e të cilëve rregullohet me Kodin e Punës, sipas vendeve të lira të krijuara, në bashkëpunim me zv. Drejtorin e Përgjithshëm, në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 4, neni 72 të "Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore".-(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 170-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil, në zbatim të urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit; rekrutimet e emërimet në ATQ, të kryhen nëpërmjet konkurrimit të hapur, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Menjëherë e në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kërkesave të posaçme në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, u konstatua se, për të njëjtin pozicion, kërkesat e arsimit dhe përvojës në punë ishin të ndryshme. Një Inspektor ka si kriter pasjen e diplomës të nivelit "Master Shkencor", si dhe me përvojë jo më pak se 2 vite në profesion, ndërsa një Inspektor tjetër, ka si kriter pasjen e diplomës "Master Profesional" dhe pa përvojë pune në profesion.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua diferencim të kërkesave të posaçme, për arsim dhe përvojë pune, në pozicionin Inspektor, me kategori page të njëjtë, III-b, në DPT. Për pozicionin Inspektor, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kërkohet diplomë "Master Shkencor" në shkenca Ekonomi/Juridik dhe përvojë jo më pak se 2 vite punë në profesion, ndërsa në Sektorin e Koordinimit po në këtë drejtori, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kërkohet diplomë "Bachelor" në shkenca Ekonomi/Juridik dhe pa përvojë pune në profesion.

Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, në Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës me strukturë (1+11), u konstatuan, me pozicionin Inspektor i Parë, kategori page III-

b, 6 prej tyre kanë si kriter arsimor pasjen e diplomës “Master Shkencor” dhe 5 me diplomë “Master Profesional”. Këto trajtime të punonjësve nuk janë në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 9, pika nr. 5 dhe 6/a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 170-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kritereve të posaçme për pozicionin e inspektorit në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kur detyrat funksionale janë të njëjta, me qëllim rritjen e performancës individuale dhe institucionale në këtë fushë.

Menjëherë e në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: -Për rregullshmërinë e administrimit të dokumentave të nevojshme në dosjet e personelit të ATQ, u audituan 25 dosje të punonjësve që janë emëruar rishtaz si dhe të atyre që janë rikthyer në ATQ, ku u konstatua se në 7 dosje, kishte mungesa në dokumentacionin e nevojshëm si: vërtetim gjykate, kopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuar, cv, kopje të kartës së identitetit, raport mjeko-ligjor, si dhe autorizim për parandalimin e konfliktit të interesit të punonjësve.

-Nga auditimi u konstatua se, në një rast DBNJ administron më shumë se një dosje personale të punonjësve të ATQ, megjithëse dokumentet e nevojshme që përmbajnë informacionet personale të punonjësve, duhet të arkivohen në një dosje të vetme, pavarësisht pozicioneve të mbajtura nga ta. Vepime të cilat janë në kundërshtim me ligjin “Për arkivat” dhe pikën nr. 4 dhe 5, kapitulli nr. II, “Dosja e personelit” e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 170-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj strukturave përgjegjëse për mosplotësim të dosjeve të personelit, si dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore në DPT dhe Sektorët e Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Rajonale, të marrin masa për plotësimin dhe përditësimin e të gjitha dosjeve të punonjësve, me dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë e në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, rezultoi se GMS nuk është mbledhur në asnjë takim gjatë vitit 2022. Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të miratuara nga MFE, si dhe nuk rezulton arkivimi i tyre. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

-Institucioni nuk disponon Manualin e Proceseve të Punës. Ai përshkruan të gjitha proceset e punës në institucion duke lejuar identifikimin e dobësive, si mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës.

-Nga auditimi u konstatua se, në disa rubrika të plotësimit të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, për periudhën në auditim 01.01.2022 – 31.12.2022, përgjigjet janë dhënë për periudhën 2019-2021.

-Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet periodike 4 dhe 8 mujore të monitorimit buxhetor, si dhe raporti 12 mujor, nuk janë publikuar në faqen e web-it të Institucionit ose të MFE-së, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; dhe pikën nr. 271, Kreu VI, “Raportet e monitorimit”, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të MFE.

-Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon një regjistër të aktiveve, në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë.

27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 201-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për kryerjen e mbledhjeve të GMS me pjesëmarrjen e nivelit drejtues të njësisë, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga veprimtaria e Komisionit të Posaçëm në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, u konstatua se, në 2 raste të trajtuara gjatë vitit 2022, nuk është mbledhur nga kryetari, brenda 2 ditë pune nga depozitimi i kërkesës me shkrim të kreditorit, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

-Me shkresën nr. 5236 prot, datë 05.04.2022, Sektori i Rekrutimit dhe i Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore i ka dhënë informacion Komisionit, praktikën e ish-punonjësës të diplomuar në degën Financë, niveli DIND, ish-nëpunëse në pozicionin Drejtor Drejtorie e Kontrollit Tatimor në DRT Korçë. Vendimi nr. 89, datë 04.03.2022, i Gjykatës Administrative të Apelit ka detyruar palën debitore DPT, për rikthimin në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të ngjashëm me të. Nga verifikimi i kryer nga DBNJ, pozicioni Drejtor Drejtorie në Kontrollit Tatimor në DRT Korçë është vakant, si dhe punonjësi gjyqfitues nuk është e punësuar në subjekt tjetër.

Nga auditimi u konstatua se, Komisioni i Posaçëm nuk ka marrë asnjë vendim për rikthimin e e punonjësit në pozicionin e mëparshëm, sipas vendimit të Gjykatës, duke qenë se ai pozicion rezulton vakant. Mosveprimi për rikthimin në punë të punonjësve shkakton një kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit duke qenë se për të njëjtin pozicion pune paguhen dy individë ose më shumë punonjës. Veprimi është në kundërshtim me pikën nr. 2 dhe 3, kreu IV, i urdhrin nr. 5151/2015. “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 170-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, edhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm, të marrë masa me sistemin e gjyqfituesve në kushtet e vakancave në strukturë, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhetin e shtetit.

Brenda datës 31.12.2023

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi -Gjatë vitit 2022, nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish-punonjës të larguar nga puna në mënyrë të padrejtë, në vlerën **77,667,121 lekë**. Kjo vlerë cilësohet si efekt negativ për buxhetin e shtetit, pasi për të njëjtin pozicion pune, paguhen 2 persona, ish-punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i emëruar rishtaz në administratën tatimore. Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja ndaj përmbauesve, në vlerën 7,955,809 lekë, nga të cilat janë paguar **7,208,415 lekë**, kjo vlerë është kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Në fund të vitit 2022, vlera e detyrimeve të prapambetura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish-punonjësit e administratës tatimore është **137,268,674 lekë**, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Institucionit dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Veprime në kundërshtim me pikën nr. 60, të

udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 170-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore.

Brenda datës 31.12.2023

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", gjerat "b", "c" dhe "ç"; bazuar në nenin 57, 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore nga "Vërejtje" deri "Largim nga shërbimi civil", për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

C.2. Për punonjësit marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna" për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar

V. ANEKSE.

V.1. Struktura

V.2. Rimbursimi i TVSH-së

V.3 Aneksi 3 për rimbursimet e DRT-ve

Për sa më lart paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

